

# RAMAZANI, një vështrim në të gjitha dimensionet e tij


Antologji dhe ese mbi  
agjërimin dhe Ramazanin

GRUP AUTORËSH

  
Literatura  
**ISLAME**

# Ramazani, një vështrim në të gjitha dimensionet e tij

Antologji dhe ese mbi agjërimin dhe Ramazanin



Titulli:

Ramazani në të gjitha dimensionet e tij

Ese mbi agjërimin dhe Ramazanin

Autor: Grup autorësh & literaturaislame.com

Përgatiti: literaturaislame.com

Boton: literaturaislame.com

**AUTORËT:**

**Hafidh Ibn Rexheb Hanbeli**

**Imam Ibën Kethir**

**Shejh Muhammed Nasirud-din Albani**

**Salih bin Fevzan Fevzani**

**Nasir El-Ahmed**

**Abdul-Aziz Raxhihi**

**Imadudin Kenani**

**Muhammed bin Ibrahim Elmukajed**

**Selman bin Fahd el-Audah**

**Dr. Abdul-Kerim Bekar,**

**Falih ibën Muhamed ibën Falih Es-Sugaj-jir.**

**Xhasim Mutava**

**Dr. Omer Suud El-Id**

**Ibrahim ibn Muhammed ibn Hukajl**

**Muhammed Abdullah Draz**

**Dr. Lutfullah Abdul-Adhim Hoxha**

**Muhamed ibn Ibrahim El-Hamed**

**Dr. Nuha Katruxhi**

**Fejsal ibën Ali El-Budani**

**alminbar.net**

## Përmbajtja

Hyrje.....	8
Të mirat e agjërimit.....	11
Urtësi dhe sekrete të agjërimit .....	20
Përfitimet psikologjike të agjërimit dhe mësimet islame .....	31
Lidhshmëria e agjërimit me devotshmërinë .....	34
Mësime pedagogjike nga ajetet kuranore mbi agjërimin.....	45
Disa rregulla për muajin Shaban, muaji paraprijës i Ramazanit i cili mundëson suksesin në Ramazan.....	52
Mikpritja e Ramazanit.....	58
Urdhri për të agjëruar .....	67
Agjërimi i Ramazanit – një pasqyrë koncize, çfarë duhet t’i bëhet me dije çdo muslimani, çdo agjëruesi.....	71
Agjërimi i Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në Ramazan .....	75
Vlera e leximit të Kuranit dhe sjellja e selefit ndaj Kuranit.....	84
Porosi të vlefshme për muajin Ramazan.....	97
Vëllai im dhe motra ime, çfarë keni përgatitur për Ramazan? .....	105
Zmadhimi i mëkatit në Ramazan .....	115
Çka e plotëson agjërimin?.....	123
Bujaria në Ramazan.....	131
Sadakaja dhe Ramazani .....	132
Ramazani muaji i durimit.....	134

Ramazani: Një përkujtues i bashkimit të muslimanëve.....	143
Ndikimi i agjërimit në fitimin e krenarisë .....	147
Itikafi .....	154
Nata e Kadrit.....	158
Bereqetet e Natës së Kadrit.....	165
Zekati i Fitrit, Sadakatul-Fitr, fitrat e ramazanit. ....	171
Ramazani dhe mërzia nga shtegtimi i tij.....	174
Listë kontrolli - Çka përfituam nga Ramazani.....	182
Rregullat e Bajrameve.....	198
Bajrami i Fitrit - përgatitja për festën, namazi i bajramit, disa gabime gjatë festës dhe çka pas festës? .....	218
Le të gëzohemi për bajram! .....	222
Bajrami dhe kuptimi shumë-dimenzional i tij.....	225
Festat Islame qëllimet dhe rregullat e tyre.....	230
Pas muajit të Ramazanit .....	234
Ramazani mundësia e artë për ripërtëritje .....	239
Ramazani, shtegu i garave ku garojnë të mirët.....	243
Veprat e mira që mund të bëhen gjatë Ramazanit .....	248
Pesë ide për ndryshim familjar në Ramazan.....	257
Program ditor për gruan muslimane në Ramazan.....	260
Ramazani sfidon globalizmin dhe post-modernizmin .....	271
Muslimanët e parë gjatë muajit të ramazanit.....	278

Agjërimi i Ramazanit, simboli që i mbijetoi komunizmit dhe modernizmit, duhet të kalojë nga adeti në adhurim me qëllim, me efekte jetëgjata.....	283
Ramazani mes realitetit dhe obligimit.....	285
DY: SHËRIMI.....	294
Merre shpërblimin e agjërimin dy herë!.....	296
Disa gabime të agjëruësve dhe agjëruësve.....	299
Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Shevval.....	310
Si të fitojmë sevape e të shlyejmë mëkatet.....	317



## Hyrje

"Ramazani, një vështrim në të gjitha dimensionet e tij" është një antologji e gjerë që bashkon një koleksion mbresëlënës trajtesash, nga dijetarë klasikë dhe bashkëkohorë, për të ofruar një kuptim të shumë-anshëm të muajit të madhërishtë të Ramazanit. Ky libër do t'i ndihmojë lexuesit në udhëtimin e tij shpirtëror, ky do t'i shpijë ata në dimensionet e ndryshme të këtij muaji të bekuar, duke përfshirë historikun në një perspektivë të pasur, rëndësinë e thellë shpirtërore dhe aspektet praktike të agjërimit dhe adhurimeve që veçohen gjatë këtij muaji.

Libri përmban kontribute të vlefshme nga studiues të shumtë, dijetar dhe mendimtarë të nderuar nga periudha të ndryshme kohore, duke ofruar një eksplorim gjithëpërfshirës të Ramazanit, të mësimave të tij dhe praktikave të tij të cilat janë të shumta. Me një theks të veçantë janë sjellë mësimet thelbësore autentike të Islamit. Kjo antologji paraqet një perspektivë të plotë dhe të thelluar të Ramazanit, duke e bërë atë një burim thelbësor për muslimanët dhe jomuslimanët njësoj, për atë që agjëron për herë të parë apo për atë që dëshiron vërtetë të gjejë kuptimet e plota të Ramazanit, qëllimet dhe urtësitë e shumta të fshehura prapa tij, dhe të përfitojë maksimumin e dobive si në nivel individual por edhe shoqërorë. Pra një libër adekuat për gjithë secilin që kërkon të vlerësojë dhe kuptojë rëndësinë e kësaj kohe të dalluar në çdo aspekt.

Sa më shumë që zhytemi në këtë antologji, do të zbulojmë urtësinë, mësimet e Profetit [paqja qoftë mbi të], përvojat e muslimanëve të parë që kishin me Ramazanin dhe njohuritë e sjella nga studiuesit bashkëkohorë. Cep më cep, libri ju bartë nga të kuptuarit e përfitimeve psikologjike të agjërimit dhe lidhjes ndërmjet agjërimit dhe devotshmërisë, deri tek të mësuarit për rëndësinë e Natës së Kadrit dhe rëndësinë e unitetit mes muslimanëve gjatë kësaj kohe, ky libër

synon të frymëzojë dhe udhëzojë lexuesit për të shfrytëzuar sa më shumë nga këto tema të këtij muaj të bekuar.

"Ramazani, një vështrim në të gjitha dimensionet e tij" është një përpjekje që ofron një eksplorim shterues të temave të lidhura me Ramazanin. Ky libër voluminoz bashkon urtësinë e studiuesve klasikë dhe modernë në një shqyrtim gjithëpërfshirës të muajit të shenjtë të Ramazanit, ku në thellësi të tij janë përfshirë edhe përfitimet dhe urtësitë e agjërimit, mësimet pedagogjike të nxjerra nga vargjet kuranore mbi agjërimin, dhe aspektet praktike të mikpritjes së Ramazanit dhe përgatitjes për Fitër Bajramin. Për më tepër, lexuesit do të gjejnë udhëzime për rëndësinë e leximit të Kuranit gjatë kësaj kohe, si dhe pse pesha dhe dënimet e mëkateve janë të zmadhuara në këtë muaj, e në anën tjetër i kuptojmë bekimet e Natës së Kadrit dhe rëndësinë e Zekatit të Fitrit.

Libri gjithashtu trajton ndikimin e Ramazanit në sfidimin e globalizmit, post-modernizmit dhe ideologjive të tjera bashkëkohore, duke theksuar rëndësinë e tij në botën e sotme edhe në faktorë sociologjik. Për më tepër, ai ofron këshilla dhe udhëzime praktike edhe për familjet, gratë muslimane dhe ato që kërkojnë të përmirësojnë mirëqenien e tyre shpirtërore gjatë kësaj kohe.

Përveç sa u tha më sipër libri fokuson gjithashtu edhe sfidat me të cilat përballemi gjatë Ramazanit, të tilla si shmangia e gabimeve të zakonshme në agjërim, trajtimi i mërzisë shpirtërore dhe emocionale dhe ruajtja e efekteve pozitive të Ramazanit përtej vetë muajit. Libri përfundon me reflektime mbi festat islame, objektivat dhe rregullat e tyre, si dhe këshilla për agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Sheval dhe rëndësinë e vazhdimit të veprave të mira dhe shlyerjes së mëkateve.

Në thelb, "Ramazani, një vështrim në të gjitha dimensionet e tij" shërben si një burim i paçmuar për ata që kërkojnë të thellojnë kuptimin e tyre për muajin e shenjtë të Ramazanit. Me temat e gjera dhe perspektivën e një numri të madh të

dijetarëve, kjo antologji nxit një vlerësim për shtresat dhe nuancat e shumta të Ramazanit dhe frymëzon lexuesit që të shfrytëzojnë këtë mundësi të artë për rinovim shpirtëror, devotshmëri, rritje dhe vetë-përmirësim në çdo drejtim.

Libri është antologji dhe ndodhë që disa gjëra të përsëriten, ky format i librit e lejon këtë përsëritje dhe ne nuk i kemi shmangur këto qëllimisht, përsëritja ndihmon që disa gjëra të nguliten përjetësisht në mendjet tona dhe zbatimi i tyre do të na bëhet i lehtë ashtu siç na lehtësohet edhe mësimi i këtyre argumenteve dhe të angazhohemi që këto tua mësojmë edhe të tjerëve.

Ju urojmë lexim të këndshëm dhe dobi të shumta prej tij, për çfarëdo sugjerimi apo vërejtje, ju lutem na shkruani që versioni i radhës të jetë më i plotë dhe më i pa gabime.

Lusim Zotin që këtë vepër ta pranoj prej neve dhe të na shpërblej për të mirat dhe dobitë në të si dhe të na falë për gabimet dhe lëshimet eventuale!

Ju urojmë një Ramazan produktiv e të dobishëm si asnjëherë më parë!

## Të mirat e agjërimit

Transmeton Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij. Një e mirë shpërblehet sa dhjetë sosh dhe deri në shtatëqind herë shumëfishohet shpërblimi, e Zoti ka thënë: “Përpos agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, për shkak se njeriu e braktisë ushqimin për Mua, e braktisë pijen për Mua, i braktisë të këndshmet për Mua, e braktisë gruan e tij për Mua. Era e keqe e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu se aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: njëri gëzim kur të hajë iftar dhe tjetri kur ta takojë Zotin e vet”. (Buhariu dhe Muslimi).

### Agjërimi dhe shumëfishimi i shpërblimit

Allahu [subhanehu ve teala] ka dalluar agjërimin nga veprat të cilat shpërblehen shumëfish, kështu që të gjitha veprat shpërblehen nga dhjetë deri në shtatëqind fish, përveç agjërimit, shpërblimi i të cilit nuk përkufizohet në këtë numër, por Allahu e shumëfishon pa numërim, sepse agjërimi është pjesë e sabrit, kurse Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“...ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”. (Ez-Zumer: 10).

Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka emërtuar muajin e agjërimit si muaj të durimit në shumë hadithe të tija.

Kurse durimi është tre llojesh:

- durim në respekt ndaj Allahut [subhanehu ve teala];
- durim në largim nga harami, dhe
- durim në caktimet e dhimbshme të Allahut [subhanehu ve teala].

Të gjitha këto lloje mblidhen në agjërim, sepse në këtë ibadet ka durim në respekt ndaj Allahut, durim në largim nga gjërat të cilat ia ka bërë haram në këtë muaj dhe durim në etjen dhe urinë që e kaplon agjëruesin gjatë këtij muajit, dobësia e epshit dhe trupit në këtë muaj, dhimbje e cila vjen nga ky ibadet dhe për të cilin Allahu [subhanehu ve teala] do të shpërblejë.

Dije se shumëfishimi i shpërblimit për veprat e mira ndodh me shkaqe. Prej këtyre shkaqeve janë edhe këto:

1- Pozita e vendit në të cilin bëhet ai ibadet, siç janë haremet. Për këtë në këto vende vlera e namazit shumëfishohet. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Namazi në xhaminë time vlen sa një mijë namaze në xhamitë tjera përveç xhamisë së Haramit”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Pozita e kohës, siç është muaji i Ramazanit ose dhjetë ditët e Dhil-Hixhxes. Për këto ditë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Në asnjë ditë veprat e mira nuk janë të dashura te Allahu si në këto dhjetë ditë. I thanë: o i Dërguari i Allahut: as xhihad në rrugë të Tij? Tha: as xhihad në rrugë të Tij, në përjashtim të njeriut i cili del në xhihad me vetveten dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë”. (Buhariu).

Pasi që vet agjërimi dallon për nga shpërblimi nga muajt tjerë, atëherë, agjërimi i muajit të Ramazanit dallon nga agjërimi i ditëve tjera, edhe atë për shkak të pozitës së kohës dhe të vet ibadetit, pasi që është një shtyllë mbi të cilin ngritet Islami.

Pse Allahu e ka veçuar këtë muaj duke ia caktuar vetvetes për dallim nga veprat tjera?

Allahu [subhanehu ve teala] e ka veçuar agjërimin më përvetësim duke thënë: “Përpos agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të...”. në këtë drejtim dijetarët kanë dhënë komentime të ndryshme, mirëpo më të dalluarat janë këto:

1- Agjërimi është lënie e epsheve dhe kënaqësive të cilat janë në natyrën e njeriut, të cilat janë të krijuara të anojnë kah Allahu. Kësi iabdeti tjetër, përveç agjërimit, nuk ka. Gjatë ihramit largohet njeriu nga kontakti seksual dhe gjërat që ta përkujtojnë siç është parfymi dhe gjërat tjera, mirëpo nuk duhet të largohesh nga ushqimi dhe pija. E njëjta vlen edhe për itikafin. Po, edhe në namaz njeriu largohet nga të gjitha epshet, mirëpo koha është shumë e shkurtë, kështu që namazliu nuk e heton mos-ngrënien dhe mos-pirjen gjatë namazit, bile është ndaluar të falet nëse ka nevojë për ushqim, i cili është i pranishëm, gjersa të hajë dhe ta qetësojë këtë nevojë. Andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka urdhëruar t’i jipet përparësi darkës para jacisë. Për dallim nga agjërimi i cili e kaplon tërë ditën. Agjëruesi e heton nevojën për këto epshe dhe për këto gjëra, sidomos gjatë ditës së nxehtë të verës, për shkak të nxehtësisë dhe për shkak të gjatësisë së ditës. Andaj është përmendur se prej veçorive të imanit është agjërimi gjatë verës.

Për këtë, kur i shtohet njeriut nevoja për një gjë, të cilën ka mundësi që ta arrijë dhe e lë për hir të Allahut [subhanehu ve teala], në momente dhe vende në të cilat nuk e sheh askush përveç Allahut [subhanehu ve teala], kjo gjë është argument i vërtetësisë së imanit. Kjo tregon se agjëruesi e di se ka Zot, i Cili e sheh edhe kur është vet. E di se Ai ia ka ndaluar disa gjëra edhe pse epshi i tij, sipas natyrës, anon kah to, dhe e respekton Zotin e vet, e zbaton urdhrin e Tij dhe largohet nga ndalesat e Tij, prej frikës së dënimit të Tij dhe nga shpresa në shpërblimin e Tij, dhe e falënderon Atë për këtë gjë. Kjo është shkak i pse Allahu këtë vepër e ka dalluar nga veprat tjera dhe e ka bërë të pastër për Të. Mu për këtë, në vijim thotë: “...e braktisë ushqimin për Mua, e braktisë pijen për Mua, i braktisë të këndshmet për Mua, e braktisë gruan e tij për Mua...”.

Pasi që besimtari i cili agjëron e di se kënaqësia e Zotit të tij është në lënien e epsheve dhe i jep përparësi kënaqësisë së Allahut para epsheve të veta, kjo tregon se kënaqësia e tij është lënia epsheve për hir të Allahut [subhanehu ve teala], pasi që beson se Allahu e sheh dhe se shpërblimi dhe dënimi janë më të mëdha sesa kënaqësia e përdorimit të tyre gjatë vetmisë. Besimtari e urren ta bënë këtë vepër gjatë vetmisë edhe ma tepër se sa që e urren nga shkak i dhimbjes së rrahjes, sepse prej shenjave të besimit është që besimtari të urren atë që Allahu e urren, edhe pse epshi e tij e kërkon. Kështu kënaqësia e tij bëhet kënaqja e Allahut, edhe pse është në kundërshtim me epshin e tij, kurse e urren atë që e urren Krijuesi i tij, edhe pse epshi i vet këtë e dëshiron.

2- Agjërimi është gjë e fshehtë mes robit dhe Zotit të vet, askush këtë ibadet nuk e sheh, pasi që është i përbërë nga nijet i brendshëm, të cilin nuk e sheh askush përveç Allahut dhe lënia e epsheve, përdorimin e të cilave zakonisht e fshehë. Andaj edhe disa dijetarë kanë thënë se edhe melekët nuk e shkruajnë këtë vepër. Ose disa kanë thënë se në këtë vepër nuk ka syfaqësi.

Allahu dëshiron që robërit e Tij të sillen në mënyrë të fshehtë me Te, mos të sheh raportin e tyre askush, saqë disa nga selefi kur kanë marrë vesh se ndonjë vepër e tyre e fshehtë është marrë vesh prej njerëzve kanë thënë: sa mirë jetoja kur ky raport ishte i fshehur mes meje dhe Zotit tim. Pastaj u lut që të vdes dhe vdiq.

Të dashuruarit xhelozojnë që njerëzit tjerë të kuptojnë fshehtësirat mes tyre dhe atyre që i dashurojnë.

### **Agjërimi dhe edukimi i shpirtit**

Duke iu afruar Allahut me lërjen e veprave që i dëshiron agjëruesi, siç është ushqimi, martesat etj, ka disa dobi, prej tyre janë:

1- Mposhtja e vetvetes, sepse ngopja dhe kontakti me gra shkakton kryelartësi dhe mendjemadhësi.

2- Zbrazja e mendjes për mendim dhe dhikr, sepse përdorimi i këtyre epsheve e ngurtëson zemrën dhe e verbëron, e pengon njeriun nga mendimi dhe dhikri dhe e sjellë pakujdesinë. Kurse zbrazja e barkut nga ushqimi e ndriçon zemrën, e zbutë, e largon vrazhdësinë dhe e mbushë me mendim dhe përkujtim.

3- I pasuri e njih vlerën e dhuntive të Allahut, të cilat ia ka dhënë, gjëra të cilat nuk ia ka dhënë shumë njerëzve të varfër. Largimi nga këto gjëra në kohë të caktuar dhe pësimi i vështirësisë për këtë qëllim, e detyron robin ta përkujton atë, i cili nuk i posedon këto gjëra vazhdimisht. Kjo shkakton tek ai ndjenjë dhe nevojë falënderimi për dhuntitë e Allahut dhe mëshirim të vëllait të vet, i cili është nevojtar dhe i varfër.

4- Agjërimi i ngushton enët e gjakut, ku edhe qarkullon shejtani, e me këtë qetësohen vesveset e shejtanit, thehet vullneti i epsheve dhe hidhërimit, andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë agjërimin mburojë, pasi që e largon nga epshi i martesës.

Dije se largimi nga gjërat e lejuara gjatë agjërimit në shenjë afrimi tek Allahu, nuk plotësohet derisa njeriu nuk i largohet edhe gjërave tjera të cilat janë të ndaluara, siç është gënjeshtria, padrejtësia, shkelja e nderit, pasurisë, etj. Andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush nuk i lë fjalët e rrejshme dhe veprimin sipas tyre, Allahu nuk ka nevojë që ta lë ushqimin dhe pijen”. (Buhariu dhe Muslimi).

Disa dijetar nga selefi kanë thënë: “agjërimi më i lehtë është të braktisësh ushqimin dhe pijen”.

Kurse Xhabiri [radijAllahu anhu] ka thënë: “kur të agjërosh, le të agjëron edhe dëgjimi, shikimi, gjuha nga gënjeshtria dhe haramet. Lëre dëmtimin e fqinjtit. Bëhu modest dhe me nder. Mos të jetë dita që agjëron dhe ajo që nuk agjëron e njëjtë”.

Sekreti i kësaj fshehet në këtë. Afrimi me Allahun duke i lënë gjërat e lejuara nuk plotësohet pa i lënë edhe gjërat e ndaluara. Nëse një njeri i afrohet Allahut duke i



lënë gjërat e lejuara, mirëpo nuk i afrohet Allahut duke i lënë gjërat e ndaluara ai i ngjan njeriut, i cili i lë farzet, kurse i afrohet Allahut me nafle. Edhe pse sipas shumicës së dijetarëve agjërimi i tij është i mjaftueshëm, sepse një vepër nuk asgjësohet nëse nuk veprohet ndonjë vepër e cila është e ndaluar të bëhet gjatë kësaj vepre. Në këtë rast agjërimi nuk priset, përderisa nuk ushqehet, sepse ushqimi është vepër e ndaluar gjatë agjërimit.

### **Gëzimet e agjëruesve**

Agjëruesi i ka dy gëzime: kur të hanë iftarin dhe kur të takohet me Zotin e vet.

1- Gëzimi i tij gjatë iftarit ndodh sepse natyra e njeriut është e tillë që anon nga gjërat e zakonshme, siç është ushqimi dhe kontakti bashkëshortor, kështu që nëse i ndalohen në një kohë, e pastaj i lejohen, kjo e gëzon, sidomos kur kjo ndalesë i vjen në kohë kur ka shumë nevojë për to. Pa dyshim se skadimi i kohës së ndalimit e gëzon pa masë. E nëse kjo vepër është e dashur te Allahu, atëherë bëhet edhe fetarisht e dashur. Kështu ngjan me agjëruesin. Pasi që Allahu ia ka ndaluar ushqimin dhe epshet deri në mbrëmje, ia ka lejuar përdorimin e tyre me ardhjen e natës, bile e pëlqen nxitimin e sajë, ashtu sikur e pëlqen edhe vonimin në syfyr, pasi që më të dashurit e Allahut janë ata që e nxitojnë iftarin, kurse melekët i bekojnë ata që e vonojnë syfyrin.

Agjëruesi i cili i lë epshet e tija gjatë ditës për t'iu afruar Allahut dhe për ta respektuar, kurse të njëjtat i përdorë gjatë natës, për t'iu afruar dhe për ta respektuar, pra, i ka lënë sipas urdhrit të Allahut dhe u kthehet sërish sipas urdhrit të Allahut, pra, ky njeri në të dyja rastet është rob, i cili e respekton Zotin e vet. Për këtë edhe ka ndaluar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] që besimtari të agjërojë dy ditë pa ndërprerë. Nëse agjëruesi nxiton të hajë iftar duke iu afruar Allahut, hanë dhe pinë dhe i falënderohet Allahut, shpresojmë që këtij njeriut t'i falen mëkatet ose të arrijë kënaqësinë e Allahut, mund që edhe duaja t'i pranohet, sepse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Tre lutje kanë përgjigje: lutja e agjëruesit, lutja e atij që i është bërë zullum dhe lutja e mysafirit”. (hadithi është sahih, transmeton Bejhakui dhe tjerët).

Nëse me ushqimin dhe pijen e tij, ka për qëllim përforsimin e trupit të tij për namaz dhe agjërim, ai për këtë edhe do të shpërblehet, ashtu sikurse e ka për qëllim nga gjumi i tij gjatë ditës ose natës, forcim për punë, edhe gjumi i tij konsiderohet ibadet.

Pra, agjëruesi edhe gjatë ditës edhe gjatë natës qenka në ibadet, gjatë agjërimit dhe në iftar i pranohet lutja, gjatë ditës është durimtar, kurse gjatë natës falënderues.

Kush e kupton këtë që e kemi thënë, nuk do të ndalet në domethënien e gëzimit të agjëruesit, sepse edhe ky lloj i iftarit është dhunti dhe mëshirë e Allahut dhe hynë nën ajetin:

“Thuaj: “Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata”. (Junus: 58).

Mirëpo me kusht që iftari i tij të jetë hallall, përndryshe, nëse iftari i tij është haram, i ngjan njeriut i cili agjëron nga hallalli, kurse ha haramin. Këtij njeriut nuk i pranohet lutja e tij. Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“I zgjatë duart në qiell dhe thotë: o Zot, o Zot, mirëpo ushqimin e ka haram, pijen e ka haram, veshmbathjen e ka haram, është ngopur me haram, si ka mundësi t’i pranohet lutja këtij njeriut”. (Muslimi).

2- Kurse gëzimi i tij kur ta takojë Allahun [subhanehu ve teala], kjo do të ndodhë nga shkak i shpërblimit të rezervuar atje, në momentin kur më së shumti do t’i nevojitet, siç tregon Allahu [subhanehu ve teala]:

“...çka të përgatitni për veten tuaj prej të mirave, atë do ta gjeni te Allahu edhe më të mirë, dhe shpërblim më të madh, e kërkoni falje prej Allahut, se Allahu është mëkatfalës, mëshirues!”. (El-Muzemmil: 20).

Sufjan ibn Ujejne [rahimehull-llah] thotë: “Shpërblimin e agjërimit nuk e marrin ata që u ka hak, por Allahu ia ruan që ta fusë me to në xhennet. Ditët janë depotë e njerëzve të cilat i kanë mbushur ose me të mira ose me të këqija, kurse në ditë të Kijametit u hapen njerëzve këto depo. Të devotshmit në këto depo gjejnë krenari dhe nderim, kurse mëkatarët pendim dhe keqardhje”.

### **Shtresat e agjëruesve**

Agjëruesit janë dy shtresa:

1- Ata që e kanë lënë ushqimin, pijen dhe epshin për hir të Allahut [subhanehu ve teala] dhe si kompensim për këtë shpreson xhennetin. Ky njeri tregton me Allahun, kurse Allahu nuk ia humbë shpërblimin atij që bënë vepra të mira dhe nuk humbë ai i cili vepron me Allahun, përkundrazi është fituesi më i madh. Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Çdo gjë që e lenë nga frika prej Allahut, Allahu për të do të jep gjëra më të mira”. (Ahmedi, hadithi është sahih).

Andaj, këtij agjëruesi Allahu do t’i japë në xhennet çka të dëshiron prej ushqimeve dhe grave.

Disa dijetarë të selefrit kanë thënë: na kanë treguar se agjëruesve do tua shtrojnë një sofër ku do të hanë, kurse njerëzit përreth do të llogariten dhe do të thonë: o Zot, ne llogaritemi, kurse ata hanë? Do tu thuhet: ata kanë agjëruar kurse ju keni ngrënë, ata janë falur, e ju keni fjetur.

2- Ata që në dynja agjërojnë nga çdo gjë përveç Allahut, e ruajnë kokën dhe çka ka brenda, barkun dhe çka hanë, e përkujtojnë vdekjen, e dëshirojnë ahiretin, andaj i lënë të mirat e kësaj bote. Kjo është bajrami i iftarit të tij, ditën kur do të takohet me të dhe të gëzohet kur ta shoh.

Ai që agjëron nga epshet e tija në dynja do t’i arrijë nesër në xhennet, kurse ai që agjëron nga çdo gjë përveç Allahut, Allahu ia kthen këto gjëra në ahiret.

*O i Dashuri i zemrës time, skam askënd tjetër përveç Teje*

*Mëshiro sot, mëkatarin që të ka ardhur*

*Unë në xhennet, nuk kam asnjë dëshirë,*

*Përveç se dëshirojë që të të shoh*

Era e agjëruesit është era e cila del nga zbrazja e lukthit nga ushqimi, për shkak të agjërimit, është erë e urryer në hundët e njerëzve, mirëpo është e mirë te Allahu, sepse del nga shkakut i respektit dhe kërimit të kënaqësisë së Tij. Mu ashtu siç vjen shehidi para Allahut, duke i rrjedhur gjaku, e ngjyrë të gjakut, kurse me erë të miskut. Era e mirë e erës së agjëruesit i ka dy domethënie:

1- Pasi që agjërimi është vepër e fshehtë mes robit dhe Zotit, Allahu [subhanehu ve teal] e shfaqë në ahiret para njerëzve, që të dallohen agjëruesit dhe të veçohen prej tjerëve, si shpërblim i fshehtësë së veprës së tyre në dynja.

2- Ai që e adhuron Allahun dhe e respekton dhe kërkon kënaqësinë e Tij në këtë botë, kjo vepër te ai shkakton gjurmë të urryera tek njeriu në dunja, mirëpo nuk janë të urryera tek Allahu [subhanehu ve teal], bile janë të dashura dhe të këndshme, sepse kanë ardhur si rezultat i ibadetit dhe kërimit të kënaqësisë së Tij. Andaj, lajmërimi me këtë gjë, ata që veprojnë këto vepra në dynja, ua rehaton zemrat që mos të urrejnë atë që e fitojnë në ahiret.

Era e agjëruesve është më e mirë sesa era e miskut, kurse uria dhe etja e agjëruesve për Të është ngopja e vërtetë, dhe lodhja e adhuruesve për Të është rehatia më e vërtetë e tyre.

Allahu ynë na bëjë prej atyre që e agjërojnë këtë muaj ashtu siç e meriton dhe na bëjë prej atyre që gëzohen në ditën kur do të takohen me Ty. Amin.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Të mirat e agjërimit - Hafidh Ibn Rexheb Hanbeli

## Urtësi dhe sekrete të agjërimit

Agjërimi në vete ngërthen shumë urtësi dhe sekrete. Ato janë në sferën e besimit, edukatës, aspekteve shoqërore, po edhe shëndetësore.

Në këtë rast do të flasim për urtësitë dhe sekretet edukative dhe shëndetësore, sepse janë kryesoret.

1- Urtësitë dhe sekretet edukative të agjërimit:

a) Agjërimi realizon domethënien e devotshmërisë.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (el-Bekare: 183).

Vahidiu thotë: “Agjërimi shpije në devotshmëri, sepse e ndalon njeriun nga shumë gjëra që ia ka ëndja, e të cilat janë mëkate”. (“El-Vesit fi Tefsir”, të Wahidiut, 1/ 272).

Kurse Ebu Mudhafer Semani duke komentuar këtë pjesë të ajetit:

“që të bëheni të devotshëm”, thotë:

“Domethënë me devotshmëri, sepse agjërimi e shpije njeriun deri te devotshmëria, që paraqet mposhtje të ëndjeve dhe thyerje të epsheve”. (“Tefsirus-Semani:, 1/ 179).

Kurse Suidiu thotë: “Që të ruheni nga ushqimi, pija dhe gratë”. (“Xhamiul-Bejan”, 3/ 413).

Kurse Ibn Kethiri, rahimehull-llah, thotë: “Agjërimi pastron trupin dhe i ngushton rrugicat shejtanit”. (“Tefsiri i Ibn Kethirit”, 1/ 318).

Transmeton Imam Buhariu dhe Imam Muslimi nga Abdullah ibn Mesudi, radijAllahu anhu,, i cili thotë:

Ishim ulur me Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem,, e tha:

“Kush ka mundësi të martohet, le të martohet, sepse kjo ta ul shikimin, ta ruan organin, kurse ai që s’ka mundësi, le të agjëron, se kjo për të është mburojë”.

Ibn Haxheri, rahimehull-llah, thotë:

“Kush agjëron e dobëson epshin, që domethënë se agjërimi e mposht epshin për martesë”. (“Fethul-Bari”, 4/ 142).

b) Agjërimi i ruan gjymtyrët nga rënia në haram.

Ibn Kajimi, rahimehull-llah, thotë: “Ai që ulet pranë agjëruesit, përfiton nga ai, është i sigurt se nuk do të gënjetet, nuk do të sillet keq me të dhe nuk do t’i bëhet padrejtësi. Nëse flet, flet gjëra që nuk ia dëmtojnë agjërimin, e nëse vepron ndonjë gjë, nuk vepron gjëra që ia prishin agjërimin, andaj të gjitha fjalët e tija janë të dobishme dhe të mira”. (“El-Vabilis-Sajib”, fq. 41).

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Ai që nuk lenë fjalët e rrejshme dhe veprimin sipas tyre, Allahu nuk ka nevojë që ta lë ushqimin dhe pijen”. (Buhariu).

Muhelebiu thotë: “Ky hadith është argument se agjërimi nënkupton edhe largimin nga fjalët e kota dhe gënjeshttrat, ashtu sikurse largohet nga ushqimi dhe pija. Nëse nuk largohet prej këtyre gjërave, i mangësohet agjërimi, fiton mlllefosjen e Zotit dhe nuk pranohet prej tij”. (“Sherhu Sahihil-Buhari”, të Ibn Battalit, 4/ 23).

Xhabiri, radijAllahu anhu, thotë:

“Nëse agjëron, le të agjërojë edhe dëgjimi dhe gjuha nga gënjeshtria dhe mëkati, mos dëmto shërbëtorin, ke dinjitet dhe qetësi ditën e agjërimit, mos e bëj ditën e agjërimit dhe ditën kur nuk agjëron të njëjtë”. (“Musennef”, Ibn Ebi Shejbe, 2/ 422).

Kurse Ebu Dherri, radijAllahu anhu, thotë:

“Kur të agjërosh, kujdesu sa ke mundësi”. (“Musennef”, Ibn Ebi Shejbe, 2/ 421).

c) Agjërimi e edukon njeriun në sinqeritet

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, thotë:

“Agjërimi dallohet nga veprat tjera sepse është e veçantë për Zotin e botëve, pasi që agjëruesi nuk bënë asgjë, por largohet nga epshi, ushqimi dhe pija për hir të Allahut. I lë gjërat e dashura për shpirtin e tij dhe kënaqjen me to duke i dhënë përparësi dashurisë së Allahut dhe kënaqësisë së Tij. Kjo është sekreti mes tij dhe Zotit të vet, askush se shih përveç Tij. Njerëzit mund të shohin largimin nga ushqimet që e prishin agjërimin, mirëpo nuk mund të shohin për cilin e bënë këtë veper, këtë asnjë njeri nuk mund ta shih. Kjo është realiteti i agjërimit”. (“Zadul-Mead”, 2/ 29).

Transmeton Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, nga Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem,, i cili thotë:

“Zoti ka thënë: çdo veper e njeriut është për Të përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe unë shpërblej për të”. (Buhariu dhe Muslimi).

Muxhahidi thotë:

“Agjërimi nuk bëhet vetëm për Allahun, nëse vetëm Allahu nuk e di këtë veper”.

Kurse Ibn Battali thotë:

“Agjërimi dhe të gjitha veprat janë për Allahun, mirëpo pasi që në veprat e dukshme participon edhe shejtani me rija dhe gjëra tjera, agjërimi është një veper

të cilën vetëm Allahu e sheh, andaj e shpërblen aq sa ma e sinqertë është për Të, andaj edhe ia mvësh vetes”. (“Sherhu Sahihil-Buhari”, 4/ 9).

Kurtubiu thotë:

“Agjërimi është sekret mes njeriut dhe Zotit të vet, vetëm Atij ia shfaqë, andaj agjërimi bëhet adhurim i veçantë për Të”. (“Tefsir Kurtubi”, 2/ 273).

d) Agjërimi dhe durimi

Ibn Rexhebi, rahimehull-llah, thotë:

“Agjërimi është prej durimit, kurse durimi është tre lloje: të gjitha këto lloje tubohen në agjërim. Sepse në agjërim ka durim në respekt ndaj Zotit, durim në largim nga epshet e ndaluara dhe durim në dhimbjet e urisë dhe etjes dhe dobësinë e shpirtit dhe trupit që i përjeton agjëruesi.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”. (Ez-Zumer: 10). (“Lataiful-Mearif”, fq. 284).

Ibn ujejne, rahimehull-llah, thotë:

“Agjërimi është durim, duron njeriu nga ushqimi, pija dhe martesë, pastaj lexoi ajetin Kuranor:

“...ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”. (Ez-Zumer: 10). (“Sherhu Sahihil-Buhari; Ibn Battal, 4/9).

Ibn Haxheri, rahimehull-llah, thotë:

“Durimtarët janë agjëruesit sipas mendimit të shumicës së dijetarëve”. (“Fethul-Bari”, 4/ 130).

e) Agjërimi ia ngushton rrugicat shejtanit

Ibn Rexhebi thotë:



“Agjërimi i ngushton vendin e qarkullimit të gjakut, nëpër të cilat qarkullon shejtani. Shejtani te njeriu qarkullon nëpër enët e gjakut, andaj agjërimi i qetëson vesveset e shejtanit, e thyen nevojën e epshit dhe hidhërimit. Për këtë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, agjërimin e ka konsideruar mburojë që e ndërpret nevojën për marrëdhënie intime”. (“Letaiful-Mearif”, fq. 291).

f) Agjërimi e thërret njeriun në falënderim për dhuntitë

Abdul-Aziz Selman thotë:

“Agjërimi thërret ta falënderojmë Zotin për dhuntitë e Tijja, sepse agjërimi paraqet largim nga ushqimi, pija dhe gratë, kurse njeriu nuk ua din vlerën këtyre dhuntive, përderisa nuk i mungojnë, kjo e shtyn ta falënderon Allahun për këto dhunti. Në këtë aludon Allahu në ajetin Kuranor kur thotë:

“(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.”. (El-Bekare: 185). (“Mevaridudh-Dhemean”, 1/ 356).

g) Agjërimi zgjon vetëdijen për kontrollin e Zotit dhe frikën nga Ai

Reshid Rida thotë:

“Agjërimi, ia bën me dije njeriut, se nuk ka kontrollues tjetër mbi të përveç Allahut, kjo vetëdije për kontroll i jep njeriut turp që të sheh Zoti atje ku e ka ndaluar. Kjo vetëdije për kontroll tregon plotësinë e besimit dhe fundosjen në madhërimin dhe shenjtërimin e Tij, kurse kjo sjell frikën prej Tij. Ky njeri që arrin këtë gjendje nuk mund të jepet pas mëkateve, sepse nuk zgjatë koha e shkujdesjes

nga Zoti. Nëse harron ose rrëshqet për shpejt kohë kujtohet dhe kthehet tek Allahu me pendim. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (Allahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)”. (El-Araf: 201). (“Tefsirul-Menar”, 2/ 145- 146).

h) Agjërimi sjell edukatë të lartë dhe kujdes për të varfërin

Ibn Rexhebi thotë:

“I kanë pyetur disa dijetar të selefët: pse është përcaktuar agjërimi? Janë përgjigjur: që i pasuri të shijojë shijen e urisë e mos ta harrojë të uriturin”. (“Letaiful-Mearif”, fq. 314).

Reshid Ridaja thotë:

“Agjëruesi kur të ndien urinë i kujtohet ai që s’ka ushqim, e kjo e shtyn që të jetë i butë, i mëshirshëm, që e thërrasin të jep lëmoshë dhe sadaka. Allahu, subhanehu ve teala, e ka përshkruar Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si të mëshirshëm dhe të butë, andaj kënaqet me robërit e tij, me ato gjëra që kënaqet me pejgamberët e Tij. Andaj edhe i ka urdhëruar që ta kenë shembull atë”. (“Tefsirul-Menar”. 2/ 147).

Abdullah ibn Abbasi, radijAllahu anhu, tregon se:

“Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu më bujar, bëhej edhe më bujar në Ramazan, kur takohej me Xhibrilin [alejhis-selam]”. (Buhariu dhe Muslimi).

Zejn ibn Muniri thotë:

“E mira dhe bamirësia e tij kaplon atë që ka cilësinë e varfërisë dhe nevojës dhe atë që ka cilësinë e pasurisë dhe mjaftueshmërisë, ma shumë se sa që kaplon shiu, të cilin e sjell reja”. (“Fet’hul-Bari”, 4/ 139).

i) Agjërimi shfaq unitetin e muslimanëve dhe ummeti kupton rëndësinë e kohës

Reshid Ridaja thotë:

“Agjërimi ummetit i mëson sistem në jetesë. Të gjithë muslimanët bëjnë iftar në një kohë, askush nuk nxiton para tjetrit as për një minutë dhe askush nuk vonohet nga tjetri as për një minutë”. (“Tefsirul-Menar”, 2/ 148).

Urtësitë dhe sekretet shëndetësore:

a) Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, thotë:

“Agjërimi është mburojë nga sëmundjet e shpirtit, zemrës dhe trupit. Dobitë nuk mund të numërohen. Ka një ndikim të çuditshëm: në ruajtjen e shëndetit, shkrirjen e tepricave, pengim të njeriut nga përdorimi i gjërave që e dëmtojnë, sidomos kur bëhet mesatarisht dhe me maturi, në kohët më të mira, fetarisht. Në kohë kur për to ka nevojë trupi. Pastaj agjërimi shkakton rehati të fuqisë dhe gjymtyrëve, gjë që shkakton deponim të fuqisë. Ka një veçori të cilës duhet dhënë përparësi: largimin e brengës së zemrës, kurse kjo është shërimi më i dobishëm për njerëzit që kanë përzjerje të ftohta dhe të lagëta. Ka ndikim shumë të madh në ruajtjen e shëndetit.

Agjërimi hyn në mjekimet shpirtërore dhe natyrore. Nëse agjëruesi kujdeset për disa gjëra të kërkuara natyrisht dhe fetarisht, shtohet përfitimi i zemrës dhe trupit, pengohen lëndët e huaja dhe të dëmshme, për të cilat është përgatitur, i largon lëndët e dëmshme, kjo fitohet varësisht nga plotësia ose mangësia e agjërimit dhe prej gjërave për të cilat duhet të kujdeset gjatë agjërimit. Këto gjëra e ndihmojnë që të arrijë qëllimin e agjërimit, sekretin dhe shkakun i cili mungon.

Qëllimi prej agjërimit është diçka tjetër jashtë lënies së ushqimit dhe pijes, duke pasur parasysh këtë element edhe është adhurim të cilin Allahu e ka veçuar për Të. Pasi që është preventivë dhe mburojë mes robit dhe asaj që ia dëmton zemrën dhe trupin, tash ose më vonë. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (El-Bekare: 183).

Nga ky ajet shihet se njëri prej qëllimeve të agjërimit është preventiva dhe mbrojtja, e kjo është shërim shumë i dobishëm.

Qëllimi tjetër: grumbullimi i zemrës dhe preokupimi me Allahun, subhanehu ve teala, dhe posedimi i fuqisë shpirtërore për të realizuar adhurimet dhe gjërat që i do Ai”. (“Et-Tibbun-Nebevij”, fq. 258- 259).

#### b) Agjërimi dhe shëndeti i trupit

“Agjërimi është i dobishëm për shëndetin e shpirtit dhe trupit të njeriut. Agjërimi koncentron mendjen dhe forcon vullnetin, pakëson barrën prej të gjitha organeve të trupit, e sidomos sistemit të tretjes, sistemit vaskular dhe të veshkave”. (“Hakaik tibbije fil-Islam”, fq. 184).

“Agjërimi aktivizon ripërtërirjen e qelizave në trup. Është e ditur se trupi i njeriut ka më shumë se 125 miliard qeliza dhe se në çdo minutë lindin dhe vdesin nga 7 miliard qeliza. Që domethënë se të gjitha qelizat e njeriut ripërtërihen, përafërsisht, për 12 ditë. Kurse gjatë agjërimit ripërtërihen vetëm për 5 ose 6 ditë”. (“Hakaik tibbije fil-Islam”, fq. 184).

#### c) Agjërimi dhe sistemi i tretjes

“Agjërimi ka ndikim shumë të madh në rehatinë e sistemit të tretjes, i cili lodhet gjatë tërë vitit. Agjërimi stimulon përfitimin nga rezervat e dhjavit në tërë trupin, ashtu që këto dhjave shndërrohen dhe copëtohen, saqë rezultojnë energji të nevojshme për të vazhduar jetën, në vend të ushqimit”. (“Et-Tibul-Vikaji fil-Islam”, fq. 253).

“Prej urtësive të fillimit të iftarit me hurma është fakti se hurmat përbëjnë sheqer, i cili shumë shpejt thithet dhe depërton në gjak. Kjo shkakton rritjen e sasisë së sheqerit në gjak dhe agjëruesi ndien një aktivitet që depërton në trupin e tij, fuqi

në koncentrim dhe shikim dhe pakëson në një far mënyrë ndjenjën e agjëruesit për nevojë për ushqim, e i pakësohet oreksi, e han sa i mjafton pa e tepruar”. (“Et-Tibul-Vikaji fil-Islam”, fq. 253).

“Pirja e ujit gjatë iftarit, para ushqimit i lëviz zorrët dhe pakëson gjendjen e kapsit, nga e cila gjendje, zakonisht, ankohen shumë pleq”. (“Et-Tibul-Vikaji fil-Islam”, fq. 253).

#### d) Agjërimi dhe shërimi i trashësisë

Njeriu me peshë shumë përfiton nga agjërimi, sepse agjëruesi pasi që tret ushqimin që e konsumon gjatë syfyrit fillon të përdorë 83 % të fuqisë së nevojshme, të cilën e merr nga rezervat ushqimore në trupin e njeriut, sidomos nëse njeriu nuk e tepron në ushqime dhe pakëson përdorimin e yndyrave dhe sheqereve”. (“Et-Tibun-Nebevij vel-Ilmil-hadithi”, 1/ 274).

#### e) Agjërimi i ruan dhëmbët nga kariesi dhe e mbron nofullën nga infektimet

Një mjek thotë: Largimi nga ngrënia që nga syfyri e deri në iftar i mbron dhëmbët nga prishja, e cila vjen si rezultat i prishjes së mbeturinave të ushqimit në dhëmbë. Andaj agjërimi i mbron dhëmbët nga sëmundja me karies. Pastaj pakëson prodhimin e jargave, të cilat shkaktojnë shtimin e lëndëve të bigorrit dhe yndyrave në dhëmbë, kurse dhëmballa i eksponohet sëmundjeve të ndryshme”. (ES-Sejdalije Muhamedije”, fq. 32- 43).

#### f) Sëmundjet e reumatizmit

Specialistët e sëmundjeve të reumatizmit dhe sëmundjeve të përhershme potencojnë se agjërimi i bën dobi të sëmureve nga reumatizmi, sidomos gratë dhe pleqët e dy gjinive. Agjërimi pakëson peshën dhe liron nga helmet që gjinden në trup. (ES-Sejdalije Muhamedije”, fq. 32- 43).

#### g) Agjërimi dhe sëmundjet e mëlçisë

Internistët thonë: shumë raste të pacientëve kanë përfituar shumë gjatë ramazanit, sepse agjërimi ndikon në pakësimin e sasisë së sheqerit në gjak dhe urinë. Andaj mjekët i udhëzojnë të sëmurit në mëlçi që të përfitojnë nga përvoja e agjërimit gjatë tërë vitit, pas teprimit në ushqim dhe rregullimit të tij. (ES-Sejdalije Muhamedije”, fq. 32- 33).

#### h) Agjërimi dhe braktisja e duhanit

Agjërimi është stimulues i madh që ndihmon në lirimin definitiv nga varësia prej duhanit dhe narkotikëve. Agjërimi jep imunitet të madh dhe ia shton njeriut gatishmërinë për të bartë përgjegjësitë dhe barrën e jetës. I mëson në durim gjatë privimit, andaj kjo edhe e ndihmon që të largohet tërësisht nga duhani dhe përmirësohet shëndeti i tyre psikik dhe fizik. (ES-Sejdalije Muhamedije”, fq. 32- 33).

#### i) Agjërimi dhe lukthi

Sa e vërtetë është ajo urtësi që është thënë shumë herët: pak agjërim e shëndosh lukthin. Gjatë agjërimit lukthi zbrazet plotësisht nga ushqimi 12 orë të plota gjatë një dite dhe në një kohë prej një muajit të plotë. Kjo kohë mjafton që të pastrohet lukthi nga çdo ushqim i shtresuar dhe i jep mundësi për pushim dhe moslodhje. Andaj e shohim se gjatë agjërimit njeriu nuk gogëson, të cilën e shkakton ngrënia e ushqimit pas ushqimit, gjë e cila shkakton prishjen e ushqimeve në lukth, para se ti tretë ato. (“Sumu tesihu”, fq. 32- 33).

#### h) Agjërimi dhe zorrët

Agjërimi i rehaton zorrët dhe zorrën e trashë nga ushqimi i shtresuar në to, andaj agjëruesi lirohet nga gazrat dhe aromat e pakëndshme, të cilat dalin si rezultat i ngopjes, tretjes së keqe dhe prishjes së ushqimit në zorrë, pasi që s’kanë mundësi të thithin ushqimin ose të lirohen nga ai. Njerëzit në të kaluarën, kur s’kishte barëra moderne, barkçitjen e shëronin vetëm me agjërim ose duke përdorur

lehtësues të cilët ndihmonin për të nxjerur lëndët helmuse nga zorra e trashë.  
("Sumu tesihu", fq. 32- 33). (alminbar.net, n.d.)

Burimi: alminbar.net

## **Përfitimet psikologjike të agjërimit dhe mësimet islame**

Agjërimi ka qenë një pjesë integrale e shumë praktikave fetare dhe kulturore gjatë gjithë historisë njerëzore. Atë e braktisën popujt e mëhershëm dhe e mbajtën besnikërisht vetëm myslimanët. Në Islam, agjërimi i muajit të Ramazanit është një nga pesë shtyllat e fesë dhe është një praktikë thelbësore për myslimanët. Ndërsa përfitimet fizike të agjërimit janë hulumtuar gjerësisht, aspektet psikologjike janë po aq të rëndësishme. Ky shkrim synon të eksplorojë përfitimet psikologjike të agjërimit dhe mënyrën se si ato përputhen me mësimet islame, duke ofruar dëshmi dhe referenca.

### **Përfitimet psikologjike të agjërimit**

**Përmirësimi i funksioni kognitiv (njohës):** Agjërimi është treguar se përmirëson funksionet njohëse, si kujtesa, të mësuarit dhe qartësia mendore (Longo & Mattson, 2014). Kjo mund të jetë për shkak të rritjes së faktorit neurotrofik që rrjedhë nga truri (BDNF), i cili shoqërohet me përmirësime njohëse (Longo & Mattson, 2014). Agjërimi në Islam inkurajon vetë-reflektimin dhe fokusimin në rritjen shpirtërore, gjë që mund të përmirësojë më tej funksionin njohës.

**Reduktimi i stresit dhe ankthit:** Agjërimi ka dhënë dëshmi të mëdha se është shkaktar i uljes së niveleve të stresit dhe ankthit në shumë individë sipas studimeve (Fond et al., 2013). Kjo mund të jetë për shkak të çlirimit të endorfinës dhe nxitjes së ndjenjës së qetësisë gjatë agjërimit. Mësimet islame theksojnë rëndësinë e mirëqenies mendore dhe gjetjes së paqes në besim, gjë që mund të kontribuojë në reduktimin e stresit dhe ankthit.



Përmirësimi i humorit dhe rregullimi emocional: Agjërimi mund të ndihmojë në përmirësimin e humorit dhe rregullimit emocional duke përmirësuar funksionin e neurotransmetuesit serotonin (Michalsen, 2010). Serotonina është thelbësore për rregullimin e humorit dhe rritja e prodhimit të saj gjatë agjëritit mund të çojë në përmirësimin e rregullimit emocional. Mësimet islame inkurajojnë vetëkontrollin emocional dhe durimin, të cilat mund të mbështesin më tej rregullimin emocional gjatë agjëritit.

Rritja e aftësisë për Vetë-disiplinë: Agjërimi kërkon që individët të përmbahen nga ushqimi dhe pijet gjatë orëve të ditës, gjë që mund të çojë në zhvillimin e vetë-disiplinës dhe vetëkontrollit (Sabry & Vohra, 2013). Mësimet islame theksojnë rëndësinë e vetë-disiplinës si një mjet për rritjen shpirtërore dhe forcimin e besimit.

Kultivimi i madh i ndjenjave të mirënjohjes dhe ndjeshmërisë: Agjërimi mund t'i ndihmojë individët të zhvillojnë një ndjenjë më të madhe mirënjohjeje për begatitë, ushqimin dhe pasuritë që kanë, si dhe ndjeshmëri më të madhe për ata që përjetojnë uri dhe varfëri (Sabry & Vohra, 2013). Mësimet islame nxisin dhembshurinë dhe ndjeshmërinë, si dhe rëndësinë e ndihmës së të tjerëve dhe ndarjes së burimeve që kemi në dispozicion me ata në nevojë.

### **Mësimet Islame që mbështesin përfitimet psikologjike të agjëritit**

Rritja shpirtërore: Agjërimi në Islam shihet si një mjet për të pastruar shpirtin dhe për të nxitur rritjen shpirtërore (Kuran 2:183). Kjo përputhet me përfitimet psikologjike të agjëritit, pasi fokusi në vetë-reflektim, qartësia mendore dhe rregullimi emocional mund të kontribuojnë në zhvillimin shpirtëror.

Vetëdija dhe ndërgjegjësimi i lartë: Mësimet islame inkurajojnë të qenit të vëmendshëm, të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm si gjatë agjëritit ashtu edhe

gjatë kohës jashtë agjërit, ky aspekt mund të çojë në përmirësimin e funksionit njohës, rregullimit emocional dhe vetë-disiplinës.

Ndërtimi i qëndrueshmërisë dhe durimit: Agjërimi në Islam është gjithashtu një mjet për zhvillimin e qëndrueshmërisë dhe durimit, pasi kërkon që individët të durojnë urinë dhe etjen (Kuran 2:45). Kjo mund të kontribuojë në zhvillimin e vetëdisiplinës dhe rregullimit emocional, të cilat janë përfitime thelbësore psikologjike të agjërit.

Agjërimi ka përfitime të shumta psikologjike, të tilla si përmirësimi i funksionit njohës, reduktimi i stresit dhe ankthit, përmirësimi i humorit dhe rregullimi emocional, rritja e vetëdisiplinës dhe një ndjenjë më e madhe mirënjohjeje dhe ndjeshmërie. Mësimet islame përputhen me këto përfitime, duke nxitur rritjen shpirtërore, vetëdijen dhe vëmendjen, qëndrueshmërinë dhe durimin. Duke kuptuar përfitimet psikologjike të agjërit dhe duke përfshirë mësimet islame, njerëzit mund të përjetojnë rritje personale dhe mirëqenie tërësore.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Longo, V. D., & Mattson, M. P. (2014). Fasting: Molecular Mechanisms and Clinical Applications. *Cell Metabolism*, 19(2), 181-192. DOI: 10.1016/j.cmet.2013.12.008

Fond, G., Macgregor, A., Leboyer, M., & Michalsen, A. (2013). Fasting in mood disorders: neurobiology and effectiveness. A review of the literature. *Psychiatry Research*, 209(3), 253-258. DOI: 10.1016/j.psychres.2012.12.018

Michalsen, A. (2010). Prolonged fasting as a method of mood enhancement in chronic pain syndromes: a review of clinical evidence and mechanisms. *Current Pain and Headache Reports*, 14(2), 80-87. DOI: 10.1007/s11916-010-0104-z

## Lidhshmëria e agjërimit me devotshmërinë

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (El-Bekare: 183).

Abdul-Gaffar Ujunus-Sud në librin e tij Rijadun-Nedire duke e komentuar këtë ajet thotë:

“Allahu [subhanehu ve teala] ua ka sqaruar besimtarëve urtësinë e obligimit të agjërimit duke thënë: “që të bëheni të devotshëm”. Domethënë që të radhiteni në radhën e të devotshmëve, sepse agjërimi është shkallë kah devotshmëria, pasi që agjëruesi e ndalon veten nga epshi i tij, duke e madhëruar urdhrin e Allahut. I ofrohen ushqime të këndshme dhe pije të lezetshme, mirëpo ai largohet nga këto gjëra edhe pse ia ka ëndja, për shkak të urdhrit të Atij që e shikon dhe e kontrollon. Duke vazhduar në këtë gjendje tridhjet ditë ose njëzet e nëntë me rend adaptohet në kundërshtim të epshit, saqë në momentin kur dobësohet ky zakon, vjen Ramazani tjetër. Me agjërimin e atij muaji sërish përforcohet ky zakon. Nëse këtë vepër e bën edhe mes dy Ramazaneve, atëherë mundet t’i bëhet prirje e thelluar në personaliteti e tij. Në këtë mënyrë radhitet në radhët e të devotshmëve dhe bëhet nga trashëgimtarët e xhennetit, siç thotë Allahu [subhanehu ve teala]:

“Ato janë Xhennetet që do t’ua trashëgojnë robërve Tanë që ishin të ruajtur (devotshëm)”. (Merjem: 63)”.

Ibn Kajjmi [rahimehull-llah] thotë: “Agjërimi ka ndikim të çuditshëm në ruajtjen e gjymtyrëve të jashtme dhe forcës së brendshme... agjërimi i ruan shëndetin edhe

---

Sabry, W. M., & Vohra, A. (2013). Role of Islam in the management of Psychiatric disorders. *Indian Journal of Psychiatry*, 55(Suppl 2), S205-S214. DOI: 10.4103/0019-5545.105526

zemrës edhe gjymtyrëve, e ia kthen atë që ia ka marrë dora e epshit. Andaj është ndihmësi më i madh i devotshmërisë”. (“Zadul-Mead”, 2/ 29).

Agjërimi ka me vete një veçori të çuditshme për të asgjësuar shkaqet e mëkateve, sepse shkaqet e mëkateve janë: shkujdesi (gafleti) dhe epshi (shehveti). Shkujdesi kundërshtohet me dije dhe përkujtim, kurse epshi me durim gjatë ndërprerjes së shkaqeve që e lëvizin epshin.

Shkujdesi është koka e çdo mëkati, andaj ilaçi më i mirë për të asgjësuar mëkatet është përzjerja e ëmbëlsisë së diturisë me hidhurin e durimit. (Muhtesar Minhaxhul-Kasidin, fq. 272).

a) Gafleti- shkujdesi është dy llojesh:

1- Shkujdesi nga madhëria e Allahut [subhanehu ve teala]. Besimtari duhet ta njeh Allahun, t’ia njeh emrat dhe cilësitë e Tij. Sepse njeriu i bënë mëkatet pasi që është i shkujdesur nga Madhëria dhe Fuqia e Tij.

Ai që është i bindur se Zoti i tij është i Fuqishëm, i Mundshëm, në Dorë të Tij është mbretëria e çdo gjëje, nuk ka mundësi që të jetë i guximshëm ndaj mëkateve. Mëkati bëhet i madh në zemrën e besimtarit për shkak të dijes së tij për Madhërinë e Allahut, andaj kur të sheh madhërinë e Atij që e adhuron, mëkatet e vogla i sheh të mëdha.

2- Shkujdesi nga dënimi i rreptë. Duhet të përkujton ajetet e Kuranit që flasin për dënimin e mëkatarëve dhe hadithet e vërteta që flasin mbi këtë temë.

Bilal ibn Sadi [rahimehull-llah] thotë:

“Mos shiko faktin se mëkati është i vogël, por shiko madhërinë e Atij që i bën mëkat”.

Kurse Fudajl ibn Ijadi [rahimehull-llah] ka thënë:

“Kur bëj mëkate, e njoh këtë nga sjellja e gomarit dhe shërbëtorëve të mij”.

b) Epshi. Ajo që neve na intereson në këtë rast është epshi i barkut dhe i organit, ajo që e ngacmon epshin nga jashtë; prania e asaj që e dëshiron dhe shikimi në te dhe ajo që e ngacmon nga brenda; mendimi rreth saj dhe cytjet e shejtanit.

1- Epshi i barkut është prej shkatërrueseve më të mëdhenj. Nga shkakut i tij doli Ademi [alejhis-selam] nga xhenneti. Pastaj ky epsh e lind epshin e organit dhe pasurisë. Këtë e pasojnë shumë të meta të tjera. Të gjitha këto burojnë nga epshi i barkut.

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Besimtari ha me një lukth, kurse mosbesimtari ha me shtatë luktha”. (Muslimi).

Në hadithin tjetër Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Biri i Ademit nuk ka mbushur enë më të keqe se sa barku i tij. I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata, me të cilat do ta mbaj shpirtin gjallë. Nëse e ka domosdo, atëherë le ta ndan një të tretën për ushqim, një të tretën për pije dhe një të tretën për frymëmarrje”. (Tirmidhiu, sahih).

Ukbe Er-Rasi thotë: Hyra te Hasan Basriu, e ai ishte duke ngrënë dhe më tha: urdhëro. I thashë: kam ngrënë saqë nuk kam vend më. Tha: subhanAllah! A han muslimani aq shumë saqë nuk gjen vend për të ngrënë edhe më tej?!

Sa i përket kësaj çështjeje sikur edhe të çështjet tjera muslimani duhet me qenë mesatar dhe i drejtë. Nuk duhet larguar nga ushqimi saqë të dobësohet aq shumë e mos të mund të zbatojë asnjë obligim të Zotit, e as të jepet pas ushqimit që mos të ketë mundësi të merr edhe frymë.

Ai që e tepron ushqimin e vet, kjo shkakton nevojë të madhe për shumë gjumë, largon mendjemprehtësinë, etj.

2- Epshi i organit. Këtë epsh Allahu [subhanehu ve teala] e ka krijuar te njeriu për dy dobi:

- Vazhdimi i llojit njerëzor;

- Për të kuptuar kënaqësinë, që në bazë të saj të krahason kënaqësinë e ahiretit.

Atë që nuk e ka shijuar njeriu nuk mundet të mallëngjehet për të. Mirëpo edhe ky epsh nëse nuk kontrollohet dhe nuk vihet në vendin e tij mesatar, atëherë sjell shumë të këqija, sprova, së fundja, po mos t'ishin këto gjëra nuk do të bëhej gruaja kurthi i shejtanit.

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Nuk kam lërë pas meje sprovë më të dëmshme për burrat se sa gratë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Disa burra të mirë kanë thënë: Po të më lësh në një shtëpi përplot me pasuri, mendoj se nuk do ta prek emanetin, mirëpo nëse më le me një vajzë zezake një çast të vetëm, nuk garantoj asgjë”.

Dhënia pas këtij epshi mundet që ta bëjë preokupim kryesor të burrit shtimin e kënaqësisë me gra e të angazhohet në dëm të ahiretit, ndoshta e shpien edhe në amoralitet, ose (ashikëri) dashuri të çmendur, që është grada më e keqe e epshit. (Muhtesar Minhaxhul-Kasidin, 163- 165).

Shërimi i tërë kësaj është agjërimi, e kjo nuk ndodh pa durim, kurse durimi nuk mundet të ndodh pa frikë nga Zoti, e frikohet ai që e njeh Zotin, kurse dija duhet të jetë largpamëse. (Muhtesar Minhaxhul-Kasidin, fq. 274).

Nëse njeriu ka nevojë për durim që të largohet nga epshi i marrëdhënieve intime, kjo mund të ndodh me tre gjëra:

1- Agjërimi i vazhdueshëm dhe gjatë iftarit të mjaftohemi me pak ushqim.

2- Largimi i shkaqeve ngacmuese, sepse ngacmimi vjen me shikim, shikimi e ngacmon zemrën, e zemra e lëviz epshin. Shërimi i kësaj është largimi prej njerëzve, kujdesi që mos të na bjer shikimi në fotografi që e ngjallin epshin, sepse

shikimi është shigjetë e helmuar e shejtanit. Andaj ose mbylli sytë e ulë shikimin ose ik dhe largohu nga ai vend.

3- Dëfrimi i shpirtit me gjërat e lejuara që i dëshiron epshi, siç është martesë, etj.

Të këqijat burojnë nga injoranca, padrejtësia dhe shkujdesi.

Shejhul-Islam Ibn Tejmij [rahimehull-llah] thotë:

“Secili njeri që e bën ndonjë të keqe dhe gabim e bën nga shkak i mosdijes se ajo është e keqe dhe gabim ose pse epshi i tij anon kah ajo. Çdo të mirë dhe obligim që e le njeriu e le duke mos e ditur se është obligim ose pse ia urren shpirti këtë gjë.

Në të vërtetë të gjitha të këqijat burojnë nga mosdija, sepse po të posedonte dituri të dobishme se kjo veprë e dëmton nuk do ta bënte. Kjo është veçori e mendjes. ashtu që nëse ka vepra të mira të cilat dihen se e dëmtojnë njeriun, siç është rënia nga ndonjë vend i lartë, ose hedhja në një lum që do ta fundos, ose kalimi afër murit që është i shtrembëruar, ose hyrja në zjarr të ndezur, etj nuk do ta kishte bërë, sepse në këtë veprë ka dëm dhe s’ka dobi. Mirëpo ai që nuk e di këtë gjë, siç është fëmija, i çmenduri, i hutuari, gafili, ndoshta edhe e bënë këtë veprë.

E nëse ndokush e bën ndonjë veprë në të cilën ka dëm për Të, duke e ditur se ka dëm, ai këtë veprë e bën për shkak të mendimit se dobia është më e madhe.

Mirëpo nëse është i bindur se dëmi është më i vogël dhe paramendon se dobia është më e madhe, atëherë ai medoemos duhet dhënë përparësi dobisë. Kjo i ngjan njeriut i cili udhëton rrugë të largët e mbi deti për të fituar pasuri. Ai po të ishte i bindur se do të fundosej në det ose do të humbte në këtë tregti, nuk do të udhëtonte, mirëpo tek ai mundësia për shpëtim dhe fitim ka qenë më e madhe, andaj edhe është nisur në këtë rrugë, edhe pse mundet të gabojë në këtë konstatim.

Kështu është edhe puna e mëkateve. Nëse vjedhësi është i bindur se do të kapet dhe do t’i pritët dora, nuk do të vidhte. Po ashtu edhe zinaqari (njeriu imoral) po

të ishte i bindur se do të gurëzohet, nuk do të bënte zina. Kurse konsumuesi i alkoolit në fillim dënohet me katërdhjetë ose tetëdhjetë shkopinjë, e nëse e vazhdon edhe më tej konsumimin e alkoolit, dënimi i tij shtohet, derisa mund të vije si dënim përfundimtar edhe mbytja e tij, sipas mendimit më të saktë.

Pra, kështu qenka edhe puna e dënimeve, nëse mëkatari është i bindur se me këtë mëkat i vjen edhe dëm i qartë dhe i sigurt, nuk e bënë atë mëkat. E nëse ndokush e bën ndonjë mëkat, atëherë e bën ose pse nuk është i bindur se është haram ose nuk është i bindur për dënimin, por shpreson falje me veprat tjera të mira, ose me pendim, ose shpreson t'ia fal Allahu, ose është i shkujdesur tërësisht nga kjo, nuk i kujtohet as se është haram kjo vepër e as kërcënimi për atë që e vepron këtë vepër. Pra, mbetet gafil. Gafleti- shkujdesi është prej gjërave të kundërta të dijes.

Shkujdesi dhe epshi janë baza e çdo të keqe. Allahu [subhanehu ve teal] thotë:

“...mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar”. (El-Kehf: 28).

Epshi nëse është i vetmuar nuk mundet ta nxitë njeriun të bëjë mëkate, nëse nuk i shoqërohet edhe injoranca, sepse pasuesi i epshit nëse është i bindur se ky epsh i shkakton sigurisht dëm, largohet nga ky epsh për shkak të natyrës së vet. Allahu [subhanehu ve teal] ka krijuar në shpirt dashuri ndaj asaj që i bën dobi dhe urrejtje ndaj asaj që i sjell dëm, ashtu që nuk e bën atë vepër për të cilën është i sigurt se do t'i sjell dëm të qartë, e nëse e bën kjo vjen nga shkak i dobësisë së mendjes.

Për këtë ky njeri cilësohet si i mençur.

Andaj, telasheja e madhe është prej shejtanit e jo vetëm prej epshit, sepse ai ia zbukuron epshit mëkatet, e urdhëron në to, ia përkujton disa të mira që i ka, që i bëjnë dobi e jo dëm, siç bëri me Ademin dhe Havanë [alejhimas-selam]. Allahu [subhanehu ve teal] thotë:



“Por, atë e ngacmoi djalli duke i thënë: "O Adem, a do të të tregoj për pemën e pavdekshmërisë dhe të sundimit të pambarim!" Ata të dy hëngrën nga ajo (pemë) dhe që të dy u zhveshën, e ia nisën ta mbulojnë veten e tyre me gjethe që mbledhnin nëpër Xhennet, dhe kështu Ademi theu urdhrin e Zotit të vet dhe gaboi”. (Taha: 120- 121).

“...dhe tha: "Zoti juaj nuk ua ndaloi ju dyve atë pemë vetëm që të mos bëheni meleqë (engjëj), ose të mos bëheni prej të përjetshmëve”. (El-A'raf: 20).

Andaj Allahu [subhanehu ve teala] tha:

“Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. E ata (djajt) do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse (jobesimtarët) mendojnë se janë duke i udhëzuar”. (Ez-Zuhruf: 36- 37).

“A atij që vepra e vet e keqe i është hijeshuar dhe e sheh si të mirë (a është i njëjtë me atë që i largohet asaj)?...”. (Fatir: 8).

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo popull veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërble për atë që vepruan”. (El-En'am: 108).

Fjala: “Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo popull veprimin e vet,...” të mirën me ndërmjetësim të melaqeve, peygamberëve dhe besimtarëve, kurse të keqën me ndërmjetësim të djajve xhin dhe njerëz. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Kështu shumicës së idhujtarëve, idhujt ua hijeshuan atyre mbytyjen e fëmijëve të vet, për t'i shkatërruar (me mashtrime) dhe për t'ua ngatërruar fenë (që e kishin pasur të Ismailit). Po sikur të donte Allahu, ata nuk do ta bënin atë, andaj hiqu tyre dhe asaj që shpifin”. (El-Enam: 137).

Baza e asaj që i shtynë njerëzit në mëkate është injoranca, mosdija se është e dëmshme ose mendimi se dobia e saj është më e madhe se sa dëmi i saj.

Andaj sahabet, [radijAllahu anhum] kanë thënë:

“Secili që bën mëkate ndaj Allahut është injorant”. Kështu e kanë komentuar ajetin Kuranor:

“Pendim i pranueshëm tek Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije dhe shpejt pendohen; të tillëve Allahu ju pranon pendimin, se Allahu është më i dijsلمي, më i urti”. (En-Nisa: 17).

Sikurse edhe ajetin:

“E kur të vijnë ty ata që i besojnë ajetet tona, thuaju: "Selamu alejkum, Zoti juaj ia ngjeshi vetes mëshirën. Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s'ka dyshim se Allahu është që falë shumë dhe është Mëshirues”. (El-En'am: 54).

Andaj gjendja kur bëhet mëkatet quhet xhahilijet- injorancë, sepse mëkatarin e shoqëron një gjendje e injorancës.

Ebul-Alije thotë: i kam pyetur shokët e Muhammedit [sal-lAllahu alejhi ve sellem] për këtë ajet:

“Pendim i pranueshëm te Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije dhe shpejt pendohen; të tillëve Allahu ju pranon pendimin, se Allahu është më i dijsلمي, më i urti”. (En-Nisa: 17). Kurse ata më janë përgjigjur:

“Secili që bën mëkat ndaj Allahut është injorant, e ai që pendohet para vdekjes, ai është penduar shpejt”. (Taberaniu në tefsirin e tij, 3/ 640).

Katadeja thotë: “shokët e Muhammedit [alejhis-selam] unanimisht kanë thënë se secili që bën mëkat ndaj Allahut është në injorancë, qoftë se e ka bërë mëkatin me qëllim ose jo dhe secili që bën mëkat ndaj Allahut është injorant”.

Kur e kanë pyet Hasan Basriun [rahimehull-llah] rreth kësaj çështjeje, ai ka thënë: “Ata janë njerëz që nuk i kanë ditur obligimet dhe detyrat e veta. E nëse e kanë ditur? Thotë: le të dalin nga ai mëkat, sepse ajo është injorancë”.

Këtë e sqaron edhe më shumë ajeti:

“...Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës”. (Fatir: 28).

Secili që ia ka frikën Allahut, e respekton dhe i le mëkatet, ai është dijetar, siç thotë Allahu [subhanehu ve teala]:

“(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimit të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim”. (Zumer: 9).

I kanë thënë Shabiut: ku je o dijetar!

Iu përgjigj: dijetar është ai që ia ka frikën Allahut”. (Ebu Neim më “El-Hilje”, 4/311).

Ajeti Kuranor:

“...Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës”. (Fatir: 28).

Tregon se secili që ia ka frikën Allahut është dijetar, sepse vetëm dijetari i frikohet Allahut, por edhe domethënë: se dijetar është ai që i frikohet Allahut, siç kanë thënë selef.

Dija mbi atë nga e cila kanë qortuar pejgamberët shkakton frikë. Nëse dija shkakton frikën, e cila e shtyn njeriun që të bëjë vepra të mira dhe t'i le mëkatet, atëherë secili mëkatar është injorant, nuk posedon dituri të plotë.

Kjo që thamë e sqaron faktin se baza e mëkateve është injoranca dhe mosdija.

Nëse nuk e njeh Zotin, nuk ka se çka e thërret që të bëjë vepra të mira dhe t'i lejë veprat e këqija. Nefsi për nga natyra është labil dhe ndryshon shpesh, pasi që është i gjallë, kurse dëshira dhe lëvizja janë prej komponentëve të jetës.

Nëse dëshira dhe puna janë komponentët subjektive të jetës, kur ta udhëzon Allahu: e mëson atë që i bën dobi dhe atë që i bën dëm, e dëshiron atë që i bën dobi dhe e le atë që i bënë dëm”. (Mexhmuul-Fetava, 14/ 287- 295).

Pra, nga kjo që kaloj kuptuam se mëkatet burojnë nga shkujdesi dhe injoranca me një anë dhe nga epshi në anën tjetër, kurse agjërimi e largon shkujdesin dhe e disiplinon epshin.

Lërja e ushqimit, pijes dhe marrëdhënieve intime është bazë për të fituar veçorinë e përkujtimit dhe diturisë të agjëruesi.

Në çdo moment, kur është agjërueshëm, e sheh ushqimin, ujin e ftohët dhe të këndshëm para tij, e sheh gruan e tij të veshur me rrobat më të bukura mirëpo kujtohet se është agjërueshëm, rob i Allahut, andaj nuk han, nuk pi, nuk i afrohet gruas së tij me qëllim të realizimit të robërisë ndaj Allahut [subhanehu ve teala].

Në çdo moment të ditës ai kujtohet se është rob i Allahut, e përkujton madhërinë e Allahut, të Cilit ia zbaton urdhrat dhe e respekton në këtë obligim të agjërimin.

Ai që për tridhjetë ditë qëndron vazhdimisht në këtë gjendje, në gjendje të përkujtimit të vazhdueshëm, do të adaptohet në këtë gjendje, e me këtë e eliminon shkakun më të rëndësishëm të mëkateve, e që është shkujdesi dhe injoranca.

Po ashtu edhe epshi. Agjërimi i mbyllë vendkalimet e shejtanit dhe i dobëson ato, ashtu që agjërimi bëhet shërim i epshit sepse e ndalon nga shpërthimi dhe sulmi. Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka urdhëruar djelmoshat që të agjërojnë, duke thënë:

“O ju djelmosha kush ka mundësi prej jush që të martohet, le të martohet. Sepse martesja ia ulë shikimin dhe ia mbron nderin (organin). E ai që s’ka mundësi që të martohet, le të agjërojë, sepse agjërimi është mburojë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Agjërimi e kontrollon, dobëson dhe disiplinon epshin, e me këtë e eliminon edhe shkakun e dytë të mëkateve, epshin.

“Mbyllja e vendkalimeve të shejtanit dhe kanaleve të tija, duke e pakësuar ushqimin dhe pijen, e dobëson epshin dhe e rregullon atë. Kjo është domethënia e hadithit të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: “...le të agjërojë, sepse agjërimi është mburojë”. Qëllimi i hadithit është të tregojë se me agjërim dobësohet epshi për marrëdhënie intime”. (Fet’hul-Bari, 4/ 119).

Duke u stërvitur në këto elemente tridhjetë ditë të plota, muslimani agjëruar adaptohet në devotshmëri, vetëdije për kontroll të Zotit, e përkujton dhe e përmend, e me këtë futet në radhët e të devotshmëve dhe lartësohet në gradat e bamerësve (muhsininëve).

## Mësime pedagogjike nga ajetet kuranore mbi agjërimin

Agjërimi dhe sekreti i devotshmërisë

Do të mundohemi që nëpërmjet disa vështrimeve t'i spikatim disa mësimet pedagogjike të rëndësishme që kanë të bëjnë me ajetin Kuranor:

"2:183. O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm". (El-Bekare: 183).

Kjo temë do të zërthehet në dy aspekte:

Një: cili është ndikimi që e le agjërimi te agjëruesi?!

Dy: Cilat janë mekanizmat e ndikimit të agjërimin dhe si ndikon te njeriu?!

### Ndikimi i agjërimin te shpirti i njeriut

Allahu, subhanehu ve teala, në këtë ajet ka sqaruar urtësinë e madhe e cila gjendet në brendësinë e këtij adhurimi, e ajo është devotshmëria, që është koka e çdo të mire për njeriun në dynja dhe ahiret.

Imam Kurtubiu, rahimehull-llah, e ka sqaruar shumë mirë ndikimin e madh që ka agjërimi në shpirtin e njeriut dhe se ky ndikim është i veçantë vetëm për agjërimin. Ai këtë e sqaron kur flet për faktin pse Allahu e ka veçuar agjërimin dhe ia ka atribuar Vetvetes, siç ka ardhur në hadithin:

"Secila vepër e njeriut është për Të përveç agjërimin, ai është për Mua dhe unë shpërblej për Të...". (Buhariu dhe Muslimi).

Ai, rahimehull-llah, thotë:

"E ka veçuar agjërimin duke ia adresuar Vetvetes, edhe pse të gjitha adhurimet janë të tijat, për dy çështje, me të cilat dallohet agjërimi prej adhurimeve tjera:

Një: agjërimi e ndalon njeriun nga epshet dhe kënaqësitë e shpirtit, ashtu si nuk mundën ta bëjnë adhurimet tjera.

Dy: Agjërimi është sekret mes njeriut dhe Zotit të vet, vetëm Ai mund ta sheh, andaj edhe është i veçantë për Të, kurse adhurimet tjera janë të dukshme, andaj ato mund t'i bëjë për sy e faqe, për ta parë tjerët, etj, andaj agjërimi është më i veçantë se adhurimet tjera..". (Shiko: Tefsir Kurtubi", 2/273-274).

Pra, sipas kësaj që tha Imam Kurtubiu shihet qartë se agjërimi ka ndikim shumë të thellë në shpirtin e njeriut, i cili:

Një: Ua kalon adhurimeve tjera, në aspekt se e ndalon njeriun nga kënaqësitë dhe epshet e tij, andaj ka ardhur në hadithin e Abdullah ibn Mesudit, radijAllahu anhu:

"Ai që ka mundësi të martohet le të martohet, sepse kjo ia ul shikimin, ia mbron organin, kurse ai që nuk ka mundësi, le të agjëron, sepse kjo për Të është mburojë". (Buhariu dhe Muslimi).

Hafidh ibn Haxheri, rahimehull-llah, në librin e tij "Fet'hul-Bari", thotë:

"Qëllimi i hadithit është të tregoj se agjërimi e mposht epshin për martesë". (shiko: "Fet'hul-Bari", 4/119).

Këtë që e ka vërtetuar Ibn Haxheri e pranojnë të gjithë njerëzit e mençur, madje edhe ata që nuk janë musliman.

Dy: Syefaqsia zakonisht nuk shfaqet në këtë adhurim. Andaj njeriu në këtë adhurim, e vëren ëmbëlsinë e sinqeritetit, të cilin nuk do ta kishte gjetur në adhurimet tjera.

Nëse dëshiron ndalu dhe analizo: si ka mundësi që kur jemi të vetmuar, na jepen mundësi të ndryshme për të ngrënë ose për të pirë, gjatë Ramazanit, në vende ku nuk na sheh askush, kurse nuk e bëjmë këtë vepër!

Me të vërtetë është një gjë e çuditshme!

A ke pyetur veten: kush na mbrojti nga ky gabim?!

Është një gjë e çuditshme që gjendet në agjërimin, qoftë në muajin e Ramazanit ose jashtë tij.

Agjërimi e stërvit njeriun në sinqeritet dhe vet-kontroll, me këtë atij i ngritet vetëdija se Allahu e shikon dhe e mbikëqyr, e në këtë formë stërvitemi në formën më të mirë në zbatimin e hadithit të Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem:

"Ke frikë Allahun, ku do që je". (Sahih, Ahmedi).

SubhanAllah!

Shtoja kësaj edhe faktin se agjërimi gjatë Ramazanit ka edhe një veçori shtesë, e ajo është prangosja e djajve dhe xhinëve, kjo pa dyshim se është përgatitje për njeriun që të angazhohet vetëm me luftën dhe përleshjen me epshin dhe nefsin e tij, e me këtë ai ngritet në një shkallë më lartë, që jashtë Ramazanit të jetë i aftë për ta luftuar dhe mposhtur edhe një armik tjetër, e ai është xhini.

Po, agjërimi posedon sekretet e çuditshëm në pastrimin e shpirtit të njeriut, kurse ky Imam e shpalosi ndikimin e agjërimin në shpirtin e njeriut.

Mirëpo, kjo që thamë deri tash është gjysma e sekretit, kurse Ibn Kajimi, rahimehull-llah, e shpalosi gjysmën tjetër.

Cili është ai?!

Mekanizmi i ndikimit

Ibn Kajimi, rahimehull-llah, participoi në shpalosjen e pjesës së mbetur të sekretit, edhe atë me sqarimet e tija precize dhe shprehjet e tija mahnitëse, na e sqaroi mekanizmin e ndikimit dhe sekretin e ndryshimit dhe si ka mundësi që agjërimi ta bëjë atë ndryshim pedagogjik.



"Trupi i njeriut është krijuar nga toka, kurse shpirti nga lartësiat e qiellit dhe janë bashkuar mes vete. Andaj kur të uritet dhe lodhet trupi i tij nga angazhimi i madh, shpirti lehtësohet dhe rehatohet, andaj edhe mallëngjehet për vendin për të cilin është krijuar, mallëngjehet për botën e lartësuar, e nëse e ngop trupin, i jep komoditet dhe gjumë, angazhohesh për ta rehatuar dhe shërbyer, trupi rëndohet dhe anon kah vendi prej të cilit është krijuar, kurse shpirti i tij e ndien veten sikur në burg, po mos të ishte mësuar shpirti të qëndroj në burg, do të kërkonte ndihmë ashtu sikur kërkon i dënuari, për shkak të largimit dhe këputjes nga bota e lartë, në të cilën është krijuar". ("El-Fevaid", fq. 133-134).

Ky dijetar, Allahu e mëshiroftë, na sqaroi, se njeriu, sipas natyrës së tij, përbëhet nga dy pjesë, kurse argument për këtë është ajeti Kuranor:

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj një njeri nga balta dhe kur ta kem përsosur atë dhe t'i kem dhënë nga ana Ime shpirt, ju menjëherë përlunoni atij (në sexhde)". (Sad: 71- 72).

Pra, trupi qenka i krijuar nga toka, kurse shpirti nga bota e lartë, andaj kur vdes njeriu, shpirti i ngritet lart në qiell, kurse trupi i kthehet sërish në tokë:

"Prej asaj (tokës) Ne u krijuam ju, e ju do t'ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë". (Taha: 55).

Secili, edhe trupi edhe shpirti, anojnë nga vendbanimi i tyre nga i cili kanë ardhur, shpirti mallëngjehet për botën e lartë, andaj edhe duhet tu përgjësojë banorëve të vet, që janë melaqet, për të cilat Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"Ata lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërzhiten". (El-Enbija: 20).

Dhe thotë:

"...që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Et-Tahrim: 6).

Këto dy ajete na i sqarojnë disa cilësi:

1- Vazhdimi i adhurimeve dhe të mos u mërzhiturit.

2- Nxitim për zbatim të urdhrave.

3- Ikja nga mëkati.

Ne, edhe pse nuk jemi të formësuar me formën e melaqeve, mirëpo jemi të urdhëruar që të bëjmë adhurime, të largohemi nga mëkatet dhe të bëjmë adhurim të mirë. Ne edhe pse kemi dallim në realizimin e këtyre cilësive për shkak të natyrës sonë njerëzore, mirëpo s'ka dyshim se në agjërim vërejmë ngritje dhe realizim sa më të madh të domethënieve të lartësirave, për shkak të pikënisjes së shpirtit dhe lirimimit nga burgu tokësor.

Ajo që e thamë për shpirtin, e kundërta tërësisht vlen për trupin, ai kërkon rëndim për toke dhe dëshiron të kënaqet me epshet dhe kënaqësitë e saja, siç është gjumi, epshi i barkut dhe organit, lirimi i gjuhës dhe syrit, e shumë të meta tjera të gjymtyrëve.

Sipas kësaj shihet se ka konflikt mes këtyre dy gjërave të bashkuara, mirëpo me anime të kundërta, ashtu që trupi dhe shpirti janë vëllezër në konflikt, ortak me kontest, secili dëshiron që tjetrin ta nënshtroj.

Kush është fituesi?!

Prej dhuntive të Allahut mbi ne është që këtë konflikt e ka përcaktuar që të përfundon në interes të shpirtit, i cili e zotëron trupin dhe e nënshton para dëshirave të veta, sidomos kur nxiton drejt adhurimeve dhe largohet nga mëkatet dhe epshet, këtë secili prej nesh e ndien gjatë agjërimit, pasi që secili njeri e ndien animin drejt adhurimeve dhe ikjen nga mëkatet.

Kjo fitore e shpirtit ka ardhur për shkak se Allahu na ka ndihmuar me dy gjëra të rëndësishme:

Një: na ka ndihmuar me urdhër kaderik, ku ne s'kemi aspak ndikim, por është thjesht dëshira dhe dhuntia e Allahut, e ajo është prangosja e shejtanëve të inatosur, e shpëtojmë nga ky armik i përbetuar. Kjo ndodh vetëm në Ramazan.

Dy: na ka ndihmuar me urdhrin e tij fetar, e ajo është agjërimi.

Allahu na urdhëroi agjërimin dhe na sqaroi gjërat që na nxisin për Të, pasi që tregoi se agjërimi është rruga për të fituar devotshmërinë, ku trupi prangoset nga ushqimi dhe pija, e ky dobësim e largon nga mëkatet.

Armiqtë më të përbetuar të njeriut janë: shejtani dhe nefsi që e ka në gjoks, nga këto nuk shpëton askush përveç atij të cilin e mbron dhe ndihmon Allahu.

Sipas asaj që treguam deri tash kuptojmë se Allahu i prangos këto dy armiqtë dhe beteja përfundon në interes të shpirtit, atëherë del në shesh urtësia për të cilën Allahu na ka krijuar, e ajo është detyrimi i nefsit dhe stërvitja e tij që të arrijë në gradat më të larta të mundshme të adhurimit, e me këtë e realizon domethënien më fisnike të njeriut:

*Puno me shpirtin dhe plotësoja vlerat*

*Se ti me shpirt e jo me trup je njeri.*

### **Pika e fundit**

Dikush mund të pyet: unë agjëroj, mirëpo kjo nuk ndikon në dobësimin e epshit tim?

Si përgjigje kësaj mund të themi: njeriu i shëndosh nuk del nga njëra prej këtyre gjendjeve:

1- Agjëron, mirëpo kur të hash iftarin e tepron në ngrënie dhe e sjell veten sikur të mos kishe agjëruar.

2- Dijetarët kanë thënë se ndikimi i agjërimit është sikur ndikimi i barërave, duhet gëlltitur kokrra një pas një, mund që edhe të zgjat më tepër procesi, derisa të vjen ndikimi i tij.

Ibn Haxheri, rahimehull-llah, duke e komentuar hadithin:

"Ai që s'mundet le të agjëron..", thotë:

"Agjërimi, sipas disave, e aktivizon edhe më shumë epshin, mirëpo kjo ndodh në fillim, kurse me kalimin e kësaj faze dhe adaptimit, ai pushon. Allahu e di më së miri". ("Fet'hul-Bari", 4/119).

Kjo që tham e shpalos sekretin!

Pa dyshim se kjo është dhunti dhe mëshirë e Allahu, për të cilën Allahu ka thënë:

"Thuaj: "Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata". (junus: 58).

Allahun e lusim që të na bëjë nga ata që i frikohen edhe në vetmi edhe në publik.

Ate e lusim që të na bëjë nga të liruarit nga zjari në këtë muaj të bekuar. Amin...

Autor: Imadudin Kenani

## Disa rregulla për muajin Shaban, muaji paraprijës i Ramazanit i cili mundëson suksesin në Ramazan

Shabani është emër i muajit, kështu është emërtuar sepse arabët shpërndaheshin për të kërkuar ujë, ose sipas disave për shkak të shpërndarjes nëpër shpella, e sipas të tretëve për shkak se gjendet mes muajit Rexheb dhe Ramazan. Shumësi i këtij emri është Shabanat ose Sheabiin.

### 1- Agjërimi në muajin Shaban

Aisheja, radijAllahu anha, thotë: "Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, agjëronte sa që mendonim se aspak nuk është duke ngrënë, dhe nuk agjëronte sa që thonim se aspak nuk agjëronte. Nuk e kam parë Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke agjëruar një muaj të plotë përveç Ramazanit, kurse më së shumti e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban". (Buhariu dhe Muslimi). Në transmetimin tjetër të Muslimit qëndron: "E agjëronte gjithë Shabanin, përveç një pjesës së vogël".

Një grup i dijetarëve, prej tyre është edhe Abdullah ibën Mubareku, kanë anuar nga mendimi se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kurrë nuk e ka plotësuar muajin e Shabanit me agjërim, por e ka agjëruar pjesën më të madhe. Këtë mendim e përforcon hadithi të cilin e transmeton Muslimi nga Aisheja, radijAllahu anha, ku thotë: "Nuk di se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka agjëruar muaj të plotë përveç Ramazanit", ose në transmetimin tjetër: "nuk e kam parë duke agjëruar një muaj të plotë prej ditës që ka ardhur në Medinë, në përjashtim të Ramazanit".

Kurse Ibën Abbasi, radijAllahu anhu, thotë: "Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk ka agjëruar asnjë muaj të plotë përveç Ramazanit". (Buhariu dhe Muslimi). Andaj Ibën Abbasi, radijAllahu anhu, e urrente të agjëron muaj të plotë përveç Ramazanit.

Ibën Haxheri, rahimehull-llah, thotë: "Agjërimi i tij vullnetar ishte më i shumtë në muajin e Shabanit sesa në muajt tjerë. Ai agjëronte pjesën më të madhe të Shabanit".

Usame ibën Zejdi, radijAllahu anhu, thotë: i thashë Pejgamberit, sal-llallahu alejhi ve sel-lem: të shoh që më së shumti je duke e agjëruar muajin e Shabanit? Mu përgjigj: ky është muaji që njerëzit e neglizhojnë, sepse gjendet mes Rexhepit dhe Ramazanit. Ky është muaji që ngriten veprat te Zoti i botëve, kurse unë dëshiroj që të më ngriten veprat duke qenë agjërueshëm". (Transmeton Nesaiu. Shiko: "Sahihut-Tergibi vet-Terhibi", të Shejh Albanit, rahimehull-llah, fq. 425). Kurse në transmetimin e Ebu Davudit, Aisheja, radijAllahu anha, thotë: "Muaji më i dashur për ta agjëruar Pejgamberi, sal-llallahu alejhi ve sel-lem, ishte muaji Shaban, pastaj e vazhdonte me muajin Ramazan". (Shejh Albani, rahimehull-llah, thotë se ky hadith është i vërtetë. Shiko: "Sahih Sunen Ebi Davud", 2/461).

Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "agjërimi i muajit Shaban është më i vlefshëm se agjërimi i muajve të shenjtë, kurse agjërimi më i mirë vullnetar është ai që është më afër Ramazanit, qoftë para ose mbrapa, ashtu sikurse namazet vullnetare me farzet, ato që falen para edhe ato që falen mbrapa, domethënë i plotësojnë mangësitë e farzeve. E njëjta gjë vlen edhe për agjërimin. Pastaj ashtu sikurse që sunetet e rregullta janë më të vlefshme sesa namazi vullnetar, ashtu edhe agjërimi para Ramazanit dhe pas është më i mirë sesa ai që është më larg.

Fjala e Pejgamberit, sal-llallahu alejhi ve sel-lem: "Shabani është muaj që e neglizhojnë njerëzit sepse gjendet mes Rexhepit dhe Ramazanit", domethënë se pasi që kufizohet me dy muaj të mëdhenj, muaji i shenjtë dhe muaji i agjërimit, njerëzit angazhohen nga ky muaj, andaj bëhet i neglizhuar. Shumica e njerëzve mendojnë se agjërimi i Rexhepit është më i vlefshëm se agjërimi i muajit Shaban, sepse muaji Rexhep është muaji i shenjtë, mirëpo kjo nuk është e saktë.

Në hadithin e lartpërmendur tregohet se mundet që disa kohëra, vende ose persona të njihen si më të vlefshëm edhe pse gjinden kohëra, vende ose persona që janë më të vlefshëm se to.

Në këtë hadith gjithashtu ka argument se është e pëlqyeshme që të shfrytëzohen me ibadet kohërat që i neglizhojnë njerëzit. Për këtë disa nga selefi (muslimanët e parë) e shfrytëzonin kohën mes Jacisë dhe Akshamit me ibadet, sepse shumica e njerëzve janë neglizhent nga ibadeti në këtë kohë. E njëjta vlen edhe për përmendjen e Allahut, subhanehu ve teala, në treg, sepse e përmendin Allahun në vend të neglizhencës dhe mes neglizhentëve. Të shfrytëzosh me ibadete kohën që zakonisht njerëzit e neglizhojnë, ka shumë dobi, prej tyre janë:

- Më lehtë e ke ta fshehësh këtë ibadet, kurse te veprat vullnetare fshehja e tyre është më e mirë. Sidomos agjërimi, i cili është ibadet i fshehur mes robit dhe Zotit të vet, për këtë edhe është thënë se në të nuk ka mundësi të ketë rija, syfaqësi. Ka pasur njerëz nga selefi që kanë agjëruar me vite, askush nuk e ka ditur. Kur ka dalë nga shtëpia për në treg ka marrë me vete bukën, rrugës i jepte ato sadaka, kurse ai vet agjëronte. Kështu, familja e tij mendonte se ka ngrënë bukën, kurse njerëzit e tregut mendoni se ka ngrënë në shtëpi. Për këtë, selefi e kanë pëlqyer për atë që agjëron që të tregon gjëra me të cilat do ta fshehë agjërimin e tij. Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu, thotë: "nëse agjëroni, përdorni vajra (në fytyrë dhe flokë)". Kurse Katadeja, rahimehull-llah, thotë: "është e pëlqyer për agjëruesin që të përdorë vajra, që të largon nga vetja pluhurin e agjërimin".

- Veprat e mira në kohën e neglizhencës janë të rënda për nefsin, kurse prej shkaqeve që një vepër e bëjnë më të vlefshme, është vështirësi e tyre për nefsin, sepse kur një vepër e bëjnë shumë njerëz, atëherë është më e lehtë, kurse nëse e neglizhojnë një vepër shumica e njerëzve, atëherë u bëhet e rëndë të zgjuarve. Transmeton Imam Muslimi nga Ma'kel ibën Jesari, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, sal-llallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ibadeti në kohën e fitnes është

sikur të bësh hixhret tek Unë". Sepse në këtë kohë njerëzit i pasojnë epshtet e tyre, andaj ai që kapet për të vërtetën është duke bërë një vepër të rëndë.

Dijetarët kanë shumë mendime për shkakun e agjërimit të shumtë të Pejgamberit, sal-Allah u alejhi ve sel-lem, në muajin Shaban, prej tyre janë edhe këto mendime:

1- Nuk mundej t'i agjëron çdo herë nga tre ditë të çdo muajit për shkak të udhëtimit, andaj të gjitha këto i kompensonte në muajin Shaban. Pejgamberi, sal-Allah u alejhi ve sel-lem, kur e bënte ndonjë vepër vullnetare e vazhdonte, e nëse i kalonte e kompensonte.

2- Disa kanë thënë: gratë e tija, i kompensonin ditët e mbetura nga Ramazani i kaluar në muajin Shaban, edhe ai agjëronte me to. Kjo është në kundërshtim me atë që e thonte Aisheja, radijAllahu anha, e cila e vononte kompensimin e agjërimit të ditëve të mbetura nga Ramazani deri në Shaban, sepse ishte e angazhuar me Pejgamberin, sal-Allah u alejhi ve sel-lem.

3- Disa të tjerë kanë thënë: sepse është muaji që shumica e njerëzve e neglizhojnë. Ky është mendimi më i saktë, duke u mbështetur në hadithin e Usame ibën Zejdit që e përmendëm pak më lartë.

Nëse i kishin mbetur Pejgamberit, sal-Allah u alejhi ve sel-lem, ditë të pa-agjëruara nga agjërimi vullnetar, i kompensonte në muajin Shaban që të plotësonte nafilet e tija para se të hyjë Ramazani, ashtu sikurse kur i kalonte sunneti i ndonjë namazi ose diç nga namazi i natës, e kompensonte, kurse Aisheja, radijAllahu anha, e shfrytëzonte kompensimin e tij që edhe ajo të kompensonte ditët e mbetura nga muaji i Ramazanit të kaluar, sepse në kohët tjera ka qenë e angazhuar me Pejgamberin, sal-Allah u alejhi ve sel-lem.

Në këtë rast duhet tua tërheqim vërejtjen se atij që i ka mbetur diç pa agjëruar nga muaji i kaluar i Ramazanit, duhet ta kompensojë para se të hyjë muaji i ardhshëm i Ramazanit dhe nuk i lejohet ta vonojë, përveç se me ndonjë arsye. Ai që ka mundësi ta kompensojë para Ramazanit të ardhshëm dhe nuk e ka bërë, përveç



kompensimit duhet bërë teube dhe për çdo ditë duhet ushqyer nga një të varfër. Ky është mendim i Malikut, Shafiut dhe Ahmedit.

Prej dobive të agjërimit të muajit Shaban është se agjërimi i këtij muaji e stërvitë njeriun para ardhjes së agjërimit të muajit Ramazan, që mos t'i vjen i rëndë agjërimi i muajit Ramazan, por i vjen muaji i Shabani dhe Ramazani i vije i lehtë pasi që tashmë ky është i përgatitur dhe aktiv.

Muaji Shaban është si parathënie e muajit Ramazan, atëherë edhe ky muaj duhet të ketë disa gjëra që i ka muaji i Ramazanit, siç është agjërimi, leximi i Kuranit dhe dhënia e sadakasë. Seleme ibën Suhejli thoshte: Muaji i Shabanit është muaj i lexuesve të Kuranit".

Edhe Habib ibën Ebi Thabit kur hynte muaji Shaban thoshte: ky është muaji i lexuesve të Kuranit. Kurse Amr ibën Kajs el-Mulai kur hynte muaji i Shabanit, e mbyllte dyqanin e tij dhe lirohej nga angazhimet tjera për të lexuar Kuran.

Agjërimi në fund të Shabanit

Tregon Ebu Hurejreja, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë: "Mos agjëroni para Ramazanit një ose dy ditë, përveç atij që ka agjëruar ditë të zakonshme". (Buhariu dhe Muslimi)

Sipas argumenteve që i kemi në disponim agjërimi para muajit Ramazan i ka tre situata:

- A) Të agjëron me nijet që mos të gabon fillimin e muajit Ramazan, kjo është haram.
- B) Të agjëron me nijet të zotimit, ose kompensimit, etj, kjo është e lejuar sipas shumicës së dijetarëve, dhe
- C) Të agjëron me nijet të agjërimit vullnetar, nëse e ka pasur traditë t'i agjëron ato ditë, siç është e hënë dhe e enjtja, atëherë i agjëron, përndryshe jo.

Nëse ndokush thotë: pse urrehet të agjërohet në ditët para muajit Ramazan, si përgjigje mund të themi, se kjo është kështu për shumë aspekte:

1- Për mos t'i shtuar muajit të Ramazanit ditë që nuk janë të tij. Për këtë shkak është i ndaluar edhe agjërimi i ditës së Bajramit, që mos të bëjnë muslimanët siç kanë bërë pasuesit e librave, të cilët kanë shtuar sipas mendimeve dhe epsheve të tyre. Për këtë edhe ka ndaluar Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, agjërimin e ditës së dyshimtë.

2- Për të ndarë agjërimin vullnetar nga ai obligator, edhe kjo është një gjë e ligjshme. Për këtë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka ndaluar ngjitjen e namazit obligator me atë vullnetar pa i ndarë ato me selam ose fjalë, sidomos sunnetet para namazit të sabahut.

Ndokush mund të mendojë se ngrënia para Ramazanit ka për qëllim ngopjen me ushqim dhe ngopjen e epsheve para se ta ndalon nga ushqimi me agjërim, por kjo është gabim dhe injorancë, nëse ndokush kështu ka menduar.

Referenca:

- 1- "Lataiful-Mearif fima limevasimil-Ami minel-Vedhaif", të Ibën Rexheb Hanbeliut.
- 2- "El-Ilamamu bishejin min ahkamis-Sijami", Abdul-Azizi Raxhihi.

## Mikpritja e Ramazanit

Pa dyshim se njerëzit zakonisht urojnë dhe përgëzojnë gjërat e mira që u ndodhin njerëzve në jetë. Në këtë drejtim duhet të jetë edhe përgëzimi që duhet t'ia bëjmë njëri tjetrit për ardhjen e këtij muaji të bekuar, muajit Ramazan.

Nëse analizojmë gjendjen e muslimanëve të hershëm duke filluar që nga koha e Muhammedit, alejhisselam, do të vërejmë se ata ua kanë përgëzuar njëri tjetrit ardhjen e këtij muajit të bekuar.

Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“U ka ardhur Ramazani, muaj i bekuar. Allahu ua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në këtë muaj hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit, lidhen në pranga shejtanët e inatosur. Allahu në këtë muaj ka një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë”. (Nesaiu, sahih).

Ky hadith i lartpërmendur na mëson se duhet përgëzuar dhe uruar muslimanët njëri tjetrit ardhjen e këtij muajit të bekuar dhe fitimprurës.

Ibn Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: “Si ka mundësi të mos përgëzoj besimtari me hapjen e dyerve të xhennetit?! Si ka mundësi mos të përgëzoj mëkatari me mbylljen e dyerve të zjarrit?! Si ka mundësi njeriu i mençur mos të përgëzoj për kohën, në të cilën prangosen djajtë?! Si ka mundësi që kjo kohë t'i përngjajë në ndonjë mënyrë kohëve tjera?!”. (“Lataiful-Mearif”, fq. 279).

### Publikim i gëzimit dhe lumturisë për ardhjen e këtij muajit të bekuar

Ashtu sikurse gëzohet njeriu në jetë për gjëra të mira që i ndodhin, aq më shumë duhet të gëzohet dhe ta publikoj këtë gëzim, kur t'ia ofrohet mundësia për adhurim dhe respekt ndaj Allahut, subhanehu ve teala.

Kjo ndjenjë i ka kapluar të gjithë besimtarët e devotshëm që nga koha e muslimanëve të parë e deri më këto ditë.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Thuaj: "Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata". (junus: 58).

Ibn Rexheb Hanbeliu thotë: “Arritja e muajit të Ramazanit dhe agjërimi i tij është dhunti shumë e madhe për atë që ia mundëson Allahu i Lartësuar. Argument për këtë është hadithi që tregon për tre personat, prej të cilëve dy ranë shëhid, kurse i treti vdiq në shtratin e tij, pas tyre. Këtë të fundit e panë në ëndërr, se ua kishte kaluar. Atëherë Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] tha:

“A nuk ka falur pas tyre kaq e kaq namaze, e ka takuar muajin e Ramazanit dhe ka agjëruar. Pasha Atë në Dorë të të Cilit është shpirti im, mes tyre ka dallim sikurse mes qiejve dhe tokës”. (Ahmedi, sahih).

Ai që mëshirohet në këtë muaj, ai është i mëshiruari, ai që privohet nga të mirat në këtë muaj, ai është i privuari, ai që nuk merr nozull nga këto ditë për ditën e kthimit, ai është i qortuari”. (“Letaiful-Mearif”, fq. 280).

### **Kush gëzohet me ardhjen e Ramazanit**

Ata që gëzohen me ardhjen e muajit të Ramazanit janë dy lloje:

#### **1- Njerëzit e adhurimeve dhe besimit;**

Ata gëzohen me ardhjen e këtij muajit sepse në këtë muaj u hapen mundësitë për adhurime të llojllojshme dhe për shkak të shpërblimit që e ka përgatitur Allahu për ata që agjërojnë.

Allahu ka përgatitur shpërblime për:

**a) Agjërimin:**

Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Ai që e agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe shpresë (të shpërblimit), i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

**b) Kujdesu për namazin.**

Nëse dëshiron që agjërimi yt të jetë i pranuar te Allahu, kujdesu për namazin. Sepse namazi është shtylla kryesore e fesë, pa këtë shtyllë nuk ngritet godina e Islamit.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Islami ngritet mbi pesë shtylla: mbi dëshminë se s’ka hyjni tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi dhe kryerja e haxhit”. (Buhariu dhe Muslimi).

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe. Ne sqarojmë argumentet për ata njerëz që kuptojnë”. (Et-Teube: 11).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Gjëja kryesore është islami, shtylla kryesore është namazi, kurse kulmi i Islamit është xihadi në rrugë të Allahut”. (Hadithi është sahih).

Namazi është gjëja kryesore në Islam, pas shehadetit, është binjak i shumë ibadeteve, është nëna e ibadeteve, është urdhri i Allahut, porosia e fundit e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është pasqyrë e veprave të muslimanit, shenjë e madhërimit të fesë në zemër të besimtarit, është shtylla e krejt feve qiellore, është simbol i vendit islam, është besim, është denoncim nga nifaku, është rruga e besimtarëve, simbol i grupit të shpëtuar dhe miqve të Allahut, është ibadet

i përbashkët i mbarë krijesave, vepra më e mirë, mënyra më e mirë për t'iu afruar Allahut, shkollë morale, është qetësi, rehati dhe kënaqësi, është dritë dhe argument, është dhuratë hyjnore, është falënderim ndaj dhuntive të Allahut, është mlllefosje e shejtanit dhe ushtarëve të tij, çlirim i njerëzimit, të pengon nga veprat e këqija dhe e pshet, t'i shlyen mëkatet dhe t'i asgjëson, është strehimore e besimtarit në vështirësi, është mburojë dhe mbrojtje, ta sjell rizkun, është fillimi dhe mbarimi i Islamit, është shkak i fitores dhe ngadhënjimit në dynja dhe ahiret, shpëtim prej dënimit të varrit, është shpresa e të vdekurve dhe të dënuarve, shpëtim nga dënimi i Zotit, shkak për tu ngritë gradat, të mundëson ta shohësh Zotin në xhennet, është çelësi i udhëzimit, etj. Kurse lënia e sajë është mosbesim, prej mëkateve më të mëdha, është dyfytirësi, është errësirë dhe shkatërrim në dynja dhe ahiret, është shkak për përfundim të keq, shkak për tu dënuar në varr, është simbol i banorëve të xhehenemit, shkak që të fundoset njeriu në epshe, është fatkeqësi dhe bela, i mundëson shejtanit ta ngërthen, është tradhti e emanetit dhe meriton dënimin e Allahut në dy botët.

#### **c) Namazi i teravisë.**

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“Kush fal namazin me besim dhe shpresë, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

#### **d) Gjallërimi i natës së Kadrit.**

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“Kush e gjallëron natën e Kadrit me besim dhe shpresë, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Aisheja, radijAllahu anha, tregon se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Kërkoni natën e Kadrit në netët tek të dhjetëshit të fundit të Ramazanit”. (Buhariu).

#### e) Umreja.

Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] i tha:

“Kur të vjen muaji i Ramazanit, kryejeni umren gjatë këtij muaji, sepse umreja gjatë këtij muajit është sikurse haxhi”. E në transmetimin tjetër qëndron: “Umreja gjatë Ramazanit vlen sa haxhi ose sa haxhi me mua”. (Buhariu).

#### f) Leximi i Kuranit.

Ibn Abbasi, radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu më bujar, e më bujari ishte gjatë Ramazanit, kur takohej me Xhibrilin [alejhisselam]. Atë e takonte secilën natë të Ramazanit, nga i cili e mësonte Kuranin. Me të vërtetë Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] ishte më bujar se era (që sjell pllenimin). (Buhariu).

#### g) Sadakaja.

Elhamdulillah që te muslimanët tanë muaji i Ramazanit shfrytëzohet edhe për të dhënë zekatin dhe sadakanë, për shkak të shpërblimit të madh që kanë këto vepra të mira. Zatën këto zeqate dhe sadaka janë duke e mbajtur në këmbë fenë Islame në këto vende. Këto kontribute janë shkak për ndërtimin e xhamive, sponsorimin e studentëve, kujdesin për jetimët, strehimin e atyre që nuk kanë kulm mbi kokë e shumë aktiviteteve tjera.

Muslimani nuk duhet të ngurojë të ndihmoj me aq sa ka, ai që mundet jep 1000 monedha, kush nuk ka aq le ti jep 500, e ai që s’ka aq le të jep 100, e ai që s’ka as këto le të jep 10 apo le të jep një të vetme, sepse tek Allahu, çdo vepër sado që është e vogël llogaritet, sikurse na ka treguar Allahu në Kuran:

"E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë". (El-Zelzele: 7- 8).

Ne si musliman e kemi obligim që t'i kuptojmë mirë porositë e Kuranit dhe t'i zbatojmë ato, e mos të bëhemi si ata që i lexojnë ajetet, mirëpo i kalojnë sikur asgjë mos të jetë thënë.

Ja një rast se si muslimanët e parë i kanë kuptuar porositë e Allahut.

Transmeton Abdullah ibn Meduri, radijAllahu anhu, i cili thotë: kur zbriti ajeti Kuranor:

"Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumëfish atë? Allahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai". (El-Bekare: 154).

Ebu Dahdah El-Ensariu, radijAllahu anhu, tha: Allahu dëshiron prej neve borxh? Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i tha: po, o Ebu Dahdah. Tha: ma zgjat dorën o i Dërguar i Allahut. Ia zgjati dorën e i tha: unë kopshtin tim ia jap borxh Zotit tim. Tha: kopshti i tij kishte gjashtëqind pemë hurma, kurse Ummu Dahdah dhe fëmijët e tyre ishin në kopsht. Shkoi Ebu Dahdahi dhe bërtiti: Ooooo Ummu Dahdah! Urdhëro burri im, iu përgjigj gruaja. Tha: dil nga kopshti se ia kam dhënë borxh Zotit tim, e kur e dëgjoi këtë gjë Ummu Dahdahi, ua nxori fëmijëve kafshatat e hurmave nga goja dhe ua zbrazti xhepat. Atëherë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha:

"Sa e sa kalavësja të rrastë do të ketë Ebu Dahdahi në xhennet". (sahih).



## **2- Njerëzit e shkujdesur, të argëtimit dhe mëkateve.**

Ata gëzohen për llojlojshmërinë e ahengjeve dhe argëtimeve që bëhen gjatë muajit të Ramazanit, prej tyre:

### **- Ushqimet e llojlojshme të Ramazanit.**

Me të cilat ushqime mbushin barkun dhe ngopen dhe e stërngarkojnë lukthin. Nga kjo gjë shumë pak njerëz shpëtojnë. Pa dyshim se kjo është në kundërshtim me urtësinë e agjërimit, i cili kërkon pakësim të ushqimit, që ndihmon në pastrimin dhe lartësimin e shpirtit. Pastaj mbushja e barkut me llojloj ushqime të këndshme të pengon edhe gjatë faljes së namazit të teravisë.

Të vërtetën e ka thënë Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] kur thotë:

“Biri i Ademit nuk ka mbushur enë më të keqe se sa barkun e vet. I mjafton birit të Ademit disa kafshata për ta mbajtur gjallë shpirtin, e nëse e ka domosdo, atëherë një të tretën për ushqimin e tij, një të tretën për pijen dhe një të tretën për frymëmarrje”. (Tirmidhiu, sahih).

### **- Televizori, mediat sociale dhe tubimet e ndryshme gjatë ramazanit dhe përcjellja e llojloj serialeve.**

Këto gjëra të fusin në harame, qofshin harame të syrit, ose të veshit ose të gjymtyrëve tjera. Përdorimi i gjymtyrëve tuaja në gjëra të ndaluara gjatë këtij muajit të bekuar, duke pasur para sysh vlerën e këtyre ditëve, me të vërtetë është një mëkat shumë i madh.

- Përzierja e gjinive, grave dhe burrave nëpër vende të shumta, gjëra të cilat bëhen shkak për të rënë në mëkate edhe më të mëdha, siç është vetmija me grua të huaj ose rënia në mëkatin e zinasë. Për këtë gjë përgjegjësi i parë dhe kryesor është kryefamiljari.

Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Secili prej jush është bari dhe secili do të jep llogari për tufën e tij. Imami është bari dhe është përgjegjës për tufën e tij (xhematin). Burri është bari në shtëpinë e tij dhe është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është bari në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për tufën e sajë. Shërbëtori është bari në pasurinë e pronarit të vet dhe është përgjegjës për tufën e tij”. (Buhariu).

### **Gabimet që ndodhin gjatë pritjes së muajit Ramazan**

Gjatë kësaj pritje të këtij muajit të bekuar ndodhin disa gabime, disa prej tyre janë më të vogla e disa janë më të mëdha, prej tyre:

**- Mllef nga ardhja e këtij muajit të bekuar.**

Tregohet në histori se një njeri me emrin Reshid ibn Sefih ka thurur poezi, ku mes tjerash ka thënë:

*Më thërriti muaji i agjërimit, ah sikur mos të ishte ky muaj*

*Nuk do të agjëroja asnjë muaj deri në fund të kohës*

*Po të kisha mundësi ndaj ndonjë muajit*

*Do ta sulmoja me tërë forcën time këtë muaj.*

E kaploi një sëmundje e madhe këtë njeri dhe vdiq para se ta arrijë muajin e ardhshëm të Ramazanit. (Lataiful-Mearif, fq. 276).

### **Mirëpo si të jemi mikpritës të mirë?**

Ndoshta gjërat që duhet t’i bëjë muslimani si përgatitje për mikpritje të mirë të këtij sezoni të adhurimeve janë të shumta, ne shkurtimisht do t’i përmendim disa prej tyre:

1- Ta përgatisim veten për një sezon përplot me vepra të mira, e cila është mundësi shumë e madhe për të mira, për të shtuar adhurimet dhe për të fituar shumë të mira.

2- Gëzimi për ardhjen e këtij muajit, zemërgjerësia se na afrohet ky muaj, lumturia se do ta takojmë këtë muaj, sepse një njeri mund të fitojë mëshirën dhe dhuntitë e Allahut në një natë të bekuar, e të fitojë lumturinë e dynjasë dhe të ahiretit.

3- Të nxitojmë në pendim të sinqertë nga të gjitha mëkatet dhe gabimet, të bëjmë istigfar për çdo mangësi që kemi karshi Zotit, të ndiejmë keqardhje për çdo gjë që kemi bërë në të kaluarën, qofshin të mëdha ose të vogla. Këtë muaj të fillojmë nga fillimi, që ta mbushim faqen e bardhë me të mira dhe vetëm me të mira, e mos të njollosim me asgjë tjetër.

4- Të jemi të vendosur që ta shfrytëzojmë çdo çast të këtij shansi të madh në gjëra që na afrojnë drejt Zotit, qoftë falja e namazit me xhemat në xhami, plotësimi i agjërimit, falja e namazit të natës pa lodhje dhe pa mërzi, leximi i Kuranit, kujdesi për prindërit dhe farefisin, dhënia sadaka, bamirësia, e shumë vepra tjera të mira, duke përpunuar një plan-program konkret për kalimin e këtij muajit.

5- Ta falënderojmë Allahun dhe ta lavdërojmë Atë ditë e natë, nëse ta zgjat ymrin dhe ta mundëson ta takosh këtë muaj të bekuar, atëherë lute që ta lehtëson agjërimitin dhe namazin në këtë muaj.

6- Përgatit shtëpinë për mikpritje meritore të këtij mysafiri dhe nxit familjen tënde që të përgatiten për Të, duke nxjerrë të gjitha gabimet, që të jetë shtëpia e pastër dhe e përgatitur për tu mbushur me adhurime dhe respekt dhe duke përgatitur numër të mjaftueshëm të mus'hafave.

7- Llogarit paraprakisht sasinë e zekatit që duhet ta japish, nëse e plotëson vitin në Ramazan, ose nëse zakonisht e jep zekatin në Ramazan.

8- Nxito të kompensosh ditët që i ke të pa agjëruara nga Ramazani i kaluar dhe mos jeni tolerant në këtë drejtim, e të arrijë ky Ramazan pa e larë borxhin nga Ramazani i kaluar, sepse kështu bëhesh mëkatar.

## Urdhri për të agjëruar

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aqë më mirë për Të. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju”. [el-Bekare: 184-5]

### Urdhri për të agjëruar

Tek një adresim ndaj besimtarëve të këtij Ummeti, Allahu i urdhëroj ata të agjërojnë, ajo është, për t’ju larguar ushqimit, pijes dhe aktivitetit seksual me qëllimin e të vepruarit kështu me sinqeritet vetëm për hir të Allahut subhane ua teala. Kjo është sepse agjërimi i pastron shpirtat dhe i pastron ata nga të këqijat që mund të përzihen me ata dhe sjelljet e tyre të sëmura. Allahu e ka përmendur që Ai e urdhëroi agjërimin për Muslimanët sikur Ai ia kishte urdhëruar atë edhe atëherë me përpara popujve të tjerë, kështu që ata duhet ta kryenin këtë obligim me më bindje sesa gjeneratat e popujve të mëparshëm.

Të njëjtë me këtë, Allahu ka thënë:

“Për secilin prej jush, Ne caktuam ligje e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Allahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtojë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira”. [el-Maide: 48]

Allahu ka thënë në këtë ajet: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”.

Përderisa agjërimi pastron trupin dhe ngushton rrugën e Shejtanit. Në Sahihët (Sahihejn) hadithi i mëposhtëm është regjistruar: “O ju të rinj, kushdo midis jush që ka mundësi të martohet, le të martohet. Kushdo që nuk mundet, le të agjërojë, sepse ai do të bëhet si një mburoje për të”.<sup>3</sup>

Allahu pastaj dëshmon që agjërimi ndodh gjatë një numri të caktuar ditësh, kështu që të mos bëhet i rëndë për zemrat, e që do t’ia dobësonte vendosmërinë dhe durimin.

### **Hapat e ndryshme të agjërimin**

Buhariu dhe Muslimi kanë raportuar që Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “(Dita) e Arafatit ishte një ditë agjërimi. Kur obligimi për agjërimin e Ramazanit ishte shpallur, ata të cilët deshën agjëruan dhe ata që nuk deshën, nuk agjëruan”.<sup>4</sup>

Buhariu e ka regjistruar të njëjtin hadith nga Ibën Umeri dhe Ibën Mesudi.<sup>5</sup>

Allahu ka thënë: “E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri”

Muadhi komentoi: “Në fillim, ata që deshën, agjëruan dhe ata që nuk deshën, nuk agjëruan dhe ushqyen një të varfër për çdo ditë”.

Buhariu ka raportuar që Selamah bin el-Akua ka thënë që kur Ajeti: “E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri” është shpallur, ata që nuk deshën të agjëronin, paguanin Fidje (ushqimin për një person të varfër për çdo ditë që ata nuk agjëronin) derisa u shpall Ajeti (2:185) dhe kështu abrogoj ajetin e mëparshëm.<sup>6</sup> Është gjithashtu i

---

<sup>3</sup> Feth el-Bari 9:8 dhe Muslimi 2:1018

<sup>4</sup> Feth el-Bari 8:26 dhe uslimi 2:792

<sup>5</sup> Feth el-Bari 8:26

<sup>6</sup> Feth el-Bari 8:29

raportuar nga Ubejdallah nga Nefi që Ibën Umeri ka thënë: ”është abroguar”.<sup>7</sup> Es-Suddi ka raportuar që Murrabi ka transmetuar që Abdullahu ka thënë rreth këtij ajeti: “E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri”

“Do të thotë “ata të cilët e patën të vështirë për të agjëruar”. Së pari ata që deshën, agjëruan dhe ata që nuk deshën, nuk agjëruan por ushqyen një të varfër në vend të agjërimit”.<sup>8</sup> Allahu pastaj ka thënë: “e ai që nga vullneti jep më tepër”

duke kuptuar kushdo që ushqente një person më tepër, “ajo është aq më mirë për të”

Më vonë Ajeti: “E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë”[el-Bekare;185]

u shpall dhe abrogoi ajetin e me përparshëm (2:184).

### **Fidjah (shpagimi) për mos agjërimin është për pleqtë**

Buhariu ka transmetuar që Ata e ka dëgjuar Ibën Abasin të thotë: “Dhe për ata të cilët agjërojnë me vështirësi (pleqtë), ata kanë një zgjedhje për të agjëruar, në vend të kësaj ata mund të ushqejnë një të varfër (miskin) për çdo ditë.

Ibën Abbasi pastaj ka komentuar: “(Ky ajet) nuk është abroguar, është për pleqtë dhe plakat të cilët agjërojnë me vështirësi, por zgjedhin në vend të agjërimit të ushqejnë një person të varfër për çdo ditë (që ata nuk agjërojnë)”.<sup>9</sup>

Të tjerë kanë raportuar që Said ibën Xhubejr e ka përmendur këtë nga Ibën Abbasi. Kështu abrogimi këtu i aplikohet vetëm njerëzve të shëndoshë, të cilët

---

<sup>7</sup> Ibid

<sup>8</sup> Feth el-Bari 8:28

<sup>9</sup> Feth el-bari 8:29

nuk udhëtojnë dhe të cilët duhet të agjërojnë, siç Allahu ka thënë: “E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë”[el-Bekare;185]

Për sa i përket pleqve dhe plakave të cilët nuk mund të agjërojnë, ata janë të lejuar të mos agjërojnë, ata nuk janë të obliguar të agjërojnë një ditë tjetër si kompensim më vonë, sepse ata nuk janë të prirë tu përmirësohet situata në mënyrë të jenë të aftë të agjërojë ditët tjera. Kështu nga ta është e kërkuar të paguajnë një Fidje për çdo ditë që humbet. Ky është opinioni i Ibën Abbasit dhe shumë të tjerëve midis selefëve të cilët kanë lexuar ajetin: “Dhe për ata të cilët agjërojnë me vështirësi (pleqtë)”.

Për të kuptuar ata të cilët e kanë vështirë të agjërojnë<sup>10</sup> siç Ibën Mesudi ka dëshmuar. Ky është edhe mendimi i el-Buharit i cili ka thënë:

“Për sa i përket plakut i cili nuk mund të agjërojë, (ai duhet të veprojë sikurse) Enesi i cili për një ose dy vjet pasi ai u bë plak ushqej me ca bukë dhe mish një të varfër për çdo ditë që ai nuk agjëronte”.<sup>11</sup>

Kjo pikë, të cilën Buhariu ia atribuon Enesit pa një zinxhir transmetimi, është koleksionuar me një zinxhir të vazhdueshëm transmetimesh nga Ebu Ja’la Mausuli në Musnedin e tij, që Ejub bin Ebu Tamimah ka thënë:

“Enesi nuk mundte më të agjëronte. Kështu ai bëri një pjatë me Therid (bukë dhe mish) dhe ftoi tridhjetë të varfër dhe i ushqej ata”.<sup>12</sup>

I njëjti gjykim i aplikohet për gratë shtatzëna dhe ato që janë në gjidhënie, nëse ato frikësohen për veten e tyre ose fetuset. Në këtë rast, ato paguajnë Fidje dhe nuk kanë nevojë të agjërojnë ditë të tjera në vend të ditëve që ata i kanë humbur.

Imam Ibën Kethir

---

<sup>10</sup> Et-Tabari 3:431

<sup>11</sup> Feth el-Bari 8:179

<sup>12</sup> Musned Ebu Jala 7:204

## **Agjërimi i Ramazanit – një pasqyrë koncize, çfarë duhet t'i bëhet me dije çdo muslimani, çdo agjëruesi**

Në këtë kapitull të shkurtër do të mundohemi që në mënyrë të qartë dhe koncize të cekim disa rregulla të rëndësishme për muajin e Ramazanit dhe agjërimit në të. Shpresojmë se lexuesi do të gjej disa prej përgjigjeve që deri tani kanë qenë dilemë për të. Allahu është Dhuruesi i suksesit!

1. Agjërimi i muajit të Ramazanit është një prej kushteve të Islamit dhe për këtë ekziston konsensus i tërë Ummetit Islam.
2. Me hyrjen e muajit të Ramazanit (muaji i nëntë i kalendarit hixhrij), gjë e cila vërtetohet më pamjen e hënës së re, obligohet me agjërime çdo musliman, i moshërritur, mentalisht i shëndosh, që gjendet në vendin e tij (nuk është udhëtar) dhe nuk ka pengesa që pengojnë agjërimit të tij.
3. Nuk lejohet agjërimi i ditës së dyshimit (jeumush-shekk) e cila është dita 30 e muajit Sha'ban. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme thotë: “Mos agjëroni para Ramazanit një apo dy ditë” Muttefekun alejhi.
4. Agjërimi është abstenim prej gjërave që konsiderohen prishës së agjërimit (do t'i cekim më poshtë) prej agimit deri në perëndim të diellit me qëllim të adhurimit.
5. Nëse një mosbesimtar pranon Islamin gjatë ditës së agjërimit obligohet me abstenim deri në perëndim të diellit dhe nuk obligohet me kompensim të agjërimit të asaj që ka kaluar duke e përfshirë edhe ditën në të cilën e ka pranuar Islamin.
6. Mustehab është që fëmijët në mënyrë graduale të mësohen të agjërojnë muajin e Ramazanit duke mos i obliguar.



7. Nëse njeriu humbë vetëdijen gjatë ditës së Ramazanit dhe kjo nuk zgjatë tërë ditën, agjërimi i tij nuk priset por nëse nuk i kthehet vetëdija tërë ditën nuk konsiderohet se ka agjëruar këtë ditë.
8. Nëse agjërimi keqëson sëmundjen e të sëmurit nuk i lejohe agjërimi dhe është i obliguar që të prish atë.
9. Nëse agjërimi është i vështirë për të sëmurin atij i preferohet që të mos agjëroj.
10. Nëse agjërimi keqëson sëmundjen e të sëmurit i cili vuan prej sëmundjes pashërueshme njeriu në fjalë nuk duhet të agjëroj dhe duhet të ushqej një të varfër për çdo ditë që se ka agjëruar.
11. I çmenduri nuk duhet të agjëroj as që duhet të shpaguaj (me dhënë fidje) ditët që si ka agjëruar.
12. Gruaja me menstruacione dhe ajo në fazën e lehonisë nuk lejohe që të agjërojnë. Ditët që nuk i kanë agjëruar duhet të kompensohen.
13. Nëse gjakderdhja e tyre ndërpritet gjatë natës dhe del agimi para se të pastrohen me larje obligohet me agjërim dhe agjërimi i tyre është i saktë.
14. Nëse njeriu bëhet xhunub gjatë natës dhe zgjohet pasi që ka dal agimi kjo nuk e dëmton agjërimin e tij.
15. Udhëtarit i lejohe mos-agjërimi gjatë udhëtimit edhe nëse nuk ka vështirësi në të.
16. Nëse gruaja shtatzëne apo ajo që i jep gji fëmijës frikësohet për shëndetin e saj apo për shëndetin e fëmijës i lejohe që të mos agjëroj. Këto ditë ajo duhet t'i kompensoj.
17. Bërja e nijetit për agjërim gjatë natës, për ditën e nesërme (para se të del agimi) është vaxhib.

18. Një nijet mjafton për tërë muajin nëse nuk ndërpritet dhe ky është mendimi i Imam Malikut dhe këtë mendim e ka zgjedhur Shejhul Islam Ibën Tejmijje.

19. Nëse agjëruesi ha, pi ose bën marrëdhënie me gruan e tij me harresë, agjërimi i tij është në rregull.

19. Atij të cilit sheriati i lejon që të mos agjëroj i lejohet ngrënia dhe pirrja tërë ditën.

20. Atij të cilit sheriati nuk i lejon që të prish agjërimin e ai e prish qëllimisht obligohet me abstenim deri në fund të ditës.

21. Ai cili me zemrën e tij nuk ka bërë nijet për agjërim farz nuk konsiderohet si agjërues edhe nëse abstenon prej ushqimit dhe marrëdhënieve seksuale deri në fund të ditës.

22. Gjërat që prishin agjërimin janë:

- Marrëdhëniet seksuale. Ai që qëllimisht bën marrëdhënie me gruan e tij gjatë ditës së agjërimit duhet të:

Pendohet sepse ka bërë mëkat, të kompensoj atë ditë dhe të liron një rob musliman apo të agjëron dy muaj me radhë si kefaret. Gjatë këtyre dy muajve nuk i lejohen ndërprerja e agjërimit përpos me arsye siç janë ditët e Bajramit, sëmundje apo udhëtim (nga ky rregull del udhëtimi i cili bëhet me qëllim të mos-agjërimit). Nëse pa arsye nuk agjëron ndonjë ditë obligohet me agjërim prej fillimit. Nëse nuk mund të agjëron 60 ditë pa ndërprerje obligohet me ushqim të 60 të varfërve.

- Ngrënia dhe pirrja. Në këtë rast do t'i përmendim edhe injeksionet ushqyese që e prishin agjërimin (infuzionet). Barërat që jepen me injeksione intramuskulare nuk e prishin agjërimin. Transfuzionet e gjakut e prishin agjërimin. Injeksionet e insulinës nuk e prishin agjërimin.

- Ejakulimi i cili bëhet si rezultat i onanimit, prekjes apo shikimit të femrës. Nëse kjo ndodhë gjatë gjumit nuk e prish agjërimin.

- Paraqitja e gjakut të menstruacioneve apo lehonisë.
- Vjellja e shkaktuar nga vetë personi. Nëse vjell pa e shkaktuar vet personi nuk priset agjërimi.

Këto gjëra përpos menstruacioneve dhe lehonisë prishin agjërimin nëse bëhen me dije, qëllimisht dhe pa presion (që rrezikon jetën). Nëse personi është injorantë dhe e bën pa vetëdije apo me presion nuk konsiderohet se ka prishur agjërimin.

Në fund ju përkujtojmë çështjen e nijetit dhe vetëdijes që kjo vepër të jetë thjesht për Allahun sepse pa të asnjë vepër nuk është e pranuar e as që do të shpërblehet. Gjithashtu mundohuni që këtë muaj të bekuar ta zbukuroni me adhurime të shumta në mesin e të cilëve do të zgjedhim: namazi në përgjithësi dhe namazi i natës i njohur si Teravi në veçanti, leximi i Kuranit dhe të menduarit për të, lëmosha, këshillimi në punë të mira, morali i mirë, vizita për hir të Allahut, ruajtja e lidhjeve farefisnore...

## Agjërimi i Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në Ramazan

Po ju paraqesim agjërimin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke përmendur farzet, rregullat, duatë, vendimet e agjërimit dhe llojet e saj, veprat që e prishin agjërimin dhe gjërat tjera. Lusim Allahun xhel-le shanuhu që t'u mundëson muslimanëve praktikimin e sunnetit të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në çdo vepër, qoftë ajo e madhe ose e vogël.

Definicioni i agjërimit është: Agjërimi është adhurim ndaj Allahut [subhanehu ve tea'la] duke lënë ato vepra që e prishin agjërimin nga mëngjesi e deri në perëndim të diellit.

Agjërimi i Ramazanit është njëra prej shtyllave të Islamit, siç thotë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: "Islami ngritet mbi pesë shtylla: Dëshmia se s'ka të adhuruar përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në haxh". (Transmeton Buhariu dhe Muslimi.)

Njerëzit gjatë agjërimit

-Agjërimi i Ramazanit është farz për çdo musliman moshërritur, i mençur, që ka mundësi ta bëjë këtë dhe nuk është udhëtar.

-Kafiri nuk agjëron dhe nuk e ka detyrë ta bëjë kaza agjërimit nëse e pranon Islamin.

-I vogli, i cili nuk ka arritur kohën e moshërritjes, nuk e ka për detyrë të agjëroj, edhe pse është mirë të urdhërohet që të agjërojë gradualisht me qëllim që të mësohet.

-I sëmuri me sëmundje të papritur, i cili pret që të shërohet, nëse është për të agjëruar mund të mos agjërojë, të cilin e bën kaza pasi që të shërohet.

-I çmenduri nuk duhet të agjërojë as të ushqejë tjerët (si shpagim) edhe pse është i madh. Gjithashtu edhe idioti (njeriu me zhvillim mendor shumë të mangët nga lindja), i cili nuk mund të dallon dhe plaku, i cili nuk mund të dallon.

-Ai që nuk mund të agjëron nga ndonjë shkak i përhershëm, siç është pleqëria e rëndë edhe i sëmuri prej ndonjë sëmundje që nuk mund të shërohet, duhet të ushqejë për çdo ditë nga një të varfër.

-Gruaja shtatzënë dhe gjdhënësja nëse u vjen rëndë, mund të mos agjërojnë nga shkak i shtatzënisë dhe gjdhënies ose nëse kanë frikë për foshnjën e tyre, mund të mos agjërojë dhe këtë ta bëjnë kaza pasi që të largohet frika.

-Ajo që është në menstruacion dhe në periudhë të lehonisë, nuk agjëron gjatë menstruacionit dhe lehonisë, kurse pasi që të kalon kjo kohë e bën kaza.

-Ai që detyrohet të prish agjërimin për të shpëtuar ndokënd nga mbytja ose djegia, më vonë këtë e bën kaza.

-Udhëtari nëse do mund të agjëroj, e nëse do e prish agjërimin, e pastaj i bënë kaza ditët në të cilat nuk ka agjëruar, pa marrë parasysh a është udhëtimi i përkohshëm ose i përhershëm. Pra, agjërimin mund ta prish, pasi që është jashtë vendit të vet.

## Rregullat e agjërimit

### 1- Nijeti:

Është farz të bëhet nijet para agimit në agjërimin e Ramazanit, ngase Muhammedi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Ai që nuk vendos për agjërimin (nuk e bën qëllim me vetëdije) para mëngjesit, nuk ka agjërim". (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

Gjithashtu Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Ai që nuk bën nijet për agjërim natën (dmth: para mëngjesit), nuk ka agjërim". (Hadithi është sahih, transmeton Nesaiu.) Vendi i nijetit është zemra, kurse të bërit nijet me gojë nuk transmetohet nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e as nga ndonjë sahabi.

### 2- Koha e agjërimit:

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

"Hani dhe pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim..." (El-Bekare: 187)

Ekzistojnë dy lloj agimesh:

- Agimi i rrejtshëm: Në këtë kohë nuk lejohet falja e namazit të mëngjesit (sabahut), ku agjëruesi nuk e ndërpret ushqimin agjëruesi. Ky mëngjes është kur të del një dritë e bardhë e gjatë e ndriçueshme dhe e ngritur si bishti i luanit.

- Agimi i vërtetë: Në këtë kohë ndalohet ngrënia për agjëruesin dhe fillon koha e namazit të sabahut. Kjo kohë është kur paraqitet drita e kuqe e përhapur çdokund mbi kodra e male.

Kurse, kur të drejtohet nata nga lindja e të shkon dita nga perëndimi dhe të perëndon dielli, atëherë lejohet që agjëruesi të bëjë iftar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Kur të drejtohet, të vjen nata nga kjo anë (lindja) e të

shkon dita nga kjo anë (perëndimi) dhe të perëndon dielli, agjëruesi lejohet të bën iftar". (Tra. Buhariu dhe Muslimi.) Dmth: pas perëndimit të diellit edhe pse shihet drita e tij.

### 3- Syfyri (Suhuri):

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Vija ndarëse mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ehli kitabit është ngrënia e syfyrit". (Transmeton Muslimi)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Bereqeti është në tre gjëra: Në xhemat (bashkësi), në paçamurë (përshesh) dhe në syfyri". (Hadithi është sahih, transmeton Taberaniu në "Mu'xhemul-kebir".)

Syfyri është bereqet ngase është pasim i sunnetit të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe të mundëson që më lehtë ta kalosh agjërimitin. Pastaj, syfyri është ushqim i bekuar, siç e ka emërtuar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: "Nxitoni në ushqimin e bekuar". (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Syfyri është ushqim i bereqetshëm, prandaj mos e leni, së paku pini një gllënkë ujë, ngase Allahu dhe melekët bëjnë dua për atë që ngrihet për të ngrënë syfyri". (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Sa syfyri i mirë për besimtarin është hurma". (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

Prej sunnetit të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] është vonimi i syfyrit deri në mëngjes.

### 4-Agjëruesi duhet lënë:

a-Thëniet e rrejshme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Kush nuk i len thëniet e rrejshme dhe veprimin me to, Allahu nuk ka nevojë që ai ta len ushqimin dhe pijen". (Transmeton Buhariu)

b-Fjalët e kota dhe të jomoralshme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Agjërimi nuk është largim nga ngrënia dhe pija, por agjërim është largimi nga fjalët e kota dhe të jomoralshme, ashtu që nëse të shan dikush ose nuk sillet mirë ndaj teje, thuaj: unë agjëroj, unë agjëroj". (Hadithi është sahih, transmeton Ibën Huzejmeja.)

5-Agjëruesit i lejohet:

- Të bëhet xhunub. Aisheja radijAllahu anha tregon se "Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e takonte mëngjesi duke qenë xhunub, e kur ngritej lahej dhe vazhdonte agjërimin". (Mutefekun alejhi)

- Të përdor misvakun. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Sikur mos t'i vinte rëndë ummetit tim, do t'i urdhëroja të përdorin misvakun në çdo abdest". (Mutefekun alejhi)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në këtë hadith nuk veçoi agjëruesin prej të tjerëve. Duke u nisur nga kjo, themi se përdorja e misvakut është sunnet edhe për agjëruesin para çdo abdestit dhe para çdo namazit, dhe në çdo kohë, qoftë para ose pas drekës.

- Shpëlarja e gojës dhe hundës. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] shpërlante gojën dhe hundën edhe pse ishte duke agjëruar, mirëpo i ka ndaluar agjëruesit ta teprojnë gjatë shpëlarjes së gojës dhe hundës, duke thënë: "...shpërlaje mirë hundën, përveçse nëse je agjërueshëm". (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

- Afrimi grave dhe puthja e tyre. Aisheja radijAllah anha tregon se "Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i puthte (gratë e tija) duke qenë agjërueshëm, mirëpo e përmbante veten". (Mutefekun alejhi)

Mirëpo, këtë nuk ia preferojmë të riut, ngase ndodh që nuk mund ta përmban veten e tij e të bëjë marrëdhënie me gruan e tij, gjë e cila ia prish agjërimin, kurse



i lejohet plakut, ngase “ai mund të përmbaj veten e tij”. (Hadithi sahih, transmeton Ahmedi.)

- Analiza e gjakut dhe marrja e injekcioeneve joushqyese. Pasi që këto gjëra as që ushqejnë e as që kalojnë nëpër fyt, nuk konsiderohen prej veprave që e prishin agjërimin.

- Hixhameja. Ibni Abbasi radijAllahu anhu thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka bërë hixhame duke qenë i agjërueshëm”. (Buhariu) Në këtë hyn edhe nxjerrja e dhëmbit.

- Shijimi i ushqimit. Kjo vepër nuk e prish agjërimin nëse nuk hyn në fyt. Kjo që thamë vlen edhe për pastën e dhëmbëve, ngase transmetohet nga Ibni Abbasi radijAllahu anhu, i cili thotë: “S’ka gjë nëse shijon uthullën ose ndonjë gjë tjetër, nëse kjo nuk depërton në fyt, kur je agjërueshëm”. (Buhariu)

- Përdorimi i syrmeve dhe pikave që hudhen në sy. Këto gjëra nuk e prishin agjërimin pa marrë parasysh se a depërtojnë në fyt ose jo, ngase Imam Buhariu [rahimehull-llah] thotë: “Enesi ibën Maliku, Hasan Basriu dhe Ibrahim Nehaiu i kanë lejuar përdorimin e syrmes agjëruesit (agjërueses)”.

6- Iftari.

- Nxitimi i iftarit. Kjo vepër është prej sunnetit të të Dërguarit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe është në kundërshtim me traditën e çifutëve dhe të krishterëve, të cilët presin derisa të dalin yjet. I Dërguari [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Njerëzit janë në të mirë përderisa e nxitojnë iftarin”. (Mutefekun alejhi)

“Ummeti im do të mbesin në sunnetin tim, përderisa nuk vonojnë iftarin derisa të dalin yjet”. (Hadithi sahih, transmeton Ibën Hibbani.)

- Ngrënia e iftarit duhet të jetë para faljes së akshamit. Enesi radijAllahu anhu thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] hante iftarin para se të falej”. (Hadithi është hasen, transmeton Ebu Davudi.)

- Me çka është mirë të fillohet iftari? Enesi [radijAllahu anhu] thotë: I Dërguari bënte iftar me hurma të freskëta, nëse nuk kishte të freskëta, atëherë me të thata, e nëse nuk kishte hurma, atëherë pinte ujë”. (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

Ç’duhet thënë para se të fillosh të hash iftarë? Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Agjëruesi në kohë të iftarit posedon dua që nuk refuzohet”. (Hadithi është sahih, transmeton Ibën Maxheja.)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] gjatë iftarit thoshte:

“Shkoi etja, u lagën venat dhe mbeti shpërblimi insha-Allah”. (Hadithi është hasen, transmeton Ebu Davudi.)

7- Veprat që prishin agjërimit:

- Ngrënia dhe pirja me qëllim. Agjërimi prihet pa marrë parasysh nëse ky ushqim është i dobishëm ose është i dëmshëm, siç është pirja e duhanit. Mirëpo, nëse e bën këtë nga harresa, me gabim ose nga përdhunimi, atëherë s’ka gjë insha-Allah. I Dërguari [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Nëse një njeri nga harresa han dhe pi, le ta plotëson (vazhdon) agjërimitin e tij, ngase ky është ushqimi me të cilin e ka ushqyer Allahu dhe pije që ia ka ofruar Allahu”. (Mutefekun alejhi)

- Vjellja me qëllim. Nëse vjell me qëllim, agjërimitin prishet, e nëse vjell pa qëllim, atëherë nuk prishet agjërimitin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Atë që e kapë vjellja nuk duhet ta bëjë kaza, kurse ai që vjell me qëllim duhet ta bëjë kaza”. (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi.)

- Marrëdhëniet seksuale. Nëse i ndodh një gjë e tillë njeriut gjatë Ramazanit, kjo ia prish agjërimitin, mirëpo nuk i lejohet të hajë dhe të pij gjatë tërë ditës deri në iftar, e pastaj këtë duhet ta kompenson dhe të shpague, duke liruar një rob. Nëse nuk ka rob, atëherë duhet të agjëroj dy muaj pa ndërprerë, e nëse nuk ka mundësi ta bëjë as këtë, atëherë duhet të ushqej gjashtëdhjetë të varfër.

- Injeksionet e infuzionit. Këto injeksione e prishin agjërimin, ngase janë ushqim.
- Menstruacioni dhe lehonja. Gruas ia prishin agjërimin menstruacioni dhe lehonja. Kur t'i kalon kjo periudhë, duhet t'i kompensojë ditët e kaluara.
- Injeksionet e gjakut. Nëse agjëruesi ka gjakderdhje të madhe, e i jepet gjak për të zëvendësuar gjakun e derdhur, kjo ia prish agjërimin.

#### 8- Kompensimi (Kazaja):

Ai që ka prishur agjërimin me ndonjë arsye është e pëlqyeshme që të nxiton t'i kompenzon këto ditë. Nëse nuk ka mundësi t'i agjëron pandërprerë, mund t'i agjërojë me ndërprerje.

Të gjithë dijetarët janë të pëlqimit se ai që ka vdekur e i kanë mbetur namaze pa falur, askush nuk duhet t'ia kompenzon. Gjithashtu edhe ai i cili vdes e nuk ka mundur të agjëroj, askush nuk duhet të agjëroj për të, por për çdo ditë duhet të ushqej nga një të varfër. Nëse i vdekuri ka zotuar agjërim, atëherë të afërmit e tij duhet të agjërojnë, ngase Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Ai që vdes e ka zotuar agjërim, duhet të agjëroj i afërmi i tij". (Mutefekun alejhi)

#### 9- Lënia e namazit dhe agjërimi:

Ai që agjëron, kurse e len namazin, duhet të dijë se ka lënë një shtyllë më të rëndësishme se agjërimi. Agjërimi nuk ka mundësi t'i bëjë aq shumë dobi nëse ky njeri e le namazin, ngase namazi është shtyllë e fesë, ngase ai që e le namazin, mund të del prej feje, kurse ai që del prej feje, prej tij nuk pranohet asnjë vepër. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Marrëveshja që është mes neve dhe atyre është namazi, ai që e le ka bërë kufër". (Hadithi është sahih, transmeton Ahmed)

#### 10- Namazi i natës (teravija)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] një kohë e ka falur namazin e taravisë me xhemat, e pastaj e ka lënë duke pasur frikë se po i bëhet farz ky namaz ummetit

të vet, e pastaj nuk do të kenë mundësi ta kryejnë. Ky namaz falet tetë rekate pa vitrin, siç transmeton Aisheja radijAllahu anha e cila thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] as gjatë Ramazanit, e as jashtë Ramazanit nuk falte mbi njëmbëdhjet rekate”. (Mutefekun alejhi)

Prandaj, muslimani obligohet të veproj sipas sunnetit të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] edhe pse shumica e njerëzve e kanë lënë pas dore këtë sunnet.

Nxitimi që e shohim në namazin e muslimanëve, qoftë gjatë leximit të Kuranit, gjatë rukusë, sexhdes, etj në shumë raste e dëmton namazin, e në disa raste edhe e prish namazin. Zoti na ndihmoftë!

#### 11- Sadakatul-fitri

Sadakatul-fitri është farz duke u bazuar në hadithin që e transmeton Ibën Omeri [radijAllahu anhu], i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë farz sadakatul-fitrin për njerëzit në Ramazan”. (Mutefekun alejhi)

Zekatul-fitri është vaxhib për çdo musliman, qoftë i vogël ose i madh, burrë ose grua, i lirë ose rob.

Sasia e saj. Zekatul-fitër duhet dhënë një sa' (katër grushta) ose gjysmë sa'i (dy grushta) nga ajo që më tepër ushqehen njerëzit në atë vend. Këtë obligohet ta bëjë kushdo që ka ushqim të mjaftueshëm për më shumë se një ditë e një natë.

Zekatul-fitri nxiret ditën e Bajramit para se të falet namazi i Bajramit, mirëpo mundet të jepet edhe para kësaj dite (një ose dy ditë), kurse nuk lejohet të vonohet pas namazit të bajramit.

## Vlera e leximit të Kuranit dhe sjellja e selefit ndaj Kuranit

Pa dyshim se fjala më e mirë është Fjala e Allahut, e shpallur në Librin e Tij, të cilin e ka sjellë shpirti besnik, Xhibrili [alejhis-selam] mbi zemrën e Muhammedit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], për tua tërheq vëmendjen njerëzimit me gjuhë arabe të qartë.

Kurani i madhërishtëm dhe sunneti i Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] janë përplot me citate që flasin mbi vlerën e leximit të Kuranit dhe veprimet sipas tij.

Ajetet dhe hadithet që flasin mbi vlerën e leximit të Kuranit

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kurani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); Allahu e di ç ‘punoni ju’”. (El-Ankebut: 45).

“Ne do ta lexojmë ty e nuk do të harrosh (Kuranin)”. (El-A’la: 6).

“Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata e shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet. Që Ai (Allahu) do t’ju plotësojë shpërblimin e tyre, e edhe do t’ju shtojë nga mirësia e Tij, vërtet Ai është mëkatfalës dhe shumë mirënjohës”. (Fatir: 29- 30).

Kurse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

1- Ebu Umame [radijAllahu anhu] thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “Lexojeni Kuranin, vërtet ai do të ndërmjetësojë Ditën e Gjykimit për të zotët e vet”. (Muslimi)

2- Abdullah ibn Mesudi [radijAllahu anhu] thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kush e lexon një shkronjë nga Kurani e meriton një

shpërblim, kurse një e mirë vlen sa dhjetë të ngjashme me të. Nuk jam duke thënë: Elif lam mim, është një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami është një shkronjë dhe mimi është një shkronjë”. (transmeton Tirmidhiu, hadithi është sahih).

3- Nevas bin Sem'an [radijAllahu anhu] thotë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “Ditën e Gjykimit do të vijë Kurani dhe të zotët e tij, të cilët vepronin sipas tij në këtë botë (dunja), u prijnë suret “El-Bekaretu” dhe “Ali imran”, të cilat ndërmjetësojnë për shokun (lexuesin) e vet”. (Muslimi)

4- Uthman ibn Afan [radijAllahu anhu] thotë se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Më i miri prej jush është ai i cili mëson Kuran dhe ia mëson atë dikujt”. (Buhariu)

5- Ebu Musa El-Esh'ariu [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Shembulli i besimtarit që lexon Kuranin, është sikurse shembulli i qitrës (etruxhxhetu): aroma e së cilës është e mirë dhe shijen e ka të mirë; shembulli i besimtarit që nuk e lexon Kuranin, është sikurse hurma (temretu): nuk ka erë, por shijen e ka të ëmbël; ndërsa shembulli i munafikut (hipokritit) i cili e lexon Kuranin, është sikurse shembulli i krizantemës (lule vjeshte) (rejhanetu), aroma e së cilës është e mirë, ndërsa shija e ithët. Shembulli i munafikut i cili nuk e lexon Kuranin, është sikurse shembulli i kungullit të egër (handzaletu), që nuk ka aromë, kurse shijen e ka të idhët”. (Muttefekun alejhi)

6- Umer ibnul Hattabi [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Vërtet Allahu me këtë Libër do t'i ngrit disa popuj, ndërsa do t'i ulë disa të tjerë”. (Muslimi)

7- Ibnu Umer ibnul Hattabi [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Nuk ka xhelozitë në dy veta: Njeriu të cilit Allahu ia ka dhënë Kuranin dhe ai e lexon atë (në namaz) natën dhe ditën, dhe njeriu të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai atë e harxhon natë e ditë në bamirësi”. (Muttefekun alejhi)

8- Berra bin Azib [radijAllahu anhuma] thotë: “Ishte një njeri i cili lexonte suretull Kehf, kurse pranë tij ishte një kalë i lidhur me dy litarë. Në një moment zbriti një re dhe filloi t'i afrohet, ndërsa kali filloi të ikë prej saj. Pasi agoi, njeriu erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i tregoi për atë që kishte ndodhur. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Kjo është mëshirë, zbriti për hir të Kuranit”. (Muttefekun alejhi)

9- Abdullah ibnu Amr ibnul Asi [radijAllahu anhuma] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Poseduesit të Kuranit do t'i thuhet: Lexo dhe hip lartë, lexoje ashtu si e ke lexuar në dynja. Vendi yt do të jetë ke ajeti i fundit të cilin do ta lexosh”. (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu thonë: hadith hasen sahih)

10- Ebu Musa [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Ruajeni Kuranin, betohem në Atë që shpirti i Muhammedit është në duart e Tij, vërtet Kurani zgjidhet më shpejt se sa deveja nga litari i saj”. (Muttefekun alejhi)

11- Ibnu Umeri [radijAllahu anhuma] tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Vërtet shembulli i një hafidhi të Kuranit është sikurse shembulli i një deveje të lidhur. –Nëse kujdeset për të e mban e nëse e lë ik”. (Kështu pra është edhe me hafidhin e Kuranit, nëse gjithnjë e lexon do të mbetet hafidh i tij, përndryshe do ta harrojë). (Muttefekun alejhi)

12- Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “Allahu nuk i lejon askujt atë që ia ka lejuar Pejgamberit, që me zë të bukur, melodik e të lartë ta lexojë Kuranin”. (Muttefekun alejhi)

13- Berra bin Azib [radijAllahu anhuma] thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke lexuar në namazin e jacisë “Vettini vezzejtuni” (suren Tin). Unë nuk kam dëgjuar zë më të bukur se zërin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]”. (Muttefekun alejhi)

Disa hadithe që flasin për vlerën e disa sureve dhe ajeteve:

1- Nga Ebu Seid El-Huderijj [radijAllahu anhu] përcillet se i Dërguari Allahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë për “KulhuvAllahu ehad”: “Për Atë, shpirti im në duart e të cilit është, kjo sure është e barabartë me një të tretën e Kuranit”. Në një transmetim tjetër tregohet se i Dërguari i Allahut u tha shokëve të tij: “A asnjëri prej jush nuk mund ta lexojë një të tretën e Kuranit brenda një nate?” –Kjo iu duk e rëndë atyre dhe thanë: “Cili prej nesh do të mund ta përballonte o i Dërguari i Allahut?” –Në atë rast u përgjigj: “KulhuvAllahu ehad. Allahus-samed është një e treta e Kuranit” (Transmeton Buhariu)

2- Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë se: “Kul huvAllahu ehad' është e barabartë me një të tretën e Kuranit”. (Transmeton Muslimi)

3- Ebu Mes'ud El-Bedriij [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kush i lexon dy ajetet e fundit të sures “Bekare” gjatë një nate, do t'i mjaftojnë”. (Muttefekun alejhi)

4- Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë: “Më autorizoi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] për ruajtjen e zekatit të Ramazanit (sadakai fitrit) dhe më erdhi një udhëtar që filloi të marrë ushqim, e kapa dhe i thashë: “Patjetër do të të dërgoj te i Dërguari i Allahut!” Ai tha: “Unë jam i nevojshëm, unë kam familje dhe nevojë shumë të madhe”. Unë e lejova të shkojë. Kur agoi, i Dërguari i Allahut tha: “O Ebu Hurejre ç'bëri me ty ai që e zure mbrëmë?” Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, u ankua në nevojshmëri dhe familje, më është dhimbsur dhe për këtë e lashë të hyjë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Sa i përket atij, ai të ka gënjyer dhe prapë do të vijë”. Pasi e dija se do të vijë prapë, sipas fjalëve të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], unë e pritja: erdhi dhe filloi të marrë ushqim. Unë i thashë: “Të dërgoj te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]”. Ai prapë tha: “Më lësho, unë jam i nevojshëm, kam shumë fëmijë dhe nuk do të vij tjetër herë”. Mu dhimbs dhe e lëshova të shkojë. Të nesërmen i Dërguari i



Allahut më tha: “O Ebu Hurejre ç'bëri me ty ai që e zure mbrëmë?” Unë i thashë: “Ankohej se ka nevojë shumë të madhe dhe ka shumë fëmijë. Mu dhimbs dhe e lirova të shkojë”. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] më tha: “Ai të ka gënjyer dhe përsëri do të kthehet”. E prita për të tretën herë kur erdhi të marrë ushqim. E kapa dhe i thashë: “Gjithsesi do të të dërgoj te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] Kjo është hera e tretë që ti thua se nuk do të kthehesh dhe prapë vjen”. Ai më tha: “Liromë, sepse unë do t'i mësoj disa fjalë, të cilat do të sjellin dobi te Allahu”. I thashë: “Cilat janë ato?” Ai më tha: “Kur të shkosh të fleshë në shtratin tënd, lexoje ajeti Kursinë deri në fund të ajetit: “Allahu la ilahe il-la huvel hajjul kajjumu”, dhe se Allahu atë natë do të ruajë dhe se shejtani nuk do të afrohet deri në agim. Për këtë e lejova të shkojë. Të nesërmen pas agimit, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] më tha: “Çka bëri rob i me ty dje?” Unë i thashë: “O i Dërguari i Allahut, ai më premtoi se do të më mësojë disa fjalë me të cilat Allahu do të më sjellë dobi, për këtë e lejova të shkojë”. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] më tha: “Cilat janë ato fjalë?” Unë i thashë se ai më tha: 'Kur të shkosh të flesh lexoje ajeti Kursinë “Allahu la ilahe il-la huvel hajjul kajjumu”, atë do ta kesh vazhdimisht mbrojtës të Allahut, as nuk do të të afrohet ndonjë shejtan derisa të zgjohesh. Prapë e lejova të shkojë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Të ka thënë të vërtetën, edhe pse ai gjithmonë është gënjeshtar. A e di se me kënd ke biseduar prej tre netësh o Ebu Hurejre?” I thash: Jo. Ai ishte shejtani!”, - m'u përgjigj. (Buhariu)

5- Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Ata njerëz që tubohen në një rën prej shtëpive të Allahut (xhami), që të lexojnë Librin e Allahut dhe ta studiojnë në mes veti, do t'ju vijë atyre paqja (qetësia) e plotë e Allahut dhe do t'i mbulojë mëshira e Tij, dhe melaqet do të kujdesen për sigurimin e tyre e Allahu do t'i lavdërojë tek ata që i ka pranë”. (Muslimi)

Për këto argumente që i paraqitëm muslimanët duhet dhënë rëndësi mësimi të Kuranit, duhet ndërlidhur fëmijët tanë me Kuranin, duhet nxitur që në secilën lagje, secila xhami të ketë vend ku do të mësohet Kurani.

Kujdesi që në çdo lagje të kemi vende, që secila xhami të mëson fëmijët leximin e Kuranit do të na sjellë shumë dobi. Prej tyre janë:

- 1- E mësojmë leximin e Kuranit, e mësojmë përmendësh dhe na shtohet dashuria ndaj tij.
- 2- I ndërlidhim fëmijët me xhamitë.
- 3- E shfrytëzojnë kohën në veprën më të dobishme.
- 4- Shkakton edukim të mirë të fëmijës, me ç'rast edhe prindi fiton nga sevapet që i fiton ai fëmijë.
- 5- Ata që tubohen në mexhlise të tilla fitojnë sevape të ndryshme, siç u përmend në hadithin e mëparshëm..
- 6- I largojmë fëmijët tanë nga humbja e kohës pa dobi.

### **Si të përfitojmë nga Kurani**

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Në të gjitha këto ka përkujtim, për atë që ka zemër, ka hedhur dëgjimin dhe është dëshmitar”. (Kaf: 37).

Nëse dëshiron të përfitosh nga Kurani, përmbli dhe zemrën gjatë leximit, hedhe dëgjimin, konsidero veten se Allahu të drejtohet me këto ajete, pasi që Allahu t'i ka dedikuar këto ajete ty. Për tu arritur dobia nga leximi i Kuranit duhet të ketë elemente që ndikojnë, vend që e pranon këtë ndikim, kushti për tu realizuar ndikimi dhe largimi i pengesës që e pengon realizimin. Përmbushja e këtyre katër kushteve mundëson arritjen e efektit të plotë. Këto gjëra ajeti i lart cituar i përmbledhë dhe i sqaron me sqarim të plotë.

Pjesa e ajetit: “Në të gjitha këto, ka përkujtim”, dmth në ajetet që kanë kaluar nga sureja Kaf deri në këtë ajet. Ky është elementi ndikues.

“Për atë që ka zemër”, është vendi që e pranon ndikimin. Qëllimi është zemra e gjallë që kupton atë që ia thotë Allahu, sikurse thotë në ajetin tjetër:

“...ai (Kurani) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kuran i qartë. Për t’ia tërhequr vërejtjen ati që është gjallë...”. (Jasin: 69-70). Dmth atij që ka zemër të gjallë.

“Dhe ka hedhur dëgjimin”. Dmth ka drejtuar dëgjimin e tij dhe e ka angazhuar këtë shqisë që të dëgjon atë që i thuhet. Kjo është kushti që të arrihet ndikimi me fjalë.

“Dhe është dëshmitar”. Dmth është i pranishëm me zemër, nuk është duke munguar.

Ibn Kutejbeja [rahimehull-llah] thotë: dëgjo Librin e Allahut duke qenë i pranishëm me zemër dhe kuptim, e jo gafil dhe i pakujdesshëm. Me këtë ka aluduar në pengesën e cila mund të pengon arritjen e dobisë, që është neglizhenca (gafleti) dhe pakujdesi ndaj asaj që i thuhet dhe mendimi rreth asaj që i thuhet. Pra, nëse gjendet elementi ndikues, që është Kurani, vendi që e pranon ndikimin, që është zemra e gjallë, ekziston kushti, që është dëgjimi dhe largohet pengesa, që është angazhimi i zemrës dhe moskujdesi ndaj asaj që i thuhet dhe marja me gjëra tjera në atë kohë, do të arrihet ndikimi, që është pasja dobi nga Kurani i madhëruar.

Si ta lexojmë Kuranin

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“...dhe Kuranin lexoje me vëmendje”. (El-Muzzemmil: 4). Dmth, lexoje ngadalë, me kujdes që të ndihmon ta kuptosh Kuranin dhe të meditosh rreth ajeteve të tija.

E kanë pyetur Ummu Selemen [radijAllahu anha], si e lexonte Kuranin Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]? Është përgjigjur: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur lexonte Kuran, e ndalte leximin në secilin ajet. Lexonte bismil-lahir-rahmanir-rahim, pastaj ndalej, lexonte el-hamdulilahi rabbil-alemin, pastaj ndalej, lexonte er-rahmanur-rahim, pastaj ndalej, lexonte maliki jeumid-din, pastaj ndalej. Kështu vepronte deri në fund të sures”. (Transmeton Tirmidhiu, hadithi është sahih).

Është e pëlqyer që leximi i Kuranit të bëhet ngadal, të zbukurohet zëri dhe mos të nxitohet.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Zbukuroni zërin e juaj gjatë leximit të Kuranit, sepse zëri i bukur ia shtonë bukurinë Kuranit”. (Ebu Davudi dhe tjerët, hadithi është sahih).

Kurse Abdullah ibn Mesudi [radijAllahu anhu] thotë: “Mos e lexoni Kuranin sikur kur e hidhni rërën e as sikur kur e lexoni poezinë, por lexoni ngadalë dhe ndaluni në mrekullitë e tija, lëvizni zemrat dhe mos ta keni qëllim përfundimin e sures”. (Buhariu).

Është e pëlqyer që pasi të lexon Kuran të bëjë lutje dhe të kërkon prej Allahut ndonjë gjë që i nevojitet, sepse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush lexon Kuran, le të kërkon prej Allahut me këtë vepër çka të dëshiron”. (Tirmidhiu, hadithi është hasen).

Kurani është argument për ty ose kundër teje

Ky nëntitull është marrë nga hadithi të cilin e transmeton Imam Muslimi në “sahihun” e tij, hadith i cili i ndaka njerëzit në dy grupe:

Një: lexues i Kuranit, për të cilin Kurani do të jetë argument për Të në Ditën e Kijametit. Ky është njeriu i cili e ka lexuar Kuranin, ka vepruar sipas urdhrave të Kuranit, largohet nga harami, hallallin e konsideron hallall, haramin haram, me të

gjykon dhe atë e arbitron, me gjykimin e tij është i kënaqur dhe mediton rreth kuptimeve të ajeteve të tij.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend”. (Sad: 29). Ai vazhdimisht lexon Kuran, e mëson përmendsh dhe e dëgjon, qoftë drejt për së drejti ose nëpërmjet pajisjeve multimediale.

Dy: lexuesi që lexon Kuran, mirëpo ky Kuran do të jetë argument kundër tij në Ditën e Kijametit. Ky njeri është ai që e lexon Kuranin, mirëpo nuk vepron sipas urdhrave të Kuranit, nuk largohet prej ndalesave të Kuranit, hallallin nuk e konsideron hallall, as haramin haram, nuk gjykon me te as nuk arbitrohet tek ai, nuk e pëlqen gjykimin e tij, nuk i intereson ta kuptojë, të meditojë rreth tij e as ta zbatojë në jetën e tij. Ai e lexon ajetin:

“...mandej sinqerisht të lutemi për mallkim, dhe mallkimi nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve”. (Ali Imran: 61). Mirëpo prapë se prapë i gënjën njerëzit gjatë bisedës, në premtime, në sjelljen e tij, në marrëveshje, etj. Është për tu habitur që , kafirat disa herë i gjenë ma të drejtë se muslimanët në bisedat, sjelljet dhe premtimet e tyre.

Abdullah ibn Abbasi [radijAllahu anhu] ka thënë: Ka zbritur Kurani që të veprohet sipas tij, kurse njerëzit leximin e konsiderojnë vepër”.

Disa njerëz e lexojnë Kuranin, bile edhe përmendësh e mësojnë, mirëpo aspak nuk veprojnë sipas porosive që janë brenda në Kuran. Sjellja e tyre është krejtësisht në kundërshtim me atë që është në Kuran.

Disa të tjerë leximin e Kuranit e kanë bërë profesion nga i cili fitojnë para. Kjo është e ndaluar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Lexoni Kuranin dhe veproni me të, mos e teproni e as mos e leni pas dore, mos hani me të e as mos u pasuroni me Kuran”. (Ahmedi dhe të tjerët, hadithi është sahih).

“Lexoni Kuran dhe kërkoni me të prej Allahut, para se të vijnë disa njerëz, të cilët do të lexojnë Kuran dhe do të kërkojnë me të prej njerëzve”. (Ahmedi dhe të tjerët, hadithi është sahih).

Mos u largoni nga Kurani

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“E i Dërguari tha: “O Zot imi, vërtet, populli im e konsideroi këtë Kuran si (diç) të hedhur!”. (El-Furkan: 30).

Mushrikët e Mekës, kur u lexonte Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] Kuran, ata nuk e dëgjonin, por bisedonin dhe e ngritnin zërin me biseda që mos ta dëgjojnë Kuranin. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Ata që nuk besuan thanë: “Mos dëgjoni këtë Kuran dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni!”. (Fussilet: 26).

Mosbesimi dhe mosbindja në Kuran është largim prej tij.

Moskuptimi dhe mosmeditimi mbi ajetet e tij është largim prej Kuranit.

Mosveprimi me te, moszbatimi i urdhrave dhe moslargimi nga ndalesat është largim prej tij.

Mos-gjykimi sipas tij dhe mos-arbitrimi i tij është largim prej tij.

Mos-leximi i tij është largim prej tij.

E lusim Allahun që të na largojë nga ajo që e hidhëron dhe të na orienton nga ajo që i pëlqen, siç është leximi i Kuranit, memorizimi i tij dhe veprimi sipas tij gjatë natës dhe ditës, ashtu sikur e dëshiron dhe e pëlqen Ai. Amin.

## Selefi dhe Kurani

Jeta e selefit është përplot shembuj interesantë mbi interesimin e madh që e kanë pasur ndaj leximit të Kuranit. Në vijim do t'i sjellim vetëm disa prej tyre:

1- Abdullah ibn Amr ibn Asi [radijAllahu anhu] tregon dhe thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] më tha: lexoje krejt Kurandin për një muaj. I thashë: mundem edhe ma tepër. Më tha: lexoje për 20 netë. I thashë: mundem edhe ma tepër. Më tha: lexoje për shtatë ditë, e mos i shto asgjë kësaj”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka ndaluar Abdullah ibn Amrin që ta lexojë Kurandin për ma pak se shtatë, ose sipas disa transmetimeve tjera, për më pak se tre ditë, sepse njeriu që e lexon krejt Kurandin për më pak se kaq ditë nuk mundet ta kuptojë, e aspak nuk mundet të meditojë rreth asaj që e lexon. Për këtë, po ta lexon një musliman krejt Kurandin për shtatë ditë, kjo do të ishte një punë e vlefshme, sepse feja është lehtësim.

2- Musejeb ibn Rafiu thotë: Abdullah ibn Mesudi [radijAllahu anhu] thoshte: bartësi i Kuranit duhet të njihet gjatë natës, kur tjerët flenë, duhet të dallohet gjatë ditës, kur tjerët hanë ushqim, duhet të jetë i mërzitur kur tjerët gëzohen, duhet të heshtë kur njerëzit përzihen tepër, duhet të ketë përulësi dhe përqendrim, kur njerëzit kanë kibër. Bartësi i Kuranit duhet të jetë lotues, i mërzitur, i butë, i urtë dhe njeri që heshtë. Bartësi i Kuranit nuk duhet të jetë i vrazhdë, as neglizhent (gafil), nuk duhet të bërtasë dhe nuk duhet të hidhërohet.

3- Junus ibn Xhubejri [rahimehull-llah] thotë: Ishim duke ecur me Xhundubin [radijAllahu anhu], e i thashë: më këshillo. Tha: ke frikë Allahun, kujdesu për Kurandin, sepse ai është dritë në natën e errët dhe udhëzim gjatë ditës. Veproni sipas tij edhe nëse e keni rëndë dhe vështirë. Nëse të vjen ndonjë sprovë, jepe pasurinë tënde, e mos e jep fenë tënde. Nëse vazhdon kjo sprovë, jepe vetveten dhe pasurinë e mos e jep fenë tënde, sepse i prishur është ai që e ka prishur dinin

e tij dhe i plaçkitur është ai të cilit ia kanë plaçkitur fenë. Dije se s'ka vështirësi pas xhennetit dhe pasuri pas xhehenemit”.

4- Imran El-Xheuni ka thënë: Xhundubi thoshte: ishim fëmijë të vegjël dhe ecnim me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Ne e mësuam imanin para se ta mësojmë Kuranin, pastaj e mësuam Kuranin, e me këtë e shtuam imanin.

5- Ata ibn Saibi thotë: Ebu Abdur-Rahmani thoshte: e kemi marrë Kuranin prej disa njerëzve që na tregonin se kur i mësonin dhjetë ajete, nuk i kalonin derisa nuk e mësoni çdo gjë që ishte në to. Ne e mësonim Kuranin dhe veprimin sipas tij. Do ta trashëgojnë Kuranin pas neve disa njerëz, që do ta lexojnë sikur që e pinë ujin, mirëpo nuk do tua kalon fytn.

6- Is'hak ibn Ibrahim thotë: Fudajl ibn Ijadi lexonte Kuran mërzitshëm, me këndje dhe ngadalë, sikurse t'i flet ndonjë njeriut. Kur kalonte ndonjë ajet ku përmendej xhenneti e përsëritke disa herë.

7- Amr ibn Seleme [radijAllahu anhu] thotë: e kishim fshatin përreth rrugës. Njerëzit kur vinin nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kalonin përreth fshatit tonë. Kur vinin, unë afrohesha dhe dëgjoja leximin e Kuranit. Kështu vazhdova derisa memorizova shumë pjesë të Kuranit. Njerëzit pritnin çlirimin e Mekës që të publikojnë islamin e tyre. Kur u çlirua Mekeja, njerëzit vinin te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i thonin: ne jemi delegatët e këtij fisi, të kemi sjellë dëshminë se ata janë musliman, e kështu me radhë. Babai im shkoi si delegat i fisit tonë për t'i dëshmuar Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] islamin tonë. Dhe u kthye prapë, e tha: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Jepni përparësi atij që di më së shumti Kuran”. Ata kërkuan njeriun që dinte më së shumti Kuran, e nuk e gjetën askënd që dinte Kuran ma shumë se unë. Unë atëherë isha djalosh. (Ahmedi).

8- Zejd ibn Thabiti [radijAllahu anhu] tregon dhe thotë: fisi im i thanë Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: ky djalosh i fisit Benu Nexhar, i dinë dhjetë sure e më tepër nga ajo që të është shpallur. I pëlqeu kjo Pejgamberit [sal-



[Allahu alejhi ve sel-lem] dhe tha: “Zejd, mëso shkrim leximin e gjuhës hebreje, sepse unë nuk u besoj çifutëve gjatë leximit të letrave që më vijnë”. E mësova shkrim-leximin e gjuhës së tyre pa kaluar 15 ditë. Unë ia lexoja letrat kur i vinin dhe ia shkruaja kur u përgjigjej. (Buhariu dhe Ahmed).

Tregimet janë të shumta në këtë drejtim, mirëpo mendojmë se kjo mjafton të jetë nxitës për secilin musliman që të kujdeset për mësim-leximin e Kuranit, pastaj leximin e tij pa ndërprerë dhe memorizimin e tij sa ka mundësi. Këtu është shpëtimi ynë, përparimi dhe bereqeti. Allahu na bëftë prej atyre që kurrë nuk ndahen prej Kuranit, e lexojnë dhe mendojnë rreth asaj që e lexojnë, dhe në fund veprojnë sipas asaj që i porosit ky Kuran. Amin.

## Porosi të vlefshme për muajin Ramazan

Është duke na ardhur një mysafir i ndershëm dhe me vlerë. Muaj i bekuar, me të cilin na vjen çdo e mirë. Muaj i cili na vjen me bereqete dhe devotshmëri, me mëshirë dhe pastërti.

Është muaji i Kuranit, namazit, agjërimit; muaj i bamirësisë, lëmoshës dhe shpëtimit nga zjari i xhehenemit.

Është muaj i Ramazanit:

“Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, të madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni”. (El-Bekare: 185).

Më lejoni që sot të bisedojmë në këtë temë me titull “Porosi për muajin e Ramazanit”.

**- Porosia e parë: Mos e privo vetveten nga Mëshira e madhe e Allahut në këtë muaj të nderuar.**

Njeriu i pafat është ai i cili privohet nga të mirat e këtij muaji.

Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhennetit”, kurse në transmetimin tjetër qëndron: “Hapen dyert e mëshirës”. (Buhariu dhe Muslimi).

Në një hadith tjetër të vërtetë Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Ju ka ardhur muaji i Ramazanit, muaj i bekuar, Allahu ua ka obliguar agjërimin e tij. Në këtë muaj hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe lidhen me pranga shejtanët e inatosur. Në këtë muaj Allahu e ka një ditë, e cila është më e

mirë se një mijë muaj. Kush privohet nga të mirat e saja, ai është i privuari”. (Hadithi është hasen. Transmeton Nesaiu dhe Bejhakui.

Në hadithin të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] transmeton nga Allahu, i Cili thotë:

“Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë (nga epshet dhe zjarri), prandaj kur të agjërojë ndokush le të mos flasë fjalë të ndyta dhe mos ta ngre zërin, e nëse dikush e ngacmon apo e sulmon, le të thotë: Unë agjëroj, unë agjëroj!”.

“Dhe, pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muahmmedit, aroma e pakëndshme që del nga goja e agjëruesit është më e mirë tek Allahu se sa era e miskut. Agjëruesi i përjeton dy gëzime: kur të hajë iftar gëzohet dhe kur ta takojë Zotin e vet gëzohet për agjërimin e vet (për shpërblimin)”.

“Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij. Një e mirë shpërblehet sa dhjetë sosh dhe deri në shtatëqind herë shumëfishohet shpërblimi, e Zoti ka thënë: “Përpos agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, për shkak se njeriu e braktisë ushqimin për Mua, e braktisë pijen për Mua, i braktisë të këndshmet për Mua, e braktisë gruan e tij për Mua. Era e keqe e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu se aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: njëri gëzim kur të hajë iftar dhe tjetri kur ta takojë Zotin e vet”.

Mundohu që të largohesh nga çdo gjë që të largon prej shfrytëzimit sa ma të mirë të këtij muaji, që të largon nga veprat e mira, të cilat të dërgojnë rrugës së xhennetit dhe rrugës së mëshirës së Mëshirmadhit.

**- Porosia e dytë: Pendohu te Allahu.**

Deri kur do të sillemi me neglizhencë ndaj mëkateve që i bëjmë, deri kurë do ta harrojmë Allahun, deri kur do të vazhdojmë në gabime dhe mëkate.

Allahu i Lartësuar thotë:

“O ju që keni besuar, pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë në mënyrë që Zoti juaj t'i largojë prej jush të këqijat, t'u shpie në Xhennete, nën të cilat rrjedhin lumenj ditën kur Allahu nuk e turpëron Pejgamberin e së bashku me të as ata që kanë besuar. Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: “Zoti ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve. Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send”. (Et-Tahrim: 8).

Poeti thotë:

*Lëre atë që ka kaluar në kohën e rinisë*

*Përkujtoj mëkatet dhe qaji, o mëkatar*

*Nuk të kanë harruar dy melekët, kur ti i harrove*

*Ato i shkruajnë këto vepra, kur ti lozë dhe je në harresë*

*Shpirti është emanet te ti, patjetër do ta kthesh*

*Kurse mashtrimi i kësaj bote është gjë që do ta lësh*

Pendohu tek Allahu për mëkatet që i ke bërë, ktheju Zotit që të ka krijuar, kërko prej Tij mëshirën e Tij, mos u trego kryenaltë, mposhtu para Allahut dhe Atij nënshtroju.

Në esencë teube do të thotë kthim, ti kthehesh Zotit, të ikësh prej mëkateve dhe të kthehesh në vepra të mira, në vepra që e kënaqin Allahun [subhanehu ve teala].

Ktheju Zotit, mos u dëshpëro, pa marrë para sysh sa ke gabuar, ktheju Zotit, sepse mëshira e Tij është shumë më e madhe sesa gabimet tuaja.

“Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez-Zumer: 53).

Transmeton Muslimi dhe Tirmidhiu se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: Zoti ka thënë:

“Biri i Ademit, nëse më lutesh dhe më shpreson do t’i fali mëkatet sado që janë. Biri i Ademit, nëse arrin mëkatet e tuaja kupën e qiellit, e kërkon prej Meje falje, Unë t’i fali, biri i Ademit, nëse vjen me mëkate sa toka, e nuk më bënë ortak, unë do të vijë me aq falje”.

Ktheju Zotit, sepse Ai gëzohet me këtë vepër, pendohu te Zotit, fiton pëlqimin e Tij.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu ma shumë gëzohet më teuben e besimtarit sesa njeriu i cili gjendet me devenë e tij në shkretëtirë dhe i ikë deveja, në të cilën gjendet ushqimi, u dëshpërua dhe erdhi nën hije të një druri që të pushoj. Në këtë gjendje i erdhi deveja, e e morri i gëzuar”.

Kush je ti që të gëzohet Zoti me pendimin tënd, Mëshira e Tij e madhe shkakton gëzim tek Ai me pendimin e besimtarëve.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tregon se:

“Allahu [subhanehu ve teala] zgjatë Dorën e Tij gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë natës dhe e zgjatë Dorën e Tij gjatë natës që të pendohet ai që bënë mëkate gjatë ditës”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu zbret në qiellin e dynjasë dhe thotë: kush më lutet që t’i përgjigjem, kush kërkon falje, t’ia fali dhe kush pendohet t’ia pranojë pendimin”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pendimi nuk plotësohet përderisa nuk i plotëson tre kushte:

- 1- Të ndiesh keqardhje për bërjen e këtyre mëkateve,
- 2- ta lësh mëkatin,
- 3- të vendosësh që mos të kthehesh në atë mëkat,

#### **- Porosia e tretë: Kujdesu për namazin.**

Nëse dëshiron që agjërimi yt të jetë i pranuar tek Allahu, kujdesu për namazin. Sepse namazi është shtylla kryesore e fesë, pa këtë shtyllë nuk ngritet godina e Islamit.

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Islami ngritet mbi pesë shtylla: mbi dëshminë se s’ka hyjni tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Allahut, falja e namazit, dhënja e zekatit, agjërimi dhe kryerja e haxhit”. (Buhariu dhe Muslimi).

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezë në fe. Ne sqarojmë agumentet për ata njerëz që kuptojnë”. (Et-Teube: 11).

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Gjëja kryesore është islami, shtylla kryesore është namazi, kurse kulmi i Islamit është xihadi në rrugë të Allahut”. (Hadithi është sahih).

- Porosia e katërt: lexo sa ma tepër Kuran në këtë muaj sepse është prej ibadeteve më të mëdha.

Gjeneratat e para të muslimanëve, kur hynte muaji i Ramazanit, pjesën më të madhe të kohës e shfrytëzonin në leximin e Kuranit, saqë Zuhriu thoshte: “Kur të hyjë muaji i Ramazanit duhet lexuar Kuran dhe duhet dhënë ushqim”. Kurse Imam Maliku kur hynte muaji i Ramazanit, e linte leximin e haditheve dhe i

përkushtoj leximit të Kuranit. Saqë shumica e tyre e lexonin krejt Kuranin në çdo tre ditë.

Lexo Kuran në këtë muaj sepse ka vlerë të madhe te Allahu. Siç e përmendëm në detale në kapitullin paraprak.

**- Porosia e pestë: shpenzo sa ma tepër dhe jep lëmoshë- sadaka në këtë muaj.**

Transmeton Buhariu se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte njeri bujar, kurse më bujar ishte në Ramazan.

Për këtë mos nguro, mos u bën koprrac, shpenzo dhe jep lëmoshë, sepse çdo ditë që të vjen dy melek thonë:

“Allahu ynë jepi pasuri nëse shpenzojnë dhe mos i jep atij që nuk shpenzon”. (Buhariu dhe Muslimi).

Jepu të varfërve, atyre që s’kanë, tregohuni solidar mes vete, të futet dashuria mes jush dhe të vjen mëshira e Zotit.

Në fund mund të themi:

Tani jemi duke folur për afrimin e këtij muaji, ky muaj do të vjen, varet prej nesh se si do ta shfrytëzojmë dhe së shpejti do të themi, kaloi ky muaj, edhe Allahu e di se a do ta arrijmë edhe muajin e ardhshëm të Ramazanit, vallë si do ta kalojmë këtë muaj dhe si do ta shfrytëzojmë këtë muaj.

Duhet të mundohemi që të shfrytëzojmë maksimalisht dhuratat që na i jep Zoti, sepse nuk dihet se a do të kemi jetë që t’i arrijmë edhe dhuratat tjera. Sa e sa shokë i kemi pasur vjet, kurse sivjet nuk janë në radhët tona. Duhet punuar para se të na vjen vdekja, sepse atëherë do të themi:

“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është

vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distançë periodike) der në ditën kur ringjallen”. (El-Muminun: 99-100).

Mirëpo në këtë moment nuk do të bënë dobi ky përkujtim sepse ka kaluar afati i kohës së punës, tani është kohë e llogarisë dhe dënimit e jo e veprave dhe punës.

Atë ditë nuk të bënë dobi as pasuria e as autoriteti që ke pasur në dunja, nuk të bënë dobi as farefisi e as fëmijët, as shokët e as miqtë, përveç veprave tuaja të mira.

“Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë”. (Esh-Shuara: 88-89).

“Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja”. (El-Hakka: 28-29).

“E kur të vijë ushtima (krisma e kijametit); Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, Prej nënës dhe prej babait të vet, Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet”. (Abbese: 33-37).

Tregohet se Harun Reshidi, kur është shtrirë në shtratin e vdekjes, ky njeri i cili ku ishte i fuqishëm dhe në pushtet thoshte: oj ti re, shko ku të duash dhe lësho shiun sepse haraxhi i asaj toke do të vjen te unë. Kur i erdhi vdekja, kur u shtri në shtartin e vdekjes, kërkoi ta shohë varin ku do të varoset, kur e dërguan atje, qau dhe tha:

“Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja”. E ngriti kokën nga qielli dhe qau gjatë, pastaj tha: o Ti që nuk largohet prej teje pushteti, mëshiro ate që i ka shkuar pushteti. Shpirti im, erdhi koha e udhëtimit, të është afruar momenti i rëndësishëm, bëhu gati, mos të të mashtrojë shpresa e madhe sepse do të shkosh në një vend, ku miku mikun e haron, do të ngarkohesh me gjera të rënda. Të gjithë ne do të shfarohemi, nuk mbetet as krenari e as i mposhturi.



Duhet t'i kthehemi Zotit, sepse sa do që të jetë kjo botë e gjatë është afatshkurtër, sado që është e madhe, është e pavlerë, nata sado që të jetë e gjatë, mëngjesi gjithsesi do të vjen dhe jeta sado që është e gjatë, patjetër duhet të hymë në dhe. Kjo është realiteti më i madh në këtë ekzistencë, të cilës duhet t'i nënshtrohen me vullnet ose pa vullnet, mëkatarët dhe bamirësit, pejgamberët dhe mbretërit. Është realitet, i cili i pëshpërit secilit njeri në vesh, secilit njeri që kupton: vetëm Allahu është Ai që mbetet përherë.

“Çdo gjë që është në të (në tokë) është zhdukur. E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i madhëruar e i nderuar!”. (Er-Rahman: 26-27).

E lusim Allahu që të na mundësojë ta shfrytëzojmë këtë muaj maksimalisht në vera që e kënaqin Allahun, në agjërim dhe namaz, në sadaka dhe lëmoshë. Allahu ynë, i pranojmë mëkatet dhe dobësitë tona, andaj na i fal dhe mbulo. Largo prej nesh brengat dhe mërzitë. Largo prej nesh fatkeqësitë dhe vështirësitë. Allahu ynë na mëshiro dhe na beko. Allahu ynë na pasuro me hallall dhe respekt ndaj Teje, e na bënë të panevojshëm për haram dhe na bënë të panevojshëm për të tjerët përveç Teje. Allahu ynë, Ty ta paraqesim dobësinë e fuqisë sonë, pamundësinë tonë, mosvlerësimin tonë nga ana e njerëzve, O i Mëshirshëm, Ti je Zoti i të dobëtëve dhe të shtypurve, Ti je Hyjnia jonë. Në duar të kujt na le, në duar të armikut që na sulmon ose në duar të mikut që na injoron, nëse Ti nuk je i mllëfësor në ne, ne nuk brengosemi. Të lutemi me Dritën e Fytyrës Tënde, e cila i ka ndriçuar errësitat dhe me të cilën janë përmirësuar gjërat e kësaj bote, që mos ta zbresësh hidhërimin Tënd mbi ne, Ty të takon lavdërimi derisa të kënaqesh. Amin.

## Vëllai im dhe motra ime, çfarë keni përgatitur për Ramazan?

Vëllai im dhe motra ime në besim!

Sa gëzim i madh për muslimanët për këto ditë që u përsëriten në çdo vjet, ditë të cilat i duan me shpirtrat dhe zemrat e tyre!

Vëlla dhe motër, a nuk është dhunti që për çdo vjet t'i kalojnë njeriut ditë, ku jeta e tij dallon nga ditët e tjera të zakonshme të jetës së tij?!

Vëlla dhe motër, gëzimi me këto ditë të bukura të muajit të Ramazanit, nuk është i veçantë vetëm për të mëdhenjtë, por i kaplon edhe ata të vegjël, për të cilët akoma nuk është obligim agjërimi i muajit të bekuar!

Vëlla dhe motër, medoemos duhet të kuptosh se ditët e Ramazanit kanë një shije të veçantë. Shija e këtyre ditëve është e ëmbël, e këndshme, e lezetshme dhe e shijshme.

Vëlla dhe motër, janë ditë që përsëriten...muaj që kalojnë, vite që vijnë njëra pas tjetrës...në tërë këto kohëra e gjejmë këtë muaj të bekuar duke e përhapur erën e këndshme të saj, në ditët, muajt, vitet, po deshe thuaj edhe në njeriun!

Vëlla dhe motër, ky është muaji i Ramazanit...muaji i durimit...muaji i Kuranit...muaji i pendimit...muaji i mëshirës...muaji i faljes...muaji i bamirësisë...muaji i lutjes...muaji i liriminit nga zjarri...

1- Vëlla dhe motër...a ke përgatitur gëzimin për ardhjen e muajit të Ramazanit?!

Vëlla dhe motër; ditët na përgëzojnë ardhjen e këtij muajit të bekuar...dhe para këtij muajit shpërndanë lule! Sikurse dëshiron të thotë: u erdhi muaji i mëshirës dhe faljes, vallë çka keni përgatitur për këtë muaj?!

Vëlla dhe motër, atje, në qytetin e Pejgamberit [salAllahu alejhi ve sel-lem] për çdo vjet Muhammedi [alejhisselam] u jepte myzhde atyre burrave dhe grave të dëlirë e të dëlira, Allahu qoftë i kënaqur me ta...

Ja se si Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] e jep këtë myzhde, myzhde hyjnore:

“U ka ardhur Ramazani, muaj i bekuar. Allahu ua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në këtë muaj hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xhehenemit, lidhen në pranga shejtanët e inatosur. Allahu në këtë muaj ka një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë”. (Nesaiu, sahih).

Ibn Rexhebi [rahimehull-llah] thotë: “Ky hadith është bazë dhe argument për përgëzimin e njerëzve mes vete për ardhjen e muajit të Ramazanit. Si ka mundësi mos të përgëzon besimtari me hapjen e dyerve të xhenetit?! Si ka mundësi mos të përgëzon mëkatari me mbylljen e dyerve të zjarrit?! Si ka mundësi njeriu i mençur mos të përgëzon për kohën, në të cilën prangosen djajtë?! Si ka mundësi që kjo kohë t’i përngjajë në ndonjë mënyrë kohëve tjera?!”. (“Lataiful-Mearif”, fq. 279).

Vëlla dhe motër, kjo është myzhdeja për të cilën kanë punuar aktivistët...kanë përvjelë krahët punëtorët...janë gëzuar për ardhjen e tij besimtarët...

Vëlla dhe motër, ku është gëzimi yt?! Ku është buzëqeshja jote?! Ti i sheh ditët që të afrohen një nga një...për ta sjellë para teje gëzimin e secilit musliman për ardhjen e muajit Ramazan!

Vëlla dhe motër, sa muaj i bekuar që është...andaj “zemrat e të devotshmëve lakmojnë për këtë muaj dhe rënkojnë nga dhimbja e ndarjes prej tij”. (Ibn Rexhebi).

Vëlla dhe motër muslimane!

Myzhde për ata që e arrijnë muajin e faljes...

Myzhde për ata që e arrijnë muajin e mëshirës...

Myzhde për ata që e arrijnë muajin e Kuranit...

Myzhde për ata që e arrijnë kohën e adhurimeve...

Myzhde për ata që i arrijnë ditët, të cilave Allahu u ka dhënë shkëlqim...bukuri...nderim...

Vëlla dhe motër, a e di se burrat e devotshëm dhe gratë e devotshme janë lutur kohë të gjatë që ta arrijnë këtë muaj të Ramazanit?!

Mua'la ibn Fadli tregon: “Ata i luteshin Allahut gjashtë muaj që të arrijnë muajin e Ramazanit, pastaj luteshin gjashtë muaj që t’i pranojë Allahu veprat e tyre që i kanë bërë gjatë këtij muajit”. (Lataiful-Mearif, fq. 280).

Jahja ibn Kethiri thotë: “Prej lutjeve të tyre ishte edhe kjo: “Allahu ynë, më dorëzo gjer te muaji Ramazan, ma dorëzo muajin Ramazan dhe më mundëso ta dorëzohet këtë muaj me vepra të pranuar”. (Lataiful-Mearif, fq. 280).

Vëlla dhe motër, edhe ti luto si ata... gëzohu si ata, ndoshta Allahu të kaplon me erërat e mëshirshme të Ramazanit, e ti fal Allahu mëkatet dhe del nga ky muaj i liruuar nga zjarri i xhehenemit.

Vëlla dhe motër, a nuk të shkuar ndërmend vlera e atij që e arrijnë Ramazanin?! A nuk ke menduar për madhësinë e shpërblimit të atij që ia ka mundësuar Allahu arritjen e këtij muajit të bekuar?!

Vëlla dhe motër, për tu plotësuar gëzimi yt, pasi që je nga ata që e ke arritur këtë muaj, të lë që ta lexosh këtë tregim:

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon: Dy njerëz nga fisi Kuda e pranuan Islamin me Pejgamberin [salAllahu alejhi ve sel-lem], njëri në fillim e tjetri në fund të vitit. Talha ibn Ubejdull-llahi tregon: e pash (në ëndërr) se i dyti hyri në xhennet para shehidit! E u habita nga kjo gjë! Në mëngjes ia tregova këtë rast Pejgamberit [salAllahu alejhi ve sel-lem], kurse ai tha:

“A nuk ka agjëruar pas tij një Ramazan, a nuk ka falur gjashtëmijë rekate namaz?! E kaq e kaq rekate namaz?!”. (Ahmedi, sahih).

Vëlla, na mundësoftë Allahu të arrijmë muajin e Ramazanit për shumë vjet dhe na mundësoftë që ta jetojmë jetën e lumtur në këto ditë dhe në ditët tjera me punë të mira.

## **2- Vëlla dhe motër, a ke përgatitur qëllim të sinqertë?!**

Vëlla dhe motër muslimane!

A ke përgatitur qëllim dhe vendosmëri të sinqertë para agjërimit tënd?!

A e ke hulumtuar zemrën tënde duke e pritur Ramazanin?! Që të mësosh sinqeritetin dhe vendosmërinë?!

Të shumtë janë ata që hyjnë në këtë muaj pa qëllim të sinqertë! Nuk kam për qëllim qëllimin e agjërimit, sepse këtë e posedon secili agjërues, mirëpo, vallë ke për qëllim të bësh agjërim të sinqertë dhe adhurim të vërtetë në këtë muaj?!

A e ke të pranishëm këtë vendosmëri të fuqishme para agjërimit tënd?!

Mendimi yt mbi harxhimet e Ramazanit dhe përgatitja e ushqimit për këtë muaj, nuk është gjë me të cilën veçohesh ti, mirëpo përgatitja për ushqimin e shpirtit dhe mendimi yt për pastrimin e shpirtit, drejtimi kah Allahu në këtë muaj të bekuar, kjo është ajo me të cilën mundesh të veçohesh!

A janë të barabartë, ai që e ka këtë qëllim dhe ai që nuk e posedon këtë qëllim?!

Nëse dëshiron të shohësh dallimin mes këtyre dy qëllimeve ndalu te hadithi i Pejgamberit [salAllahu alejhi ve sel-lem]:

“Ai që e agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe shpresim (të shpërblimit), i falen mëkatet që i ka bërë më herët. Kush gjallëron Natën e Kadrit me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ibn Haxheri duke komentuar fjalën “me besim” thotë: “domethënë duke i besuar premtimit të Zotit për shpërblim, kurse “me shpresim” domethënë duke kërkuar shpërblimin, e jo për ndonjë far qëllimi tjetër, siç është syfaqësia, ose diç tjetër”. (“Fet’hul-Bari”, 4/ 251).

Ibn Rexhebi [rahimehull-llah] thotë: “Kur të shtohet mallëngjimi i shpirtit për gjërat që ia ka ëndja, të cilat mundet t’i posedojë, e i le për hir të Allahut [subhanehu ve teala], në një moment kur nuk e sheh askush përveç Allahut, kjo është argument se imani i tij është i gjallë”.

Vëlla, përgatit sinqeritetin e vërtetë dhe vendosmërinë në vigjilje të Ramazanit, për ditën e Bajramit.

Sinqeritetin dhe vendosmërinë që e përgatit për agjërimin tënd është vendosmëria jote për të bërë adhurime, për ta pritur këtë muaj me pendim të sinqertë, me vendosmëri për të hapur faqe të bardhë, të cilën do ta mbushësh me vepra të mira, faqe të kulluara nga njollat e mëkateve, e cila i përngjan pastërtisë dhe shkëlqimit të këtij muaji të bekuar.

Kurse vendosmëria për ditën e Bajramit është që të jesh i vendosur që t’i vazhdosh punët e mira që i ke bërë gjatë këtij muajit, muajit të mëshirës, bereqeteve dhe faljes.

Vëlla, nëse e pret muajin e agjërimit me pendim, nënshtrim dhe i vendosur për punë të mira, nëse ditën e bajramit e pret i vendosur për ta vazhduar këtë rrugë,

atëherë do të jesh me të vërtetë fitimtar i fryteve të agjërimit dhe erërave të mëshirshme të këtij muajit të bekuar!

Përgatite zemrën plotësisht për të pritur këtë muaj bëhet duke e pastruar zemrën dhe duke e ushqyer me sinqeritet gjatë adhurimeve ndaj Allahut [subhanehu ve teala]:

“Thuaj: "Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun, të jem i sinqertë në adhurimin ndaj Tij!". (Ez-Zumer: 11).

Na dhuroftë Zoti sinqeritet në fjalë dhe vepra...dhe na bëftë nga njerëzit e vërtetë në jetën sekrete dhe publike.

### **3- Muaji i Ramazanit është muaji i faljes, vallë e ke llogaritur vetveten?!**

Vëlla dhe motër muslimane!

Sa Ramazane u kalojnë njerëzve e ata të shkujdesur?! Atyre nuk u intereson asgjë tjetër përveç Ramazanit që e jetojnë!

Vëlla dhe motër, para se të ikin ditën e Ramazanit, para se të thuash: erdh Ramazani tjetër, duhet ta dish se Ramazani vjen, je ti ose nuk je, mirëpo, vallë a the: jetova derisa e arrita Ramazanin...mirëpo sa vepra të mira kam bërë në shumë Ramazane që më kanë kaluar?!

Vëlla dhe motër, nuk besoj se ke harruar të përgatitësh buxhetin e Ramazanit për ushqim dhe pije, mirëpo si duket ke harruar të përgatitësh buxhetin e punëve të mira, të pendimit, faljes, luftes, etj?!

Vëlla, buxheti i atyre veprave duhet ta posedon një dosje me emrin “kthimi te Allahu”.

Kurse titulli i parë që do të ballafaqohesh në këtë dosje është: “Llogarit vetveten”.

Nëse arrin sukses të mbushësh këtë titull me përgjigje të sakta, do të kalosh në titullin tjetër: “Pendimi”.

Nuk mundesh ta kalosh këtë titull me sukses nëse nuk sjell fakte të vërteta gjatë mbushjes së titullit të kaluar, nëse dëshiron që pendimi yt të jetë i sinkertë!

Vëlla dhe motër, llogarit vetveten para agjërimit, që të mbetet agjërimi yt i pastër... që të jesh agjërues i vërtetë!

Hasan Basariu [rahimehull-llah] thotë:

“Robi është në të mira, përderisa ka këshillues të brendshëm dhe ambicia e tij është llogaria”.

Vëlla, të shumë janë ata që nuk e përgatisin vetveten duke e pritur këtë muaj, e hynë në këtë muaj të njollosur me mëkate dhe gabime! Te këta nuk ndikon edhe aq shumë agjërimi, nuk i dridh namazi, e dalin nga ky muaj ashtu si kanë hyrë!

Vëlla dhe motër, mëkatet lënë gjurmë të rënda në zemrën e njeriut! Kurse Ramazani është muaj i pastrimit, muaji i zemrave të buta, e nëse nuk përgatit zemër të butë, e të pastër prej mëkateve, të ikë anija e shpëtimit e mbetesh i vetmuar në bregdet, i privuar nga çdo e mirë dhe pret kush do të të shpëton! Vëlla dhe motër, jini të vërtetë me Zotin tuaj në këtë muaj, do ta gjeni Zotin afër vetes..

4- Vëlla e ke përgatitur vendosmëri të vërtetë për të hapur faqe të re?!

Vëlla nëse para Ramazanit keni qenë dembelë dhe nuk keni qenë të pranishëm në namazin me xhemat...vendosni që gjatë Ramazanit t'i vizitoni shtëpitë e Zotit vazhdimisht, me shpresë se Allahu do tu jep sukses. Të mbetemi vizitor të xhamive deri në vdekje.

Nëse keni qenë koprrac, Ramazanin bëjeni kohën e flijimit dhe bujarisë, sepse është muaj i bujarisë, bamirësisë dhe shumëfishimit të shpërblimit.

Nëse keni qenë shpërfillës të përmendjes së Allahut, Ramazanin bëjeni ditë të përmendjes (dhikrit), lutjes, leximit të Kuranit, sepse është muaji i Kuranit.



Vëlla dhe motër, kujdesu që agjërimi yt të mbetet i pastër, ashtu siç kujdeseni për pastërtinë e rrobave tuaja. Largohuni nga bisedat e kota, fjalët imorale, sjelljet e këqija. Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Agjërimi nuk është nga ushqimi dhe pija! Por nga fjalët e kota dhe imorale! Nëse ndonjëri të ofendon ose sillet keq me ty, thuaji: jam agjërueshëm”. (Ibn Huzjeme, sahih).

Mos u bënë nga ata që i ka përshkruar Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem]:

“Sa e sa agjërues nga agjërimi kanë vetëm uri e etje. Kurse sa e sa nga ata që falin namazin e natës kanë vetëm pagjumësi”. (Taberaniu, sahih).

Hasan Basriu [rahimehull-llah] thotë:

“Allahu [subhanehu ve teala] muajin e Ramazanit e ka bërë mejdan për krijesat e veta, ku bëjnë gara që me adhurimet e tyre të fitojnë kënaqësinë e Allahut. Ata që janë të shpejtë fitojnë, e ata që janë të ngadalshëm humbin. Habi është puna e atij që lozë dhe qeshet, në ditën kur fitojnë bamirësit, e humbin përtacët”.

Bëjeni agjërimin tuaj shkollë, ku do ta edukoni vetveten, do t’ia mësoni sjelljen e mirë, vlerat dhe moralin e lartë, që kur të përfundon Ramazani të ndieni rezultatet e mira të agjërimit, e të përfitoni nga ky muaj i bekuar...

### **5- Vëlla, a je bërë gati që të bëhesh nga të liruarit nga zjarri i xhehenemit?!**

Vëllau dhe motra ime muslimane!

Ky është qëllimi për të cilin agjërojnë besimtarët dhe për të cilin bëjnë gara muslimanët, lirimi nga zjarri i xhehenemit!

I lumtur është ai që del nga agjërimi i tij me mëkate të falura dhe i shënuar nga banorët në begati të përhershme.

A i ke folur vetvetes para Ramazanit që të bëhesh nga të shpëtuarit nga zjarri?! A e ke përgatitur vetveten me frikë nga zjarri i dënimit të Allahut?!

Ai është zjarri, që nga frika prej tij etshohen burrat e devotshëm dhe durojnë nxehtësinë e kësaj bote, që të fitojnë siguri dhe hije në ditën e Kijametit...

Të pakët janë ata që e kanë përgatitur vetveten para Ramazanit për ta pritur me frikë dhe shpresë!

Nëse udhëton për ndonjë punë tënden tredhjet ditë, dhe në fund të udhëtimit kthehesh duar bosh, puna dhe munda yt shkon bosh, si do të ndiheshe?!

Ky është shembulli i atij që e agjëron Ramazanin, qëllimi i të cilit është arritja e faljes dhe shpëtimit nga zjarri, mirëpo nuk e arrin këtë qëllim! Ky me të vërtetë është i privuari!

Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu në çdo bajram ka të liruar nga zjarri”. (Ahmedi, sahih).

Abdullah ibn Mesudi [radijAllahu anhu] kur përfundonte Ramazani thoshte:

“Kush është i pranuar prej nesh t’ia urojmë, e kush është i privuar, ta ngushëllojmë”.

Kujdesu që të të kaplojë era e mëshirës së këtij muajit, me shpresë se Allahu fundin ta bënë të mirë. Pejgamberi [salAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Bëni punë të mirë tërë jetën, ekspozohuni erës së mëshirës së Allahut, sepse Allahu ka erë të mëshirës, me të cilën e kaplon cilin do nga robërit e Tij. Luteni Allahun tua mbulon të metat dhe tu garanton nga trishtimi”. (Taberaniu, sahih).

Po i përmbylli këto letra, me lutje drejtuar Allahut që të na e përmbyll këtë muaj të bekuar dhe të na bënë të mëshiruar me agjërimin e tij.

Vëlla i imi dhe motra ime muslimane!

Është muaj i bekuar, lutu të bëhesh nga ata që e takojnë dhe mirë e kalojnë.

Allahu na dhuroftë vërtetësi të agjërimit, na bëftë nga të dhënurit pas namazit, posedues të veçorive të të devotshmëve, na ringjalltë me të shpëtuarit dhe na mundësoftë të arrijmë gradat e të njerëzve të afërt me Zotin. Amin.

Ez'heri Ahmed Mahmud

## Zmadhimi i mëkatit në Ramazan

Për vlerën e Ramazanit flasin shumë argumente. Prej tyre është edhe hadithi të cilin e transmeton Buhariu nga Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ku thotë:

"Allahu ka thënë: çdo vepër e njeriut është për Të përveç agjërimit, ai është për Mua dhe Unë e shpërblej atë. Agjërimi është mburojë, andaj nëse dikush është agjërueshëm mos të flet fjalë të ndyta dhe mos të bërtet. Nëse e shan dikush le të thotë: unë agjëroj, unë agjëroj. Pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti i Muhammedit era e gojës së agjëruesit është më e këndshme se sa aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: një kur ha iftarin dhe e dyta kur të takohet me Zotin e vet".

Në këtë hadith i kemi katër myzhde:

Një: agjërimi është për Allahun dhe Ai veçanërisht shpërblen për Të.

Pa dyshim se Allahu është Ai që shpërblen për të gjitha adhurimet, mirëpo veçimi i agjërimit këtu tregon shtimin e shpërblimit që e jep Allahu për këtë vepër.

Sufjan ibn Ujejne ka thënë:

"Në Ditën e Kijametit Allahu do ta llogarit robin e Tij. Do t'i lan të gjitha zullumet që ua ka bërë njerëzve me veprat e tija, e do t'i mbetet vetëm agjërimi. Zullumet tjera do t'i merr përsipër Allahu t'ia lan, kurse me agjërimin ka me hy në xhennet".

Disa dijetarë tjerë kanë thënë: secila vepër shpërblimin e ka të kufizuar, kurse agjërimi e ka pa kufi. Argument për këtë është hadithi në sahihun e Muslimit:

"Çdo vepër e njeriut i shumëfishohet. Një e mirë në dhjetëfish deri në shtatëqind fish. Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: përveç agjërimit, sepse ai është për Mua dhe unë shpërblej për Të".

Dy: Agjërimi është mburojë, domethënë mburojë nga zjarri i xhehenemit.

Transmeton Tirmidhiu se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Agjërimi është mburojë nga zjarri".

Pasi që shejtani qarkullon në njeriun në kapilarët ku i qarkullon gjaku, e kur agjëron njeriu i ngushtohen kapilarët për shkak të qarkullimit të vogël të gjakut, e me këtë ia ngushtojmë kanalet shejtanit, andaj pakësohen vesveset. Nga ana tjetër në këtë muaj edhe prangosen djajtë, andaj njerëzit jepen pas adhurimeve, e agjërimi bëhet mburojë.

Tre: Era e keqe e agjëruetit është më e këndshme se aroma e miskut.

Kjo pa dyshim se është keramet për agjëruetin.

Dijtarët kanë thënë:

Allahu e shpërblen me aromë të mirë në ahiret, mu ashtu sikurse ndodh edhe me njeriun që plagoset në rrugë të Zotit. (shiko: "Feth'hul-Bari", 4/106).

Katër: agjërueti gëzohet me agjërimin e vet dhe takimin me Allahun.

Domethënë kur e takon dhe e shpërblen, kjo pa dyshim e gëzon.

Vlerat e agjërimin

Prej vlerave të agjërimin është:

1- Falja e mëkateve.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Domethënë duke i besuar urdhrave të Allahut, me nijet të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin e Allahut.

Gjithashtu Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Prej vlerave të Ramazanit është edhe prania e natës së Kadrit në këtë muaj, i cili është më i mirë se një mijë muaj, domethënë më i mirë se 83 vjet.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ju ka ardhur muaji, në të cilën ka një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj, ai që privohet nga e mira e saj është i privuar nga të gjitha të mirat, sepse vetëm i privuari privohet nga të mirat e saja". (Hasen, Ibn Maxhe).

### **Shkaku i zmadhimit të mëkateve në Ramazan**

Mëkatet në këtë muaj shumëfishohen dhe zmadhohen.

Cili është shkaku?

Shkaku është zgjedhja dhe dallimi i cili e shumëfishon dhe zmadhon shpërblimin po edhe dënimin, pa marrë parasysh se kjo zgjedhje ka të bëjë me vendin, kohën ose personin.

a) Allahu e ka zgjedhur Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, edhe kjo zgjedhje ka qenë shkak për shumëfishim të shpërblimeve të tija, fiton shpërblimin e atyre që veprojnë sipas udhëzimeve të tij, duke mos iu pakësuar atyre aspak shpërblimi, e me këtë është bërë njeriu me grada më të larta.

Gjithashtu Allahu, subhanehu ve teala, e ka lajmëruar se edhe gabimet e tija i shumëfishohen, edhe pse ai nuk gabon, mirëpo për sqarim fetar ndaj atyre që janë të zgjedhur dhe të dalluar.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Në të vërtetë ata (idhujtarët) gati arritën të sprovonjë ty nga ajo që Ne ta shpallëm, e të trillosh tjetër nga çka të shpallëm, e atëherë do të zinin ty mik. Dhe sikur Ne të mos të kishim forcuar ty, ti gati anove diçka pak te ta. E atëherë Ne

do ta shijonim mundimin dyfish të kësaj jete dhe dyfish të jetës tjetër, e pastaj ti nuk do të gjeje mbrojtës kundër nesh". (El-Isra: 73- 75).

Domethënë dënim dyfish në dynja dhe dyfish në ahiret.

Në këtë drejtim është edhe dedikimi që u është bërë nënave të besimtarëve, grave të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

"O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish, e kjo për Allahun është shumë lehtë. E kush prej jush i përvishet adhurimit të Allahut dhe respektimit të të Dërguarit të Tij dhe bën punë të mira, asaj do t'i japim shpërblimin e dyfishtë dhe për të kemi përgatitur furnizim të këndshëm". (El-Ahzab: 30- 31).

Pra, ato ia ka zgjedhur Allahu, subhanehu ve teala, Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, andaj kanë hise në dhunti, në besim, grada dhe jetesë në shtëpinë e Pejgamberit, cilat nuk i kanë të tjerat, andaj atyre nuk u ka hije mëkati, ashtu sikurse u shumëfishohet shpërblimi i veprave të tyre të mira.

b) I njëjti vendim vlen edhe për vendet e veçuara dhe të dalluara, siç është Mekeja, për shembull. Veprat që bëhen në meke janë më të mëdha se ato që bëhen jashtë Mekës. Namazi që falet në Mesxhidul-Haram është sa njëqind mijë namaze që falen në xhamitë e tjera, po edhe me mëkatin është e njëjta gjë.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"S'ka dyshim se ata të cilët nuk besuan dhe pengojnë prej rrugës së Allahut dhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes), të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur, dhe kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë mëkat, Ne kemi për t'ua shijuar një dënim të ithët". (El-Haxhxh: 25).

c) Kjo dispozitë vlen edhe për kohërat e veçuara dhe të dalluara, siç është muaji i Ramazanit, kurse argument i veçimit janë argumentet që tregojnë madhështinë e këtij muajit, sasia e madhe e shpërblimit, mëshira e Allahut në këtë muaj, hapja e

dyerve të xhennetit, mbyllja e dyerve të xhehenemit, prangosja e djajve, veçimi me natën e Kadrit. Pra, shpërblimet qenkan të shumëfishuara. Nëse e kuptojmë se shpërblimet janë të shumëfishuara, atëherë vërtetohet se edhe dënimet shumëfishohen, pasi që treguam më herët se në raste të veçimit dhe dallimit shumëfishohen edhe shpërblimet edhe dënimet.

Pastaj kemi edhe argument decidiv që tregon se mëkati në Ramazan është shumë i madh, pasi që Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i ka parë disa njerëz të varur për kapilarët e tij, bark shqyer, duke rrjedhur gjaku prej tyre, e ka pyetur: kush janë këta? U janë përgjigjur melekët: ata që kanë ngrënë para se ta përfundojnë agjërimin e tyre". (Ibn Huzejme, shiko: "Sahihu tergibi ve terhibi", 1/420).

Kurse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, njeriun që ka pasur marrëdhënie intime me gruan e tij gjatë ditës së Ramazanit i ka përcaktuar kefaretin më të rëndë, kefaretin e vrasjes dhe dhiharit: lirim të një robi, e nëse nuk gjen agjërim të dy muajve radhazi, e nëse nuk mundet, atëherë të ushqejë gjashtëdhjetë të ngratë.

Kefareti i madh vjen si rezultat i mëkatit të madh.

Kurse në këtë rast njeriu që ka marrëdhënie me gruan e tij, të cilën e ka hallall, paska bërë gabim shumë të madh që duhet shpague me këtë kefarete kaq të madh, kjo tregon se mëkati që bëhet në Ramazan nuk është sikur mëkati që bëhet jashtë Ramazanit.

Pastaj nëse ky mëkat qenka nëse njeriu nuk e respekton ndershmërinë e këtij muajit duke bërë marrëdhënie me gruan e vet, e çka të themi për ata që bëjnë zina?!



## Definicioni i mëkatit.

Ka njerëz që aspak nuk i përfillin rregullat e sherijatit, andaj mëkatet i rangojnë në rangun e gjërave të lejuara, andaj duhet sqaruar se çka është mëkat sipas sherijatit.

Në arabisht fjala mëkat vjen në disa forma, porse të gjitha e kanë një kuptim fetar, të gjitha këto shprehje e shprehin realitetin e asaj që e bën njeriu kur i kundërshton urdhrat e Allahut dhe të gjitha këto shprehje kanë ardhur në kontekstin e qortimit dhe kërcënimit.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen)". (Ali Imran: 135).

"Kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetshëm. E për të është një dënim i rëndë". (En-Nisa: 14).

"Kush bën ndonjë gabim ose mëkat, e pastaj atë ia hedh një të pafajshmit, ai ngarkohet me një shpifje e me një mëkat të hapët". (En-Nisa: 112).

"Po, (do të ju kapë zjarri) ai që bën keq dhe që e vërshojnë gabimet e tij, ata janë banues të zjarrit, aty janë përgjithmonë". (El-Bekare: 81).

"Pendim i pranueshëm te Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije shpejt pendohen; të tillëve Allahu ju pranon pendimin, se Allahu është më i dijsلمي, më i urti". (En-Nisa: 17).

Të gjitha këto forma ku përmendet mëkati e kanë një kuptim: kundërshtim i urdhrave të Allahut, me moszbatim ose me veprim.

Kundërshtimi bëhet duke lenë ndonjë vaxhib, obligim ose duke bërë ndonjë haram, ndalesë, këtu nuk hyn lënia e ndonjë mendubi, ose veprimi i ndonjë mekruhi, sepse mendub është çdo vepër për të cilën shpërblehet ai që e bën, mirëpo nuk denohet nëse nuk e bën, kurse mekruhi është çdo vepër për të cilën nuk denohet nëse e bën dhe shpërblehet nëse e le. Andaj në këto dy kategori nuk hyn mëkati.

Kurse nëse lihet një obligim, ke bërë mëkat dhe nëse ke bërë një gjë të ndaluar, ke bërë mëkat.

Andaj kur thuhet filani ka bërë mëkat, nënkuptohet se filani ka lënë ndonjë obligim ose ka kryer ndonjë ndalesë.

I tërë ummeti janë të pajtuar se muslimanët duhet t'i kryejnë obligimet dhe të largohen nga haramet.

Çdo gjë që ka urdhëruar Allahu është obligim, siç është namazi, agjërimi, haxhi, zekati, bamirësia ndaj prindërve, vërtetësia, amaneti, mbulesa për gruan, përmbushja e premtimit, ruajtja e gjuhës, etj, kurse çdo gjë që ka ndaluar Allahu është haram, siç është shirkku, sihri, falli, kamata, zinaja, ryshfeti, ngrënia e pasurisë së huaj, lakuriqësia e grave, mosrespektimi i prindërve, gënjeshtër, përgojimi, bartja e fjalëve, etj.

Obligimet janë të njohura edhe haramet janë të njohura, siç ka thënë Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem:

"Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë".

Andaj s'ka hapësirë për të ndryshuar gjërat, sepse Allahu ka garantuar ruajtjen e fesë, Kuranin dhe shërijatin, kur ka thënë:

"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij". (El-Hixhr: 9).

Së fundja dije se mëkat është ajo që ti e ndien se është mëkat, siç ka thënë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

"Mëkat është ajo që të ngacmon në gjoks, dhe nuk ke dëshirë ta shohin njerëzit tjerë".

Natyra e pastër dhe zemra e shëndosh e orientojnë njeriun drejt të vërtetës, sepse hallalli është i qartë, Po ashtu edhe harami është i qartë, e vërteta shndërrit, kurse e kota është e zbehtë.

Dr. Lutfullah Abdul-Adhim Hoxha

## Çka e plotëson agjërimin?

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (El-Bekare: 183).

Dijetarët kanë thënë se agjërimi është tre grada:

- agjërimi i masë së gjerë të muslimanëve;
- agjërimi i masës së veçantë të njerëzve;
- agjërimi i elitës.

Agjërimi i masës së gjerë domethënë abstenimi i barkut dhe organit nga kënaqësitë dhe epshet e tyre.

Agjërimi i masës së veçantë domethënë abstenim i dëgjimit, shikimit, gjuhës, dorës, këmbës dhe mbarë gjymtyrëve nga mëkatet.

Agjërimi i elitës domethënë abstenim i zemrës nga çështjet e kësaj bote, nga mendimet rreth kësaj bote, largim nga çdo gjë përveç Allahut. Drejtim me tërë ambiciet e tija kah Allahu dhe largimi nga çdo kush tjetër.

Ibn Rexheb Hanbeliu [rahimehull-llah] thotë: “Shtresa e dytë e agjëruesve është: ai që agjëron – abstenon nga çdo gjë përveç Allahut, dhe e ruan kokën dhe çka ka brenda, barkun dhe çka nxë, e përkujton vdekjen dhe telashet, e dëshiron ahiretin dhe i le zbukurimet e kësaj bote.

Ky agjërues nuk feston bajramin ditën e parë të Shevalit, por bajrami i tij është atë ditë kur do të takohet me Zotin e vet dhe do të gëzohet me shikimin kah Ai.

Ai që agjëron nga epshi i tij, do t'i arrijë ato nesër në xhennet, ai që agjëron nga çdo kush përveç Allahut, bajram e ka ditën kur do të takohet me te. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“E kush shpreson takimin (shpërblimin) e Allahut, s'ka dyshim se afati i Allahut do të vijë pa tjetër, e Ai është dëgjuesi i dijshti”. (El-Ankebut: 5).

O ju agjërues!

Agjëroni sot nga epshet që të takoni bajramin në ditën e takimit me Të, mos t’jua humbë shpresën vonimi i exhelit, sepse pjesa më e madhe e ditëve të agjërimit ka shkuar, kurse dita e bajramit është afruar.

Agjërues!

Plotësimi dhe përsosja e agjërimit, të cilin secili prej jush e kërkon, nuk mundet të plotësohet pa gjashtë gjëra:

**Një: Ulja e shikimit dhe mos zgjerimi i shikimit në gjëra të ndaluara, të qortuara dhe të urryera.**

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre...”. (En-Nur: 30- 31).

Xherir ibn Abdullahu [radijAllahu anhu] tregon dhe thotë:

E pyeta Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] për shikimin e befasishëm? Tha: “Largo shikimin tënd”. (Muslimi).

Ke kujdes vëllai im që agjëron nga shikimi i tepruar, e mos të flasim për shikimin në shejtanin e kësaj kohe, i cili ua mori mendjen njerëzve të mençur e mos të flasim për mendjelehtit, e ai është televizori, telefoni dhe përmbajtja që ofrohet në to.

Mos e lëndo agjërimin tënd, mos e zvogëlo shpërblimin tënd, sepse kështu nuk vepron ai që dëshiron plotësim dhe përsosje të agjërimit të tij.

Mjaftojnë prezantimi i çdo lloji të së keqes që e ofron ofrojnë mediat dhe interneti. Ngacmim i esphit, lakuriqësi, këngë e muzikë dhe zbritje në nivele shtazarake.

Çka fiton nëse lirisht shikon në ato fotografi të paraqitura, a të shtohen shpërblimet, a të zmadhohet besimi, a të shtohet dija, e cila të afron kah xhenneti dhe të largon nga xhehenemi?!

Mendoj se përgjigja e tërë këtyre pyetjeve është tërësisht negative, edhe pse ti e njeh veten ma mirë se të tjerët.

Merr mësim nga njerëzit që kanë kaluar para nesh. Dëgjo këtë lajm.

Ebu Edjani thotë: isha me mësuesin tim Ebu Bekr Dekak, e pran nesh kaloi një djalosh i ri, e unë e shikova. Më pa mësuesi im duke shikuar në te e më tha: biri im, do ta gjesh të keqen e këtij shikimi pas një kohe. Njëzet vjet e pritsha atë ditë kur do të më kthehet kjo e keqe. Një natë më zuri gjumi duke menduar për këtë problem e kur u zgjova e kisha harruar Kuranin.

Vëlla, dëshiron të gjesh keqardhjen e këtyre shikimeve pas një kohe të caktuar, e të humbësh diç nga besimi yt ose nga të mirat tuaja atë ditë kur do të takohesh me Zotin tënd. Cili është shkaku, shikimi yt në harame!

*Thuaju atyre që shikojnë në gjërat e këndshme në vendin e tyre*

*Kjo është një mostër nga vendi i përhershëm*

*Nëse i nxiton fëmija e epshtit përfundimin e tyre*

*Premtohu afërsinë e shtegtimit në drejtim të vendit të tyre*

*Thuaju besimtarëve le të ulin shikimin e tyre.*

Dy: Ruaje gjuhën nga fjalët e tepruara, fjalët e kota, nga polemika sterile, nga kacafytja, gënjeshtra, bartja e fjalëve, fjalët imorale, nga ofendimi, shprehjet banale, nënçmimi, përqeshja, etj.

Gjuhën duhet detyruar që të heshtë, të preokupohet me përmendje të Allahut dhe lexim të Kuranit. Në këtë mënyrë agjëron gjuha.

Ai që ia zgjidh frerët gjuhës, e flet çka t'i kujtohet, shejtani e dërgon në çdo luginë, e çon në buzë të greminës, që më në fund ta hedh në xhehenem. Ndryshe, njerëzit nuk hedhen në xhehenem me hundë dhe më fytyrë përveç se si rezultat i asaj që e korrë gjuha e tyre.

Muhamed ibn Vasiu i ka thënë Malik ibn Dinarit:

“Ebu Jahja, ruajtja e gjuhës është më rëndë për njerëzit se sa ruajtja e dinarit dhe dirhemit”.

Mendo rreth fjalës së Allahut [subhanehu ve teala]:

“Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm”. (Kaf: 18).

Fjalimi është katër lloje:

Një lloj është tërësisht i dëmshëm, tjetri është tërësisht i dobishëm, i treti është i dëmshëm dhe i dobishëm, dhe një lloj ku nuk ka as dëm as dobi.

Lloji që është tërësisht i dëmshëm duhet heshtur, e po ashtu edhe lloji që është edhe i dëmshëm edhe i dobishëm.

Lloji që nuk është as i dobishëm e as i dëmshëm, është fjalim i tepruar, e angazhimi me te është humbje e kohës, që është kulmi i humbjes. Në këtë mënyrë kuptojmë se tre të katërtat e fjalëve janë të dëmshme, kurse mbetet vetëm pjesa e katërt. Edhe ky lloj është i rrezikshëm nëse përzihet me gjëra të imta të syfaqësisë

dhe shtirjes, lavdërim të vetvetes, bisedimit të tepruar, andaj fjalimi më i prerë është fjala e Pejgamberit [sal-Allahü alejhi ve sel-lem]:

“Kush heshtë shpëton”.

Ebu Hurejre [radijAllahü anhu] tregon se Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] ka thënë se Allahu thotë:

“Çdo vepër e birit të Ademit është për Të përveç agjërimit, e ai është për Mua e unë e shpërblej për Të. Agjërimi është mburojë. Nëse ndonjëri është duke agjëruar në ndonjë ditë le të mos flet fjalë imorale dhe le të mos bërtet. Nëse e ofendon ndokush ose e lufton le të thotë unë jam njeri agjërues”.

Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] thotë:

“Sa agjërues nuk fitojnë nga agjërimi asgjë tjetër përveç urisë, dhe sa njerëz që falin namaz nate nuk fitojnë asgjë përveç se pagjumësisë”.

Kush na qenka ky njeri? Çfarë ka bërë ky njeri?

Disa dijetar kanë thënë: ai që e han iftarin në haram, ose ai që han iftar mishin e njerëzve me përgojim, ose ai që nuk i ruan gjymtyrët nga mëkatet.

Ky njeri është larë nga obligimi, andaj nuk dënohet për lënie të adhurimit, mirëpo qortohet me qortim të rreptë, sepse nuk shpreson shpërblimin, i cili gjendet te Zoti i vet.



**Tre: ai që kërkon të ketë agjërime të plotë le ta largon veshin nga dëgjimi i gjërave të ndaluara dhe të urryera.**

Çdo gjë që është e ndaluar të thuhet, është e ndaluar edhe të dëgjohet. Andaj Allahu i ka barazuar ata që dëgjojnë haram me ata që hanë harama duke thënë:

“Janë ata që dëgjojnë (i përgjigjen) të pavërtetën dhe hanë shumë haramin (ryshfetin)...”. (El-Maide: 42).

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“E, pse paria fetare (e krishterë dhe jehude) të mos i ndalin nga ato thënie të tyre të rreme dhe nga ngrënia e haramit (e ryshfetit)! Sa punë e keqe është ajo e tyre (e parisë fetare)”. (El-Maide: 63).

Poeti thotë:

*Nëse nuk e ruan dëgjimin*

*Shikimin nuk e ul dhe nuk hesht*

*Nga agjërime më mbetet uria dhe etja*

*Nëse them se kam agjëruar, nuk kam agjëruar.*

O ti që ke venduar veshin për të dëgjuar muzikë, ke frikë Allahun, kujdesu për agjërimit tënd. Ky agjërime nuk i ngjan agjërimit të burrave të devotshëm, nuk i ngjan agjërimit të atyre që kërkojnë plotësimin dhe përsosjen e agjërimit.

**Katër: mbrojtja e gjymtyrëve tjera nga harami.**

Mbroje dorën dhe këmbën nga gjërat e urryera, largo barkun nga ushqimet e dyshuara në kohën e iftarit, sepse ushqimi i ndaluar është helm i cili shkatërron fenë, kurse ushqimi hallall është shërim. Pak pre saj të mjafton, kurse nëse e tepron të dëmton. Qëllimi i agjërimit është ta pakëson.

**Pesë: mos ta tepron me ngrënie të ushqimit hallall në kohën e iftarit, që ta mbush barkun, sepse ena më e keqe të cilën e mbush njeriu është barku i tij.**

Si ka mundësi të përfitojë nga agjërimi, i cili e mposht armikun e Allahut dhe e then epshin, që kur të vjen koha e iftarit të kompenson tërë atë që i ka ikur gjatë ditës së Ramazanit. Saqë është bërë traditë te njerëzit që të gjitha ushqimet të ruhen për në Ramazan. Han në këtë muaj aq sa nuk hanë në të gjitha muajtë tjerë.

Zbutja e zemrës dhe pastrimi i saj bëhet duke e lënë ngopjen.

Ai që ha shumë edhe flenë shumë, e ai që flen shumë humbë shumë. Gjumi i gjatë ta humbë ymrin dhe të largon nga namazi i natës, e nëse ngritet që të fal namaz nate nuk e shijon ëmbëlsinë e adhurimit.

Gjashtë: zemra e tij pas iftarit duhet të jetë e lidhur mes shpresës dhe frikës.

Sepse nuk e din a i është pranuar agjërimi, e të radhitet në radhët e njerëzve të privilegjuar të Zotit ose jo, e të radhitet në radhët e njerëzve të urryer nga Zoti. I tillë duhet të jetë në fund të secilit adhurim.

Hasan Basriu kaloi pran disa njerëzve, të cilit ishin duke qeshur e u tha:

“Allahu e ka bërë muajin e Ramazanit mejdan ku bëjnë gara njerëzit në adhurime. Disa njerëz arritën të parët e fituan, e tjerët u vonuan e humbën. Është për tu

habitur çështja e njeriut që qeshet dhe loz në këtë ditë që fitojnë të parët e humbin përtacët. Pasha Allahun po ta largon mbulesën do të angazhohej bamirësi me mirësinë e tij kurse keqbërësi me të këqijat e tija”.

E lusim Allahun të na mëshiron me rahmetin e Tij.

## Bujaria në Ramazan

Ramazani është muaj i bujarisë dhe bamirësisë, është muaj i dorëdhënies dhe fisnikërisë, andaj ti që i dëshiron të mirat urdhëro, kurse ti që i dëshiron të këqijat largohu.

Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] ishte njeriu më bujar, e edhe më bujar ishte në Ramazan.

Bujaria e tij kaplonte çdo bujari, duke filluar nga shpërndarja e dijes, e pasurisë e deri te dhënia e shpirtit për hir të Allahut, për të shfaq fenë e Tij dhe për të udhëzuar robërit e Tij. Ai luftonte për tua sjellë të mirat në çdo mënyrë, duke i ushqyer të uriturit, duke i këshilluar injorantët, duke ua kryer punët nevojtarëve, duke ua bartur barrët e tyre. Ai i kishte këto vlera të larta që nga fëmijëria e tij.

Erdhi një njeri te Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem], kurse ky i dha dhen sa mbushet hapësira mes dy kodrave. Kur u kthye te populli i vet u tha:

“O njerëz, bëhuni musliman, se Muhammedi [alejhis-selam] aq shumë jep saqë nuk i frikohet varfërisë”. (Muslimi).

Safvan ibn Umejje thotë: “Aq shumë më dha Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem], edhe pse ishte njeriu më i urryer tek unë. Ai vazhdoi duke më dhënë derisa u bë njeriu më i dashur te unë”.

Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] hyri te Bilali [radijAllahü anhu], e te ai pa një enë me hurma dhe i tha:

“Çka është kjo, Bilal! E ruaj këtë për mysafirët e tu. Tha: “A nuk ke frikë se mundet të kesh tym në zjarr të xhehenemit. Shpenzo, o Bilal dhe mos u frikëso pakësimin nga Pronari i Arshit”.

Enesi [radijAllahü anhu] thotë: Pejgamberi [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] asgjë nuk depononte për nesër.

I tillë ka qenë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

## **Sadakaja dhe Ramazani**

Sadakaja në këtë muaj të bekuar i ka disa veçori, prej tyre janë:

- Vlera e kohës dhe shumëfishimi i shpërblimit të atij që bënë punë të mira në këtë muaj.
- U ndihmon agjëruesve që kanë nevojë për të kryer adhurimet e tyre, e me këtë fiton sa shpërblimi i tyre. Andaj ai që i jep iftar një agjëruesi ka shpërblim sa shpërblimi i tij.
- Në këtë muaj Allahu tregohet Bujar ndaj robërve të Tij me mëshirë dhe falje. Ai që tregohet bujar ndaj robërve të Allahut Allahu tregohet bujar ndaj tij me dhënie dhe dhurata, sepse sipas punës vjen edhe shpërblimi.

## **Raporti i sadakasë me agjërimin**

Agjërimi dhe sadakaja kanë një lidhje të veçantë.

Të dyja së bashku i mundësojnë njeriut hyrjen në xhennet. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Në xhennet ka dhoma, që ana e brendshme shihet nga jashtë dhe ana e jashtme shihet nga Brenda. I thashë; kujt i takojnë këto dhoma? Tha: “Atij që flet mirë, jep ushqim, vazhdon agjërimin dhe falet natën kur njerëzit flenë”.

Disa dijetar të selefët kanë thënë:

“Namazi e sjell njeriun deri në gjysmë të rrugës, agjërimi e sjell deri te dera e Mbretit, kurse sadakaja e kap për dore dhe e fut Brenda te Mbreti”.

Agjërimi është mburojë, kurse sadakaja e fikë mëkatin sikurse uji zjarrin.

Gjatë agjërimit njeriu doemos do të bëjë lëshime dhe gabime, andaj sadakaja e plotëson mangësinë dhe e përmirëson lëshimet. Për këtë është bërë obligim që në fund të muajit të Ramazanit të jepet zekatul-fitri që ta pastron agjëruesin nga fjalët e kota dhe imorale.

Agjërimi dhe sadakaja janë shlyes (kefarete) për disa gjëra, siç janë betimet, gabimet e ihramit, për marrëdhëniet gjatë Ramazanit.

Jepni sadaka në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, sepse njerëzit më të mirë janë ata që janë më të dobishëm për njerëzit.

Ai që kujdeset për të vejat dhe skamnorët është sikurse muxhahidi në rrugë të Allahut. Allahu i veçon disa njerëz me dhunti që tu bëjnë dobi njerëzve tjerë, e nëse shpenzojnë nga kjo pasuri, atëherë Allahu ua lë, e nëse nuk japin, Allahu ua merr e ua jep tjerëve.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Shëroni të sëmurit tuaj me sadaka”.

A nuk e di vëlla se sadakaja ta shton ymrin dhe të mbetet edhe pas vdekjes.

O agjërues! Sa mundet të jetë ajo që e jep! A nuk ke dëgjuar se Allahu e bekon sadakanë, saqë sadakadhënësi në ditën e Kijametit e sheh sa kodra e Uhudit!

Nëse bën adhurim me trup, ajo mbetet vetëm tek ti, kurse sadakaja ka dobi të përgjithshme. Ai që ushqen një agjërues ka sa shpërblimi i tij, një e mirë shpërblehet dhjetëfish deri në shtatëqind fish, e Allahu ia shumëfishon atij që Dëshiron.

O ju besimtar agjërues! Ky është muaji juaj, kjo është mundësia, ai që nuk jep sadaka në Ramazan, kur do të jep?! Vallë, a q na kanë vdekur zemrat saqë i kemi haruar vëllezërit tanë?!

Nasir El-Ahmed

## Ramazani muaji i durimit

Pa dyshim se Ramazani është muaji i durimit, andaj ai që agjëron ai është i disiplinuar me një disiplinë të plotë gjatë një muaji të plotë, andaj sigurisht se me përfundimin e këtij muajit ai edhe e fiton këtë virtyt. Ai që duron ndaj haramit, ai që duron nga ngrënia dhe pirja, ai që duron gjatësinë e namazit të teravisë, ai që duron nga fjalët e fëlliqura, ai që gjymtyrët i largon nga gjërat që i ka ndaluar Allahu, ai që duron në të gjitha këto gjëra, sigurisht se me përfundimin e muajit të Ramazanit del si njeri durimtar.

Mirëpo nëse në tërë këto gjëra duron, kurse nuk bëhet njeri durimtar, pa dyshim se i ka ikur një e mirë shumë e madhe, një mundësi për ta fituar këtë cilësi, e ajo është cilësia e durimit, që është edukatë e pejgamberëve.

Durimi është i nevojshëm në shumë sfera nga jeta e njeriut, andaj kërkojmë që njeriu që ka duruar në Ramazan të duron edhe ta kontrollojë vetveten kur t'i vijë fatkeqësitë e kësaj bote dhe mos të trishtohet e as mos të habitet.

Dëshirojmë që agjëruesi pas Ramazanit të ketë aftësi që të durojë dhe të jetë i disiplinuar dhe mos të mërzhitet e as mos të lodhet, kur obligohet me detyra dhe vepra që kërkojnë qëndrësë dhe durim, ta kontrollojë vetveten kur të hidhërohet dhe mllëfoset, atëherë kur e provokojnë disa gjëra dhe e detyrojnë të reagon pa urtësi dhe baraspeshë.

Dëshirojmë që agjëruesi që del nga Ramazani të ketë durim dhe mos të frikohet, atëherë kur i paraqiten disa shkaqe të frikës, që mos të bëhet frikacak në vendet ku duhet të jetë trim.

Dëshirojmë durim nga lakmia, atëherë kur paraqiten elemente që e largojnë njeriun nga ajo që kërkon Allahu.

Dëshirojmë durim nga epshet dhe kënaqja e tij.

Dëshirojmë durim në përballimin e vështirësive dhe dhimbjeve trupore dhe shpirtërore.

Ai që duron, vëllezër të mi, ka shpërblim të madh te Allahu, subhanehu ve teala.

Mjafton argument për vlerën e durimit, fjala e Allahut, subhanehu ve teala:

"Thuaj: "O robërit e Mi që keni besuar, kini frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e Allahut është e gjerë, ndërsa të durueshmive u jepet shpërblimi i tyre pa masë!". (Ez-zumer: 10).

Robër të Allahut!

Islami i udhëzon besimtarët që të jenë të kënaqur me caktimin e Allahut, në të gjitha fatkeqësitë që i ndodhin, të cilat i sjellin dhimbje, lodhje dhe vuajtje.

Ua ka sqaruar besimtarëve edhe urtësinë e sprovës në jetën e kësaj bote.

Allahu cakton që ta sprovon njeriun me gjëra që i urren dhe që i shkaktojnë dhimbje, mirëpo Allahu, az-ze ve xhel-le, u ka premtuar durimtarëve shpërblim të madh, nëse ata janë dakord me caktimin e Allahut, në shenjë respekti dhe duke shpresuar fitimin e kënaqësisë së Tij:

"Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepu myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: "Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi"! Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë". (El-Bekare: 155- 157).

Pasi që Allahu e përmendi se fatkeqësitë e godasin njeriun në trupin, familjen dhe pasurinë e tij, i pakësohet furnizimi, i përgëzoi durimtarët me dy urdhra të dashur dhe të mëdhenj:

Një: bekimi nga Allahu;

Dy: mëshira e Allahut për ta.



Kurse në ajetin tjetër Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"...Zoti juaj është një Zot, andaj vetëm Atij dorëzohuni, e përgëzo të dëgjueshmit. Të cilët, kur përmendet Allahu, u dridhen zemrat e tyre, të cilët janë të durueshëm ndaj asaj që i godet, të cilët rregullisht e falin namazin dhe të cilët japin për qëllime të dobishme nga ajo me çka i furnizua Ne". (El-Haxh: 34- 35).

Kur ta dijë besimtari se Allahu e sprovon me fatkeqësi që t'ia teston sasinë e durimit, sa është i kënaqur me Zotin e vet, që ta shpërblen me shpërblim të madh, ai e gjen veten të shtyrë për t'i duruar fatkeqësitë dhe të jetë dakord me to, e kur ta dijë se shpërblimi është edhe më i madh se kjo, sepse kaplon edhe faljen e mëkateve dhe gabimeve, me durimin e tij gjatë fatkeqësive, atëherë edhe më shumë do të duron.

Transmeton Imam Buhariu dhe Imam Muslimi, rahimehumull-llah, nga Ebu Seidi dhe nga Ebu Hurejre, radijAllahu anhuma, se Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Çdo gjë që e godet muslimanin, qoftë lodhje, sëmundje, brengë, mërzi, dëmtim, stres, madje edhe thera që e shpon, i shlyhen mëkatet me këto gjëra".

Abdullah ibn Mesudi, radijAllahu anhu, tregon:

"Hyra te Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, dhe e gjeta të sëmurë. I thashë: si duket paske dhimbje të madhe? Tha: po. Unë kam dhimbje sa dy prej jush". I thash: sepse ti ke dy shpërblime? Tha: po, kështu është. Secili musliman që e godet ndonjë dëmtim, therrë e më shumë se kjo, Allahu ia shlyen mëkatet ashtu sikur bien gjethet nga druri". (Buhariu).

Kur ta dijë besimtari se durimi i tij ndaj fatkeqësive dhe dhimbjeve ia shlyen mëkatet, ia ngrit shkallët dhe për secilën ndjenjë dhe dhimbje i shënohet shpërblim te Allahu, ai e kupton se gjendet në një mirësi shumë të madhe, e sheh veten brenda një tregu me tregti fitimprurëse.

Andaj një besimtar i mirëfilltë asnjëherë nuk e kërkon vdekjen për të shpëtuar nga vuajtjet, fatkeqësitë dhe dhimbjet, sepse besimtari e di se ymri i gjatë është mundësi për të bërë vepra të mira, ai që është bamirës vazhdon të bëjë bamirësi dhe ai që është mëkatar pendohet.

Transmeton Imam Buhariu, rahimehull-llah, nga Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Askush mos të kërkoj vdekjen, sepse nëse është bamirës i shton të mirat, kurse nëse është mëkatar, pendohet".

Kurse në transmetimin e Imam Muslimit qëndron kjo:

"Askush prej jush mos ta kërkojë vdekjen dhe mos të lutet para se t'i vijë koha, sepse nëse vdes i ndërpriten veprat, kurse besimtarit ymri i gjatë vetëm të mirat ia shton".

Këtë e kanë kuptuar shumë mirë sahabet, radijAllahu anhum, andaj Habab ibn Ereti, nuk e ka kërkuar vdekjen edhe pse ka arritur në një gjendje ku vdekja ka qenë më e dashur për Të se sa jeta.

Transmeton Imam Buhariu, rahimehull-llah, në sahihun e tij, nga Kajs ibn Ebi Hazimi, i cili tha:

"Shkuam ta vizitojmë Habab ibn Eretin, radijAllahu anhu, i cili shtatë herë ishte shëruar me keq (shërim me drapër të skuqur). Ai tha: shokët tanë që kanë shkuar nuk u ka munguar asgjë nga dynjaja, kurse ne kemi fituar gjëra për të cilat nuk gjejmë vend askund përpos se në dhe. Pastaj tha: po mos të ishte ndalesa e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, që ta kërkojmë vdekjen, do ta kërkoja".

Kjo është edukata islame, e ngrit lart moralin e muslimanit në jetë, ia forcon vullnetin, e largon mërzinë dhe vendon të jetë pengesë absolute mes tij dhe vetëvrasjes.

Kurse ai që nuk beson në Allahun dhe ahiretin, ai që nuk u beson parimeve islame, lindet tek ai mërzia nga jeta, në të keqen e parë që e godet, e nëse i shpeshtohen këto gjëra, i shkaktajnë shtypje të madhe, saqë nuk gjen as një rrugë tjetër përpos rrugës së besimit në Allahun dhe ditën e Ahiretit, të dakordohet me caktimin e Allahut dhe ta pret shpërblimin e madh që e ka përgatitur Allahu për durimtarët.

Nëse i vijnë fatkeqësitë njeriut një pas një derisa të eksplodojnë para tij, ky eksplodim i fatkeqësive mund ta shpien në vetëvrasje, ose në çmendje, ose në krim të madh, ose në dhënie pas alkoolit dhe pijeve narkotike.

Kurse besimtarët, ata janë rehat nga këto sprova. Këtu del në shesh imuniteti i habitshëm të cilin e ndërton besimi dhe durimi.

Robër të Allahut!

Do ta sjelli shembullin më të shkëlqyeshëm që flet për durimin.

Allahu, subhanehu ve teala, na e tregon tregimin e rrallë, heroizmin e vërtetë nga heroizmat e durimit, ku flitet për djalin dhe prindin e tij, në një provë të çuditshme, e ata janë dy peygamberët durimtar: Ismaili dhe Ibrahim, alejhinessalam.

Allahu e obligon Ibrahimin me ëndërr që ta therë djalin e tij, Ismailin, alejhissalam. Ai niset me një durim të habitshëm në zbatimin e urdhrit të Allahut dhe i thotë birit të tij:

"... "O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. ...". (ES-Saffat: 102).

Kurse ëndrrat e Pejgamberëve janë obligime. Kurse djali i tij i kujdesshëm i drejtohet duke i thënë:

"Ai tha: "O babai im, punoje atë që urdhërohesh, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!"

Ata iu dorëzuan urdhrit të Allahut si durimtar dhe duke vepruar për ta zbatuar obligimin. Therës dhe i therur. E kur Allahu e vërejti respektin e tyre, nënshtrimin e vërtetë, ua zbriti një dash, i cili e shpëtoi djalin dhe me këtë u ndërpre urdhri edhe për prindin edhe për djalin.

Kur Kurani e prezanton këtë tregim, aludon në durimin dhe vlerën e tij, në zbatimin e urdhrave të Zotit, sado që është i rëndë dhe i vrazhdë, udhëzim për tu përgatitur për të duruar vështirësitë, fatkeqësitë e ndryshme dhe nisja drejt tyre me guxim dhe trimëri.

Allahu, subhanehu ve teala, në suren Es-Saffat duke treguar tregimin e Ibrahimit, alejhisselam, me popullin e tij thotë:

"Ata i menduan atij një kurth, kurse Ne i mposhtëm ata të nënçmuar". Ai tha: "Unë po shkoj aty ku më urdhëroi Zoti im, e Ai më udhëzon!" Zoti im, më dhuro mua (një fëmijë) prej të mirëve! Ne e gëzuam atë me një djalë që do të jetë i butë (i sjellshëm). Dhe kur arriti ai (djali) që së bashku me të (me Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: "O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?" Ai tha: "O babai im, punoje atë që urdhëroresh, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!" E kur ata të dy iu dorëzuan urdhrit të Zotit dhe e përmbysi atë në fytyrë (në ballë). Ne e thirrëm atë: "O Ibrahim!" Ti tashmë e zbatove ëndërrën! Ne kështu i shpërblejmë të mirët!". (Es-Saffat: 98- 105).

Robër të Allahut, ky është tregimi më interesant që sillet si shembull për durimin.

Vallë, a do të përfitojnë agjëruesit nga ky tregim dhe të tjerat, e ta vazhdojnë rrugën e adhurimit, zbatimin e urdhrit të Allahut, kujdesin për namazin me xhemat në xhami, vazhdimin e leximit të Kuranit pas Ramazanit, dhe të durojnë në adhurime edhe jashta Ramazanit e jo vetëm në Ramazan.

Robër të Allahut!

Nëse ndalemi dhe analizojmë hapësirat ku kërkohet durimi në jetën e njeriut, do të shohim se durimi është i domosdoshëm në jetën e njeriut për çdo vepër të mirë. Fitimi i rizkut kërkon durim, sjellja me njerëzit kërkon durim, zbatimi i detyrave dhe kërkesave fetare kërkon durim, largimi nga haramet dhe gjërat e urryera kërkon durim, xhahadi në rrugë të Allahut kërkon durim, rezistimi i vështirësive të jetës dhe bartja e përgjegjësive kërkon durim, pra, të gjitha veprat që i vepron njeriu në jetën e tij, kërkojnë durim.

- Prej argumenteve se edhe veprimet e adhurimit kanë nevojë për durim është ajeti:

"Ne (engjëjt, thotë Xhibrili) nuk zbresim (nuk vijmë) vetëm me urdhrin e Zotit tënd. Vetëm Atij i takon e tërë çështja e tashme, e ardhme dhe mes tyre, e Zoti yt nuk është që harron. Ai është Zot i qiejve dhe i tokës dhe çka ka midis tyre, pra Atë adhuroje, e në adhurimin ndaj Tij bëhu i qëndrueshëm. A di për Të ndonjë emnak (adash)?!". (Merjem: 64- 65).

- Sjellja me njerëz kërkon durim:

"...Ne bëmë njërin prej jush sprovë për tjetrin se a do të jeni të durueshëm. E Zoti yt është Ai që sheh çdo gjë". (El-Furkan: 20).

- Xhahadi kërkon durim:

"O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimit të Allahut". (Ali Imran: 200).

"O ju që besuat, kur të konfrontoheni me ndonjë grup, përqëndrohuni dhe përmendni çdo herë Allahun, që ta arrini fitoren e dëshiruar". (El-Nefal: 45).

"Dhe respektojuni Allahun e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se Allahu është me të durueshmit". (El-Nefal: 46).

- Studimet shkencore dhe ixhtihadi për të nxjerrë ndonjë dispozitë fetare kërkojnë durim të madh:

"A nuk e di se Allahu e fut (errësirën) natën në ditë dhe e fut (dritën) ditën në natë, dhe Ai i nënshtroi Diellin e Hënën (të lindin e të perëndojnë) dhe secili rrjedh (noton) deri në një afat të caktuar dhe se Allahu hollësisht është i njohur për atë që vepron. Kjo (dokumenton) se Allahu është Ai (Zoti) i vërtetë, dhe se ajo që ata adhurojnë pos Tij është gënjeshtër, e Allahu është Ai i larti, i madhi. A nuk e sheh se anijet lundrojnë në saje të mirësisë së Allahut, e për t'ju treguar juve madhërinë e Tij. Vërtet, edhe në këtë ka argument për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë mirënjohës". (Lukman: 29- 31).

- Frenimi i mllëfit dhe gëlltitja e hidhërimit kërkojnë një durim shumë të madh:

"Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që kanë virtyt të lartë. E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej Allahut, se vërtet Ai është dëgjuesi, i dijsلمي!". (Fusilet: 34- 36).

Durimi është prej virtyteve më të rëndësishme me të cilat duhet të stoliset ai që udhëheq njerëzit, pa marr parasysh se në çfarë sferë, sepse ai që nuk duron dështon dhe bjer nga pozita që ka.

Allahu, subhanehu ve teala, kur flet për Jusufin, alejhisselam, thotë:

"Ata thanë: "A ti je vetë Jusufi?" Ai tha: "Unë jam Jusufi, e ky është vëllai im, Allahu na dhuroi shpëtimin, pse ai që ruhet dhe bën durim, s'ka dyshim Allahu nuk humb shpërblimin e punëmireve". (Jusuf: 90).

Për Musain, alejhisselam, ka thënë:

"Ne i patëm dhënë edhe Musait librin, e ti (Muhammed) mos ke dyshim në çka pranon (në Kuranin libër qiellor si i Musait), kurse atë (librin e Musait) e bëmë udhërrëfyes për beni israilët. Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata (që i bëmë prijësa) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur". (Es-Sexhde: 23- 24).

Kurse në suren El-A'raf flet për këtë ligj shoqëror dhe njerëzor:

"E atij populli që ishte i nënshtruar i trashëguam lindje e perëndim të tokës, që Ne e bekuam (me të mira), ndërsa për durimin që patën, u plotësua fjala më e mirë (premtimi i vërtetë) e Zotit ndaj beni israilëve; rrënuam atë që bënte faraoni i tij, si dhe atë që kishin ndërtuar ata". (El-A'raf: 137). (El-Ahmed, n.d.)

Nasir Muhamed El-Ahmed

## Ramazani: Një përkujtues i bashkimit të muslimanëve

Ebu Hurejrah radiallahu anhu ka transmetuar se Pejgamberi, salallahu alejhis ua salam, ka thënë: "Agjëro kur ata agjërojnë, përfundoje agjërimin kur ata ta mbarojnë të tyrin dhe bë kurban kur ata të bëjnë kurban".<sup>13</sup>

El-Bejhaki ka transmetuar përmes Ebu Hanifa-s i cili ka thënë: Ali Ibnul-Akmar më ka transmetuar mua nga Maskuk i cili ka thënë: "Unë kam hyrë tek Aisha në ditën e Arafatit kështu ajo më ka thënë: "Shërbeje Marsukun me ca përshesha (llapë) dhe bëje më të ëmbël". Masruku i ka thënë: "Asgjë nuk më pengojë mua të agjëroj këtë ditë përveç frikës se mos ishte dita e Kurbanit. Kështu Aisha më ka thënë mua: "Dita e Kurbanit është kur njerëzit bëjnë kurban dhe dita e përfundimit të agjërimin është kur njerëzit e përfundojnë agjërimin e tyre".

Ky zinxhir transmetimi është xhejjid (I mirë) për shkak të asaj çfarë ka vazhduar.

### Kuptimi i Hadithit

Imam et-Tirmidhi ka thënë pasi e ka cituar hadithin:

"Një nga njerëzit e dijes e ka shpjeguar këtë hadith duke thënë: Kuptimi i tij është për të agjëruar dhe për ta përfunduar agjërimin bashkë me xhematin dhe maxhorancën e njerëzve".

Es-San'ani ka thënë në Subulus-Selam (2/72):

"Në këtë hadith është një fakt që është në përputhje me njerëzit që e kanë pranuar vendosjen e Bajramit (Id- në arabisht) dhe që individit që beson se është ditë Bajrami për shkak të shikimit të hënës atëhere është e obligueshme mbi të të jetë

---

<sup>13</sup> Sahih: i transmetuar nga Et-Tirmidhiu (2/37). Shejh Albani e ka verifikuar sahih në es-Sahiha (nr. 224).



në përputhje me njerëzit dhe që gjykimi i njerëzve...për sa i përket faljes, përfundimit të agjërimit dhe bërjes Kurban është e detyrueshme mbi këtë individ”.

Ibën Kajjim, rahimahullah, e ka përmendur këtë kuptim në Tehdhibus-Sunan (3/214) dhe ka thënë ”Është e thënë: Në të është një refuzim për ata të cilët thonë që kushdo që e di pozicionet e hënës për shkak të llogaritjeve astronomike atëherë është e lejueshme për të të agjërojë dhe ta përfundojë agjërimitin, madje edhe nëse të tjerët nuk e dinë. Është thënë: Që individi që dëshmon të shfaqurit e hënës, por Kadiu (gjykatësi) nuk e ka pranuar dëshminë e tij atëherë nuk ka agjërim për të, siç nuk ka agjërim për njerëzit”.

Ebul Hasan es-Sindi ka thënë në “Hashijah a’ala Ibën Maxhe” pasi ka përmendur hadithin e Ebu Hurejrah-s i cili është transmetuar nga et-Tirmidhiu: ”Dhe kuptimi i dukshëm është: Që nuk ka vend për (opinionet) e individëve për të hyrë në këto punë, e as të veprojnë në mënyrë individuale për këtë. Ndërsa kjo punë i përket Imamit (liderit të muslimanëve) dhe Xhematit (trupit të bashkuar të muslimanëve nën udhëheqësi të imamit). Është e obligueshme mbi individët të ndjekin Imamin dhe Xhematin. Nga kjo është se nëse një individ e shikon hënën por Kadiu e ka refuzuar dëshminë e tij atëherë individi nuk ka të drejtë në këto çështje por duhet të ndjek xhematin në këtë”.

Dhe ky është kuptimi i cili është i dukshëm nga hadithi dhe i cili është i theksuar nga fakti që Aisha, radiallahu anha, e ka përdorur atë me Masrukun kur ai e ka penguar veten për të agjëruar në ditën e Arafatit duke iu frikësuar se mos është ditë kurbanit. Kështu ajo ia ka shpjeguar atij që nuk ka peshë opinionin e një individi për këtë dhe që ai duhet të ndjek xhematin. Kështu ajo i ka thënë atij: ”Dita e kurbanit është kur njerëzit bëjnë Kurban dhe dita e përfundimit të agjërimit është kur njerëzit përfundojnë agjërimitin e tyre”.

Dhe kjo është çfarë është më e dobishme; natyrshmëria dhe toleranca e Sheriatit (Ligjit Islam), ku njëri nga qëllimet është bashkimi i njerëzve së bashku, duke i

unifikuar radhët e tyre dhe duke u larguar nga të gjithë ata që ndahen nga bashkimi i tyre i përgjithshëm – nga opinionet individuale. Kështu Sheriati nuk i jep asnjë peshë opinionit të individëve në çështje që i përkasin Ibadah xhama'ijah (rite kolektive të adhurimit) të tilla si agjërimi-Bajrami dhe falja me xhemat – edhe nëse opinionin është korrekt, nga njëra anë. A nuk shikoni që sahabet, radiallahu anhum, janë falur mbrapa njëri-tjetrit. Kështu nga ata ka pasur prej tyre që e kanë konsideruar që prekja e një gruaje ose derdhja e gjakut nga trupi e zhvlerëson abdesin dhe janë falur përkrah me ata të cilët nuk e kanë mbajtur këtë pikëpamje. Nga ata ka pasur prej tyre që e kanë kompletuar faljen ndërsa udhëtonin ndërsa të tjerët e kanë shkurtuar. Dhe këto dhe të tjera ndryshime nuk i kanë penguar ata nga të falurit kolektivisht pas një imami të vetëm dhe kanë mbajtur mendimin se është i pranueshëm. Dhe kjo është sepse ata e dinin që tafarruk (përçarja) në fe është më e keqe sesa ndryshimet në Ihtilaf në disa opinione. Madje, çështja me një prej tyre arriti deri aty sa ta quante të papranueshme asnjë opinion i cili ka ndryshuar me Imamin e madh në grumbullime të mëdha; të tilla si grumbullimet në Mina (gjatë Haxhit) deri aty që ai do ta linte veprimin mbi opinionin e tij në atë grumbullim – duke u larguar nga ajo e cila mund të rezultojë në keq, për shkak të veprimit në opininin e tij.

Kështu Ebu Dauudi transmeton (1/307) që Uthmani, radijallahu anhu, i ka falur katër rekatë në Mina, kështu Abdullah Ibën Masudi e ka kritikuar atë duke thënë: "Unë kam falur dy rekat me Pejgamberin, salallahu alejhis ua selam, dhe dy rekatë me Ebu Bekrin dhe dy rekatë me Omerin dhe dy rekatë me Othmanin në fillim të qeverisjes së tij, pasta ai e komplettoj atë (duke falur katër rekatë). Pas kësaj rrugët u bënë të ndara me të gjithë ju. Kështu unë shpresoj nga këto katër rekatë që të dyja këto të jenë të pranueshme". Më pastaj Ibën Mesudi vet ka falur katër rekatë. Kështu i është thënë atij: "Ti e ke kritikuar Othmanin e ti u fale me katër rekatë? E ai ka thënë: "Ndryshimi është i keq".

Kështu ata të cilët vazhdojnë të ndahen përsa i përket faljeve dhe të cilët refuzojnë të ndjekin imamët lokal në disa xhami – veçanërisht në Faljen e vitrit gjatë

Ramazanit – duke përdorur si fakt që është kundër medhhebit të tyre atëherë ata duhet të reflektojnë mbi hadithin e mësipërm dhe etherin [trasmetimin].

Pra ata të cilët kanë dituri astronomike dhe për shkak të opinionit të tyre agjërojnë dhe e përfundojnë agjërimin vetëm duke munguar ose ndarë nga maxhoranca e muslimanëve, duke mos parë asnjë gjë të keqe në të vepruarit kështu – ai duhet të reflektojë edhe mbi faktet e përmendura më parë. Kështu të gjithë ata duhet të konsiderojnë dhe të reflektojnë mbi dijen që është përmendur. Ndoshta do të gjejnë për vetet e tyre një kurë për injorancën e tyre dhe vetdëshpërimin, kështu që ata mund të bëhen atëhere një rresht i bashkuar përkrah vëllezërve të tyre musliman – sepse me të vërtetë Dora e Allahut është mbi xhematin. (Albani, n.d.)

Shejh Muhammed Nasirud-din Albani

Marrë nga: Silsilatul-Ahadithus-Sahihah (1/442-445)

## Ndikimi i agjërimit në fitimin e krenarisë

Krenaria është veçori e ndershme, cilësi e lavdëruar, moral i lartë dhe edukatë e dalluar, mallëngjehen për të burrat fisnik dhe synojnë fitimin e saj shpirtë-mëdhenjtë.

Islami është fe e krenarisë dhe nderit, fe e epërsisë dhe ngritjes, fe e seriozitetit dhe përpjekjes, nuk është fe e nënshtrimit dhe ngratësisë, e as fe e përtacisë, dembelisë dhe rehatisë.

Muaji i Ramazanit është mejdan i gjerë për të fituar krenarinë dhe për tu cilësuar me të, edhe atë në disa aspekte të ndryshme. Agjëruesi, psh. e fiton këtë cilësi gjatë agjërimit, gjatë lënies së ushqimit, pijes dhe epsheve të lejuara, e mos të flasim për ato të ndaluarat.

Agjërimi i shtyn njeriun të ngritet nga gjërat e ulëta dhe të pavlera, e çliron nga zakonet dhe epsheet e veta.

Krenaria arrihet, gjithashtu, duke u larguar nga polemikat sterile, debatet e padobishme, injoranca, fjalët e ndyta, bërtitja, sjellja e keqe ndaj njerëzve, duke e zbatuar hadithin e Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi:

"Nëse dikush është agjërueshëm mos të flet fjalë të ndyta e as mos të bërtet".

Në transmetimin tjetër qëndron: "mos të sillet si injorant" ose "mos të polemizon".

Nëse agjëruesi është i këtillë, ai e ruan krenarinë dhe nderin e vet, e ngrit nga pasimi i grupit të njerëzve që parapëlqejnë aventurën.

Besimtari agjërues e fiton krenarinë në këtë muaj nga agjërimi i vet, veprat e shumta të mira, këputja e çdo lidhje përpos lidhjes me Allahun, edhe kjo pa dyshim se është sekreti më i madh, sepse me këtë shkak e fiton krenarinë shpirtërore, i shtohet besimi dhe lidhet dhe i afrohet edhe më shumë Allahut:

"... Ndërsa e tërë krenaria i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë". (El-Munafikun: 8).

Muslimanët e fitojnë krenarinë në këtë muaj për shkak shtimit të sasisë së lëmshës së shpërndarë dhe bamirësia ndaj të varfërve dhe nevojtarëve.

Pa dyshim se në këtë mënyrë ruhet fytyra e njerëzve nga lypja, shpëtimi i shumë njerëzve nga nevoja e varfërisë dhe nënçmimi i nevojës, e cila mund ta sjell njeriun deri në prishje të madhe morale dhe humbje të edukatës.

Kështu na bëhet e qartë se si ndikon agjërimi në fitimin e krenarisë, atë individuale dhe atë kolektive.

Sa shumë kemi nevojë për këtë edukatë të lartë, në të cilën na ka udhëzuar feja jonë, na ka stimuluar që të stolisemi me të, na ka orientuar që ta fitojmë dhe na i ka treguar të gjitha rrugët që na çojnë tek ajo.

Prej manifestimeve të edukimit të muslimanëve në këtë sjellje është udhëzimi që vetëm Allahut t'i drejtohen në çështjet e vogla dhe të mëdha, të shumta dhe të pakta.

Në këtë hyn edhe udhëzimi i muslimanëve që të fitojnë hallall, duke punuar dhe duke u lodhur, duke ecur mbi rruzullin tokësor, që të jetë njeriu i ndershëm dhe mos të ketë nevojë për tjerët.

Gjithashtu Islami i ka udhëzuar që mos të lypin prej njerëzve, i ka neveritur nga kjo sjellje e keqe, në përjashtim të atij që ka qenë në vështirësi, në ngushticë dhe varfëri.

Islami i ka udhëzuar njerëzit se dora e lartë është më e mirë se dora e ultë, ia ka ndaluar atij që ka mundësi të fitojë që ta zgjatë dorën, sepse kjo ia humb dinjitetin.

Sipas rregullave islame lejohet të përdoret tejumumi dhe nuk ia ka bërë obligim ta pranon dhuratë çmimin e ujit, sepse kjo ia pakëson ambicjen e lartë.

Në këtë hyjnë edhe mos-detyrimi që të kërkojë petk për ta mbuluar aurretin, sepse kështu ia ruan dinjitetin.

Prej rregullave që kujdesen për këtë sjellje është edhe vet fakti se lëmosha nuk e zen vendin e vet nëse ai të cilit don t'ia japish nuk e pranon, sepse disa njerëz krenar nuk e pranojnë, sepse urrejnë që ndokush tua përmend. Përmendja e ndryshk kanalit e krenarisë, andaj njeriu me edukatë të lartë nuk e duron këtë gjë, përpos se kur është i detyruar, sidomos kur kjo i vjen nga një njeri jofisnik dhe jo me edukatë të lartë.

Sherijati e ka mësuar muslimanin që kur të merr pasurinë ta merr me bujari, me qëllim që të lëshon bekimin e Vet Allahu, e mos ta merr me israf, trishtim, poshtërim dhe lakmi.

Nëse njeriu cilësohet me krenari bëhet i ndershëm, kokëlartë, shpëton nga nënçmimi, çlirohet nga robëria e epsheve dhe nënçmimi i lakmisë dhe ece vetëm sipas asaj që ia dikton besimi dhe e vërteta të cilën e bartë.

Andaj e vërejmë se njerëzit më të vendosur dhe të paluhatsëm janë krenarët dhe ata që janë larg lakmisë.

Krenaria njeriut i jep dinjitet, prestigj, madhërim dhe pozitë në zemër të njerëzve, e kjo pa dyshim ia zgjeron gjoksin njerëzve të mëdhenj.

Normalisht se qortohet njeriu, i cili këtë pozitë e përcakton si qëllim final, duke mos e shtyrë në këtë drejtim arritja e kënaqësisë së Allahut dhe pastaj bërja dobi tjerëve.

Ashtu sikurse krenaria ka ndikimin e vet në individë, ka ndikimin e vet pozitiv edhe në shoqëri, sepse një popull që ngopet me krenari, i shtohet kujdesi që të jetë i pavarur në çështjet e veta, i panevojshëm për popujt tjerë, kujdeset shumë që mos të bjerë në dorën e atij që ia nënçmon nderin ose ia shkel të drejtën.

Agjërues të nderuar, këto janë disa shenja të krenarisë dhe ndikimi i agjërimit në fitimin e tij.

U ofrojmë disa argumente fetare që flasin për krenarinë:

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Abdullah ibn Abbasit, radijAllahu anhu:

"Kur të lypsh vetëm prej Allahut lyp, e kur të kërkosh ndihmë vetëm prej Allahut kërkko ndihmë". (sahih, Tirmidhiu).

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Të merr dikush prej jush një litar e të mbledh dru, e ta mbron fytyrën (nga lypja) është me mirë për Të se sa të lyp prej njerëzve, i japin ose jo". (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Ai që bëhet i pavarur prej njerëzve e pasuron Allahu, ai që kërkon nderin, i jep nderë Allahu, ai që e mëson veten në durim, i jep durim Allahu, askujt si është dhënë dhunti ose dhënie më të gjerë se sa durimi". (Buhariu dhe Muslimi).

Gjithashtu transmeton Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Vazhdon lypësi të lyp prej njerëzve derisa kur të vijë në Ditën e Kijametit do të vijë me fytyrë pa mish në te".

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Ai që lyp prej njerëzve, lyp gacë, le ta pakëson ose le ta shton". (Muslimi).

Madje Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka porositur disa shokë të tij që mos të kërkojnë asgjë prej njerëzve.

Transmeton Imam Muslimi në "Sashihun" e tij nga Auf ibn Malik El-Eshxheiu, radijAllahu anhu, i cili ku iu besatua Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, me disa sahabe tjerë, i thanë: në çka të të besatohemi?

Tha:

"Që të adhuroni Allahun dhe Atij mos t'i bëni rival asgjë, të falni namazin, të respektoni... e tha një fjalë me zë të ultë dhe tha: mos të kërkoni asgjë prej njerëzve".

Aufi, radijAllahu anhu, thotë: i kam parë disa prej tyre që edhe kur ju binte shkopi nuk kërkonin nga askush që tua afron.

Kabisete ibn Muharik El-Hilaliu, radijAllahu anhu, thotë:

"Mbajta një mall dhe shkova te Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të kërkoj nga ky mall. Kurse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, më tha: "prit derisa të na vjen sadakaja e të japim".

E pastaj më tha: Kabisa! Lypja nuk i lejohet përpos tre personave:

- Ai që bart ndonjë mall, ka të drejtë të lyp, sa ta kërkon, e pastaj të ndalet;
- njeriut që i ka goditur ndonjë fatkeqësi në pasurinë e tij, edhe këtij i takon lypja, derisa të fiton aq sa i mjafton ushqim;
- njeriu, të cilin e ka kapluar varfëria dhe të dëshmojnë tre njerëz të mençur se filani është i varfër, edhe këtij i lejohet të lyp derisa ta siguron ushqimin e mjaftueshëm. Të tjerët, han pasuri që nuk ju takon". (Muslimi).

Agjërues të nderuar!

Ashtu sikurse argumentet fetare e lavdërojnë krenarinë dhe e stimulojnë atë, në këtë drejtim flasin edhe shumë porosi të dijetarëve dhe njerëzve të urtë.

Vehb Ibn Munebehi, rahimehull-llah, i ka thënë një njeriu që lypte prej mbretërve:



"Vaj për ty! Lyp prej atij që ta mbyll derën, ta paraqet varfërinë që ka, e fsheh pasurinë që ka dhe len Atë që ta hap derën gjatë natës dhe gjatë ditës, ta shfaq pasurinë dhe thotë: më lutu që të përgjigjem".

Tavusi i tha Atas, rahimehumAllah:

"Ke kujdes e mos kërko nevojat tuaja nga ai që ta mbyll derën e të pengojnë rija e tij, kërko nga Ai që derën e ka të hapur deri në ditën e Kijametit, Ai që të ka urdhëruar që ta lutesh dhe të ka premtuar se do të të përgjigjet".

I kanë thënë Ebu Hazimit, rahimehull-llah:

"Cila është pasuria jote? Ka thënë: bindja ime te Allahu dhe mos-shpresimi tek njerëzit".

Halifi i muslimanëve i shkroi Ebu Hazimit, rahimehull-llah: trego se çka është nevoja jote?

Ebu Hazimi i tha:

"He! I kam treguar nevojat e mia Atij që nuk deponon asgjë, jam dakord me atë që ma ka dhënë dhe me atë që s'ma ka dhënë".

Dijetari Izuddin ibn Abdus-Selami, rahimehull-llah, kur ndonjë nxënës lexonte ndonjë libër para tij dhe kur vinte fundi i thoshte:

"Lexo edhe nga kapitulli tjetër diç, se unë nuk kam dëshirë të ndalem në kapituj (dyer)".

Imam Ahmed ibn Jahja Thalebiu, rahimehull-llah, e thuri këtë poezi:

*Ai që është i ndershëm (që nuk lyp) është i lehtë për mikun e vet*

*Kurse miku i lypjes fytyrën e ka të nxirë*

*Vëllai yt është ai që ia kursen qesen*

*E nëse kërkon prej tij ndihmë, ti për të je i rëndë*

Kurse shejhu El-Mekudiju, rahimehull-llah, ka thënë:

Nëse në ndonjë kohë kam ndonjë nevojë dhe më është komplikuar situata

Ndalem te dera e Allahut i përulur dhe them: Zoti im unë te Ti jam nisur

E nuk ndalem te dera e atij, që shërbëtorët e tij thonë: zotëriu është duke fjetur.

Agjërues të nderuar!

Kjo është krenaria, kurse ne jemi në muajin e të mirës dhe krenarisë, vallë a nuk e ndjejmë këtë domethënie gjatë agjërimit tonë?!

Duhet ta kuptojmë se krenaria i takon Allahut, Pejgamberit dhe besimtarëve, andaj ta kërkojmë krenarinë aty ku duhet, të veprojmë që ta kuptojmë si duhet dhe të cilësohemi me të, e të kemi krenari, gëzim dhe përmendje të mirë në këtë botë dhe shpërblim e dhurata të pakufishme në ahiret!

Allahu ynë na bë krenari me respektin tonë ndaj Teje dhe mos na poshtëro me mëkatet që i bëjmë ndaj Teje.

Autor: Muhamed ibn Ibrahim El-Hamed

## Itikafi

Itikaf është të qëndruarit në xhami me nijet të caktuar, për t'i bërë ibadet Allahut subhanehu ue teala edhe në qoftë një orë natën ose ditën, dhe nuk kushtëzohet pastrimi (gusli) për të.<sup>14</sup>

### Dispozitat e Itikafit:

Është sunet në çdo kohë e në Ramazan është më e sigurt e në dhjetë ditët e fundit edhe më shumë, siç transmetohet nga Aishja radijallahu anha që ka thënë: "Ka qëndruar i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Itikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit derisa vdiq, pastaj kanë qëndruar gratë e tij ". (Buhariu)

Ka thënë Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë: "Nuk di se dikush nga dijetarët e ka kundërshtuar mendimin se Itikafi s'është sunet" (E ka transmetuar nga ai Ebu Davudi).

### A kushtëzohet për Itikafin agjërimi?

Thënja më e saktë është se nuk kushtëzohet agjërimi për Itikaf, në qoftë se do të kushtëzohej një gjë e tillë nuk do të llogaritej Itikafi i natës, sepse natën nuk ka agjërim.

---

<sup>14</sup> Me fjalë të tjera itikaf është të izoluarit e vetvetes në xhami, për një kohë të caktuar, me qëllim për t'i bërë ibadet All-llahut subhanehu ve teala. Është e lejuar në çdo kohë për mashkull ose femër, por më e pëlqyeshme është në muajin Ramazan; në dhjetë ditët e fundit dhe ky është suneti i pejgamberit sa-lallahu alejhi ve selem.

## **Kur bëhet Itikafi obligim (vaxhib)?**

Ka thënë Ibn Mundhiri: "Kanë rënë në pajtim dijetarët se Itikafi nuk është obligim, vetëm nëse njeriu ia bën vetes obligim me anë të zotimit (nedhrit). Këtë e argumenton fjala e Muhammedit, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ku thotë: "Ai që është zotuar që ta respektojë Allahun, le ta respektojë." (Buhariu)

Kush zotohet që të bëjë Itikaf një ditë obligohet për atë itikaf; kush zotohet që të bëjë Itikafin agjërueshëm obligohet ta bëjë Itikafin para agimit e deri në perëndim të diellit; e kush zotohet ta bëjë Itikafin agjërueshëm obligohet të rrijë gjatë ditës qoftë edhe një orë, sepse ai duhet që të qëndrojë në Itikaf agjërueshëm.

### **Kushtet e Itikafit:**

-Islami.

-Nijeti.

-Logjika (të jetë i mençur). Fëmija, qoftë mashkull ose femër, nëse qëndron në itikaf, itikafi i tij është i saktë.

- Itikafi të jetë në xhami ku falen namazet me xhemat.

### **Vendi i itikafit:**

Itikafi bëhet në çdo xhami në të cilën falet namazi me xhemat, në cilindo vend që të jetë e më së miri të jetë në xhami ku falet namazi i xhumasë, që mos të ketë nevojë të dalë nga xhamia kur të vijë koha e namazit të xhumasë. Por nëse nuk gjen xhami të tillë, atëherë bën Itikaf aty ku ka mundësi, dhe ka të drejtë të shkojë pastaj që ta falë namazin e xhumasë.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Duhet ditur se, nëse ka mundësi të bëhet Itikafi në dy haremet: xhamia në Mekë ose në Medine ose në xhaminë e Aksas, shpërblimi është më i madh, sepse edhe namazet në to e kanë vlerën e dyfishuar siç ka ardhur në shumë hadithe të sakta të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve selem.

## **Kur fillon koha e hyrjes në Itikaf?**

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se Itikafi fillon në natën e njëzet e një të muajit Ramazan.

## **Kur del personi nga Itikafi:**

Personi del nga vendi i Itikafit pas përdimit të diellit natën e Bajramit.

## **Gjërat e pëlqyeshme gjatë Itikafit:**

Duhet që personi që bën itikaf të angazhohet me ibadet ndaj Allahut subhanehu ue teala, me lexim të Kuranit, dua, dhikër, namaz nafile (vullnetar) e të tjera, e mos ta kalojë kohën me gjëra që nuk kanë dobi.

## **Gjërat e ndaluara në Itikaf:**

Personi që qëndron në Itikaf duhet ti lërë gjërat që si bëjnë dobi prej fjalëve dhe veprave, gjithashtu polemikën dhe teprimin në bisedë ose që është e ngjashme me të. Ka thënë Muhammedi sal-Allahu alejhi ue sel-lem : "Prej të mirave të islamit është që ta lërë njeriu atë që nuk i intereson." (Këtë e ka nxjerrë Tërmiidhiu, Ibn Maxhe dhe El-Bagaviju)

## **Gjërat që e prishin Itikafin:**

1.Marrdhëniet intime. Këtë e argumenton Fjala e Allahut subhanehu ue teala ku thotë: "E kur jeni të izoluar (në Itikaf) në xhamia, mos t'u afroheni atyre (për marrëdhënie intime). (suretu el-Bekare: 187)

2.Dalja nga xhamia pa pasur nevojë të domosdoshme. E kanë përmendur disa dijetarë që gjithashtu prishet nëse personi vepron mëkate të mëdha ose ndonjë nga gjërat e ndaluara (haramet).

A i lejohet personit që rri në Itikaf të dalë nga xhamia ?

Të dalurit nga xhamia në këtë gjendje dijetarët e kanë ndarë në tre pjesë:

1.E lejuar: Kjo është dalja për një çështje të domosdoshme qoftë ajo e lidhur me çështje fetare ose çështje të natyrshme si psh: dalja për namaz të xhumasë; për të ngrënë ose për të pirë, nëse nuk ka njeri që t'ia sjellë këto gjëra; dalja për abdes, pastrim janë të obliguar, ose për të kryer nevojë personale

2.Dalja që ka të bëjë me ibadet jo të obligueshëm:

Si psh,: vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes; kjo lejohet vetëm nëse e ka kushtëzuar në fillim të itikafit përndryshe nuk lejohet

3.Dalja për një çështje që e prishë itikafin: si psh,: dalja për shitblerje, për marrëdhënie me gruan; kjo nuk lejohet as me kushtëzim e as pa kushtëzim.

Allahu e din më së miri

Muhammed bin Ibrahim Elmukajed

## Nata e Kadrit

Allahu thotë (përkthim i kuptimit):

1. Ha, Mimë. [Këto shkronja janë prej mrekullive të Kuranit dhe askush tjetër pos Allahut (të Vetmit) nuk e din kuptimin e tyre.]
2. Pasha librin sqarues (të së drejtës nga e kota)!
3. Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (në natën e Kadrit). Ne dëshirova t'u tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm.
4. Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë.
5. Urdhër i përcaktuar nga Vetë Ne. S'ka dyshim se Ne dërguam të dërguar.
6. (E zbritëm) Nga Mëshira e Zotit tënd; Ai është dëgjuesi, i dijshti. [al-Duhan 44:1-6]

Allahu dërgoi Kuranin në këtë natë të cilën Zoti e ka përshkruar si të bekuar. Transmetohet prej një grupi të Selefët – duke përfshirë Ibn 'Abbaas, Kutaadah, Sa'iid ibn Xhubejr, 'Ikrimah, Muxhahid dhe tjerë – se nata në të cilën është shpallur Kurani ka qenë Nata e Kadrit.

Shprehja Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë do të thotë, në atë natë fati i të gjitha krijesave vendoset për vitin e ardhshëm. Në atë natë shkruhet se kush do të jetojë, kush do të vdes, kush do të shpëtohet, kush do të mallkohet, kush do të paracaktohet për në Xhenet, e kush do të paracaktohet për në Xhehenem, kujt do t'i dhurohet nderi, kush do të turpërohet, ku do të paraqitet thatësia dhe uria, dhe çdo gjë tjetër të cilën e dëshiron Allahu atë vit.

Ajo që nënkuptohet me idenë se fati i të gjitha krijesave shkruhet në Natën e Kadrit është – e Allahu e din më së miri – se në Natën e Kadrit ato barten prej Leuhul Mahfudh. Ibn 'Abbaas tha: “Mund të shihni një njeri i cili furnizon shtëpinë e tij ose e punon token e tij, dhe ai është prej atyre të cilët do të vdesin,”

dmth., është urdhëruar në Natën e Kadrit se ai është njëri prej tyre të cilët do të vdesin (në vitin e ardhshëm). Dhe po ashtu është thënë se në këtë natë, fati i njerëzve ju tregohet melaikeve.

Kuptimi i “Kadr” është nderim ose respektim, dmth. ajo është natë e cila nderohet për shkak të karakteristikave të saja të veçanta, dhe pasi që personi i cili rri i zgjuar gjatë kësaj nate bëhet njeri i nderit. Dhe është thënë se Kadr do të thotë shtrëngim, në kuptimin se dituria kur është saktë kjo natë, është e fshehur. El-Haliil ibn Ahmed ka thënë: është quajtur Nata e Kadrit pasi që bota shtrëngohet nga numri i madh i melaikeve në këtë natë, dhe Kadr do të thotë shtrëngim. Allahu thotë (përkthim i kuptimit):

“Por, kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin (e varfëron) [fë kadara ‘alejhi rizkahu]...” [el-Fexhr 89:16], dmth., duke shtrënguar ose zvogëluar furnizimin e tij.

Dhe është thënë se Kadr do të thotë Kadar, dmth., se në këtë natë vendosen urdhrat për vitin e ardhshëm, siç thotë Allahu (përkthim i kuptimit):

“Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë.” [ed-Duhaan 44:4]

dhe pasi që urdhrat e Allahut vendosen dhe shkruhen në këtë natë.

Ashtu që Allahu e ka quajtur Nata e Kadrit, për shkak të vlerës së madhe të saj dhe statusit të lartë me Allahun, dhe pasi që aq shumë mëkate falen dhe aq shumë të meta fshihen gjatë kësaj nate. Pasi që ajo është nata e faljeve, siç është përcjellë në Sahiihejn nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të) se i Dërguari (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kush e falë natën e Kadrit me besim dhe shpresim i falën mëkatet që i ka bërë më parë” (el-Buhaari, 1910; Muslim, 760).

Allahu i ka dhënë kësaj nate karakteristika speciale të cilat e bëjnë atë unike:

është nata në të cilën është shpallur Kurani, siç përmendëm më lartë. Ibn ‘Abbaas dhe të tjerët kanë thënë: “Allahu dërgoi Kuranin në një kohë prej el-Leuh el-



Mahfuuz në Bejt el-‘Izzah në qiellin e parë, dhe mandej ju shpall të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) në periudha sipas ngjarjeve gjatë njëzet e tre vjetëve.” (Tefsiiir Ibn Kathiir, 4/529)

Allahu e ka përshkruar atë duke qenë më e mire sesa një mijë muaj, siç ka thënë Ai (përkthim i kuptimit): “Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!” [el-Kadr 97:3].

Allahu e ka përshkruar si të bekuar, siç ka thënë Ai (përkthim i kuptimit): “Ne e zbritëm atë (këtë Kuran) në një natë të bekuar (në natën e begatshme të Kadrit)” [el-Duhaan 44:3].

Në këtë natë, melaiket dhe Shpirti [er-Ruuh] zbresin, “dmth., shumë melaiket lëshohen poshtë në këtë natë pasi që është shumë e bekuar, dhe melaiket zbresin poshtë kur bekimi dhe mëshira e Allahut vijnë poshtë, posikur atëherë kur recitohet Kurani, dhe ato i rrethojnë qarqet e dhikrit (tubimet ku përkujtohet Allahu), dhe ato me respekt ndaj atij, i rrahin krahët e tyre për atë i cili sinqerisht kërkon dituri.” (Shif’Tefsiiir Ibn Kathiir, 4/531). Shpirti [er-Ruuh] është Xhibrili (alejhi selam), i cili veçanërisht përmendet në këtë mënyrë si shenjë respekti ndaj tij.

Kjo natë përshkruhet si paqe, dmth., është e sigurt, pasi që Shejtani nuk mund të bën asnjë të keqe ose të shkakton dëm në këtë natë, siç ka thënë Muxhaahid. (Shif Tefsiiir Ibn Kathiir, 4/531). Në këtë natë, shumë njerëz shpëtohen prej dënimit për shkak të veprave të tyre për të adhuruar Allahun, Qoftë i lartësuar.

“Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë.” [ed-Duhaan 44:4 – përkthim i kuptimit], dmth., punët e atij viti dërgohen prej el-Leuh ul-Mahfuuz melaikëve të cilat shënojnë urdhërat; e atyre të cilët do të jetojnë, dhe atyre të cilët do të vdesin, çfarë furnizimi do t’ju jepet, çka do të ndodhë deri në fund të vitit, çdo çështje e paracaktimeve urdhërohet, dhe ajo nuk mund të ndryshohet apo të ndërrohet. (Shif’Tefsiiir Ibn Kathiir, 4/137, 138). E tëra kjo i është e njohur Allahut para se ajo të shenohet poshtë, por Ai ja bën të njohur melaikëve se çka do të

ndodhë, dhe i urdhëron të kryejnë atë për të cilën janë besuar. (Sherh Sahiih Muslim li'l-Neueui, 8/57).

Allahu i falë gabimet e mëparshme të atij i cili qëndron i zgjuar dhe falet gjatë natës me besim dhe shpresë për ta përfituar shpërblimin nga Ai. Transmetohet në hadithin e Ebu Hurejres (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se i Dërguari (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Cilido që agjëron muajin e Ramazanit nga besimi dhe shpresa për të fituar shpërblim, të gjitha mëkatet e tija të mëparshme do të falen, dhe cilido që rri i zgjuar gjatë Natës së Kadrit nga besimi dhe shpresa për të fituar shpërblim, të gjitha mëkatet e tija të mëparshme do të falen.” (Buhaari, Muslim). Shprehja “nga besimi dhe shpresa për të fituar shpërblim” do të thotë, besimi në premtimin e Allahut për këtë veprë, dhe kërkimi i shpërblimit, pa asfarë synimi ose qëllimi tjetër, siç është kryerja e saj me qëllim që të tjerët të shohin, etj.” (Fet’h el-Beeri, 4/251).

Allahu ka shpallur një sure që ka të bën me këtë natë e cila do të përsëritet deri në Ditën e Ringjalljes, në të cilën Ai përmend nderin dhe vlerën e madhe të kësaj nate. Kjo është sureja në të cilën Ai thotë (përkthim i kuptimit në gjuhën shqipe):

“Ne e zbritëm atë (Kuranin) në natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dijsh se ç'është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit”. (El-Kadër: 1-5).

I dërguari (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) e kërkonte këtë natë, me shpresë se do të përfiton të mira prej kësaj nate, dhe ai është shembull për këtë Ummet.

Është mustehabb që të kërkohet ajo gjatë Ramazanit, e sidomos gjatë dhjetë netëve të fundit të muajit.

Nata e Kadrit është në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, siç është përmendur në hadithin e Ebu Sa'iid të përmendur më lartë, dhe siç është përmendur në hadithin

e 'Aa'ishes, dhe në hadithin e Ibn 'Umerit i cili ka thënë se i Dërguari (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kërkoni natën e Kadrit në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit".

Është më e mundshme të jetë njëra prej netëve me numër tek, për shkak të hadithit të 'Aa'ishes e cila ka thënë se i Dërguari i Allahut (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kërkoni natën e Kadrit në ditët tek nga dhjetë ditët e fundit të Ramazanit." (Buhariu, 4/259)

Duhet sidomos ta kërkojmë në netët me numër tek, dmth., me njëzet e një, njëzet e tre, njëzet e pesë, njëzet e shtatë dhe njëzet e nëntë. Transmetohet në el-Sahiihejn se i Dërguari (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kërkoni natën e Kadrit në ditët tek nga dhjetë ditët e fundit të Ramazanit." (rrëfyer nga el-Buhaari, 1912, shif po ashtu, 1913, po ashtu e rrëfyer nga Muslimi, 1167, shif po ashtu 1165).

Në Sahih ul-Buhaari rrëfëhet se 'Ubaadah ibn es-Saamit ka thënë: se i Dërguari (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) doli të na tregon se kur është Nata e Kadrit, dhe dy prej muslimanëve grindeshin. Ai tha: "Dola të ju tregoj se kur është Nata e Kadrit, ndërsa filani me filanin grindeshin, prandaj ajo [dituria se kur është Nata e Kadrit] u morr prej meje. Ndoshta kjo është më mirë për ju. Pra kërkojeni me të nëntin dhe të shtatin dhe të pestin" (el-Buhaari, 1919), dmth., në netët me numër tek.

Ky hadith tregon se sa keq që është të grindet dhe të përleshet, e sidomos me çështje të cilat kanë të bëjnë me fenë, dhe se kjo është shkak për largimin dhe fshehjen e të mirës.

Nata e Kadrit është më e mundshme të jetë në shtatë ditët e fundit. Ibn 'Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tregon se një njeri prej shoqëruesve të Dërguarit (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) ka parë Natën e Kadrit në ëndërr dhe se ajo ka qenë njëra prej shtatë netëve të fundit. I Dërguari i Allahut (sal-IAllahu alejhi ue sel-lem) tha: "Si duket ëndrrat e tua janë dakorduar se është njëra prej shtatë netëve

të fundit, ashtu që kush dëshiron ta kërkon, le ta kërkon në shtatë netët e fundit.” (rrëfyer nga Buhariu, 1911; Muslimi, 1165).

Më e mundshme është që të jetë në natën e njëzet e shtatë. Është transmetuar në një hadith të rrëfyer nga Ahmedi prej Ibn ‘Umerit, dhe një hadith të rrëfyer nga Ebu Davuudi prej Mu’avijes, se i Dërguari (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nata e Kadrit është nata e njëzet e shtatë.” (Musnedi i Ahmedit dhe Suneni i Ebu Davuudit, 1386).

Këndvështrimi se është nata e njëzet e shtatë është mendimi i shumicës së Sahabeve dhe shumicës së dijetarëve, dhe Ubejj ibn Ka’b (Allahu qoftë i kënaqur me të) e kërkonte, duke mos thënë “inshaAllah”, se është nata e njëzet e shtatë. Zurr ibn Hubejsh tha: Unë thash: Çka të bën ta thuash këtë, O Ebu’l-Mundhir? Ai tha: sipas shenjave me anë të cilave i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) na tregoi: se dielli lind në atë mëngjes pa rreze të dukshme. (Rrëfyer nga Muslim, 2/268).

Fakti se zakonisht ajo është nata e njëzet e shtatë – e Allahu e din më së miri – nuk do të thotë se ky është gjithmonë rasti. Mund të jetë nata e njëzet e një, siç është përmendur në hadithin e Ebu Se’iid, ose mund të jetë e njëzet e treta, siç është përmendur në rrëfimin e ‘Abd-Allaah ibn Unejs (Allahu qoftë i kënaqur me të). Sipas një hadithi të rrëfyer nga Ibn ‘Abbaas (Allahu qoftë i kënaqur me te), i Dërguari (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kërkojeni në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, atëherë kur kanë mbetur nëntë ditë, dhe kur kanë mbetur shtatë ditë, dhe kur kanë mbetur pesë ditë.” (Rrëfyer nga Buhariu, 4/260).

Allahu ka fshehur këtë natë ashtu që robërit e Tij do të përpiqen ta kërkojnë, dhe do të përpiqen në adhurimin e tyre, ashtu sikur ka fshehur edhe orën e xhum’asë, e ashtu me radhë. Ashtu pra besimtari duhet të përpiqet me këmbëngulësi gjatë ditëve dhe netëve të këtyre dhjetë ditëve, duke kërkuar Natën e Kadrit dhe duke përcjellë shembullin e të Dërguarit tonë (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem), dhe ai duhet të përpiqet të bëj du’a dhe të kërkoj afrimin ndaj Allahut.

Transmetohet se 'Aa'isheja ka thënë: "Unë thash, 'O i Dërguar i Allahut, çka mendon nëse e dëshmoj-përfjetoj Natën e Kadrit, çka duhet të them?' Ai tha:

"Allahumme inneke Afuw-wun Keriimun tuhibbul afwe fe'fuanni"

"Allahu im, Ti je Falës, Bujar dhe e do faljen, ndaj më fal mua".'" (Imaam et-Tirmidhi (3515) isnedi i tij është sahiih).

E treta: vlerë më e madhe i përvishet Itikaf-it në këtë natë në dallim prej të gjitha netëve gjatë vitit.

Nuk është thelbësore për atë i cili e "zënë" Nata e Kadrit të din se e ka "zënë". Qëllimi është të përpiqet shumë dhe të jetë i sinqertë në adhurimin e tij, pa marrë parasysh se a e din ai se a e ka "zënë". Është e mundur që disa prej tyre të cilët nuk e dinë këtë mund të jenë më mirë me Allahun dhe në pozitë më të lartësuar sesa ata të cilët dinin se cila është kjo natë, pasi që të parët u përpoqën shumë. Ne lusim Allahun të pranojë agjërimin tonë dhe namazin tone gjatë natës, dhe të na ndihmon ta përkujtojmë Atë dhe ta falënderojmë Atë dhe ta adhurojmë Atë ashtu siç duhet. Allahu e bekoftë të Dërguarin tone Muhammedin.

## Bereqetet e Natës së Kadrit

Natën e Kadrit duhet ta shfrytëzojmë, me qëllim që të gëzojmë të mirat dhe bekimet që i ngërthen në vete.

Ai që sillet me injorim ndaj kësaj nate, ai që e neglizhon këtë natë, pa dyshim se është një njeri shumë shkurt pamës dhe i pafat.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush privohet nga të mirat e kësaj nate është i privuari". (sahih).

Andaj duhet përpjekur dhe vepruar, duhet nxituar dhe luftuar për ta shfrytëzuar në formën më të mirë këtë natë.

Nata e Kadrit është një natë përplot me të mira, një natë e ndershme, me vlerë të madhe dhe me llojloj bereqete.

- Prej bereqeteve të kësaj nate është se është më e vlefshme se një mijë muaj.

"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj".

Domethënë më e mirë se tetëdhjet e tre vjet e katër muaj.

- Prej bereqeteve të kësaj nate është se në këtë natë ka zbritur Kurani:

"Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (në natën e begatshme të kadrit). Ne dëshiruam t'u tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm". (Ed-Duhan: 3).

- Prej bereqeteve të kësaj nate është se ai që e ngjall me adhurime me besim dhe shpresim të shpërblimeve, i falen mëkatet që i ka bërë më herët, siç transmetohet në dy sahihet nga Ebu Hurejre, radijAllahu anhu.

Këto janë disa bereqete të kësaj nate, edhe pa dyshim se janë vetëm një pjesë shumë e vogël e gjërave me të cilat Allahu e ka veçuar këtë ummet, i cili është ummet i bereqetshëm, Libri i këtij ummeti është i bereqetshëm dhe Pejgamberi i këtij ummeti është i bereqetshëm.

Bereqetet që ia ka sjellë Allahu këtij ummeti për shkak të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, janë të shumta.

Allahu ka lëshuar bereqet në këtë ummet në mëngjesin e hershëm, i ka dhënë bereqet në punët e tyre, dijen e tyre, andaj e ka bërë ummetin më të mirë dhe më fisnik te Allahu.

Shejhul-Islami Ibn Tejmiu, rahimehull-llah, thotë:

"Secili që analizon gjendjen e botës do të vërën se muslimanët janë më mendjemprehtët dhe më mendim drejtët, ata për një kohë shumë të shkurtër fitojnë nga realiteti i dijes dhe veprave shumëfish më shumë se sa që munden të tjerët të fitojnë gjatë shekujve dhe gjeneratave".

Kurse në një vend tjetër thotë:

"Allahu ka udhëzuar me bereqetin e pejgamberllëkut të Muhammedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, me udhëzimet dhe sqarimet që ka sjellë, aq mirë, saqë nuk mund ta përshkruan askush, i ka tejkaluar njohjet e dijetarëve më të mëdhenj, saqë ummeti i tij, besimtarët në përgjithësi, e dijetarët në veçanti, kanë arritur dije të dobishme dhe vepra të mira, moral të madh, sunete udhërrëfyese, saqë nëse mblidhen urtësitë e tërë popujve, qoftë dije ose vepër, të pastruar nga çdo njollë dhe ta krahasojmë me urtësinë që ka sjellë Pejgamberi, alejhisselam, do të shohim dallimin shumë të madh, që pengon njohjen e përpjesëtimit mes tyre. Allahun e falënderojmë siç dëshiron dhe është i kënaqur Zoti ynë. Këtu nuk është vendi për t'i sjellë argumentet dhe dëshmitë për këtë".

Qëllimi është, agjërues të nderuar, që të tentojmë të përfitojmë nga këto erëra dhe të fitojmë nga këto bereqete, edhe atë me besim, vepra të mira, sinqeritet, pasim të sunnetit, shpresim të shpërblimit dhe ikja nga mëkatet.

Në vijim do të sjellim edhe një koment të shkurtër të sures El-Kadr të marrë nga mr. Abdulatif Birxhavi, i cili u ka dhënë një vështrim komentues sureve të shkurtra të Kuranit, me qëllim të plotësimit të vështrimit tonë kësaj nate të bekuar.

S'ka dyshim se ky vështrim ka edhe shumë aspekte tjera, të cilat duhet të sqarohen dhe shpjegohen, mirëpo kjo mund të bëhet në shkrime tjera.

## **Meditime Kuranore mbi**

Suren El-Kadr

Kur të shumëfishohet brenga dhe të shtohen detyrat dobësohet dhe zbehet feja te njerëzit, andaj prej bujarisë dhe mëshirës së Allahut është që në Kuran ka zbritur sure të shkurtra dhe disa të tjera që janë të gjata, që tu përshtaten njerëzve me ambicie të ndryshme gjatë shekujve.

S'ka dyshim se suret e shkurtra janë stacion i rëndësishëm në jetën e shumicës së muslimanëve, sepse shumica e muslimanëve vetëm suret e shkurtra i dinë dhe vetëm ato i lexojnë në namaz, andaj ka nevojë për meditim rreth tyre, për të sqaruar qëllimet dhe dimensionet e ndryshme që i bartin në vete, edhe atë për disa shkaqe:

- 1- Lidhshmëria e shumicës së muslimanëve me to.
- 2- Zbulimi i sekreteve të mëdha që gjinden në këto sure.
- 3- Ngritja për ta kuptuar tërë Kuranin.

Në realitet shumë sure të Kuranit në një formë ose tjetër i përmbajnë synimet e Kuranit, pra përmbajnë tevhidin, edukimin, tregimet, sjelljen, etj.

Ne do të mundohemi që të hedhim pak dritë në disa meditime Kuranore në suret e shkurtra.

Prej tyre do të zgjedhim suren El-Kadr.

## **Sureja El-Kadr**

"97:1. Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit.

97:2. E ç'të bëri ty të dish se ç'është Nata e Kadrit?



97:3. Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!

97:4. Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje.

97:5. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit". (Sureja El-Kadr).

Kjo sure është Mekase sipas mendimit më të saktë, kurse sipas renditjes së zbritjes, ajo është e njëzet e pesta.

Sipas Muaxhahidit kjo sure ka zbritur si shkak i një rasti që është përmendur para Pejgamberit, alejhisselam, për një person nga populli i Beni Israilit i cili kishte luftuar një mijë vjet në rrugë të Zotit, e Pejgamberit, alejhisselam, iu dukë pak ymri i ummetit të vet, atëherë ka zbritur kjo sure.

Në realitet kjo sure përmban ne vete shumë ide të rëndësishme, disa prej tyre do t'i sqarojmë:

Një: Domethënia e fjalës Kadr.

Fjala Kadr, e ka kuptimin e vendimit, kurse fjala takdir kuptimin e organizimit. Rrënja e fjalës rrotullohet rreth përcaktimit të gjërave, që e mban domethënien e natës së vendimit, rregullimit dhe gjykimit.

"Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë". (Ed-Duhan: 4).

Abdullah ibn Abasi dhe Hasan ibn Aliu, radijAllahu anhumu, kanë thënë:

"Natën e Kadrit Allahu i përcakton të gjitha exhelet, rizkun, krijimin deri në vitin e ardhshëm".

Dy: Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj.

Nga ky ajet dalin disa përfitime:

1- Veçimi i gjërave është në Dorë të Allahut, Ai është që i ka dalluar peygamberët mes tyre, që ka bërë dallimin e disa muajve, dallimin e disa vendeve, madje edhe dallimin e disa ushqimeve.

"E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojlojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njëren prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur". (Er-Ra'd: 4).

2- Nata e Kadrit në realitet është mundësi për ta zgjatur ymrin, sepse një mijë muaj vlejnë më shumë se sa tetëdhjetë e tre vite, kurse ai që e arrin këtë natë dhjetë herë, sikur të kishte jetuar tetëqind e tredhjet vjet, e nëse e arrin këtë natë njeriu njëzet herë, i zihet sikur të kishte jetuar 1660 vjet. Pa dyshim se kjo është një dhunti shumë e madhe.

3- Nuk duhet shikuar ymrin e gjatë sa duhet shikuar veprat e mira. Andaj shtimi i ymrit nuk do të kishte peshë nëse këto vite nuk shfrytëzohen për shtimin e veprave të mira, sepse mund që një çast i vetëm të jetë më i mirë se tërë jeta e njeriut.

S'ka dyshim se Nata e Kadrit vlen sa tetëdhjetë e tre vite, mirëpo një çast i sahabeve që kanë qëndruar me Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, vlen edhe ma shumë. Sepse ata i ka përshkruar Kurani duke thënë:

"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh". (Et-Teube: 100).

Kjo është ajo që na shtyn të tentojmë për të hyrë në erërat e mëshirës së Allahut dhe të shfrytëzojmë këto mundësi të arta.

Tre: "Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit".

Në hadithe është treguar se Allahu është paqë dhe se prej emrave të Allahut është edhe emri Paqe.

Nata e Kadrit është natë e paqes, sepse është nata e parë në të cilën ka zbritur Kurani. Pra, Allahu botës ia dëshiron paqen dhe sigurinë, ia dëshiron shoqërisë shpëtimin nga rezilat, pastrimin e zemrës dhe shpirtit nga urrejtjet, pastrimin e raporteve nga devijimi, e llojloj paqeje në shoqëri, madje edhe në botë.

Duhet potencuar se paqja nuk mund të realizohet në mungesë të islamit.

Katër: Nata e Kadrit është lindja e Islamit, andaj edhe duhet të jetë pikënisja e muslimanit, e jo vetëm një pikë kalimtare, por duhet të jetë pikë e ndryshimit në jetën e tij, e jo vetëm përkujtim me rituale të caktuara.

Pesë: Shumë njerëz hadithin që flet për namazin në Natën e Kadrit, e kuptojnë në kuptimin tekstual, kurse si pjesë e këtij kuptimi është edhe zbatimi i porosive dhe kërkesave të kësaj nate, pasi të përfundon kjo natë.

## **Zekati i Fitrit, Sadakatul-Fitr, fitrat e ramazanit.**

Zekatul Fitri në Ramazan është i emërtuar ashtu ngase shkaku për Të është “Fitri”-bajrami dhe lidhja me të është lidhje e gjerë me shkakun e saj.

Argument për obligimin e tij është Kurani, Sunneti dhe Ixhmaja.

Allahu thotë:

“ka shpëtuar ai që e pastron”

thanë disa nga selefi se këtu “tezekka” ka të bëjë me nxerjen e zekatul-fitrit.

Po ashtu hyn në përgjithshmërinë e ajetit:

“dhe jepni zekatin”

në sahihejn dhe në tjerat:

“Resulullahu [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë farz sadakatul-fitrin një sa’ (katër grushta) gru ose një sa’ shirija, qoftë i vogël ose i madh, burrë ose grua, i lirë ose rob.”

Dhe është treguar nga më shumë se një dijetar për ixhmanë e muslimanëve në obligimin e nxjerrjes së tij.

Zekatul-fitri është vaxhib për çdo musliman, qoftë i vogël ose i madh, burrë ose grua, i lirë ose rob nga hadithi që e transmeton Ibën Omeri [radijAllahu anhu] që e përmendëm më parë.

Po ashtu në këtë hadith është caktuar edhe sasia e caktuar për çdo person një sa’ (katër grushta) si dhe lloji nga ajo që më tepër ushqehen njerëzit në atë vend qoftë ajo gru, shirija, hurma, ullinj apo tjetër.

Sikur që na ka treguar edhe për kohën e dhënies së tij Zekatul-fitri nxiret ditën e Bajramit para se të falet namazi i Bajramit, ashtu që koha më e mirë për dhënie fillon prej pas akshamit të natës së bajramit deri sa të falet namazi i Bajramit

mirëpo mundet të jepet edhe para kësaj dite (një ose dy ditë), transmeton Buhariu rahimehullah se sahabet e kanë dhënë edhe një ditë ose dy ditë para dhe kjo është ixhma nga ata.

Dhënia e Zekatul-fitrit ditën e Bajramit para se të falet namazi i Bajramit, nëse i kalon ajo kohë atëherë obligohet ta japë atë si kompensim, nga hadithi i ibn Abbasit :

“Kush e jep atë para namazit ajo është sadaka e pranuar, dhe kush e jep pas namazit ajo është një sadaka prej sadakave”

dhe ka bërë mëkat me vonimin e dhënies nga koha e caktuar ngase ka vepruar në kundërshtim me urdhrin e Resulull-llahut (sal-llallahu alejhi ve sel-lem).

Muslimani e jep për vete dhe për ata që ai i furnizon nga gratë dhe farefisin si pasojë e përgjithshmërisë së fjalës së Pejgamberit (sal-llallahu alejhi ve sel-lem):

“jipne Fitrin për ata që i mbani me pasuri”

Preferohet dhënia për fëmijën që është në bark për shkak se Othmani radijAllahu anhu ka vepruar ashtu.

Nëse ai që e ka obligim tjetër kush dhënien e fitrit për Të e nxjerr nga ai që e ka obligim këtë pa lejen e tij, është e lejuar, ngase kjo i është bërë obligim i parë atij kurse tjetri është zëvendësim dhe jo bazë. Nëse e jep një person fitrat për dikë që nuk e ka obligim dhënien për Të, lejohet nëse është me lejen e tij kurse pa leje prej vete personit, nuk lejohet.

Për atë që e ka obligim dhënien e fitrave për tjetrin duhet dhënë për vete dhe për tjetrin në vendin ku gjindet edhe nëse ai tjetri është në vend tjetër.

E pamë të rrugës të japim këtu disa fjalë mbi llojin e asaj që jepet për fitra nga Ibn Kajjimi rahimehullah i cili thotë:

“dhe këto ishin ushqimi më i shpeshtë në Medine, dhe vendet dhe krahinat ku ushqimi është tjetër, atyre u takon të japin një sa’a nga ai ushqim. Dhe nëse ushqimi nuk është nga grurërat por p.sh. nga qumështi, mishi dhe peshku; duhet të japin fitrat e tyre nga ushqimi që kanë në atë vend, çfarëdo lloji qoftë ai. Kjo është fjala e xhumhurit (shumica e dijetarëve) dhe është e drejtë që nuk lëviz dot. Pra lejohet edhe dhënia miell edhe pse hadithi nuk e cek atë, kurse sa i përket dhënies së ushqimit të gatshëm ose bukës ajo edhe pse mundet me qenë më e dobishme për të vobektit, nga shkakut i rëndësisë dhe ngase nuk qëndron gjatë kohë, munden drithërat të jenë më të dobishme për ta ngase qëndrojnë më gjatë”

Sa i përket dhënies së fitrave në vlerën e ushqimit, të jepet të holla në vlerë të asaj sasive; është veprim në kundërshtim me sunnetin dhe kjo nuk është e lejuar ngase nuk është përcjellë nga Resulullahu se ka dhënë vlerën për fitrin e as nga ndonjëri prej sahabeve (shokëve të Pejgamberit).

Thotë imam Ahmedi: “nuk jipet vlera”

I thuhet atij: disa njerëz thojnë: Omer ibn AbdulAzizi e ka marrë atë në vlerë!

Tha: E lejnjë fjalën e Resulullahut [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] anash dhe thonë: ka thënë filani, kurse ibn Omeri transmeton se “Resulullahu [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] e ka obliguar.....” (hadithi i lartëpërmendur)

SadakatulFitri duhet të arrijë tek konsumuesi në afatin e caktuar për dhënien e tij, ose tek i autorizuari i cili është i caktuar për marrje në zëvendësim të tij. Nëse nuk gjen të autorizuar në afatin e caktuar i obligohet dhënia ndonjë personi tjetër.

Këtu gabojnë disa njerëz kur lëjnë Zekatin e fitrit tek persona të cilat nuk janë të autorizuar nga konsumuesi dhe duhet pasur kujdes.

Salih bin Fevzan Fevzani

Marrur nga: "Kitabul MelhasulFikhi"-1

## Ramazani dhe mërzia nga shtegtimi i tij

Na është afruar përfundimi i këtij muaji të bekuar, këtij muaji të dashur. Na vjen shumë keq për këtë ndarje. Secili prej nesh duhet të pyetet, si do të jemi pas Ramazanit?

O shpirt i muslimanit!

Nëse gjatë Ramazanit ke qenë në namaz, agjërim, lexim të Kuranit, teravijë, lutje dhe përkujtim, sadaka, bamirësi dhe përkujdes për farefisën, nëse në këto ditë të Ramazanit kemi zbutur zemrën dhe jemi lidhur fort me Allahun [subhanehu ve teala]!

Nëse gjatë këtij muajit kur na është lexuar Kuran na është rrëqethur trupi dhe na kanë lotuar sytë, nga besimi, frik-respekti dhe devotshmëria ndaj Allahut. Nëse në këtë muaj kemi shijuar ëmbëlsinë e besimit dhe kemi kuptuar realitetin e agjërimit. Nëse në këtë muaj kemi shijuar kënaqësinë e lotit dhe ëmbëlsinë e lutjes drejtuar Zotit në kohën e syfyrit.

Nëse në këtë muaj kemi falur namazin e Pejgamberit [sal-Allahun alejhi ve sellem], të cilit namazi i është bërë kënaqësia më e madhe e shpirtit të tij. Nëse kemi agjëruar duke e shijuar ëmbëlsinë dhe shijen e vërtetë të agjërimit. Nëse në këtë muaj kemi shpenzuar sikurse njeriu që nuk i frikohet aspak varfërisë. Nëse kemi bërë shumë vepra të mëdha dhe të mira në këtë muaj.

Dijeni se ky muaj do të përfundon, mirëpo çka pas Ramazanit?!

Do të shtegton Ramazani, mirëpo a do të thotë kjo se ai që s'është falur para Ramazanit duhet ta lë namazin pas Ramazanit?!

Ai që ka ngrënë kamatën para Ramazanit, a duhet të thotë se bënë t'i kthehet sërish këtij harami?!

Ai që ka dëgjuar gjëra të ndaluara para Ramazanit, vallë a domethënë se këto gjëra sërish i lejohen pas Ramazanit?!

Ai që ka qenë i dhënë pas imoralitetit para Ramazanit, a domethënë se edhe pas Ramazanit mund të vazhdojë me avazin e vjetër?!

Nëse shtegton Ramazani, nuk duhet të harrojmë kënaqësinë e agjërimit, nuk duhet të largohemi nga agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Shevval, të hënën dhe të enjten, ditët e bardha nga çdo muaj, etj.

Nëse shtegton Ramazani, nuk duhet të privohemi nga shijimi i shijes së namazit të natës, nuk duhet të ikë prej nesh frikë-respekti dhe lotët gjatë sexhdes dhe rukusë!

Nuk duhet harruar dhikrin dhe istigfarin, lutjet e vetmuara që ia drejtoje Allahut [subhanehu ve teala].

Nëse shtegton Ramazani, nuk duhet harruar Kuranin, të cilin e kemi lexuar gjatë Ramazanit, ditën dhe natën, në mëngjes dhe në mbrëmje. Nëse kalon Ramazani nuk duhet injoruar Kuranin, e të realizohet ankesa e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]:

“E i dërguari tha: "O Zot im, vërtet populli im e konsideroi këtë Kuran si (diç) të hedhur!”.

Duhet të mërzhitemi për këtë ndarje, sepse do të largohemi nga kënaqësia e adhurimit dhe ëmbëlsia e besimit.

O Ramazan, si po ik prej neve, kurse ishe miku ynë më i mirë, me ndihmën e Allahut ishe ndihmësi ynë më i mirë në adhurimet tona, në leximin e Kuranit, në faljen e namazit, në agjërimin e këtij muajit, në shpërndarjen e sadakasë, në lutje, përmendje, frikë-respektin dhe lotët tonë.

Do të shtegtosh prej nesh, mirëpo ndarja prej teje është shumë e vështirë për burrat e mirë, ata të qajnë me mërzi dhe të përshëndesin për lamtumirë.



Poeti thotë:

*Lëre qajtjen për kodrinat dhe shtëpitë  
e përkujtoja mikut dhe fqiut  
lëri lotët e mërzisë dhe qaj me keqardhje  
për ndarjen nga netët e shndritshme  
për netët e muajit të agjërimit, të cilat  
janë për të na i pastruar mëkatet dhe gabimet  
o ti që më qorton për qajtjen time  
dëgjo hadithet dhe tregimet e të parëve  
sa mirë ishim të gjithë të bashkuar  
njëri falej e tjetri lexonte Kuran.*

### **Grupet e njerëzve pas Ramazanit**

Njerëzit pas Ramazanit janë dy grupe:

Fitimtar dhe të dështuar.

Ah, sikur ta dinim se kush është fitimtari e ta përgëzojmë, e kush është i dështuari e ta ngushëlojmë!

Mirëpo largimi i muajit të Ramazanit është i hidhur për të dy grupet, edhe për fitimtarët edhe për të dështuarit.

Largimi i këtij muajit është i hidhur për fitimtarët sepse kanë humbur ditët e lezetshme, netët e bukura...dita u kalonte në sadaka, agjërime, derse dhe namaz,

kurse nata në lexim të Kuranit, në teravija dhe vizita farefisnore...era e këndshme e këtij muajit ishte dhikri dhe lutja, kurse aroma e mirë ishte loti dhe qajtja...

Ata e ndiejnë dhimbjen e kësaj ndarjeje andaj i shprehin këto me shprehje të ndryshme, e si mos të jetë kështu kur ky muaj është muaj i rahmetit, shlyerjes së mëkateve, drejtim i shtrembërimeve, lutjet përgjigjen, të këqijat largohen, kurse të gjitha të mirat tubohen?!

Si mos të pikëllohemi për largimin e këtij muajit kur ne nuk e dimë; vallë jemi të pranuar ose të refuzuar?!

Si mos të pikëllohemi për largimin e këtij muajit kur ne nuk e dimë se a do të jemi të gjallë vitin e ardhshëm kur do të na vjen përsëri?!

Prej tash, neve duhet të na brengos kjo gjë; a jemi prej atyre që i ka pranuar Allahu, ose jemi nga ata që i ka refuzuar?!

Vallë, a jemi ne nga ata që kanë fituar në këtë Ramazan ose jo?!

Cili prej nesh lutet me të madhe që Allahu tia pranon veprat e këtij muajit?!

Ne lexojmë dhe dëgjojmë se selefi i devotshëm i janë lutur Allahut gjashtë muaj që tua pranon veprat që i kanë bërë në muajin e Ramazanit, kurse ne prej tani nuk na bjer ndër mend të lutemi që të na pranohet ato pak vepra të mira që i kemi bërë në këtë muaj!

Si duket ne pas Ramazanit do ta harrojmë menjëherë këtë muaj dhe do ta lëmë pas dore sikurse të kemi shkarkuar një barrë të madhe nga supet tona!

Do të largohet ky muaj, mirëpo çka kemi përfituar nga ky muaj, ku janë gjurmët e tij në shpirtin dhe sjelljen tonë, në fjalët dhe veprat tona?!

Shpërfillësit e këtij muajit janë dy lloje:

Ata që nuk e kanë shfrytëzuar si duhet këtë muaj janë dy lloje:

Një: ata shumë pak vepra të mira kanë bërë. Ata e kanë falur teravinë, mirëpo kanë kërkuar imamë më të shpejtë. Ata kanë lexuar Kuran, mirëpo vetëm sa mos të thotë se s'ka lexuar aspak Kuran. Ata kanë falur namaz, mirëpo sa mos të thuhet se nuk janë falur...

Namazet farz ankohen për mënyrën se si janë falur, kurse agjërimi për shëndetin dhe dobësimin e tij, e Kurani për leximin e shpejtë ose hedhjen e tij pas shpine, kurse sadakaja është pasuar me lëvdatë dhe përmendje...

Gjuhët shumë pak e kanë përmendur Allahun...të shkujdesura nga lutja dhe istigfari. Ato janë në konflikt me epshin edhe gjatë Ramazanit, mirëpo natyra e të mirës e tërheq, e herë-herë ajo fiton e herë-herë e keqja fiton!

Ndoshta ditën kemi bërë ndonjë adhurim, mirëpo natën ose muhabet ose gjumë. Ata arsyetohen se kemi qenë të lodhur dhe kemi pasur punë, mirëpo kur të kthjellën do të shohin se ky muaj i dashur ka shtegtuar, e do tu vjen keq, do të vjen hidhur, do të qajnë dhe pendohen, mirëpo vonë do të jetë...

Do të mërzhitemi, mirëpo kur?! Pasi që të kalon afati dhe pasi që të përfundojnë ditët më të mira?!

Dy: Ata janë të dështuarit, Allahu na ruajt e mos na bëftë prej tyre.

Ka prej muslimanëve që nuk kanë falur teravi, nuk kanë lexuar Kuran, ndoshta, që është edhe më e keqe, as nuk kanë agjëruar Ramazanin.

As netët e fundit si kanë respektuar, as natën e Kadrit se kanë kërkuar...vallë kur do të përmirësohet ai që nuk është përmirësuar në Ramazan!

Kur do të shëndoshet ai që vuan nga sëmundja e injorancës dhe shkujdesit!

Ai që nuk mbjellë në kohën e të mbjellave, nuk mund të korrë asgjë tjetër përveç se keqardhje dhe humbje.

Të ngratët ata, u ka ikur Ramazani, ditët më të mira, e janë privuar nga çdo e mirë dhe kanë fituar humbjen dhe demoralizimin!

Zemra që nuk është pasuruar me devotshmëri, si bënë dobi as agjërimi e as teravia.

O ti i humbur! Do të ikë ky muaj dhe do të dëshmon se ke humbur dhe do ta kesh armik në ditën e Kijametit.

Do të ikë ky muaj duke dëshmuar për ty se nuk e ke përfillur Kuranin, vaj për atë që hasëm të vetin e ka Kuranin dhe muajin e Ramazanit!

O ti që e humbë ymrin tënd dhe e humbë kohën tënde, si ka mundësi të shpresosh ndërmjetësimin e agjërimin dhe Kuranit?! Vallë mos dëshiron të thuash se Allahu është Falës dhe i Mëshirshëm?! Po, ajo është ashtu, mirëpo:

“...S'ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve”. (El-A'raf: 56).

Është afër atyre që i zbatojnë shkaqet dhe frikohen nga dënimi i Allahut.

O ti i humbur!

Do të shtegton Ramazani, e ti me vete do të marrësh një humbje të madhe, mirëpo, falë i qofshim Zotit, edhe më tej dera është e hapur, kurse e mirë e përhapur. Para se të vjen shpirti në fyt, qaj dhe pendohu, e thuaj:

*Shtegtoi ky muaj dhe iku*

*Ai që i ka shërbyer e fiton fitoren në xhennet*

*I shkujdesuri, i ngrati mbeti i demoralizuar*

*Sikurse unë, vaj për ne prej gjërave të mëdha jemi privuar*

*Ai që nuk mbjell në kohën e mbjelljes*

*Ai vetëm keqardhje dhe brenga do të korrë*

*I lumi ai që devotshmërinë e ka mall të vetin*

*Në këtë muaj dhe është i kapur për litarin e Allahut.*

## Nëse përfundon Ramazani, puna e besimtarit nuk përfundon

Ramazani duhet të jetë pikënisje, platformë nga e cila nivesh për tu kujdesur për namazin në muajt e tjerë.

Platformë nga e cila nivesh për tu larguar nga mëkatet në muajt që vijojnë. Ke dronë dhe mos u bë nga adhuruesit e Ramazanit.

Prej shenjave të pranimit të punës është vazhdimi në punët e mira, nga ditët që vijojnë do të marrësh vesh, a janë pranuar veprat tuaja ose jo?!

- Ti që ke larguar gjuhën nga përgojimi, bartja e fjalëve dhe gënjeshtër gjatë Ramazanit, vazhdo këtë vepër edhe pas Ramazanit. Nëse syri të ka agjëruar nga shikimi i ndaluar, largo shikimin nga harami edhe pas Ramazanit.

- Ti që ke larguar veshin nga dëgjimi i gjërave të ndaluara dhe të fëlliqura, mos iu kthe atyre gjërave pas Ramazanit.

- Ti që ke ruajtur barkun tënd nga ushqimet e lejuara në Ramazan dhe nga harmi, kujdesu që në barkun tënd mos të hyjë asgjë haram as pas Ramazanit.

- Ti që je kujdesur për të varfrit gjatë Ramazanit, mos i harro ata pas Ramazanit.

Unë e di se ne nuk mundemi të jemi në të njëjtën gjendje sikurse në Ramazan, mirëpo kërkojmë që të vazhdojmë në adhurime, në kryerjen e detyrave, në përmendje të Allahut, në frikë nga Allahu, edhe pse këto adhurime do të jenë të vogla, sepse pak e që vazhdon është më e mirë se shumë që ndërpritet.

*Selam nga i Mëshirshmi çdo herë  
Për muajin dhe kohën më të mirë që ka kaluar  
Selam muajit të agjërimit  
Sepse është garancë nga i Mëshirshmi  
Ike o muaj i agjërimit me agjërimit tonë  
Ti Ishe dritë në çdo vend  
Nëse përfundojnë befasi ditë tuaja  
Mërzia ime për ty kur nuk përfundon  
Selami i Zotit qoftë për ty, ji  
Dëshmitar i mirë për ne.*

- ✓ Allahu im, pranoje prej nesh Ramazanin. Allahu im pranoje prej nesh Ramazanin. Allahu im pranoje prej nesh Ramazanin.
- ✓ Na i fal mangësitë dhe shkujdesin tonë.
- ✓ Allahu ynë, na bëjë në këtë muaj prej fitimtarëve.
- ✓ Allahu ynë, na mëshiro dobësinë, mangësinë dhe na ndihmo që të përmendim, të falënderojmë dhe mirë të të adhurojmë.
- ✓ S'ka fuqi dhe mundësi përveç se me ty, e mos na lë në vetveten tonë as sa hapja dhe mbyllja e syve.
- ✓ Allahu ynë, bëje krenar islamit dhe muslimanët, mposhte shirkun dhe idhujtarët.
- ✓ Allahu ynë, Ti që e largon çdo të keqe dhe telashe, Ti që di çdo sekret dhe të fshehtë, të lusim për rrugëdalje të afërt për muslimanët dhe durim të mirë për të shtypurit.
- ✓ Allahu ynë, mëshiroj të shtypurit musliman që gjenden në çdo vend. Allahu ynë, bëhu ndihmësi i tyre, në këto ditë që s'ka kush iu ndihmon, ji përkrahës i tyre sot, kur askush nuk i përkrah.
- ✓ Allahu ynë, na i mëshiro fëmijët jetimë, gratë e veja dhe pleqtë e moshuar.
- ✓ I lartësuar dhe i falënderuar qoftë Allahu. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç Teje, kërkoj falje dhe pendohem te Ti. Paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij në përgjithësi.

## Listë kontrolli - Çka përfituam nga Ramazani

Çka përfituam nga Ramazani?!

- 1- Ramazani është shkollë e durimit. A e mësuam durimin?
- 2- Ramazani është shkollë e bujarisë, mirësisë, bamirësisë dhe përkujdesit familjar. A i kemi përvetësuar këto gjëra?
- 3- Ramazani është muaj i flijimit, luftës dhe fitoreve. A i përjetojmë këto komponentë?
- 4- Ramazani muaj i Kuranit dhe namazit të natës. E i kemi realizuar si duhet keto adhurime?
- 5- Ramazani dhe vëllazëria dhe dashuria. Ku janë këto dukuri në jetën tonë?
- 6- Ramazani dhe falja e lirimi nga zjarri. Mbetemi me shpresë se do te fitojmë këtë dhuratë!
- 7- Ramazani, pendimi dhe devotshmëria. Vallë, kemi arritur devotshmërinë dhe kemi realizuar pendimin?
- 8- Ramazan, muaj i sinqeritetit dhe vërtetësisë. Sa jemi të sinqertë dhe të vërtetë?!

## 1- Ramazani është shkollë e durimit. A e mësuam durimin?

Në gjuhën araba fjala sabër domethënë: të mbyllësh dhe të ngujosh.

Ragib El-Esfahani thotë: “Sabër është të ndalesh në ngushticë”. (shiko: “El-Mufredat”, fq. 474).

Është emërtuar agjërimi sabër sepse është një lloji tij.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin)”. (El-Bekare: 45).

Ibn Xherir ka thënë se qëllimi në këtë ajet është agjërimi, sepse agjërimi është një pjesë e domethënies së durimit. (Tefsiri i Taberiu, 1/ 259).

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Agjërimi i muajit të sabrit dhe tre ditëve nga çdo muaj është sikurse agjërimi i tërë vitit”. (Nesaiu, Sahih).

Sujuti thotë: “Muaji i durimit është muaji i Ramazanit, kurse origjina e durimit është: ngurrimi, andaj agjërimi është emërtuar durim, sepse njeriu gjatë këtij muajit ngurron nga ushqimi, pija dhe martesë”. (Sherhu sunenin-Nesai, 4/ 218).

Ramazani është shkollë për ta mësuar durimin

Ibn Rexheb Hanbeliu [rahimehull-llah] ka thënë:

“Lloji më i mirë i durimit është agjërimi. Sepse i përmbledh që të tre llojet e durimit; është durim në zbatimin e urdhrave të Allahut, është durim në largimin nga ndalesat e Allahut. Pasi që ky njeri i lë gjërat e këndshme për Të edhe pse shpirti ndoshta anon kah to. Andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:



“Çdo vepër e birit të Ademit është për Të, përveç agjërimit, i cili është për Mua edhe unë shpërblej për Të. Ai ka lërë epshin, ushqimin dhe pijen për Mua”. (Buhariu dhe Muslimi).

Në agjërime gjendet edhe lloji i tretë i durimit, durimi në caktime të dhimbshme, të cilat i përjeton besimtari, siç është uria dhe etja. Andaj Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] e emëronte muajin e agjërimit, muaj të durimit”. (Xhamiul-Ulumi vel-hikemi, 1/ 26).

Llojet e sabrit

Ibn Kajim El-Xhevziu [rahimehull-llah] thotë:

“Sabri është tre lloje: durim në zbatimin e urdhrave të Allahut derisa t’i kryen ato, durim në largimin nga ndalesat derisa të mos bjer në to dhe durim në përcaktime, që mos ta mllëfosin”. (Medarixhus-Salikin, 2/ 165).

## **2- Ramazani, është muaj i bujarisë, bamirësisë, mirësisë dhe kujdesit për farefisin.**

Ibn abbasi [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu më bujar, e edhe më bujar ishte gjatë Ramazanit, kur takohej me xhibrilin [alejhis-selam]. Ai takohej me te çdo natë të Ramazanit dhe së bashku mësonin Kuranin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte edhe më bujar se era e bereqetshme. (Buhariu dhe Muslimi).

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] thotë:

“Mësimi i Kuranit e ripërtërinë pasurimin e shpirtit, kurse pasuria e shpirtit është shkak i bujarisë. Bujaria në shërijat është: ti japish atë që duhet atij që duhet, andaj edhe është më e gjërë se sa sadakaja. Pastaj Ramazani është sezonë e mirësive, pasi që dhuntitë e Allahut ndaj robërve të Tij janë më të mëdha se sa në kohërat tjera, e Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dëshironte të përcjell ligjet e Zotit që i ka përcaktuar mbi besimtarët. Me grumbullimin e vlerës së kohës, elementeve të zbritura (Kuranit), zbritësit (Xhibrili) dhe mësimit, shkaktohet shtimi i bujarisë. Allahu e di më së miri”. (Fet’hul-Bari, 1/ 31).

Hapësirat e bujarisë, bamirësisë, mirësisë dhe përkujdesit familjar:

1- Dhënia iftar agjëruesit.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush i jep iftar një agjëruesit, ka shpërblimin e tij, duke mos iu pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit”. (Tirmidhiu, sahih).

2- Bamirësia ndaj prindërve dhe përkujdesi familjar.

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] ka thënë:

Erdhi një njeri te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e i tha: Për cilin njeri duhet të kujdesem më shumë? Tha: për nënën tënde! E pastaj? Tha: për nënën

tënde! E pastaj? Tha: për nënën tënde! E pastaj? Tha: pastaj për babin tënd!”.  
(Buhariu dhe Muslimi).

Enesi [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush dëshiron t’i zgjerohet rizku dhe ti shtohet ymri le të përkujdeset për farefisin”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ata ibn Ebi Rebah [rahimehull-llah] thotë:

“Të jap një dirhem ta jap te farefisi im është më e dashur se të jap një mijë dirhem të njerëzit e varfër. Njëri i tha: edhe në qoftë se është sa unë i pasur? Tha: edhe në qoftë se është ma i pasur se ti”. (Mekarimul-Ahlak, fq. 62).

### 3- Sadakaja dhe shpenzimi në rrugë të Zotit.

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

Për çdo nyje që e ka njeriu në trupin e tij, duhet të jep sadaka. Mirëpo për çdo ditë që del dielli nëse i pajton dy njerëz, edhe kjo është sadaka. Nëse i ndihmon njeriut që ta ngarkon devenë e tij ose ia ngritë ndonjë mall atij me devenë e tij është sadaka. Fjala e mirë është sadaka. Çdo hap që e ecë drejt namazit është sadaka dhe largimi i pengeave nga rrugët është sadaka”. (Buhariu dhe Muslimi).

#### **4- Ramazani është muaj i fljimeve, luftës dhe fitores.**

Në këtë muaj më së miri del në shesh lufta e njeriut me epshin e tij, me djallin e tij, me vetveten. Në këtë muaj beteja më e madhe të cilën e fiton njeriu është ngadhënjimi ndaj vetvetes, epshit dhe djallit të tij.

Të flijon mirëqenien, komoditetin, rehatinë për hir të vëllezërve të tij, për hir të kauzës së tij, për të interesit të përgjithshëm të muslimanëve të këtyre vendeve.

Nga kjo vetëdije fillon procesi i fitores dhe ngadhënjimit tonë të përgjithshëm.

Do t'ju përkujtojmë se në këtë muaj kanë ndodhur disa beteja dhe disa fitore.

##### **a) Beteja e Bedrit.**

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“... dhe atë (Kuranin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhammedit) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembëra), ditën e konfrontimit të dy grupeve. Allahu është i fuqishëm për çdo gjë”. (El-Enfal: 41).

Urve ibn Zubejri duke e komentuar këtë ajet thotë:

Në këtë ditë Allahu e ndau të vërtetën nga e kota. Ky rast është beteja e parë e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], kurse udhëheqësi i idhujtarëve ishte Utbe ibn rebia. Ata u takuan ditën e xhuma. Shokët e Muhammedit [alejhis-salam] ishin tre qind e ca njerëz, kurse ushtria idhujtare numëronte mes nëtëqindëve dhe njëmijëve. Në këtë ditë Allahu u shkaktoi disfatë idhujtarëve dhe u vranë më shumë se shtatëdhjet, e shumë prej tyre u robëruan”. (Taneraniu, 10/9).

##### **B) Çlirimi i Mekës.**

Ibn Abbasi [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] gjatë Ramazanit doli nga Medinje, kurse me vete kishte dhjetë mijë ushtar. Pas tetë vjet e gjysmë që kishin emigruar në Medinë. Ai së bashku me muslimanët

që ishin me ta, shkuan për në Mekë. Ai agjëronte edhe muslimanët agjëronin. Kur arriti në një burim që ishte mes Asfanit dhe Kudejdit, e ngrënën të gjith iftarin. (Buhariu).

Po ashtu tregon në një transmetim tjetër se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] e bëri betejën e çlirimit të Mekës në Ramazan. (Buhariu).

c) Beteja e Ajnul-Xhalut.

Kjo betejë ishte mes muslimanëve dhe mongolëve nën udhëheqjen e Holakos. Kjo luftë ndodhi me 25 Ramazan të vitit 658, në të cilën luftë muslimanët korrën fitre të madhe. (shik detajet e kësaj beteje në “El-Bidaje ven-Nihaje”, 17/ 403).

d) Beteja e Shekhebit.

Kjo betejë ka ndodhur në ditën e shtunë, në ditën e parë të Ramazanit, gjatë vitit 702 dhe vazhdoi deri në ditën e ardhme. Kjo betejë ishte mes muslimanëve dhe tatarëve. Në këtë betejë ka marrë pjesë edhe Shejhul-Islam, Ibn Tejmii. E në këtë betejë korrën fitore muslimanët.

Ibn Kethiri [rahimehull-llah] thotë:

Ibn Tejmii e nxiste sulltanin në luftë dhe e përgëzonte me fitore. Ai filloi të betohet duke thënë se sigurisht me lejen e Allahut do të fitojmë. Ai u dha fetva njerëzve që mos të agjërojnë gjatë betejës, Po ashtu edhe ai nuk agjëroi. Lëvizte nga një epror te tjetri dhe merrte nga ushqimi i tyre, për tua bërë me dije që të hanë, me qëllim që të bëhen më të fuqishëm në këtë luftë kundër armikut dhe të gjithë e ndërprejnë agjërimin dhe ngrënën ushqim. (El-Bidaje ven-Nihaje, 18/ 26).

## 5- Ramazani muaj i Kuranit dhe namazit të natës.

Lidhja mes Kuranit dhe Ramazanit del qartë nga ky ajet, ku Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)”. (El-Bekare: 185).

Edhe nga tregimi i Ibn abbasit [radijAllahu anhu]:

Ibn abbasi [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu më bujar, e edhe më bujar ishte gjatë Ramazanit, kur takohej me xhibrilin [alejhis-selam]. Ai takohej me te çdo natë të Ramazanit dhe së bashku mësonin Kuranin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte edhe më bujar se era e bereqetshme. (Buhariu dhe Muslimi).

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] thotë:

“Ky hadith na tregon madhërimin e Kuranit, sepse është i veçuar me fillim të zbritjes së Kuranit në këtë muaj edhe me krahasimin e shpalljes shumë herë nga Xhibrili [alejhis-selam], që domethënë se Xhibrili [alejhis-selam] ka zbritur shpesh, e me zbritjen e Xhibrilit [alejhis-selam] me të kanë ardhur edhe shumë të mira dhe begati që num mundemi ti numërojmë.

Mësojmë edhe këtë: vlera e kohës arrihet me shtim të adhurimeve. Vazhdimësia në lexim të Kuranit shkakton shtimin e të mirave. Shtimi i adhurimeve në fund të jetës. Përkujtimi i njeriut të vyeshëm dhe të mirë për kah e mira dhe me dije, edhe pse ai këtë e di, për ta shtuar përkujtimin dhe këshillimin. Nata e Ramazanit është më e mirë se dita e Ramazanit. Leximi duhet të jetë i shoqëruar me prani të zemrës dhe kuptim, kjo ndodh natën, sepse është qetë, kurse ditën ka pengese dhe angazhime të kësaj jete. (Fet’hul-Bari, 9/ 45).

Sa lexonin Kuran të parët tanë të devotshëm

Ibrahim Nehaiu thotë:

“Esved Duveliu e përfundonte leximin e Kuranit në çdo dy netë gjatë Ramazanit. Vetëm mes akshamit dhe jacisë flente. E jashta Ramazanit e përfundonte leximin e Kuranit vetëm për gjashtë netë”. (Sijeru Alamun-Nubela, 4/ 51).

Katadeja e përfundonte leximin e Kuranit për shtatë ditë, e kur vinte Ramazani, e përfundonte për tre ditë, kurse në dhjetshin e fundit e përfundonte për çdo natë”. (Po aty, 5/276).

Imam Shafiu e përfundonte leximin e Kuranit gjashtë dhjet herë gjatë Ramazanit.

Musa ibn Muavije thotë:

U largova nga Kajrevani dhe nuk mendosha se ndokush është më i devotshëm se Behlul ibn Rashidi gjersa u takova me Vekiun. Ai lexonte gjatë Ramazanit për çdo natë nga një hatme dhe një të tretën e Kuranit. I falte 12 rekate namaz duha dhe falej nga dreka deri në iqindi”. (Po aty).

Misbah ibn Seidi thotë:

Muhamed ibn Ismaili, Imam Buhariu gjatë Ramazanit për çdo ditë e përfundonte nga një herë leximin e Kuranit, kurse pas teravije për tre netë e përfundonte nga një hatme. (po aty).

Namazi i teravisë dhe Ramazani

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“Kush e fal namazin e natës gjatë Ramazanit, me besim dhe shpresim i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Imam Neveviu [rahimehull-llah] thotë:



“Duke besua dhe duke shpresuar, domethënë duke besuar në vlera e saj është e vërtetë dhe duke shpresuar vetëm Allahun, e jo shikimin e njerëzve, e as gjërat tjera që bien ndesh me sinqeritetin”. (Sherhu Muslim, 6/ 39).

Disa pamje nga namazi i natës të gjeneratave të para të devotshme

Ali ibn Medini thotë:

“Sujejd ibn Gafle na e falte namazin e natës gjatë Ramazanit, kurse i kishte 120 vjet”. (Sijer, 4/ 72).

## 6- Ramazani dhe vëllazëria dhe dashuria. Ku janë këto dukuri në jetën tonë?

Shpirtrat zakonisht i duan ata që u bëjnë mirë. Dukuria e vëllazërisë dhe dashurisë shfaqet në iftaret kolektive, në dhënien e zekatit, në dhënien e sadakatul-fitrit, etj.

Kjo po ashtu del në shesh nëpërmjet vetëdijes se ky adhurim është i përbashkët për mbarë muslimanët, nga lindja deri në perëndim.

Ne kemi nevojë të madhe për të ngritur këtë dukuri dhe për ta sjellë në vendin e vet, sidomos në këto kohëra, kur egoizmi, individualizmi dhe veçimi e kanë kapluar shpirtin e çdo njeriu.

Ky muaj është mundësi e madhe për tu kujdesur për vëllezërit tanë nevojtar, për ata skamnorë që s'kanë as kafshatën e gojës, për familjet e dëshmorëve, për invalidët e luftës, për studentët e shkëlqyeshëm, mirëpo që s'kanë pasuri për të vazhduar studimet e tyre, etj.

## 7- Ramazani dhe falja e lirimi nga zjarri. Mbetemi me shpresë se do të fitojmë këtë dhuratë!

Falja dhe lirimi nga zjarri shfaqet nëpërmjet këtyre gjërave:

- ✓ agjërimit të Ramazanit;
- ✓ namazit të natës gjatë Ramazant;
- ✓ ngjalljen e natës së kadrit.

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe shpresim i falen mëkatet që i ka bërë më herët dhe ai që e gjallëron natën e Kadrit, me besim dhe shpresim i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Edhe thotë:

“Kush e fal namazin e natës gjatë Ramazanit me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

E qëllimi i faljes është lirimi nga zjari i xhehenemit.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Natën e parë të muajit Ramazan prangosen shejtanat dhe xhinët e inatosur, mbyllen dyert e xhehenemit, dhe nuk hapet asnje derë, hapen dyert e xhennetit dhe nuk mbyllet asnje derë. Thërret një thirrës: o kërkues i së mirës urdhëro, kurse ti o kërkues i të keqes nguro. Allahu në çdo natë ka njerëz që i liron nga zjarri i xhehenemit”. (Tirmidhiu, hasen).

## 8- Ramazani dhe pendimi dhe devotshmëria. Vallë, kemi arritur devotshmërinë dhe kemi realizuar pendimin?

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“Kur të vjen Ramazani, hapen dyert e xhennetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë”. (Muslimi).

“Ky hadith ka mundësi të ketë domethënie e hapjes së dyerve të adhurimeve në këtë muaj, adhurime të cilat nuk ndodhin në muajt tjerë, siç është agjërimi dhe namazi i natës. Po ashtu edhe mbyllja e dyerve të xhehenemit domethënë largim dhe ngurrim të njerëzve nga mëkatet”. (Sherhu muslimi, 7/ 188).

Ramazani është shans për tu penduar mëkatarët

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“I mposhtur qoftë njeriu që kur përmendem unë nuk dërgon salavate mbi mua. I mposhtur qoftë njeriu, i cili e arrin Ramazanin dhe shtegton pa iu falur mëkatet. I mposhtur qoftë njeriu që i ka dy prindërit e moshuar, e nuk futet në xhennet”. (Tirmidhiu, sahih).

Ramazani është sezonë e shlyerjes së mëkateve dhe gabimeve

Ebu hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sellem] ka thënë:

“Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan i shlyejnë mëkatet që janë bërë mes tyre, nëse u largohet mëkateve të mëdha”. (Muslimi).

Ramazani është shkollë që të edukon në devotshmëri

Ky është edhe qëllimi i agjërimit. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”. (El-Bekare: 183).

Imam Kurtubio thotë:

“Aq sa ma shumë pakësohet ushqimi aq ma shumë dobëset edhe epshi, e aq sa ma shumë dobësohet epshi, aq ma tepër pakësohen mëkatet. Kjo është një renditje shumë e bukur. Agjërimi është shkak i devotshmërisë sepse e mbyt epshin”. (Tefsiri i Kurtubiut, 2/ 275- 276).

Ibn Kethiri [rahimehull-llah] thotë:

“agjërimi është pastrim i trupit dhe ngushtim i kanaleve të shejtanit. Andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“O ju djelmosha, kush ka mundësi prej jush që të martohet le të martohet, e ai që nuk ka mundësi, le të agjëron, sepse kjo për Të është mburojë”. (Buhariu)”. (Ibn Kethiri, 1/ 219).

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush nuk i le gënjeshtat dhe dëshmitë e rrejshme, Allahu nuk ka nevojë që të lë ushqimin dhe pijen”. (Buhariu).

Ibn Ethiri thotë:

“Domethënë se kjo vepër nuk është e pranuar, ashtu sikurse njeriu i zemëruar, kur ti kthehet kërkesa mbrapsht, thotë: nuk kam nevojë për asgjë prej teje. Qëllimi është i refuzohet agjërimi njeriut që flet gënjeshtër, e e pranon vetëm atë agjërim që është i pastër prej tyre”. (Fet’hul-Bari”, 4/ 117).

8- Ramazan, muaj i sinqeritetit dhe vërtetësisë. Sa jemi të sinqertë dhe të vërtetë?!

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] tregon se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij. Një e mirë shpërblehet sa dhjetë sosh dhe deri në shtatëqind herë shumëfishohet shpërblimi, e Zoti ka thënë: “Përpos agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, për shkak se njeriu e braktisë ushqimin për Mua, e braktisë pijen për Mua, i braktisë të këndshmet për Mua, e braktisë gruan e tij për Mua. Era e keqe e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu se aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: njëri gëzim kur të hajë iftar dhe tjetri kur ta takojë Zotin e vet”. (Buhariu dhe Muslimi).

Imam Kurtubiu thotë:

“Pasi që veprave u futet rijaja- syfaqësia, agjërimit nuk mundet ta sheh askush tjetër përveç Allahut [subhanehu ve tealal], andaj edhe ia ka mveshur Vetvetes e ka thënë: “I lë epshtet për hir Timin”. (Fet’hul-Bari, 4/ 107).

Ibn Xhevziu thotë:

“Të gjitha adhurimet shihen në vepër, andaj është shumë vshtirë të shpëton nga syfaqësia ndonjë vepër që shihet, për dallim nga agjërimi”. (Fet’hul-Bari, 4/ 107).

Një shembull nga sinqeriteti i gjeneratave të devotshmë të muslimanëve

Tregohet se:

“Davud ibn Ebi Hindi ka agjëruar dyzet vjet, nuk e dinte këtë gjë gruaja e tij. Ishte tregtar i mëndafshit, ushqimin e merte me vete dhe e jepte sadaka përgjat rrugës”. (Sijer, 6/ 378).

## Rregullat e Bajrameve

Muslimanët i kanë vetëm tre festa. Edhe ato:

a) Festa e javës, dita e xhuma, përmyllësi i javës.

Në këtë ditë i ka udhëzuar Allahu [subhanehu ve teala], pasi që i verbëroi para kësaj dite ithtarët e Librit, çifutët dhe të krishterët. Ibn Huzjemeja [rahimehull-llah] thotë: “Kaptina e argumenteve se dita e Xhuma është ditë feste dhe se ndalohet agjërimi i saj, pasi që është festë”. Pastaj përmend një hadith nga Ebu Hurejre [radijAllahu anhu], i cili thotë: kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë:

“Dita e xhumasë është ditë feste, andaj mos e bëni këtë ditë të festës ditë agjërimi, përveç se nëse agjëroni një ditë para ose një ditë mbrapa”. (Hadithi është i vërtetë. Transmeton Ahmed, Ibn Huzjemeja etj.).

b) Bajrami i fitrit, domethënë me përfundimin e agjëritit të muajit Ramazan, në të cilin muaj gjendet nata e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj.

Kjo është dita e dhuratave për ata që kanë agjëruar këtë muaj dhe e kanë ruajtur agjërimin, kanë falu namaz nate në formën më të mirë. Të gjitha këto ibadete i kanë bërë me sinqeritet ndaj Allahut. Kjo festë është vetëm një ditë, edhe atë ditën e parë të muajit Shevval.

c) Bajrami i kurbanit.

Kjo është dita përmyllëse e dhjetë ditëve të dhil-Hixhxes, të cilat janë ditët më të mira, kurse veprimi në këto ditë janë veprat më të mira, siç tregon Ibn Abbasi [radijAllahu anhu] nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]:

“Veprat në asnjë ditë nuk janë ma të mira se sa në dhjetë ditët e Dhil-Hixhxes. Thanë: as xhahadi në rrugë të Allahut? Tha: as xhahadi në rrugë të Allahut, përveç

njeriut, i cili del me vetveten dhe pasurinë e tij dhe nuk kthehet me asgjë”. (Buhariu).

Kjo ditë është dita e dhjetë e Dhil-Hixhxes, para saj është dita e Arafatit, e cila është ditë feste, pas saj janë tre ditët e teshrikut edhe ato janë ditë feste. Kështu që ditët e kësaj feste janë pesë ditë. Siç tregohet në hadithin e Ukbe ibn Amirit [radijAllahu anhu], se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Dita e Arafatit, dita e kurbanit dhe ditët e teshrikut janë për ne, muslimanët, festë, janë ditë të ngrënies dhe pirjes”. (hadithi është sahih, transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu, etj).

Ky bajram është më i madh se bajrami i fitrit. Ibn Rexhebi [rahimehull-llah] thotë: kjo festë është më e madhe dhe më e vlefshme, sepse pason pas përfundimit të veprave të haxhit.

Shejhul-Islam ibn Tejmie [rahimehull-llah] pasi që e përmend ajetin:

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe”. (El-Maide: 3).

Thotë: për këtë Allahu e ka zbritur këtë ajet në festën më të madhe të ummetit besim-drejtë, sepse nuk ka festë më të madhe se sa festa ku mbliidhen edhe vendi edhe koha, e kjo është festa e kurbanit.

Gjithashtu thotë: “dita më e mirë e vitit është dita e kurban bajramit, disa kanë thënë se ajo ditë është dita e Arafatit, mirëpo mendimi i parë është më i vërtetë. Sepse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Dita më e mirë te Allahu është dita e kurbanit, e pastaj dita (e freskët) që vjen pas saj”. (hadithi është sahih, transmeton Ahmedi dhe të tjerët).

Sepse është dita e haxhit më të madh, sipas imam Malikut, Imam Shafit dhe Imam Ahmedit, siç qëndron në sahihul-muslim:



“Dita e kurbanit është dita e haxhit më të madh”. (Muslimi).

Disa rregulla që kanë të bëjnë me bajramin

1- Vendimi i sherijatit mbi namazin e bajramit.

Dijetarët kanë tre mendime rreth vendimit mbi namazin e bajramit, edhe atë:

a) është obligim për secilin musliman. Ky është mendimi i medhhebit hanefit.

b) është sunnet i fortë. Ky është mendimi i Imam Malikut dhe shumicës së dijetarëve të medhhebit shafit.

c) është obligim kolektiv, (farzi kifaje), nëse banorët e një vendi me qëllim e lënë pas dore këtë ibadet, luftohen për hir të këtij gabimi. Ky është mendimi i hanbelive, dhe disa dijetarëve të medhhebit shafit.

Mendimi më i saktë për ne është, se namazi i bajramit është obligim, edhe atë për këto argumente që vijojnë:

### **1- Urdhri i Allahut [subhanehu ve teala]:**

“Andaj, ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!”. (El-Keuther: 2).

Urdhri rezulton domosdoshmëri të kryerjes së atij urdhri. Gjithashtu i ka urdhëruar edhe gratë të dalin në këtë namaz.

2- Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] vazhdimisht e ka falur këtë namaz dhe asnjëherë nuk e ka lënë pa falur.

3- Është prej simboleve të dukshme të fesë, kurse simbolet e dukshme janë obligim, siç është ezani dhe disa vepra tjera.

Ibn Tejmii [rahimehull-llah] thotë: për këtë i dhamë përparësi mendimit se namazi i bajramit është obligimi për secilin musliman. Kurse ai që ka thënë se nuk është obligim, është shumë larg nga e vërteta, sepse është prej simboleve të Islamit, njerëzit në këtë ditë tubohen ma shumë se sa në ditën e xhumasë. Në këtë ditë

është e ligjshme thënia e tekbireve. Kurse ai që ka thënë se është obligim kolektiv (farzi kifaje) nuk ka mundësi të rregullohet, sepse nëse në një vend të madh po u tubuan katërdhjetë perosna nuk arrihet qëllimi, por arrihet qëllimi nëse marrin pjesë të gjithë muslimanët ashtu sikurse në ditën e xhumasë.

Këtë mendim e kanë edhe Ibn Kajjimi, [rahimehull-llah], Shevkaniu, [rahimehull-llah], Ibn Sa'diu, [rahimehull-llah], Ibn Uthejmini, [rahimehull-llah], shejh Albani, [rahimehull-llah], etj.

Sipas këtij mendimi ai që nuk merë pjesë në këtë namaz dhe e lë pas dore ka bërë mëkat dhe ka humbur në ditën e gëzimit dhe dhuratave.

## **2- Vendimi i sherijatit mbi namazin vullnetar që mund të falet para ose mbrapa.**

a) Ibn abbasi [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] doli në ditën e fitër bajramit dhe i fali vetëm dy rekate, nuk fali asgjë tjetër, as para e as mbrapa”. (Buhariu dhe Muslimi).

b) Ebu Seid El-Hudriu [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk falte asgjë para namazit ta bajramit, e kur kthehej në shtëpi i falte dy rekate”. (Hadithi është sahih, transmeton Ibn Maxhe dhe të tjerët).

Prej këtyre dy haditheve na bëhet e qartë se:

- Namazi i bajramit nuk ka sunnete të rregullta që falen para ose mbrapa, duke u mbështetur në hadithin e Ibn Abbasit [radijAllahu anhu].
- Nëse i fal dy rekate në shtëpi, e ke qëlluar sunnetin e Pejgamberit [alejhis-selam], pasi që ai e ka pasur zakon të falë namazin e duhasë, siç përmendet në hadithin e Ebu Seid El-Hudriut.

- Nëse namazi i bajramit falet në xhami, nuk duhet të ulet para se ti fal dy rekate, duke u mbështetur në hadithin e Ebu Katades [radijAllahu anhu], i cili thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kur ndokush prej jush hynë në xhami le ti fal dy rekate para se të ulet”. (Buhariu dhe Muslimi).

- Nëse është në musal-la, edhe atëherë nuk ulet derisa nuk i fal dy rekate, sepse musal-laja në këtë rast e ka pozitën e xhamisë, pasi që Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ka urdhëruar gratë me menstruacione që mos ti afrohen musal-lasë. Edhe kjo sipas disa dijetarëve.

### **3- Falja e namazit të bajramit në musal-lah.**

Prej sunneteve të vdekura në vendin tonë është falja e namazit të bajramit në musal-lah, sepse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] çdo herë namazin e bajramit e ka falur në musal-lah. Ai e ka lënë namazin në xhaminë e vet, ku një namaz shpërblehet sa një mijë namaze, dhe ka dalë jashtë e është falur në hapësirë, në musal-lah, për të treguar vlerën që ka namazi i bajramit në musal-lah.

Këtë e kanë bërë edhe halifet pas tij.

Ibn Kudameja [rahimehull-llah] thotë se në këtë ka ixhma’.

### **4- Koha kur falet namazi i bajramit.**

Koha e namazit të bajramit është nga ngritja e diellit sa një shtizë deri në kur të afrohet dielli në zenit.

Ibn Battali thotë: të gjithë fukahatë janë të një mendimi se namazi i bajramit nuk falet para se të lind dielli e as gjatë lindjes së tij, por lejohet atëherë kur të lejohet falja e namazit nafle.

Ibn Kajjimi [rahimehull-llah] thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e vononte namazin e fitër bajramit, kurse e nxitonte namazin e kurban bajramit,

kurse Ibn Omeri [radijAllahu anhu], duke qenë se kujdesej me të madhe për pasimin e sunnetit, nuk dilte derisa nuk lindte dielli.

Ibn Kudameja [rahimehull-llah] këtë e arsyeton duke thënë: çdo bajram i ka detyrat e veta, fitër bajrami ka detyrën e nxerjes së sadakasë, e cila duhe të jipet para namazit të bajramit, kurse kurban bajrami ka detyrë therrjen e kurbanit, koha e së cilës është pas namazit të bajramit.

### **5- Nuk thirret ezan për namazin e bajramit.**

a) Transmeton Ibn Abbasi [radijAllahu anhu] dhe Xhabiri [radijAllahu anhu], të cilët thonë: “Nuk thirrej ezan për namaz të fitër dhe kurban bajramit”. (Buhariu dhe Muslimi).

b) Transmeton Xhabir ibn Semure [radijAllahu anhu], i cili thotë: “Kam falur shumë herë namazin e bajrameve me Pejgamberin [alejhis-selam], nuk thirrej as ezan e as ikamet”. (Muslimi).

Maliku [rahimehull-llah] thotë: kjo është sunneti për të cilin ska dallim të mendimeve, kurse Ibn Kudameja thotë se në këtë vepër ka ixhma'. Nuk thuhej asgjë në kohën e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], por kur i afrohej musal-lasë falej.

Ibn Abdul-Berri [rahimehull-llah] thotë se i pari i cili ka thirru ezan për namaz të bajramve është Muaviu [radijAllahu anhu].

### **6- Falja e namazit para mbajtjes së ligjëratës, hutbes.**

Ibn Kudameja thotë se në këtë janë të pajtimi tërë dijetarët , kurse Ibn Mundhiri thotë: “Ka argumenete të plotfuqishme se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka filluar me namaz para ligjëratës në ditën e bajramit, kështu kanë vepruar edhe hulefatë e drejtë pas tij, në këtë mendim janë edhe mbarë dijetarët e vendeve”.

## 7- Tekbiret gjatë namazit.

Shejhul-Islam, Ibn Tejmii [rahimehull-llah] thotë: mbarë ummeti është i pajtuar se namazi i bajramit veçohet me tekbiere shtesë.

A) Numri i tekbiereve. Në rekatën e parë i bënë shtatë tekbiere pa tekbinin e rukusë, kurse në rekatën e dytë, pesë pa tekbinin e ngritjes. Të këtij mendimi janë shtatë fukahatë.

Kurse Amr ibn Shuajbi transmeton nga babi e ai nga gjyshi i tij se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ka marrë 12 tekbiere, shtatë në rekatën e parë dhe pesë në rekatën e dytë. (Ahmedi, hadithi është sahih).

Sahabet nuk janë të një mendimi sa i takon tekbiereve, andaj Imam Ahmedi e ka zgjëruar këtë çështje.

B) Me'mumi merr tekbiere duke pasuar imamin. Kështu ka thënë Ibn Tejmii [rahimehull-llah].

C) I ngritë duart për çdo tekbiere, duke u mbështetur në hadithin e Vail ibn Huxhrit [radijAllahu anhu] ku qëndron se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ka ngritur duart me çdo tekbin. (Transmeton Bejhakui, hadithi është sahih). Kjo është e përgjithshme edhe për në bajram edhe për namaze të tjera.

D) Dhikri që bëhet mes tekbiereve. Nuk asnjë argument nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] që e tregon atë të ketë bërë diçka mes këtyre tekbiereve, mirëpo Ukbe ibn Amir thotë: kam pyetur Ibn Mesudin: çka duhet të them mes tekbiereve të namazit të bajramit? Ai tha: e falënderon dhe lavdëron Allahun dhe dërgon salavate mbi Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

Shejhul-Islam ibn Tejmii thotë se mes tekbiereve e falënderon dhe e lavdëron Allahun dhe lutet me çka dëshiron.

E) Vendimi i sherijetit për këto tekbiere shtesë. Ibn Kudameja thotë se janë sunnet, e nuk janë vaxhib, andaj nëse i harron ose i lë me qëllim, nuk prishet namazi.

Mirëpo nëse e lë me qëllim, atëherë me qëllim ke lënë sunnetin e Pejgamberit [sal-Allahü alejhi ve sel-lem] dhe kjo është gabim dhe personi që i lë ka humbur shpërblim shumë të madh.

F) Nëse me'mumi hynë me imamin në namaz dhe i kalojnë disa tekbire shtesë, ai i vazhdon tekbiret që i kanë mbetur, kurse ata që i kanë kaluar nuk i përsëritë.

## 8- Çka është sunnet të lexohet në namaz të bajramit.

Është sunnet që në namaz të bajramit të lexohet kjo:

- Në rekatën e parë suren El-Kaf, kurse në rekatën e dytë suren El-Kamer, sepse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ka lexuar që të dy suret në namazin e bajramit, siç tregohet në hadithin e Ebu Vakid Lejthiut. (Muslimi).
- Në rekatën e parë suren El-A'la dhe në rekatën e dytë suren e El-Gashije duke u mbështetur në hadithin e Numan ibn Bëshirit [radijAllahu anhu] se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i lexonte në bajram.
- Nëse në një ditë tubohen edhe xhumaja edhe bajrami, atëherë që të dy suret mund t'i lexojë edhe në bajram edhe në xhuma, sepse është sunnet që të lexohen në të dy namazet. (Muslimi).

## 9- Kompensimi i namazit të bajramit.

a) Nëse nuk kanë kuptuar se atë ditë është dita e bajramit deri sa ka ardhur dielli në zenit, atëherë mundet që ta falin në ditën e nesërme, duke u mbështetur në hadithin të cilin e transmeton Umejr ibn Enesi nga disa axhallarë të tij prej ensarëve, të cilët kanë thënë:

“Nuk mundëm ta shohim hënën e Shevvalit, andaj vazhduam agjërimin, mirëpo në fund të ditës na erdhi një grup njerëzish dhe dëshmuuan se ata e kanë parë hënën dje, atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i urdhëroi që të prishin agjërimin atë ditë dhe nesër të dalin për ta falur namazin e bajramit”. (Ahmedi, Ebu Davud dhe të tjerët. Hadithi është sahih).

b) Nëse e takon imamin në teshehud ulesh në atë gjendje, e kur të jep selam, ngritesh dhe i fal dy rekate, së bashku me tekbiret.

c) Nëse të ikë namazi i bajramit me imam, atëherë nuk duhet ta kompensosh me asgjë. Ky është mendimi i Ebu Hanifes [rahimehull-llah], Imam Malikut dhe Muzeniut.



## **10- Namazi i Bajramit në udhëtim.**

- Nëse është udhëtar dhe i takon njerëzit duke u falur, obligohet që ta fal, ashtu siç obligohet ta falë namazin e xhumasë.
- Nëse janë në udhëtim si xhemat, atëherë nuk e kanë obligim as namazin e bajramit e as të xhumasë, sepse nuk është e ligjshme në udhëtim. Të këtij mendimi janë Ebu Hanifeja, Maliku dhe Ahmedi. Këtë mendim e përkrahë edhe Shejhul-Islam ibn Tejmîu [rahimehull-llah].

## 11- Nëse bashkohen edhe xhumaja edhe bajrami.

- Ijjas ibn Remle [radijAllahu anhu] thotë: kam parë Muaviun [radijAllahu anhu] duke pyetur Zejd ibn Erkamin: a ke qenë i pranishëm me Pejgamberin [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] kur janë bashkuar xhumaja dhe bajrami? Tha: po. Tha: Si veproi? Tha: E fali namazin e bajramit e pastaj për xhumanë tha: “Kush dëshiron le ta fal xhumanë”. (Ebu Davud, Nesaiu dhe të tjerë. Hadithi është sahih).

- Ebu Hurejere [radijAllahu anhu] thotë: Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Nëse në një ditë ju tubohen dy bajrame: kush dëshiron i mjafton në vend të xhumasë, mirëpo ne edhe xhumanë do ta falim”. (Ebu Davud dhe Ibn Maxhe, hadithi është sahih).

Në bazë të kësaj që paraqitëm shohim se ai që e ka falur namazin e bajramit, i mjafton nga falja e namazit të xhumasë, mirëpo disa dijetarë kanë kushtëzuar të falin drekën. Edhe pse nga praktika e sahabeve nuk nënkuptohet kjo. Mirëpo pa dyshim se më mirë është të falet dreka.

## 12- Rregullat e hutbes së bajramit.

a) Vendimi i pjesëmarrjes në dëgjimin e hutbes.

Prania për dëgjim të hutbes është sunnet, duke u mbështetur në hadithin e Atasë, i cili transmeton nga Ibn Saibi, i cili thotë: kam marrë pjesë me Pejgamberin [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] në namaz të bajramit, e kur e kreu namazin tha:

“Ne do të mbajmë hutbe, kush dëshiron të dëgjojë hutben le të ulet, e kush dëshiron të shkojë le të shkoj”. (Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe të tjerë. Hadithi është sahih, sipas Hakimit dhe Dhehebiut).

b) Një hutbe ose dy?

Fukahatë thonë se duhet mbajtur dy hutbe, mes të cilave ulet, duke u mbështetur në hadithin e Xhabirit [radijAllahu anhu], i cili thotë:

“Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] doli në ditën e fitër ose kurban bajramit dhe mbajti hutben në këmbë, pastaj u ul dhe u ngrit sërish”. (Transmeton Ibn Maxheja, mirëpo ky hadith është i dobët).

Ky hadith i ka dy transmetues për të cilët Ahmedi, Nesaiu dhe të jerët kanë thënë se janë metruk dhe daif.

Siç duket për bajram duhet vetëm një hutbe duke u mbështetur në hadithin e Xhabirit [radijAllahu anhu]:

“Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] në fitër bajram u ngrit dhe filloi me namaz, pastaj mbajti hutben, e kur e kreu, zbriti dhe erdhi te gratë e i këshilloj duke qenë i mbështetur në dorën e Bilait [radijAllahu anhu]...”. (Buhariu dhe Muslimi).

Në këtë hadith u përmend vetëm një hutbe, kurse këshillimi i grave nuk mundet të konsiderohet hutbe e dytë, sepse ka zbritur te ato që të dëgjojnë këshillimin e

tij, sepse gjatë bajramit tubohen shumë njerëz saqë gratë që janë larg nuk mund të dëgjojnë hutben e tij.

Ibn Uthejmini thotë: kush shikon në sunnetin e vërtetë, në dy sahihet ose në vende tjera, i bëhet e qartë se Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] vetëm një hutbe e ka mbajtur”.

c) Tekbiret gjatë hutbes.

Hutben e fillon me falënderim ndaj Allahut. Shejhul-Islam Ibn Tejmie [rahimehull-llah] thotë: askush nuk transmeton ndonjë hadith që na tregon se Pejgamberi hutben e bajramit ose të istiskasë e ka filluar me diç tjetër përveç falënderimit”.

Kurse Ibn Kajjimi [rahimehull-llah] thotë: Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] hutbet e tija i fillonte me falënderim, e nuk ka snjë hadith që tregon se hutbet e bajramit i fillonte me tekibire.

Kurse gjatë hutbes është e pëlqyshme që të bëhen tekibire, edhe pse ska ndonjë argument i cili e veçon hutben e bajramit nga hitbet tjera me tekibire.

d) Tema e hutbes.

Ebu Seid El-Hudriu [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] ditën e fitër dhe kurban bajramit dilte në musal-lah dhe fillimisht fillonte me namaz, pastaj kthehej nga njerëzit, kurse njerëzit të ulur në safet e tyre, e i këshillonte, i porositke dhe i urdhëronte. Nëse dëshironte të caktojë ndonjë delegacion përcaktonte, ose të urdhëronte diç, urdhëronte. Pastaj largohej”. (Buhariu dhe Muslimi).

Disa dijetarë kanë thënë që gjatë fitër bajramit të bëhet hutbe mbi fitrin, kurse gjatë kurban bajramit të bëhet hutbe mbi kurbanin. Sa i përket të parës nuk ka vlerë, sepse afati i dhënies se fitrit veç më ka kaluar, kurse sa i përket sqarimit mbi kurbanin, kjo mund të jetë valide.

e) Këshillimi i grave.

Është prej sunnetit që tu veçohet këshillë edhe grave, siç tregohet në hadithin e Xhabirit [radijAllahu anhu] të lartë-cituar.

### **Sunnetet dhe veprat e pëlqyeshme gjatë bajramit**

1- Tekbiret gjatë bajramit.

Është e pëlqyeshme për njerëzit të merren tekbiere netëve të bajramit qofshin në xhami, në shtëpitë e tyre, në rrugë, qofshin udhëtar ose në vendin e tyre, duke u mbështetur në ajetin:

“... të madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falenderoni”. (El-Bekare: 185).

Thërrasin tekbiere gjatë rrugës për në namaz të bajramit dhe e ngrisin zërin. Për këtë ka shumë argumente nga vepra e sahabeve dhe tabiinëve.

Edhe gratë thërrasin tekbiere mirëpo me zë më të ulur, siç përmendet në hadithin e Ummu Atijes [radijAllahu anha]:

“...dilnim edhe gratë me menstruacione e qëndronin pas njerëzve, edhe ato thërritnin tekbiere me ta edhe luteshim me lutjet e tyre...”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Larja dhe zbukurimi.

Imam Buhariu [rahimehull-llah] thotë: “kaptina e bajramit dhe zbukurimit gjatë tij”, pastaj përmend një hadith nga Ibn Omeri [radijAllahu anhu], i cili thotë:

“Omeri [radijAllahu anhu] mori një vel (manto) që shkëlqente, e cila shitej në treg. E mori dhe shkoi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: o I dërguar i Allahut, bleje këtë vel, zbukurohu me te për bajram dhe për delegacionet...”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ibn Kudameja thotë: Kjo tregon se zbukurimi në këto raste ka qenë gjë e njohur te ta.

Kurse Ibn Omeri [radijAllahu anhu] gjatë bajramit i veshte rrobat më të mira. (Bejhaku, hadithi është sahih).

Imam Maliku thotë: kam dëgjuar se dijetarët e pëlqejnë parfumosjen dhe zbukurimin në çdo bajram.

Kurse sa i përket larjes tregohet se Ibn Omeri [radijAllahu anhu] lahej ditën e fitër bajramit para se të shkojë në musal-lah. (Maliku, Abdurrezaku dhe Begaviu).

Zbukurimi është në veshmbathje dhe dukje, duke i shkurtuar mustaqet, duke i prerë thonjtë, duke i veshur rrobat më të mira, kurse kjo dallon nga dallimi i vendit.

3- Ngrënia para bajramit.

- Enesi [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk dilte ditën e fitër bajramit pa ngrënë hurme”, në një transmetim tjetër qëndron: “i ngrënte tek”. (Buhariu).

- Në transmetimin tjetër qëndron:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] asnjë herë ditën e fitër bajramit nuk ka dalur pa ngrënë hurme, tre ose pesë ose shtatë”. (Ibn Hibbani, hadithi është sahih, sipas Hakimit dhe Dheheniut).

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] thotë: kjo është argument i qartë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë këtë vazhdimisht.

- Burejde [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk dilte ditën e fitër bajramit derisa nuk hante, kurse ditën e kurban bajramit nuk hante deri sa nuk e therte kurbanin”. (Ahmedi, Tirmidhiu, etj. Hadithi është sahih).

Këto hadithe tregojnë se në fitër bajram hante para namazit, kurse e vononte ushqimin gjatë kurban bajramit derisa ta therte kurbanin që të hante nga kurhani i vet.

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] i përmend disa urtësi nga ngrënia para namazit:

- Mos të mendon se është duke vazhduar agjërimin deri në ditën e bajramit.
- Nxitimim në zbatimin e urdhrin për ngrënie, etj.

4- Dalja herët për namaz të bajramit.

- Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“...përpiquni dhe nxitoni për punë të mira”. (El-Maide: 48).

Kurse bajrami është prej të mirave më të mëdha. Ka shumë argumente që sqarojnë nxitimin për në xhematë dhe në xhami në kohë të xhumasë, për afrim me ulje afër imamatit dhe për vlerën e safit të parë. Krejt këto vlejën edhe për bajram.

- Imam Buhariu [rahimehull-llah] thotë: “Kaptina që flet mbi daljen herët për në bajram”, pastaj përmend hadithin e Bera-së [radijAllahu anhu], i cili thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] mbajti hutbe në ditën e kurban bajramit dhe tha:

“Vepra e parë që e bëjmë në këtë ditë është falja e namazit...”.(Buhariu dhe Muslimi).

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] thotë: kjo na tregon se këtë ditë nuk duhet të angazhohemi me asgjë tjetër përveç përgatitjes për namaz dhe daljes për në namaz. Kjo është mosveprimi i asgjësë para namazit, kurse kjo kërkon të dalim herët për në namaz të bajramit.

5- Dalja e grave dhe fëmijëve.

- Sa i përket grave argument për këtë është hadithi i Ummu Atijes [radijAllahu anha]:

“Jemi urdhëruar që t’i nxjerrim në fitër dhe kurban bajram: gratë, kurse ato që janë në menstruacione nuk falin namaz, mirëpo dëshmojnë të mirat dhe lutjen e muslimanëve”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ato duhet të jenë të mbuluara ashtu siç mëson sherijati, mos të zbukurohen dhe parfumohen, gjëra të cilat i sprovonë burrat.

Sa i përket daljes së fëmijëve, Imam Buhariu ka caktuar një kaptinë të tërë mbi këtë gjë, pastaj ka sjellë hadithin e Ibn Abbasit [radijAllahu anhu]:

“Dola me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ditën e fitër dhe kurban bajramit, e ai e fali namazin e pastaj mbajti hutben...”. (Buhariu dhe Muslimi), kurse në transmetimin tjetër qëndron:

“Po mos të isha i vogël nuk do të mundesha ta shoh”. (Buhariu).

6- Ecja për në musal-lah.

Sa i përket ecjes për në musal-lah kjo vepër është e pëlqyeshme për shkak të transmetimeve që ekzistojnë nga disa tabiinë.

Ibn Mundhiri thotë: ecja për në bajram është më mirë sepse është më afër modestisë, mirëpo edhe nëse shkon me mjet hypës s’ka gjë.

7- Urimet për bajram.

- Xhubejr ibn Nufejri thotë:

“Sahabet e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur takoheshin ditën e bajramit i thonin njëri tjetrit: tekabel-lAllahu minna ve minke: Allahu i pranofte veptrat tona dhe tuajat”. (Ibn Haxheri thotë është hasen).

- Muhammed ibn Zijad El-elehani thotë: isha me Ebu Umamete El-Bahiliun [radijAllahu anhu] dhe disa sahabe tjerë të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Ata kur ktheheshin nga namazi i thonin njëri tjetrit: tekabel-lAllahu minna



ve minke: Allahu i pranofte veprat tona dhe tuajat”. (Ahmedi thote senedi eshte i mire).

Sa i perket urimeve qe jepen per bajram ato dallojne nga vendi ne vend, andaj nuk eshte me rendesi se cfare fjale i thua, nese ajo fjale nuk eshte e ndaluar ose nese nuk ka ne te perngjasim me kafirat.

8- Ndërimi i rruges.

Xhabiri [radijAllahu anhu] thote:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ne ditën e bajramit e ndërronte rrugën”. (Buhariu).

Dijetarët i kanë hulumtuar urtësitë e kësaj veprë të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i kanë gjetur mbi njëzet urtësi.

Prej tyre i kanë numëruar edhe këto:

- Shfaqje e simboleve islame.
- Që ti dëshmojnë dy rrugë.
- Shfaqja e përmendjes së Allahut.
- Futja mllef në zemrat e kafirave dhe munafikëve.
- Dhënia selam banorëve të dy rrugëve.
- Ose mësimi i tyre.
- Ose dhënia sadaka nevojtarëve të dy rrugëve.
- Ose vizita e farefisit që banojnë në dy rrugët, etj.

9- Gëzimi për bajram.

- Aisheja [radijAllahu anha] thote:

“Hyri te unë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke qenë aty të pranishme dy vogëlushe të cilat këndonin. U shtri në shtrat dhe e ktheu fytyrën. Ndërkohë hyri Ebu Bekri dhe më qortoi e më tha: a fyellë të shejtanit te

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]? U drejtua nga ai Pejgamberi [alejhis-selam] dhe i tha: “lëri ato dyja. Kur e zuri gjumi i preka që të dalin”.(Buhariu dhe Muslimi). Në transmetimin tjetër qëndron:

“Këndonin me def”. (Muslimi).

Ibn Haxheri [rahimehull-llah] thotë: “në këtë hadith ka shumë dobi, prej tyre janë edhe këto: mundet t’i mundësosh familjes gjëra që u shkaktojnë lozje dhe rehati nga ibadetet, dhe se largimi prej adhurimeve kërkohet në këto ditë dhe se shfaqja e gëzimit në bajrame është prej simobleve të fesë”.

Mendo rreth dhuntive të Allahut, ku muslimanët gëzohen me bajramin dhe shpërblehen me këtë gëzim sepse është prej simobleve të fesë. Mirëpo duhet ditur se ky gëzim duhet të jetë sipas kufinjve të fesë dhe nuk duhet kaluar ato me gjëra negative dhe mëkate, sepse ky nuk është gëzim i lejuar fetarisht por është ngacmim nga shejtani.

- Bashkimi i njerëzve në ushqim gjatë bajramit është sunnet. Sepse në këtë mënyrë e shfaq këtë simbol të madh. Shejhul-Islam Ibn tejmie [rahimehull-llah] thotë: bashkimi i njerëzve në ushqim gjatë bajrameve dhe ditëve të teshrikut është sunnet, sepse është prej simobleve të Islamit, të cilat i ka lënë sunnet Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

Ibrahim ibn Muhammed ibn Hukajl

## **Bajrami i Fitrit - përgatitja për festën, namazi i bajramit, disa gabime gjatë festës dhe çka pas festës?**

Akrepat e orës punojnë palodhshëm, ditët pandërprerë pasojnë njëra-tjetrën dhe kështu çdo gjëje i afrohet fundi. Muaji i bekuar i Ramazanit sikur po na shpreh fjalët lamtumirëse, për shkak se po ndahet prej neve. E ne me lotë në sy i japin shpresë njëri-tjetrit për takim të serishëm.

Lexues i dashur, dije se Ramazani do të dëshmojë para Allahut [subhanehu ve tealala] për ty ose kundër teje. Ai që ka bërë vepra të mira le ta falënderojë Allahun [subhanehu ve tealala] dhe le të shpresojë shpërblimin e tij, i bindur se Allahu [subhanehu ve tealala] nuk humb veprat e bamirësve. E ai që ka bërë mëkate ndaj Allahut [subhanehu ve tealala] le të pendohet tek Ai sinqerisht, se Allahu [subhanehu ve tealala] pranon pendimin e robit të vet, Ai është Mëshirëplotë.

Allahu i Madhëruar ligjësoi në fund të muajit të Ramazanit festën e Fitër Bajramit, gëzim për muslimanët ashtu siç ligjësoi festën e Kurban Bajramit në ditën e dhjetë të muajit Dhul-Hixhxe. Transmetohet nga Enesi [radijAllahu anhu], i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] erdhi në Medine dhe gjeti njerëzit duke festuar dy ditë të caktuara. Ai pyeti: “Çfarë janë këto dy ditë”? Ata u përgjigjën: Në periudhën e xhahilijetit (injurancës), këto ditë ishin festa për ne. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Allahu ua zëvendësoi me dy ditë më të mira, me Kurban Bajramin dhe Fitër Bajramit.” (Ebu Davudi, Nesaiu, Ahmedi – hadith sahih)

Këtyre dy festave vjetore u bashkëngjitet edhe një festë tjetër javore, ajo është dita e Xhuma. Transmeton Ibën Maxhe nga Ibën Abbasi [radijAllahu anhuma] se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] për ditën e Xhuma ka thënë: “Allahu këtë ditë e ka bërë festë për muslimanët”. Pra, këto janë festat tona.

Festa e Bajramit manifestohet duke falur namazin e Bajramit. Allahu [subhanehu ve tealala] në Kuranin Famëlartë thotë: “Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që

përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet.” (A’la: 14-15) Po ashtu Allahu [subhanehu ve teala] thotë: “Ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd.” (Keuther: 2)

## DY FJALË RRETH NAMAZIT TË BAJRAMIT

Koha e namazit të Bajramit fillon me ngritjen e Diellit nga horizonti sa një shtizë, derisa të arrijë në zenit. Ibën Kajjimi [rahimehull-llah] thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] vononte namazin e Fitër Bajramit dhe shpejtonte namazin e Kurban Bajramit, e Ibën Omeri për shkak të përkujdesjes së tij të madhe në pasimin e sunnetit, nuk dilte në namaz derisa të lindte Dielli.”

Namazi i Bajramit ka dy rekate dhe dallon prej namazeve tjera për nga mënyra e faljes. Në rekatën e parë pas tekbirit fillestar merren shtatë tekbire, mandej lexohet sureja Fatiha dhe ndonjë sure tjetër (preferohet të lexohet sureja A’la ose Kaf). Pas plotësimit të rukusë dhe sexhdesë së rekatit të parë, ngritet për në rekatën e dytë dhe menjëherë merren pesë tekbire pas të cilëve lexohet Fatiha dhe ndonjë sure (preferohet leximi i sures Gashije ose Kamer), më pas shkohet në ruku dhe sexhde e kështu përfundon namazi.

## PËRGATITJA PËR FESTËN E BAJRAMIT

1. Larja e trupit. Transmeton Nafiu nga Ibën Omeri [radijAllahu anhum] se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] lahej ditën e Bajramit para se të shkojë në musal-la (Hapësirë e madhe ku falet namazi i Bajramit.. (Bejhakiu dhe Maliku – hadith sahih)

2. Të stolisurit me rrobe të bukura. Transmeton Xhabiri [radijAllahu anhu] se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka pasur një xhybe të veçantë, që e ka veshur në dy bajramet dhe në xhuma. (Ibën Huzejme në sahihun e tij)

3. Ngrënia e hurmave para daljes për të falur namazin e Bajramit. Enesi [radijAllahu anhu] thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] para se të shkojë për të falur namazin e Bajramit hante hurma.

4. Shkuarja herët në musal-la për të falur namazin e Bajramit.

5. Shkuarja në musal-la këmbas. Aliu [radijAllahu anhu] thotë: Prej sunnetit është shkuarja në musal-la për të falë namazin e Bajramit këmbas.

6. Ndërrimi i rrugës në shkuarje dhe kthyerje nga musal-la. Ibën Kajjimi [rahimehull-llah] thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ditën e Bajramit e ndërronte rrugën, shkonte në një rrugë dhe ktheheshte nga një tjetër.

## GABIMET NË KËTË FESTË

Shumë njerëz duke mos i ditur rregullat që kanë të bëjnë me festën e Bajramit, bien në gabime, që duhet tërhequr vërejtjen nga ato:

1. Agjërimi i ditës së Bajramit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka ndaluar këtë vepër, siç transmetohet nga Ebu Seid el-Hudriju në Buhari dhe Muslim.

2. Mospjesëmarrja e grave në faljen e namazit të Bajramit. Duke patur parasysh faktin, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka urdhëruar që gratë të falin këtë namaz. Ummu Atijje thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] urdhëronte edhe gratë që të dalin dhe të falin namazin e Bajramit. (Buhari, Muslimi)

3. Mosdhënia rëndësi këshillimit të grave në hutben e Bajramit.

4. Caktimi i vizitimit të varrezave ditën e Bajramit. Kjo vepër bie në kundërshtim me praktikën e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

5. Gëzimi për shkak kalimit të muajit Ramazanit dhe kthimit në jetën e shfrenuar. Kjo nuk gjendet përveç se tek ata të cilëve Allahu [subhanehu ve teala] ua ka vulosur zemrat në mëkate.

## Le të gëzohemi për bajram!

Allahu i dhashtë të gjithë muslimanëve një bajram të gëzueshëm. Kjo është ajo që duhet të jetë. Allahu ka thënë: "Thuaj: "Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata". [Junus: 58]

Bajrami është rasti i përzemërsisë, faljes dhe rinovimit të vëllazërimit. Është një kohë për të gjithë ata të cilët besojnë që nuk ka zot tjetër përveç Allahut, të punojnë së bashku në të mira dhe në devotshmëri dhe ta urdhërojnë njëri tjetrin për kah e vërteta dhe durimi. Është kohë për tu zhveshur nga gabimet. Askush nuk mund ta përjetojë gëzimin e bajramit ndërsa jeta e tij është e mbushur me mashtrime dhe dëshira të kota.

Ne duhet të shikojmë përpara për një të nesërme më të mirë dhe për të ngritur optimizmin tonë sepse e tmerrshme është jeta pa shpresa. Poeti el-Mutanabbi nisi një traditë të keqe kur ai shkroi verset pesimiste rreth bajramit. Të tilla poema qarkullojnë shpesh në ditët tona. Temë kjo që vazhdimisht sillet nëpër shtëpitë tona e që është se nuk ka gëzim me rastin e bajramit pa pasur mbështetjen kundër armiqve tanë.

Realizimi i aspiratave tona pa dyshim janë një shkak për gëzim por nuk është i njëjti si gëzimi që ne përjetojmë me rastin e bajramit. Allahu e dinte se muslimanët do të kalonin përmes etapave të ndryshme në historinë e tyre. Ai e dinte që ata do të ankoheshin dhe do të neglizhonin, që ata do të qëndronin me nostalgjinë e arritjeve të së kaluarës dhe të arratiseshin nga detyrat e tyre. Ai e dinte se ata do të vuanin nga kriza dhe mjerime. Megjithatë ai vendosi që ata duhet të gëzohen me rastin e bajramit dhe të japin falënderime. Mu ashtu siç Allahu thotë: " ... të madhëroni Allahun për atë se ju udhëzoi dhe që të falënderoni". [el-bekare: 185]

Nuk ka pikë dyshimi që muslimanët kanë marrë pjesë në këto dy bajrame madje edhe gjatë kohërave të vështira dhe të rënda. Ata do të japin në bamirësi dhe do të mbështesin të varfrit dhe nevojtarët dhe do të gëzoheshin në kënaqësi të lejueshme që nuk i kishin kryer në asnjë kohë tjetër të vitit.

Njerëzit kanë një tendencë natyrale që mërziten kur një gjë që thuhet pa pushim madje edhe kur kuptimi i asaj që thuhet mund të jetë korrekt. Edhe shpata më e mprehtë mund të topitet. Nuk ka asgjë të keqe nëse ne bëjmë një pushim nga të ankuarit tonë dhe vuajtjes kështu që zemrat tona të mund të marrin një shije të vogël nga gëzimi që vjen nga e vërteta dhe udhëzimi që ne kemi si musliman. Ishte nga urtësia e Allahut që Ai i urdhëroi muslimanët të flejnë në qetësi kur ata u rrethuan nga frika dhe ankthi dhe u mundën në luftën e Uhdit. I nxori nga rrethanat e tyre të tmerrshme dhe vendosi qetësi në emocionet e tyre dhe siguri tek besimi i tyre.

Ka edhe një kuptim tjetër që ne mund ta mësojmë nga kjo e ajo është që asgjë në jetë nuk është e përhershme. Çdo gjë është në duart e Allahut. Ai i drejton të gjitha punët. Poshtërimit dhe athtësisë që ka pllakosur botën muslimane, sot, nesër, ose më vonë do t'i vijë fundi. Nuk ka asnjë arsye për botën muslimane për tu dëshpëruar dhe për të humbur shpresën.

Kam parë athtësinë dhe dhimbjen në fytyrat e shumë njerëzve që unë kam takuar dhe unë kam dëgjuar herë pas here se çfarë ata kishin për të thënë. Pa dyshim ky bashkim i ndjenjave është një paraqitje e ndershme e betimit tonë për fenë tonë dhe vetëdijes tonë për vuajtjet e vëllezërve tanë muslimanë.

Bajrami është pjesë e caktimit hyjnor të zbritur për muslimanët. Lidh të kaluarën e tyre me të tashmen. Bashkon të afërmit dhe të huajt. Forcon indentitetin tonë me besimin tonë i cili është çelësi i suksesit tonë.

Rrethanat tona të tanishme nuk duhet të na bëjnë të harrojmë që ky është ende bajram. Ne nuk duhet ta kthejmë në ditë vajtimi. Ne duhet të gëzohemi në bajram.



Kjo është tradita e profetëve. Ne mund të marrim shpresë nga një rreze e vogël drite që ne mund ta shohim para nesh...Paqja e Allahut qoftë mbi ju.

Shejh Selman bin Fahd el-Audah

## Bajrami dhe kuptimi shumë-dimenzional i tij

Festat dhe bajramet gjinden në të gjithë popujt, pa marrë parasysh se a janë ithtarë të librit ose idhujtar, sepse festat kanë të bëjnë me intuitën dhe natyrën e njerëzve. Të gjithë njerëzit dëshirojnë që të kenë raste festive, të cilat do t'i kremtojnë dhe do të tubohen e të shpalosin gëzimin dhe harenë.

Festat tek mosbesimtarët ndërlidhen me gjëra të kësaj bote, siç është fillimi i vitit, ose sezona e mbjelljes, ose ndryshimi i klimës, ose themelimi i një shtetit, ose ardhja në pushtet të ndonjë kryetari, etj.

Herë-herë ndërlidhen me ndonjë rast fetar, siç janë shumica e festave të krishterët dhe çifutët. Prej festave të të krishterëve janë psh festa e krishtlindjeve, ose e vitit të ri, e shumë festa tjera që festohen në vendet ku dominojnë të krishterët, edhe pse në ato vende mundet të ketë edhe musliman, të cilët disa herë festojnë me ta ose nga injoranca ose nga dyfytësia.

Edhe zjarrputistët kanë festat e tyre të veçanta, sikurse është festa e nevruzit, e cila është futur te në nëpërmjet bektashive, edhe disa festa tjera.

Muslimanët veçohen me festat e tyre

Hadithi i Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]:

“Secili popull ka festat e veta, kurse kjo është festa jonë”, tregon se muslimanët veçohen vetëm me këto dy festa dhe nuk u lejohet muslimanëve që tu përngajnë mosbesimtarëve dhe idhujtarëve në festat e tyre të veçanta, as me ushqim, as me veshmbathje, as me ndezje të zjarrit, as me adhurim, as duke lozur fëmijët në festat e tyre, as duke shfaqur zbukurimet.

## Dimensionet e bajramit

1- Bajrami në dimensionin fetar domethënë: falënderim ndaj Allahut për plotësimin e adhurimit, të cilin nuk e thotë besimtari vetëm më gjuhë, por depërton në brendësitë e tija duke shpalosur kënaqësinë dhe qetësinë e tij dhe shfaqet në jetën e tij publike si gëzim dhe hare.

2- Bajrami në dimensionin humanitar domethënë: dita kur takohet forca e të pasurit me dobësinë e të varfrit në dashuri, mëshirë dhe drejtësi nga shpallja e qiellit, titulli i të cilës është zekati, bamirësia dhe lehtësimi.

Bajrami te i pasuri ndikon që të harrojë varësinë e tij nga pasuria, zbret nga lartësitat e tija dhe tregohet modest para njerëzve, duke e përkujtuar vetveten se të gjithë ata që gjinden përreth tij janë vëllezërit dhe ndihmësit e tij. Ky njeri i shlyen gabimet e tija që i ka bërë për një vjet me bamirësinë që e bënë për një ditë.

Kurse për të varfrin domethënë largim i brengave, ngritet në horizontin ku i vizatonte ëndrrat e tija, i harron lodhjet dhe vështirësitë që i ka përjetuar gjatë tërë vitit. Gëzimi i bajramit i shlyen gjurmët e mllefrit dhe neveritjes nga vetvetja, dështon dëshpërimi në momentin kur fiton shpresa.

3- Bajrami në dimensionin psikologjik domethënë: Kufiri mes përkufizimeve, të cilave i është nënshtruar shpirti, i janë dorëzuar gjymtyrët dhe pikënisjes në hapësirat e lejuara të lozjes dhe kënaqjes me gjërat e këndshme.

4- Bajrami në dimensionin kohor domethënë: një copë kohë e veçuar për të harruar brengat dhe mërzitë, për të larguar përgjegjësitë dhe detyrat, për të pushuar përpjekjet e jetës.

5- Bajrami në dimensionin shoqëror domethënë:

- dita kur gëzohen fëmijët duke lozur dhe duke u argëtuar.
- Dita kur gëzohen të varfrit duke iu lehtësuar jeta dhe duke shijuar komoditet.

- Dita kur farefisi takohen në bamirësi dhe kujdes për njëri tjetrin.
- Dita kur muslimanët bashkohen në falje dhe vizita reciproke.
- Dita kur miqtë i ripërtërinë urat e dashurisë dhe elementet e afërsisë.
- Dita kur shpirti fisnik i harron gabimet e tjerëve ndaj tij; bashkohet pas ndarjes, pastrohet pas përllomjes dhe e përshëndet pas injorimit.

E tërë kjo domethënë ripërtëritje e lidhjeve shoqërore në formën më të fuqishme dhe më të mirë, në dashuri, besnikëri dhe vëllazërim.

Kjo ua përkujton anëtarëve të shoqërisë që të përkujdesen për të dobëtit dhe të paafittit, që gëzimi i bajramit të depërtojë në secilën shtëpi dhe dhuntitë t'i përjetojë secila familje.

Këtë qëllim shoqëror e ka sadakatul-fitri në fitër bajramin dhe kurbanin në kurban bajramin. Shpërndarja e sadakatul-fitrit para namazit të bajramit është shtytës për njerëzit e mirë që ta zgjasin dorën e bamirësisë, me qëllim që atë ditë që do të lind dielli, të lindin edhe shpresat e reja për këta njerëz, ti kalon gëzimi dhe galdimi fytyrat dhe shpirtin e tyre.

Në bajram ka rregulla që e ndalin epshin, ka urtësi që e ushqejnë mendjen, sekrete që e pastrojnë shpirtin, përkujtime që bëhen shëmbëlltjërë në të vërtetë dhe të mirë, në brendësinë e tij ka mësim që shpalosin të vërtetë, kritere që ngrisin drejtësinë në mesin e llojeve të ndryshme të njerëzve, synime fisnike që kujdesen për të ruajtur unitetin dhe përmirësimin, dhe mësim të larta praktike në sakrificë, altruizëm dhe dashuri.

Në bajram del në shesh vlera e sinqeritetit, e lartësuar mbi të gjithë. Njerëzit i dhurojnë njëri tjetrit dhurata nga zemra e sinqertë dhe e dashur. Sikurse të jetë bajrami shpirti i një familjes në mbarë ummetin.

Bajrami e zgjeron domethënien e fqiut saqë e kaplon tërë atë botë të banuar nga muslimanët, ku realizohet në praktikë domethënia e vëllazërisë.

Bajrami në Islam është qetësi dhe dinjitet, madhërim të Allahut që është Një dhe i Gjithfuqishëm dhe largim nga shkaqet e shkatërrimit dhe hyrjes në xhehenem.

Pas tërë kësaj bajrami është mejdan i garave në të mira dhe fisnike.

### **Madhëria e bajramit**

Madhëria e bajramit del në shesh duke pasur parasysh faktin se Islami secilin bajram e ka ndërlidhur me një adhurim madhështor islam, që janë simbole gjigante të fesë, të cilat:

- Kanë ndikim të madh në gjërat shpirtërore.
- Ndikim të madh në gjërat shoqërore.
- Përplot me të mira, bamirësi, mëshirë dhe devotshmëri.
- Ndikim në edukimin individual dhe shoqëror, pa të cilin një ummet nuk meriton ekzistim e as nuk mund të sjell dobi.

Ato janë:

Muaji i Ramazanit, ku fitër bajrami vjen si përfundim aromatik dhe si mirënjohje për përfundimin e tij;

Haxhi, pas të cilit vjen kurban bajrami.

Ndërlidhja që ua ka bërë Zoti këtyre dy festave me këto dy adhurimet mjafton për ti vlerësuar dhe për të shpalosur të vërtetën e tyre.

Pra, këto janë dy festa fetare me të gjitha sunnetet që janë përcaktuar në to, madje feja preferon që të ndërmirren disa veprime, të cilat janë të kësaj bote, siç është zbukurimi, parfymosja, harxhimi më i madh për veshmbathjen e fëmijëve dhe familjes, në ushqim, kujdesi për mysafirët, argëtimi, lozja, me kusht që mos të kalon në harxhim të tepruar (israf). Këto gjëra të lejuara shndërrohen në adhurim nëse nijjeti është i mirë.

Prej mirësisë së Islamit është që shumë gjëra të lejuara nëse bëhen me nijet të mirë, synohet të realizohen disa urtësi të Allahut, ose falënderim ndaj Allahut, ato shndërrohen në adhurime, siç ka thënë Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem]:

“Saçë edhe kafshatën që ia afron gruas tënde deri te goja”.

Sekreti i bajramit nuk fshihet në ditën që fillon me lindjen e diellit dhe përfundon me perëndimin e tij, por në veprat me të cilat mbushet ajo ditë, bamirësia dhe veprat e mira që bëhen në këtë ditë, lumturia që i kaplon shpirtrat e përgatitur për të mira dhe lartësira. Bajram është domethënia e kësaj dite, jo vet dita.

Këto janë disa dimensione të domethënies së bajramit, siç i kuptojmë nga Islami, siç i realizojnë muslimanët e sinqertë. Vallë ku jemi ne nga këto festa?! Ku janë këto festa prej nesh?! Cila është hiseja jonë nga këto domethënie?! Ku janë gjurmët e adhurimet nga gjurmët e adeteve në festat tona?!

Përmbyllje e kësaj feste me adhurim

Pasi që festa e bajramit është festim për shkak të përfundimit të një adhurimit me sukses, pas festimit, në shenjë falënderimi besimtari, sërish fillon me adhurim.

Prej këtij adhurimi të preferuar, e jo të obliguar është agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit.

Për këto ditë Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush agjëron Ramazanin, pastaj e përcjell me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit, i regjistrohesh sikur të kishte agjëruar tërë vitin”. (Muslimi).

## Festat Islame qëllimet dhe rregullat e tyre

Popujt e mëparshëm festat i njihnin për lozje dhe dëfrim, për dehje dhe vallëzim, bile disa fe të vjetra festat e tyre fetare i shfrytëzonin për nihilizëm dhe kaotizëm moral, e mos të flasim për festën e “Pakosit” të grekët e vjetër e pastaj të romakët, festë e cila përsëritej disa herë në vit, ku burrat dhe gratë detyroheshin të çveshen nda nderi dhe turpi dhe të lirohen nga çdo përkufizim të xhelozisë dhe nderit, tua zgjidhin frerët ndjenjave kafsharake, për të kryer nevojën e vet publikisht dhe haptazi, për të kënaqur hyjnitë e tyre, siç pretendonin ata. Saqë ai që refuzonet një gjë të tillë në atë kohë, kryetarët e fesë së tyre gjykonin që të varroset i gjallë në shpella të largëta dhe gropa të panjohura derisa ti vjen vdekja, ose ta arrijë caktimi i Zotit.

Në skajin tjetër, përballë këtij materializmi shohim spiritualizmin e asketëve të vetmuar dhe të tërhequr në vete, të cilët mjaftohen me përsëritjen e përkujtimeve të shenjta, duke e përsëritur në vetvete, ose duke e shprehur me zë të dobët në skajet e faltores së tyre, ose duke i lexuar disa lutje ose duke i kryer disa rite dhe simbole.

Vjen Islami me peshojën e tij të drejtë dhe standardet precize dhe ndarëse duke i dhënë ndriçim të ri festave, larg nga çdo nihilizëm dhe fëlliqësira e sajë dhe larg nga çdo asketizëm ekstrem. Ajo nga këto dy shkolla merr atë që është e mirë dhe mesatare duke lënë pas shpine çdo element të tyre që përmban sherr ose çorodi, duke i shtuar edhe elemente të reja të mira, dukë thuru nga të gjitha këto fotografi të gjallë, të fuqishme dhe të bukur në korniza të pastërtisë dhe fisnikërisë, mbrojtjes së vlerave dhe nderit.

Kjo është ideja mbi festat në Islam.

Ngjyra e parë e festave islame është ngjyra shpirtërore, mirëpo jo e shpirtit të heshtur dhe me zë të zbehtë, por e shpirtit të zgjuar dhe flakëruës. Dëgjo zërin e fuqishëm, ekoja e së cilit përhapet fuqishëm nëpër rrugë; në gjuhë të njerëzve që

shkojnë në namaz të bajramit një nga një ose grupe grupe, e njerëzve në xhamia, duke u falur ose duke pritur namazin, e njerëzve në shtëpi pasi që kanë falur namazet, ditëve të teshrikut, në mina gjatë hedhjes së gurëve, në gjuhë të haxhilerëve etj. Dëgjo këtë zë, i cili e shpërthen shpirtin dhe i jep nisje të gëzimit dhe haresë për plotësimin e udhëtimit të rëndë dhe të sukseshëm, udhëtimin e agjërimit ose haxhit. Pastaj në shenjë përgëzimi dhe shikimit në të ardhmen me sy të bindjes dhe shpresës. Është simbol i ngadhnjimit shpirtëror në përvojën e kaluar dhe vendosshmëri për të vazhduar në këtë ngadhnjim shpirtëror në përvojat e ardhme, ky zë është:

Allahu ekber Allahu ekber, la ilahe il-Allah Allahu ekber, Allahu ekber ve lilahil-hamd.

Ky element shpirtëror dhe entuziazist, Islami kërkon që ta shfaqim thelbin e saj në pamje të zbulimit dhe bukurisë, në atmosferë të kënaqjes dhe komoditetit trupor, duke mos bërë israf (harxhim të tepruar), i cili e shëmton plotësinë e sajë dhe e shndërron në të kundërtën e sajë.

Po, obligimi i modestisë dhe privimit, ishte gjobë e patjetërsueshme gjatë agjërimit dhe haxhit, mirëpo kur vjen dita e bajramit, mos thuaj: është lejuar ajo që ka qenë e ndaluar, mirëpo thuaj: është bërë obligim ajo që ka qenë e ndaluar dhe është ndaluar ajo që ka qenë e obliguar. Po, këtë ditë nuk ka agjërime e as privim nga të mirat dhe të këndshmet:

“(E thuhet) Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë”. (El-Hakka: 24).

Sot nuk ka modesti e as privim nga ushqimet e këndshme edhe nga zbulimet, secili prej nesh le ti vesh rrobat më të mira, le ti shfaq gjurmët e dhunitve të Allahut mbi te, sepse kjo është dita e shfaqjes së dhuntive. Po ashtu në këtë ditë nuk ka ekstremizëm dhe privim nga lozja dhe ahengu, mirëpo të jetë i lejuar dhe i pastër.



Transmetojnë pronarët e suneneve nga Enesi [radijAllahu anhu] i cili thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] erdhi në Medinë, kurse banorët e sajë kishin dy ditë që i festonin, e tha: Çka janë këto dy ditë? Thanë: loznim në këto dy ditë në xhahilijet. Atëhere Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: ua ka zëvendësuar Allahu me dy ditë më të mira se ato: ditën e kurban dhe ditën e fitër bajramit”. (hadithi është sahih).

Imam Muslimi transmeton në sahihun e tij nga Aisheja [radijAllahu anha] e cila thotë:

“Hyri te unë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në ditë feste, duke qenë aty të pranishme dy voglushe të cilat këndonin. U shtri në shtart dhe e ktheu fytyrën. Ndërkohë hyri Ebu Bekri dhe më qortoi e më tha: a fryllë të shejtanit te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]? U drejtua nga ai Pejgamberi [alejhis-salam] dhe i tha: “Iëri ato dyja, sepse secili popull ka festën e vet, kurse sot është festa jonë.

Aisheja thotë: disa njerëz nga Habeshi loznin me shtiza dhe me shpata, dhe ose e pyeta Pejgamberin ose më tha: a dëshiron ti shikosh? I thashë: po. Më la mbrapa ti, e futa kokën mbi supet e tija, kurse faqeja ime mbi faqen e tij, e kur u lodha më tha: mjafton? I thashë: po. (Muslimi).

Në këtë rast dëshiroj të theksoj edhe këtë, se sa i përket kësaj lozjeje që u përmend në hadithin e Aishes, jo që vetëm është i lejuar, por nëse bëhet me qëllim të mirë, është vepër në të cilën nxit Islami dhe nxitë në të shtu siç nxitë në gjujtje, në not, vrapim dhe në kalorësi dhe në të gjitha llojet e sportit të dobishëm, sepse i jep njeriut vendosshmëri, imunitet, e bënë ushtar të gatshëm për të mbrojtur fenë dhe atdhenë. Sa shumë kemi nevojë të ngjallim këto sunnete në festat tona.

Kështu në festat Islame takohen ajo shpirtëroreja e lartë dhe ajo materialeja e dobishme, e bukur dhe e pastër. Edhe pse Islami nuk është mjaftuar në festat e veta vetëm me këto dy elemente, gjersa e ka përforcuar edhe me element të tretë,

i cili është më i përforcuari dhe më i dashuri, e ajo është domethënja shoqërore humanitare, që e bënë ummetin si një trup. Edhe ate jo vetëm me simbol dhe ndenja, jo vetëm me pamjen e tubimit madhështor në dhikër dhe namaz, jo vetëm në këto takime miqësore dhe vëllazërore, jo vetëm në këto buzqeshje me të cilat e takon muslimani vëllaun e vet gjatë bajramit, por edhe me domthënje më të madhe se kjo, me sistemin e pjesmarjes ekonomike praktike, të cilën e caktuar sherijati mes anëtarëve të këtij xhemati, për tua lehtësuar nevojtarëve dhe duke i bërë të panevojshëm për lypje në këtë ditë. Kjo është zekatul-fitri gjatë fitër bajramit dhe kurbanit në ditën e kurban bajramit.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Andaj, ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!”. (El-Keuther: 2).

“Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet”. (El-A’la: 14-15). (Draz, n.d.)

Muhammed Abdullah Draz

## Pas muajit të Ramazanit

T'i bëjmë disa vështrime me rastin e përcjelljes së Ramazanit, lusim Allahun që të na bëjë dobi me të.

Vështrimi i parë:

Ç 'fituam prej Ramazanit?

Ah, e përcollëm Ramazanin e ndershëm, me ditët e tij të bukura dhe netët e mrekullueshme. Ah, e përcollëm muajin e Kuranit, të devotshmërisë, durimit, përpjekjes, mëshirës, faljes, shpëtimit prej zjarri, etj. (Gjërat e lartpërmendura nuk janë të posaçme vetëm për Ramazan...por në të gjitha ditët dhe kohët arrihet mëshira dhe falja e Allahut... në të gjitha kohët duhet të kërkohet takvallëku dhe të furnizohet muslimani me dukatën Islame. Qëllimi për atë që përmendëm është se në këtë muaj shumëfishohen sevapet, shtohen të mirat dhe ibadetet.)

A e fituam takvallëkun (devotshmërinë), dhe a e mbaruam shkollën e Ramazanit me diplomën e të devotshmëve?!

A e edukuam vetveten gjatë Ramazanit në të gjitha llojet e përpjekjeve tona?! A i luftuam vetvetet dhe epshet tona apo na fituan shprehitë e këqija dhe pasimet e verbëta e të këqija?! A nxituam në ato punë të cilat janë shkaqe të rahmetit, të faljes dhe shpëtimit prej zjarri. A vepruam... A vepruam... A vepruam...?!

Pyetje të shumta dhe të rëndësishme. Ia parashton vetvetes çdo musliman i sinqertë. E pyet veten e tij dhe përgjigjet me sinqeritet:

Çka fitova prej Ramazanit?

Vërtetë ai është shkollë e besimit, stacion i shpirtit për furnizimin e tij gjatë tërë vitit dhe për ngritjen e ideve dhe qëllimeve për jetën e mëtejshme.

Kur do të pranojë këshillën, do të ketë dobi dhe do të ndryshohet apo ta ndryshojë jetën e tij ai i cili nuk e bën këtë në muajin Ramazan?!

Me të vërtetë ai është shkollë për përmirësim, përmirësojmë në të veprat tona, sjelljet, adetet dhe moralët që janë në kundërshtim me ligjin e Allahut [ subhanehu ve teala ] Thotë Allahu [ subhanehu ve teala ]: "Vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli për derisa ata nuk e ndryshojnë vetveten" (Err-Rrad, 11)

Vështrimi i dytë:

Mos e humbni mundin tuaj

Nëse je prej atyre që përfituan prej Ramazanit...i fitove cilësitë e të devotshmëve, e agjërove si duhet, je falur me sinqeritet dhe i ke luftuar dëshirat tua epushore, falënderoj Allahun dhe lute atë që të të përforcojë në këtë rrugë derisa të të takojë vdekja. Kujdes që mos ta humbësh atë që ke fituar gjatë këtij muajit. Si ta merr mendja nëse një grua do ta turrte një shllung lesh e pastaj prej tij të bën ndonjë fanellë apo diçka tjetër, e pasi të mbaron i pëlqen shumë ajo fanellë dhe fillon që ta prishë atë fije-fije. Çdo të thonin njerëzit për të?!!

Kjo është e njëjtë me atë i cili iu kthehet mëkateve dhe punëve të këqija e largohet prej ibadeteve dhe punëve të mira pas Ramazanit...pasi që të begatohet me begatitë e ibadeteve dhe kënaqësinë e shpëtimit kthehet në gropën e mëkateve dhe punëve të këqija!! Sa njerëz të keqinj janë ata të cilët Allahun [ subhanehu ve teala ] e njohin vetëm me Ramazan.

Të dashur:

Humbja e asaj që u fitua në Ramazan mund të shihet në disa aspekte e nuk janë vetëm ato:

1. Atë që shohim nëpër xhamia, edhe atë prej ditës së parë të Bajramit. Në Ramazan xhamitë ishin përplot me xhemat, të mbledhur për të falur namazin e teravisë, që është sunnet, ndërsa tani në pese namazet e ditës që janë farz nuk shohim xhemat përveç se pak.

2. Me këngë dhe muzikë...zbulimi i gruas dhe përzierja e saj me burra të huaj, lënia e leximit të literaturës islame etj.

3. Vajtja në vende të këqija për të bërë mëkate.

Kështu nuk bëhet falënderimi i të mirave...kështu nuk përfundohet ky muaj dhe nuk falënderohet Allahu për atë se na ka mundësuar të falemi dhe agjërojmë...kjo nuk është shenjë se Allahu t'i ka bërë kabull veprat tua (t'i ka pranuar), por kjo është mohim i begative dhe mos falënderim për to.

Kjo është shenjë e mospranimit të veprave, Allahu na ruajte. Agjëruesi me të vërtetë gëzohet ditën e Bajramit. E falënderon Allahun se ia mundësoi ta plotëson agjërimin. Por prapëseprapë ai qan nga frika se ndoshta Allahu nuk ia ka pranuar agjërimin. Nga gjeneratat e para tona pas Ramazanit kishte që qanin gjastë muaj, duke e lutur Allahun që t'ua pranon veprat e tyre!

Prej shenjave të pranimit të veprave është ta shohësh muslimanin në gjendje më të mirë se sa ka qenë më parë, ta shohësh duke nxituar drejt veprave të mira. Thotë Allahu [ subhanehu ve teala ]: "Përkujtoni, kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: nëse falënderoni do t'ua shtojë të mirat..." (Ibrahim, 7). Shtimi në të mira ka për qëllim shtimin konkret dhe abstraktë d.m.th. shtimi i imanit dhe punëve të mira...sikur muslimani ta falënderonte Allahun ashtu si meriton, do ta shihje duke shtuar të mirat dhe ibadetet dhe duke u larguar prej mëkateve. Falënderim do të thotë lënie e mëkateve, siç kanë thënë gjeneratat e para të muslimanëve.

Vështrimi i tretë:

"Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të arrijë vdekja"

Kështu duhet të jetë muslimani, të vazhdojë në respektin e Allahut, i përqëndruar me sheriatin e Tij, i udhëzuar me fenë e Tij. Jo, atë nuk mund ta huton askush, e të adhuron Allahun në një muaj e në tjetrin jo, në ndonjë vend e në tjetrin jo, me disa njerëz e me të tjerë jo...jo, jo dhe njëmijë herë jo!! Por, e dinë se Zoti i Ramazanit është Zot edhe i muajve tjerë, e dinë se Ai është Zot i të gjitha

kohërave dhe vendeve...kështu që drejtohet dhe përforcohet në ligjin e Allahut [ subhanehu ve teala ] derisa të takojë Zotin e tij të kënaqur me te. Thotë Allahu [ subhanehu ve teala ]: "E ti përqendrohu ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty (o Muhammed) edhe ata që u penduan" (Hud, 112) dhe ka thënë "Pra drejtohuni Atij dhe kërkoni falje prej tij" (Fussilet, 6) Pejgamberi [ sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ] ka thënë: "Thuaj besova, e pastaj përqëndro" (Transmeton Muslimi)

Nëse ka mbaruar agjërimi i Ramazanit kemi edhe agjërim vullnetar, sikurse: gjashtë ditët e muajit Shevval, çdo e hënë dhe e enjte, ditët e bardha, dita e ashures, e arafatit, etj. Nëse ka mbaruar namazi i teravisë, namaz nate mund të falësh çdo natë. Thotë Allahu [subhanehu ve teala]: "E ata flenin vetëm një pjesë të shkurtër të natës" (Dharrijat, 17)

Nëse ka mbaruar sadakatul-fitri, mund të japish zekatin vjetor që e ke obligim, pastaj ke edhe vende tjera ku mund të inkuadrohesh me dhënien e sadakasë (lëmoshës).

Leximi i Kuranit nuk është i veçantë vetëm për Ramazan, por ai duhet të lexohet gjatë tërë vitit.

Ja kështu... veprat e mira mund të kryhen në çdo kohë. Mundohu, o vëlla në ibadete e ki kujdes prej të kotës dhe përtacësisë. Nëse nuk i vepron gjërat vullnetare, dije mirë se lënia e farzeve nuk të lejohet asnjëherë, sikurse pesë namazet e ditës etj.

Kujdes, mos të biesh në haramë qoftë ajo fjalë, punë, shikim në të apo dëgjim i tij. Kujdesuni, kujdesuni që të përqendroheni dhe të përforcoheni në fe gjatë tërë kohës. Ti nuk e din se kur të vjen meleku i vdekjes. Kij kujdes mos të të gjejë në mëkate. O Zot, o Ndryshuesi i zemrave, na i përforco zemrat tona në fenë tënde.

Së fundi: Duhet të kujdesesh shumë për veprat e mira e ditën e Bajramit të gjendesh mes shpresës dhe frikës, frikohesh për mospranimin e veprave dhe

shpreson në pranimin e veprave. Të mendojmë ditën e Bajramin për Ditën e daljes para Allahut, ku prej neve do të ketë që janë të gëzuar dhe të dëshpruar.

Lus Allahun që të pranojë prej neve dhe juve agjërimin, namazin dhe gjitha veprat tjera...t'i bëjë Bajramet tona me gëzime, të na e kthejë Ramazanin përsëri, e ne deri në atë kohë të jemi në gjendje më të mirë dhe t'i kemi përmisuar punët tona, të jetë ummeti jonë në poziten me te larte dhe të kthehet te Zoti i tij me kthim të mirë.

## Ramazani mundësia e artë për ripërtëritje

Ramazani gëzon përkujdesin e muslimanëve si në kohërat e vjetra ashtu edhe në këto moderne dhe në të gjitha vendet e muslimanëve. Përgatitja e muslimanëve për mikpritjen e tij i ka kaluar të gjitha standardet e zakonshme me adhurimet, madje disa musliman kanë shtytës të fshehur për ta bërë këtë muaj manifestim të plotë, e cila kurorëzohet me festimin e bajramit. Ibën Xhevziu ka përmendur se në mesin e muslimanëve të kohës së tij kishte të atillë që edhe po t'i kamxhikosje për të prishur agjërimin, ata nuk do ta prishnin, mirëpo nëse i kamxhikos për tu falur ata nuk do të faleshin! Është një gjë e çuditshme! Mua më duket se shumë njerëz prishjen e agjërimin e shikojnë si mangësi të burrërisë dhe dobësi të personalitetit, andaj ata kujdesen kaq shumë për agjërimin. Ja disa mendime që kanë të bëjnë me këtë simbol kaq të madh.

1- Allahu, azze ve xhel-le, i ka përcaktuar adhurimet në islam për ta kalitur njeriun dhe për ta edukuar ate, për të forcuar raportin e njeriut me Allahun, dhe normalisht se janë mjete të sprovës dhe testimin. Ai që i kryen si duhet dhe sipas rregullave, korrë sukses dhe shpëton, kurse ai që dështon në këto gjëra ka dështuar dhe e ka eksponuar veten para dënimeve më të rënda. Kjo domethënë se ne duhet të prekim ndikimin që le adhurimi i agjërimi në thelbin e fesë, i cili përbëhet nga sinqeriteti, dashuria, shpresa, mallëngjimi, turpi, veprimtaria e vërtetë dhe e palodhur për të fituar kënaqësinë e Allahut, subhanehu ve teala. Ai që agjëron Ramazanin, fal namazin, bën shprehi vizitimin e xhamive në këtë muaj, meriton të ndien se një ndryshim i mirë po përjeton personaliteti i tij dhe se ka rikarikuar energji shpirtërore, e cila është harxhuar shumë në kohën mes dy ramazaneve. Ajo që dua ta them këtu është kjo: fryti i agjërimin duhet të manifestohet në adhurimin e mirë të muslimanit ndaj Allahut, azze ve xhel-le, edhe atë në fushën e shpresës, frikës, bindjes, mposhtjes, dashurisë, miqësisë, etj. duhet të posedon ndjenjat e njeriut i cili ka humbur nga familja dhe shtëpia e tij e pastaj i ka gjetur ato! Fryti



i agjërimit në rrafshin e sjelljes praktike duhet të manifestohet në kujdesin ndaj kufijve që i ka caktuar Allahu, subhanehu ve teala, dhe veprimi sipas rregullave fisnike të sherijetit... dëshirojmë të shohim pas Ramazanit përmirësim në pikëpamjet tona ndaj dynjasë dhe ahiretit, domethënë lëvizjet tona të shprehin besimin tonë se dynjaja është tokë pjellore e ahiretit.

2- Më vjen keq të them se: shumica e medias e shpërfytyron fytyrën e vërtetë të Ramazanit, i ndërron pamjen e mesazhit që ia jep umetit, duke ia pasqyruar njerëzve se është një mysafir i rëndë, nikoqirët duhet shumë ta pushojnë veten para se të vijë ky mysafir që mund të bartin peshën e kujdesin ndaj tij dhe që të kalon mirë. Edhe pse pikëpamja islame origjinale dhe relativisht e trashëguar se ky muaj i nderuar është një shansë e madhe për atë që Allahu i mundëson ta agjërojë dhe fal namazin e këtij muaji.

Shpërfytyrimi tjetër që ia bën media është paraqitja e Ramazanit sikurse mundësi e gjatë e argëtimit, dëfrimit dhe kënaqjes në llojlloj ushqimesh, ndejave të natës, lojës me letra, ndeja të adoloshentëve dhe djelmohave rrugëve, etj. edhe pse nga ajo që dimë nga sekretet e përcaktimit të agjërimit është se muslimani në Ramazan edukon vetveten duke e privuar nga kënaqësitë dhe epshet. Ashtu që uria nga e cila vuan shkakton që ti kujton të uriturit dhe e zgjat dorën e bamirësisë ndaj të varfërve. Shtoja kësaj edhe faktin se njerëzit gjatë Ramazanit hanë dy shujtë (ushqime) për dallim prej ditëve tjera kur hanin nga tre, kjo domethënë se mbetet tepricë, e cila ndihmon për tu ndarë si sadaka dhe me këtë freskohet kapitali nacional. Mirëpo realiteti na tregon se ajo që harxhojnë njerëzit në ushqimet e Ramazanit është më i madh se ajo që e harxhojnë në muajt tjerë! Kështu abortohet ky adhurim kaq i madh dhe kështu largohen këto principe të ndershme nga drejtimi i tyre i ndershëm!

E thërras veten dhe vëllezërit e mi që të pakësojnë shikimin e televizorit dhe mediave të tjera gjatë Ramazanit deri në minimumin e mundshëm që t'i kthehet

Ramazanit shkëlqimi dhe të ribëhet shansë e nafleve, dhikrit, leximit të Kuranit, shpenzimit të sadakasë, bërjes mirë, etj.

3- Ramazani çelikos tek ne shpirtin rezistues, forcon vullnetin dhe vendosmërinë dhe duhet të përfitojmë nga kjo duke e bërë muajin e agjërimit mundësi për ndryshimin e disa shprehive të padëshirueshme dhe përfitimin e shprehive të lavdëruara. Në të vërtetë ajo që një njeri e bën serioz dhe superior janë vetëm disa cilësi të numëruara, gjithashtu ajo që sjelljen e një njeriu e bën të cilësohet si e keqe janë pak gjëra, andaj mjafton të pastrohet njeriu në çdo Ramazan nga një shprehje të keqe dhe përfitimin e një shprehje të mirë në vend të saj që ta gjejë veten pas pesë viteve të ndryshuar dhe transformuar nga një njeri i keq në një njeri të zakonshëm, ose nga një njeri i zakonshëm në një njeri të mirë ose superior.

Parafytyro me mua një njeri i cili në një vit e le shprehinë e prolongimit, e cila llogaritet si shprehje që shkakton kaosin në raportin tonë me kohën, në të dytin braktis shprehinë e hiperbolizimit të gjërave kur flet, në vitin e tretë shprehinë e vonimit nga namazi me xhemat, në vitin e katërt shprehinë e raporteve të thata me familjen dhe farefisën, etj, si do të jetë gjendja e tij?!

4- Ne jetojmë në një situatë të re botërore, e cila tani është duke e marrë formën dhe është duke u përhapur, në këtë situatë i jepet përparësi gjërave konkrete para atyre abstrakte, direkte para atyre indirekte, të tanishmëve para atyre të së ardhmes, fuqisë para mëshirës, suksesit para shpëtimit, dinamikëve para statikëve. Është një situatë frikësuese dhe tmerruese, nëse vazhdon gjendja kështu siç është kjo domethënë se gjeneratat e ardhshme do të shikojnë me nënçmim shumë gjëra që ne tani i llogarisim të çmueshme dhe të mëdha. Zgjedhja e këtij problemi të madh nuk do të jetë filozofik e as udhërrëfyes, por praktike dhe konkrete duke ngjallur Ramazanin sikurse e kanë ngjallur gjeneratat e para: agjërimit nga ushqimi, pija, mëkatet dhe gabimet, ngjallje netëve të bekuara, shpirttrave dhe zemrave dhe afrim të Allahu me llojlloj adhurimesh dhe afrimesh. Vetëm kjo është shprehje e

vërtetë e refuzimit tonë të shthurjes së brendshme dhe sulmit kulturor të ardhshëm, i cili do ta na sulmon nga çdo anë.

Allahu na dhashtë sukses!

Dr. Abdul-Kerim Bekar,

## Ramazani, shtegu i garave ku garojnë të mirët

Me të vërtetë muaji i Ramazanit është muaj i bereqeteve dhe të mirave, muaj i dhuratave dhe angazhimeve. Shpirti besimtar e pret këtë muaj me gëzim dhe disponim për shkak të asaj që gjendet në të, si agjërimi, namazi, istigfari (kërkimi i faljes), si dhe adhurime tjera. Kërkohet nga muslimani që ta dyfishojë adhurimin e tij gjatë këtij muaji, që të garojë së bashku me të mirët, të futet në grupin e të devotshmëve dhe të ngadhënjë së bashku me ngadhënjimtarët.

Do të flasim pak për të garuarit në të mirën, prandaj do të paraqesim një pamje të garimit gjatë muajit të Ramazanit pasi që është koha më e mirë dhe është prej arenavë më të gjëra për garim. Cilat janë punët që duhet garuar në to që të jemi prej të parëve?

Do t'i përmendi disa prej punëve në të cilat mund të garohet:

- Shpejtimi për në teube (pendim) dhe istigfar (kërkim faljeje) pas lënies dhe largimit nga mëkatet, të mëdha qofshin ato apo të vogla, si dhe vazhdimësia në istigfar natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi.
- Rishikimi i obligimeve me të cilat Allahu, subhanehu ve teala, i ka obliguar robërit e Tij, si dhe vendosmëria në vazhdimin e kryerjes së tyre.
- Përkujdesja për kryerjen e namazeve obligative në xhami, si dhe përkujdesja për Tëkbirin dhe safin (rreshtin) e parë. Gjithashtu përkujdesja për shkuarje të hershme në xhami; pasi që namazi ka pozitë të veçantë, gjë të cilën muslimani i arsyeshëm dhe i vyer e di.
- Përkujdesja për agjërim të plotë me të gjitha obligimet, rregullat dhe gjërat e lëvdueshme gjatë kryerjes së tij; prej tyre:
  - Të kuptuarit e rëndësisë së agjërit, qëllimit të tij si dhe të kuptuarit se agjërimi të shpie deri te devotshmëria.

- Përmabajta e kohës së iftarit dhe syfyrit si dhe praktikimi i sunetit gjatë tyre.
- Largimi nga të ndaluarat në përgjithësi e posaçërisht gibetit, nemimes (bartjes së fjalëve me qëllim të futjes së përçarjes) dhe gënjeshtërs.
- Shërimi i plagëve të shkaktuara nga mëkatet.
- Përkujdesja për shpeshtrimin e leximit të Kur`anit në mënyrë që të kemi një pjesë të caktuar ditore nga Kur`ani për mësim përmëndësh dhe lexim.
- Të caktojmë një kohë ditore për meditim rreth Kur`anit, kuptim të domethënies dhe kërkesave të tij.
- Përkujdesja për faljen e namazit të teravive me xhemat dhe të mos largohemi vetëm se pasi të largohet imami.
- Pjesëmarrja në dhënien e iftarit agjëruesve, aq ditë sa kemi mundësi. Sa më shumë që do ta bëjmë këtë punë, shpërblimi do të jetë më i madh.
- Përkujdesja për mbikëqyrjen e familjeve, grave dhe fëmijëve tanë që të kemi shpërblim edhe nga ky aspekt, si dhe t`ua përpilojmë atyre një program që do ta aplikojnë, ashtu siç e bëjmë për vete.
- Shpejtimi për falje dhe bamirësi ndaj të afërmëve, komshinjëve, shokëve dhe muslimanëve në përgjithësi. Të fillojmë një jetë të re me ta; me vizita, mëshirë dhe dashuri, ose së paku të lutemi për ta dhe të jemi në kontakt nëpërmjet telefonit.
- Ta bëjmë një orar me qëllim të shtimit të përkujdesit ndaj prindërve tanë, duke përfshirë vizitat, dhuratat, lutjet për ta si dhe kryerja e nevojave të tyre, gjë e cila do të jetë çdo ditë.
- Muaji i Ramazanit është muaj i xhihadit dhe fitoreve të mëdha. Në të ka ndodhur lufta e Bedrit dhe ka përfunduar çlirimi i Mekkes. Obligohet muslimani që gjatë këtij muaji posaçërisht të bëjë çdo punë që ka mundësi me anë të së cilës do t`a ndihmojë fenë e Allahut dhe t`a lartësojë fjalën e Tij, siç është: urdhërimi

për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, këshilla, dhurimi i ndonjë libri, ndonjë ligjërate të dobishme, ndonjë fletushkeje apo organizimi i ndonjë ligjërate apo mësimi, etj.

- Të bëjmë umre në Ramazan; sepse e ka shpërblimin e haxhit.

- T'i ngushëllojmë të varfërit dhe të mjerët si dhe t'u ndihmojmë atyre me të holla, ushqim, pije, veshmbathje si dhe të jemi pjesmarrës në ndihmën e të tjerëve. Për këtë qëllim duhet caktuar një pjesë nga pasuria jonë, e nëse nuk kemi mundësi atëherë duhet kontribuar fizikisht për t'i ndihmuar ata.

- Të futemi në i tikaf në dhjetëditëshin e fundit nëse mundemi, e nëse jo atëherë disa ditë prej tyre. I tikafi në haremin e Mekkes dhe Medines është më i vlefshmi nëse kemi mundësi për një gjë të tillë. Duhet shfrytëzuar i tikafin për lexim të Kura`nit, namaz, dhikër, lutje, meditim dhe llogaritje të vetave tona.

- Ta kërkojmë natën e Kadrit në dhjetëditëshin e fundit duke i kaluar këto netë në namaz, lexim të Kur`anit, dhikër dhe lutje.

- T'i përmbahemi edhkareve (lutjeve dhe përmendjes së Allahut) të caktuara ditore dhe atyre të përgjithshme dhe vazhdimësia në to.

- T'i pakësojmë lidhjet dhe kontaktet e panevojshme me qëllim të shfrytëzimit të kohës.

- Të lutemi për vetat tona, për prindërit tanë, familjet tona, për të afërmit tanë dhe për muslimanët në përgjithësi; sidomos në kohën e iftarit dhe syfyrit, në mes të ezanit dhe të ikametit, gjatë namazeve dhe të mos përtojme. Gjithashtu duhet t'i drejtohem Allahut për shpërblim në botën tjetër e nuk ka asgjë të keqe t'i drejtohem edhe për nevojat tona në këtë botë.

- Ta caktojmë një kohë për mësim dhe përsëritje të Kura`nit përmendësh, si dhe për mësim të sunetit (haditheve).

- T'i gëzojmë fëmijët tanë, vëllezërit tanë, komshinjtë tanë, shokët tanë dhe muslimanët në përgjithësi, aq sa kemi mundësi.

- Ta mbledhim sadekatul fitrin para bajramit dhe t'ua shpërndajmë të varfërve.

- Ta vizitojmë ndonjë të sëmurë apo ta përcjellim ndonjë xhenaze.

Këta ishin disa shembuj të garimit përgjatë Ramazanit, prandaj i mbetet të sinqertëve që të garojnë në këto punë dhe punë tjera. Prej gjërave që ndihmojnë për këtë garim janë:

1. Sinqeriteti dhe lutja e vazhdueshme e Allahut për të. Ka thënë i Lartmadhërishtmi: "E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë." (suretu el bejjine -5). Githashtu ka thënë Allahu i Lartmadhërishtëm: "Ne të shpallëm ty librin për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij" (suretu ez zumer- 2).

2. Programimi i ditës dhe natës: duke e ndarë kohën ashtu si na përshtatet, p.sh.:

a) Nëse ndonjëri prej nesh është nëpunës:

o Zgjohet për syfyr, merr abdest, i falë dy apo më tepër rekate dhe hanë ushqim. Pastaj e falë namazin e sabahut, bënë dhikër, lexon Kur'an aq sa mundet deri sa të lindë dielli dhe falet përsëri (namazin e duhasë)

o Pushon deri në kohën e punës.

o E kryen punën e tij me disponim dhe gjallëri.

o E cakton një kohë për lexim të Kur'anit, dhikër pas ikindisë si dhe lutje, apo për kryerjen e punëve të mira si vizita e të afërmëve ose kryerja e punëve të familjes.

o Ne kohën e iftarit bënë lutje.

o Pas namazit të taravive e cakton një kohë për punë bëmirëse.

b) E nëse është nxënës; atëherë i praktikon gjërat e lartpërmendura si dhe bënë përsëritjen e mësimëve të tij pas ikindisë ose pas jacisë.

c) Ndërkaq sa i përket gruas; ajo i përmbahet gjërave të lartpërmendura duke shtuar edhe qëndrimin e saj në shtëpi dhe kalimin e kohës së saj me fëmijët e saj, etj.

Këta ishin vetëm disa shembuj, pastaj çdonjëri e programon jetën e tij ashtu si i duket atij më së miri.

3. T`i programojmë punët tona; p. sh leximi i Kur`anit pas namazit të sabahut dhe të ikindisë, vizitat familjare pas jacisë, punët vullnetare bamirëse pas ikindisë, e kështu me radhë me qëllim që të mos e pengojë ndonjë punë, punën tjetër.

4. Programimi dhe përcaktimi i pasurisë, mvarësisht prej personit, psh: për familje kaq, për zeqat kaq, për sadaka kaq, për ushqim të agjëruesve kaq, etj.

5. Lutja për ndihmë dhe vendosmëri.

6. Dhënia e çdo gjëje të drejtën e vetë; mos t`i lëmë disa punë në kurriz të punëve tjera dhe mos të fokusohemi vetëm në persona e t`i lëmë anash familjet, etj.

7. Të bashkëpunojmë me të tjerët me qëllim që t`na nxisin në të mirë qofshin ata anëtarët e familjes, fëmijët, shokët apo shoqata dhe organizata të da`ves dhe ndihmave, etj. Ç`do gjë mvarësisht prej nevojës.

Falih ibën Muhamed ibën Falih Es-Sugaj-jir.



## Veprat e mira që mund të bëhen gjatë Ramazanit

Me të vërtetë muaji i Ramazanit është muaj i të mirave dhe bamirësisë. Është kohë e vlefshme. Kjo vlerë ndikon edhe te veprat e mira që bëhen gjatë këtij muajit të bekuar. Shpirtrat janë më aktivë në këtë muaj se sa në muajt tjerë. Dyert e veprave të mira janë të shumta edhe në këtë muaj edhe në muajt tjerë, mirëpo edhe më shumë potencohen në këtë muaj.

Prej këtyre veprave janë:

### 1- Singëriteti:

Singëriteti është baza e çdo vepre, boshti i çdo iniciative dhe themeli i çdo përpjekje. Është njëri prej dy kushteve të pranimit të veprave të mira.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singërtë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë”. (El-Bejjine: 5).

### 2- Ripërtëritja e pendimit

Pendimi është një adhurim i cili duhet ta shoqëron njeriun deri në vdekje. Njeriu çdo herë ka nevojë për pendim, sepse nga natyra e tij është mëkatar. Pra, pendimi është obligim i njeriut gjatë tërë ymrit të tij.

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që pendohet para se të del dielli nga perendimi, atij Allahu ia pranon pendimin”. (Muslimi).

Ky afat është në rrafshin kolektiv, mirëpo në rrafshin individual është ardhja e shpirtit në fyt.

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu ia pranon pendimin njeriut derisa nuk i ka ardhur shpirti në fyt”. (Hasen, Tirmidhiu).

### 3- Agjërimi i Ramazanit me besim dhe shpresim

Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

### 4- Namazi i teravisë gjatë Ramazanit

Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që e ngjall me namaz Ramazanin me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

### 5- Ngjallja e natës së Kadrit me adhurime

Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që e ngjall natën e Kadrit me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Në tre hadithet e larpërmendura flitet për falje të mëkateve. Shikoni me këto vepra sa mund të fitojmë, të na falen mëkatet që i kemi bërë gjatë tërë vitit. SubhnAllah, a ka dhuratë më të mirë dhe më të madhe se kjo. Andaj pse mos ti analizojmë pak më thellë këto gjëra dhe të mundohemi ta kemi parasysh këto gjëra gjatë realizimit të këtyre veprimeve.

### 6- Përpjeket për adhurime në dhjetë ditët e fundit

Aisheja [radijAllahu anhu] thotë:

“Kur hynin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] e ngjallte tërë natën me adhurime, e zgjonte familjen dhe e shtërngonte brezin”. (Buhariu dhe Muslimi).

## 7- Umreja në Ramazan

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Umreja në Ramazan vlen sa haxhi, ose haxhi me mua”. (Buhariu dhe Muslimi).

## 8- Itikafi

Itikafi është një adhurim, i cili shkakton që njeriu të vetmohet dhe të analizon vetveten, veprat e tija, të arriturat e tija, gabimet dhe rrëshqitjet e tija. Është një mundësi shumë e madhe për përmirësim. Larg nga çdo bisedë e kotë, larg nga çdo ndejë e pavlefshme, larg çdo gjëje që e largon njeriun nga Zoti, Famëmadh.

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit bante itikaf”. (Buhariu dhe Muslimi).

## 9- Ta falim namazin e teravis me imanin derisa ta përfundon

Ebu Dherri [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Kush falet me imamin derisa ta përfundon, i regjistrohet sikur të kishte falur tërë natën namaz”. (Ebu Davudi, sahih).

## 10- Shtimi i leximit të Kuranit

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbasi [radijAllahu anhuma], i cili thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte njeriu më bujar, edhe më bujar ishte në Ramazan, kur takohej me Xhibrilin [alejhis-selam], para të cilit e mësonte Kuranin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur takohej me xhibrilin ishte edhe më bujar se sa era që sjell bereqetin”.

Muaji i Ramazanit është muaji i Kuranit. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)...”. (El-Bekare: 185).

#### 11- Nxitimi i iftarit

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Njerëzit janë në të mirë përderisa e nxitojnë iftarin”. (Buhariu dhe Muslimi).

#### 12- Iftari në hurma nëse gjinden

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Kur dikush prej jush është agjërueshëm, le të bënë iftar në hurme, e nëse nuk gjen, atëherë në ujë, sepse uji është pastrim”. (sahih, shih: “Sahihu Xhamus-Sagir”, nr. 746).

#### 13- Kujdesu për lutjen pas iftarit

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] kur hante iftar thoshte:

“Shkoi etja, u lagën venët dhe mbeti shpërblimi inshaAllah”. (hasen, Ebu Davudi).

#### 14- Të bëjmë sa ma shumë lutje kur jemi agjërueshëm

Lutja është thelbi i adhurimit dhe kajmaku i tij. Lutja të jep gjëra që as në ëndër nuk mund ti mendosh. Është një adhurim shumë i lehtë, irëpo dobitë e saja janë shumë të mëdha.

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Tre lutje janë të pranuara: lutja e agjëruesit, lutja e atij që i është bërë zullum dhe lutja e udhëtarit”. (Bejhakui, sahih).

#### 15- Kujdesi për syfyrimin

Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Hani syfyr se në syfyr ka bereqet”. (Buhariu dhe Muslimi).

Koha e syfyr it është kohë e bereqetshme, sepse në këtë kohë zbret Allahu [subhanehu ve teala] në qiellin e dynjasë, për të parë robërit e Tij dhe nevojat që kanë.

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Zoti ynë zbret për çdo natë në qiellin e dynjasë, kur mbetet pjesa e tretë e natës e thotë: kush më lutet që ti përgjigjem, kush kërkon që ti jap, kush kërkon falje që tia fali”. (Buhariu).

16- Ta falënderojmë Allahun pas ngrënies dhe pijes

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu është dakord me njeriun, i cili kur ha një ushqim e falënderon Allahun për Të dhe kur pin ndonjë pije e falënderon Allahun për Të”. (Muslimi).

17- Heshtja dhe kujdesi për gjuhën

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që beson në Allahun dhe në Ditën e mbramë le të flet mirë ose le të heshtë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Po ashtu Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që nuk le fjalët e rrejshme dhe veprimin sipas tyre dhe injorimin, Allahu nuk ka nevojë që ai ta le ushqimin dhe pijen”. (Buhariu).

Po ashtu thotë:

“Agjërimi nuk është nga ngrënia dhe pija, por agjërimi është nga fjalët e kota dhe imorale. Nëse ndokush të shan ose ofendon, thuaji: unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm”. (sahih, Ibn Hibbani dhe të tjerët).

18- Shkuarja herët në xhami dhe pritja e namazeve

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Po ta dinin njerëzit çfarë vlere ka në ezan dhe në safin e par, e nëse nuk gjenin mënyrë tjetër për të takuar këto vlere përveç se me short, do të hedhnin short”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Njeriu konsiderohet në namaz, përderisa namazi e ndal, vetëm namazi nuk e le të shkon në shtëpi te familja”. (Buhariu dhe Muslimi).

Po ashtu Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“A t’ju tregoj se çka ua shlyen mëkatet dhe ua ngrit shkallët? Thanë: po o i dërguar i Allahut. Tha: Marja e abdestit edhe pse të vjen rëndë, hapat e shumta drejt xhamisë dhe pritja e namazit pas namazit. Kjo është ribat (qëndrim në gatishmëri ushtarake nëpër kufinjë), kjo është ribat”. (Muslimi).

19- Kujdesi për të dhënë ushqim në këtë muaj

Abudll-llah ibn Amri [radijAllahu anhu] tregon se një njeri e pyeti Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: cili Islam është më i miri? Ai u përgjegi:

“Të japish ushqim dhe ti japish selam atij që e njeh dhe atij që se njeh”. (Buhariu dhe Muslimi).

Abdullah ibn Selami [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“O ju njerëz! Përhapne selamin, jepni ushqim, kujdesuni për farefisn, faluni natën kur tjerët flejnë, do të hyni në xhennet me paqë”. (sahih, Tirmidhiu dhe të tjerët).

Zuhriu kur hynte Ramazani thoshte:

“Ky muaj është për të lexuar Kuran dhe për të dhënë ushqim”.

20- Dhënia iftar agjëruesve, ose duke u përgatit ushqim në shtëpitë tona, ose duke u dërguar ushqimin në shtëpitë e tyre ose atje ku gjinden ata

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Ai që i jep iftar një agjëruesit, ka sa shpërblimi i tij, edhe pse atij nuk i pakësohet aspak shpërblimi”. (Sahih, Tirmidhiu).

21- Sadakaja dhe lëmosha në rrugë të Allahut

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“O ju që keni besuar, para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësim, jepni nga ajo me çka Ne u furnizua juve. Pabesimtarët janë mizorë”. (El-Bekare: 254).

Ebu Hurejre [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Ai që jep sadaka sa një hurmë nga pasuria hallall, sepse Allahu vetëm hallallun e pranon, Allahu e pranon me të Djathtën e Tij, pastaj e rit, ashtu sikurse e rit njeriu mazin e tij, gjersa të bëhet sakur kodra”. (Buhariu dhe Muslimi).

Adij ibn Hatimi [radijAllahu anhu] thotë: Kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë:

“Secili prej jush do të flet me Allahun, nuk do të ket mes tij dhe Zotit ndërmjetësues. Do të shikon në të djathtën e tij, do të sheh vetëm kontributin e tij, do të shikon në të majtën e tij, do të sheh vetëm kontributin e tij, do të shikon para vethetes, vetëm zjarin do ta sheh. Rujuni nga zjari edhe vetëm një gjysmë hurme”. (Buhariu dhe Muslimi).

22- Koordinimi me tregtarët dhe të pasurit për të blera rroba dhe gjëra të nevojshme për nevojtarët dhe skamnorët, për tua ndarë gjatë këtij muajit të bekuar

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“...Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi...”. (El-Maide: 2).

Ebu Musa [radijAllahu anhu] thotë se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Deponisiti besnik, i cili e jep atë që është urdhëruar të plotë, pa mangësi, me zemërgjërësi, derisa tia dorëzon atij që është urdhëruar tia jep, është dhënës i sadakasë”. (sahih, Ebu Davudi).

23- Zgjedhja e disa fjalive, një këshillë të shkurtër, ose thirrja e ndonjë hoxhe për të këshilluar njerëzit

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Kush thërret në udhëzim, ka shpërblimin e atyre që udhëzohen, duke mos iu pakësuar aspak shpërblimi, i atyre që e kanë pasuar”. (Muslimi).

24- Dhënia e zekatul-fitrit në fund të Ramazanit

Abdullah ibn Abbasi [radijAllahu anhuma] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë obligim zekatul-fitrin si pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota dhe të imoralshme dhe ushqimpër nevojtarët. Ai që e jep para namazit (të bajramit) është zekat i pranuar, e kush e jep pas namazit, është sadaka sikur edhe sadakatë tjera”. (Hasen, Ebu Davudi).

25- Falja e namazit të bajramit me muslimanët

Ebu Seid el-Hudriu [radijAllahu anhu] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në namazin e fitër dhe kurban bajramit dilte në namazgjah (musalah), vepra e parë që bante ishte falja e namazit”. (Buhariu dhe Muslimi).

26- Ti mësojmë fëmijët në agjërime



Rubej' bin Mivedh [radijAllahu anha] thotë:

“I shtinim fëmiët tanë të agjërojnë dhe u bënim lojë nga leshti i ngjyrosur, e kur qante ndonjëri prej tyre për ushqim, ia jepnim derisa të bëhej koha e iftarit”. (Buhariu).

27- Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevvalit

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Kush agjëron Ramazanin dhe e pason me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit, i regjistrohët si agjërim i tërë vitit”. (Muslimi).

Vëlla i dashur, këto janë disa vepra të mira që kanë të bëjnë me këtë muaj të bekuar të Ramazanit, andaj kujdesu për këto vepra të mira dhe mos lejo që të ikin, sepse mundet të jetë ky Ramazani i fundit. Shfrytëzo shansën dhe vepra, të cilat dëshiron ti shohish atë ditë kur do të prezentohen veprat para Zotit [subhanehu ve teala]:

“Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vete atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që bëri, do të dëshirojë që në mes tij dhe në mes të asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë). Allahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij, megjithëqë Allahu është i mëshirshëm ndaj robërve”. (Ali Imran: 30).

“Dhe vihet libri (i veprave), e i sheh mëkatarët të frikësuar nga shënimet që janë në të dhe thonë: "Të mjerët ne, ç'është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë?", dhe atë që vepruan e gjejnë të gatshme - prezente, e Zoti yt nuk i bën padrejt askujt”. (El-Kehf: 49).

Allahu na dhuroftë vepra me të cilat është i kënaqur dhe të cilat i Do.

## Pesë ide për ndryshim familjar në Ramazan

Prej cilësive të burrave dhe grave që kanë marrë dhjetë prej dhjetë poenave është edhe: “shfrytëzimi i mundësive” dhe përfitimi nga rastet me gjëra të cilat ua realizojnë synimet familjare në jetë. Dallimi mes një tregtarit të suksesshëm në tregtinë e tij dhe tjetrit që ka dështuar qëndron në faktin se i pari i ka shfrytëzuar mundësitë dhe ka përfituar nga rastet. Pasi që ne gjendemi në muajin e Ramazanit, bashkëshortët duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të përfitojnë maksimalisht në ndryshimin e jetës së tyre bashkëshortore drejt asaj që është më e mirë...

Pse jemi përqendruar në ndryshim?

Ai që analizon detalisht muajin e Ramazanit, sheh se çdo gjë në gjithësi dhe tokë ndryshon. Andaj të gjitha librat qiellor, të cilat kanë shkaktuar ndryshime në rruzullin tokësor, kanë zbritur në Ramazan. Edhe tevrati, edhe zeburi, edhe Inxhili, edhe Kurani. Madje edhe qielli ndryshon në Ramazan, sepse prangosen djajtë dhe thërret një thirrës:

“O ti që do të mirën urdhëro dhe ti që do të keqen nguro”.

Pra, e gjithë atmosfera është e përgatitur për ndryshime. Në këtë ndihmon edhe gjendja e njerëzve.

Xhamitë ndryshojnë, shumë njerëz lexojnë në mus’hafet që gjinden në xhamia. Morali i njerëzve ndryshon, madje edhe orari i hapjes së tregjeve dhe mbyllja e tyre ndryshon. Mëkatet pakësohen kurse adhurimet shtohen, e shpirtit fiton një transparencë. Andaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] na ka tërhequr vërejtjen nga mos shfrytëzimi i mundësisë dhe përfitimi nga ky muaj për ndryshim, duke thënë:

“Sa agjërues nga agjërimi s’fitojnë asgjë tjetër përveç urisë dhe etjes dhe sa namazli s’fitojnë nga namazi asgjë përveç pagjumësisë”.

Sepse agjëruesi në këtë rast nuk i ka ndryshuar cilësitë e tija negative dhe nuk i ka zëvendësuar me ato pozitive.

Pasi që të gjitha këto gjërat ndryshojnë në Ramazan, kjo na jep shpresë dhe forcë në ndryshim.

Ide për ndryshime familjare

Bashkëshortët mund të përfitojnë nga muaji i bekaur i Ramazanit dhe atmosfera e rehatshme shpirtërore me disa ide familjare, prej tyre:

1- Bashkëshortët duhet të kontrollojnë ditët e kaluara; vlerësimi i tyre, përfitimi nga gjërat pozitive në to dhe debatimi i gjërave negative. Këta dy bashkëshortë nëse dëshirojnë të arrijnë këtë rezultat, duhet të ulen dhe të parashtrajnë këtë pyetje:

Cilat janë gjërat pozitive të këtij viti?

Pastaj kalon në vitin para tij dhe në ate më herët. Të njëjtën e veprojnë edhe me negativitetet. Këtë biesë e bajnë gjatë netëve të Ramazanit, sa ndeja të bukura janë këto ndeja.

2- Bashkëshortët duhet të kenë takime ku shtohet imani ose të falin namaz nate së bashku. Familjes duhet ti përgatisin program shpirtëror dhe imanor, siç është namazi i teravisë, ndeja pas iqinidsë për të lexuar tefsir të Kuranit, e kështu me rradhë.

Ose programe tjera fetare dhe mediale. Duhet të mbjellim cilësi pozitive në familje, si fillim i ndryshimit. Duhet të kujdesemi që të vazhdojmë në këtë program të përmirësimit dhe ndërtimit.

3- Bashkëshortët duhet të kujdesen gjatë Ramazanit për vizitat ferefisnore dhe forcimin e raporteve shoqërore, duke bërë vizita prej një shtëpie në tjetrën. Nëse nuk ka mundësi të realizohet kjo atëherë, së paku duke u telefonuar familjes dhe dashamirëve, ose duke u dërguar fakse dhe emaila. Është e pëlqyeshme që kjo të

jetë vepër kolektive që e gjith familja të mer pjesë në këtë vepër. Sepse kështu realizohet kjo domethënie fisnike shoqërore.

4- Përfitimi nga tubimi i tërë familjes gjatë iftarit tredhjet herë gjatë muajit. Kjo është një mundësi që dy bashkëshortët ta shfrytëzojnë për të forcuar raportet mes tyre, mes tyre dhe fëmijëve të tyre, duke zhvilluar debate dhe duke ndërruar mendime dhe ide. Duke polemizuar problemet dhe duke arritur në rezultate aspirative dhe ndryshim më të mirë.

5- Shfrytëzimi i mundësisë së bajramit, gëzimin, galdimin dhe lumturinë e njerëzve për të shkaktuar ndryshime në sjellje dhe veprime të gabuara, sepse njeriu pranon udhëzimet kur është i gëzuar dhe me shpirt të qetë, kurse refuzon çdo udhëzim kur është i angazhuar ose dekoncentruar.

Këto janë pesë idetë, edhe pse besoj se lexuesi posedon edhe tjerë ma shumë, të cilat mund ti realizojë dhe ta shfrytëzojë Ramazanin për ndryshim familjar drejt asaj që është më e mirë.

Në fund, u propozoj bashkëshortëve disa ide, të cilat ndoshta u ndihmojnë në metodën e ndryshimit në këtë muaj të ndryshimeve.

1- Secili bashkëshort le të përcakton gjërat që dëshiron t'i ndryshojë në palën tjetër. Preferohet që mos të përcaktohet ma shumë se një gjë, me qëllim që ti jep mundësi të ndryshimit palës tjetër.

2- Bashkëshortët duhet të caktojnë qëllimet e tyre të ardhshme familjare.

3- Bashkëshortët duhet të përcaktohen për ndryshimin e një sjelljes negative të fëmijët e tyre dhe të përfitojnë nga ky muaj në këtë drejtim.

Autor: Xhasim Mutava

## Program ditor për gruan muslimane në Ramazan

Në ditët e Ramazanit shohim se disa musliman dhe muslimane, i kalojnë ditët pa ndonjë shtesë të madhe të adhurimit, angazhohen në gjëra të kota, me gjëra të cilat nuk u sjellin të mira as në dynja e as në ahiret, por angazhohen me gjëra të ndaluara, andaj e pash të arsyeshme që të paraqesim një program ditor, sipas të cilit do ta kalon ditën me gjëra që i bënë dobi dhe e ngritë në shkallët e xhennetit. Program i cili fillon nga syfyri në syfyr.

Një: Para agimit të mëngjesit.

Është sunnet për muslimanin që të ha syfyr, sepse Pejgamberi, sal-Allahuejhi ve sel-lem, ka urdhëruar këtë vepër, duke thënë:

“Hani syfyr se në syfyr ka bereqet”. (Buhariu dhe Muslimi).

Syfyri realizohet me ushqimin e pranishëm, nëse s’ka tjetër gjë, edhe vetëm me hurma. E nëse nuk ka hurma, së paku të pi një gllënjë ujë.

Është e pëlqyeshme për muslimanen që ta vonoj sa ma shumë syfyrin, përderisa nuk frikohet se ka aguar mëngjesi.

Enes ibn Zejd ibn Thabiti thotë:

“Ngrënëm syfyr me Pejgamberin, sal-Allahuejhi ve sel-lem, e pastaj u ngrit ta fal namazin. I thash: sa kishte mes ezanit dhe syfyrit? Tha: sa të lexosh pesëdhjetë ajete”. (Buhariu dhe Muslimi).

Shokët e Pejgamberit, sal-Allahuejhi ve sel-lem, e vononin syfyrin dhe e nxitonin iftarin, siç tregon Amr ibn Mejmuni.

Ndoshta prej urtësive të syfyrit janë këto:

- Me syfyr njeriu forcohet për agjërimin e ditës, andaj vonimi është më i dobishëm për Të.
- Njeriu nëse ha syfyr herët natën, ndoshta flen dhe nuk e fal namazin e sabahut.

Dy: Ezani i Sabahut

Muslimaneja obligohet që kur të vërtetohet hyrja e kohës së namazit të sabahut, ta ndal ushqimin, dhe kur ta dëgjon muezinin duke thirrur ezanin, të përsërit fjalët që i thotë muezini, e pastaj ta thotë lutjen:

“O Allahu im, Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit i cili do të falet, jepi Muhammedit ndërmjetësimin dhe nderi-min dhe ngrite atë në vendin e lavdishëm të cilin ia ke premtuar; (Buhariu)

Për të fituar shefatin e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pastaj e fal sunnetin e sabahut, duke lexuar në rekatin e parë: kul ja ejuh-el-kafirun dhe në rekatin e dytë: kul huvAllahu ehad. Duhet të kujdeset për faljen e sunneteve të sabahut, sepse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk i linte as në vend e as në udhëtim.

Gjatë farzeve të sabahut duhet lexuar ma shumë Kuran, nëse ke mundësi, përndryshe aq sa ke mundësi.

Pasi që e përfundon faljen e namazit të sabahut, kujdesu për dhikret të cilat thuhën pas namazeve.

Këto dhikre mund t'i lexoni nga libri “Mburoja e Muslimanit” dhe nga aplikacionet e shumta që e kanë të përbrendësuar këtë libër dhe libra të ngjashëm.

Pas këtyre dhikreve, lexon dhikrin e mëngjesit, të cilat të mbrojnë nga shejtani dhe të bëjnë mburojë të fuqishme nga çdo e keqe.

Është sunnet për çdo musliman dhe muslimane që të qëndrojnë në vendin ku e fal namazin e sabahut deri në lindjen e diellit dhe derisa të ngritet dielli një shtizë, duke e përmendur Allahun, pastaj ngritet e i fal dy rekate, që me këtë veper të fiton shpërblimin e umres dhe haxhit të plotë, siç na ka treguar Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në hadithe të vërteta.

Gjatë këtij qëndrimi duhet të lexojë Kuran, ta përsërit hifzin, nëse është hafize, e nëse nuk di të lexojë Kuran, atëherë le të dëgjoj ndonjë recitues të Kuranit, ose të angazhohet me dhikre. Prej dhikreve janë edhe këto:

“S’ka hyjni tjetër përveç Allahut, i cili është Një dhe pa ortak, Atij i takon mbretëria dhe falënderimi dhe Ai ka mundësi të bëjë çdo gjë”. Një qind herë.

Ose:

“I lavdëruar dhe i falënderuar qoftë Allahu”. Një qind herë.

Për të fituar shpërblimin që e ka treguar Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në hadithe të ndryshme, se është mburojë nga shejtani dhe se i fshihen mëkatet edhe nëse janë sa shkuma e detit.

Ose

“S’ka mundësi dhe fuqi përveç se me Allahun”. Sepse kjo është një thesar nga thesaret e xhennetit. Me këtë e ka porositur Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem Ebu Musa Eshariun.

Pa dyshim se njeriu më së miri e kalon kohën duke i përmendur fjalët më të dashura të Allahut:

“I lavdëruar qoftë Allahu, i falënderuar qoftë Allahu, s’ka hyjni tjetër përveç Tij, Allahu është më i Madhi”.

E shumë dhikre dhe lutje të ndryshme, që mund të bëhen në këto kohëra.

Pasi që të ngritet dielli sa një shtizë, agjërueseja i fal dy rekate, ose sa të dëshiron, e pastaj mund të pushon ose të fle.

Kur të bjer në gjumë mos të harrojë të bëjë dhikrin e gjumit, siç është leximi i ajetul-Kursisë, suren el-ihlas, el-felek dhe en-nas, pastaj të frynë në duar dhe me ato duar të fërkon tërë trupin, sepse kështu ka vepruar Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Të thotë lutjen:

“Me emrin tënd ngjalle dhe vdes”.

Lutjen:

“Allahun e falënderoj që më dha ushqim dhe pije, më mjaftoi dhe më dha strehim, se sa njerëz ka që kanë gjëra të mjaftueshme e as strehim”. E shumë lutje tjera që mund të thuhën në këso raste.

Kujdesu që këto lutje tua mëson edhe fëmijëve tu, që kur të bien në gjumi, ti thuan këto lutje, sepse kjo është edukim i tyre dhe thirrje në fenë e Zotit. Pastaj kujdesin e Zotit mbi ta dhe i ruan nga shejtani.

Tre: Namazi i drekës

Motër e nderuar.

Nëse nuk ke obligime të shkollës ose punës, zgjohu më herët, që të kesh mundësi të falish namazin duha, sepse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, shumë sahabë i ka porositur që të kujdesen për këtë namaz.

Kur të thërret ezani i drekës, dëgjoje ezanin dhe përsërite atë që e thot muezini, e pastaj bëre lutjen që e përmendëm në namazin e sabahut.

Fale namazin e sunnetin e drekës, katër rekate, pastaj fale farzin e drekës dhe pas tyre fali edhe dy rekate, ose nëse dëshiron katër rekate, kjo është edhe më mirë. Mos harro dhikret pas namazeve dhe të lexosh Kuran sa ke mundësi.

Shtëpitë e agjërueseve

Ramazani është muaji i Kuranit, Allahu, subhanehu ve te'ala, në këtë muaj e ka zbritur Kuranin.

“Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)...”. (El-Bekare: 185).



E ka urdhëruar muslimanin ta lexoje atë dhe e ka stimuluar që shtëpisë t'ia bëjë një hise nga leximi i Kuranit.

Agjërueseja duhet të caktoj një hise të përditshme nga Kurani, të cilën do ta lexoj gjatë ditës ose gjatë natës dhe në kohën e lirë që së paku ta përfundon leximin e tërë Kuranit, ashtu siç ka urdhëruar Pejgamberi, sal-Allahuejzi ve sel-lem, Abdullah ibn Amr ibn Asin. E nëse e lexon për gjysmë muaj, ose për një javë ose për tre ditë, kjo është edhe më mirë. Abdullah ibn Amri dhe temim Dariu, e përfundonin leximin e Kurant për tre ditë.

Pejgamberi, sal-Allahuejzi ve sel-lem, na ka sqaruar se shtëpia në të cilën lexohet Kurani, nuk i afrohet shejtani. Leximi i Kuranit ndikon në fëmijët dhe të vegjlit, kur dëgjojnë ajete të Kuranit duke u lexuar. Leximi i Kuranit është shkak i zbritjes së mëshirës së Allahut mbi ju.

Pejgamberi, sal-Allahuejzi ve sel-lem, thotë:

“Shtëpia në të cilën lexohet sureja el-Bekare, nuk hyn shejtani”. (Muslimi).

Në këtë kohë kemi dhunti të mëdha, kemi audio incizime me lexues të ndryshëm të Kuranit, ligjërata të ndryshme, andaj muslimaneja mund të dëgjon kur të dëshiron ajetet e Kuranit dhe çdo të mirë, kur do që dëshiron.

Andaj ato motra që s'mund të lexojnë Kuran nga Mus'hafi, mund ta kompensojnë duke i dëgjuar këto incizime të dobishme, e të fitosh shpërblime duke i dëgjuar. Me këto mjete shtëpia duhet të mbushet me lexim të Kuranit, në vend se të dëgjohet muzikë.

Shtëpitë e sahabeve ishin përplot me dhikr dhe lexim të Kuranit, së paku të kujdesemi që të jemi si ata.

Katër: Namazi i iqindisë

Kur të thërret ezani i iqindisë, të themi ashtu si thotë muezini, e në fund ta bëjmë lutjen siç treguam më herët. T'i falim katër rekate sunnete të iqindisë, sepse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Allahu e mëshiroftë njeriun që fal pra iqindisë katër rekate”. (hasen, Ebu Davudi).

Pastaj fal farzin dhe mos harro pas farzit dhikrin e namazit.

Pas kësaj nisë aktivitet e përgatitjes së ushqimit të iftarit, duke mos e tepruar me gjëra dhe duke mos harxhuar ma shumë se sa duhet.

Gjatë përgatitjes së ushqimit mos harro të kesh nijet se këtë je duke e bërë për të fituar shpërblimin e Allahu, sepse me këtë vepër je duke i shërbyer agjëruesve. Fiton shpërblim të madh me këtë vepër. gjatë kryerjes së këtyre punëve mund të dëgjosh edhe ndonjë ligjëratë të dobishme, ose lexim të Kuranit.

Pesë: Gëzimi i agjërueses

Para akshamit, agjëruesja e pret ezanin. Tërë ditën është larguar nga ushqimi dhe pija, duke iu përgjigjur kërkesës së Zotit të vet. Andaj këtë kohë shfrytëzoje duke bërë lutje, sepse është kohë kur lutja pranohet, siç është treguar në hadithe të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Kur të thërret ezani është e pëlqyeshme nxitimi me iftar, sepse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Edhe më tej njerëzit janë në të mirë, përderisa e nxitojnë iftarin dhe vonojnë syfyryn”. (Buhariu dhe Muslimi).

Mos harro bismilahun në fillim të ushqimit, fillo iftarin me hurmë, e nëse s'ke hurmë, atëherë me ujë, ose me atë që e ke të pranishëm. Pastaj përsërit ezani dhe lutu me lutjen e duhur pas ezanit.

Vërejtje:

Vërehet se shumë shtëpi para iftarit vendojnë sofrë të mëdha dhe me llojloj ushqimesh, kjo shkakton vonimin e namazit të akshamit, mos faljen e namazit të akshamit me xhemat, apo mosfaljen e akshamit tërësisht. Kjo nuk lejohet jashtë Ramazanit e mos të flasim për në Ramazan.

Motër e nderuar ndihmoji familjes tënde në adhurime ndaj Allahut, ofroju ushqim, i cili ua largon urinë, kurse punët tjera bëni pasi ta falësh namazin e akshamit, sepse lënia e namazit është mëkat shumë i madh dhe rrezik për besimin tënd.

Të përkujtoj që mos të harrosh dhikrin pas iftarit:

“Shkoi etja, u lagën venët dhe mbeti shpërblimi, inshaAllah”. (hasen, Ebu Davudi).

“Allahun e falënderojmë që na ka ushqyer dhe na ka dhënë pije, e na ka bërë musliman”.

Ali ibn Husjeni, radijAllahu anhu, thotë:

“Na i mësonin betejat dhe ndodhitë ashtu sikurse na i mësonin suret e Kuranit”.

Kur të thërret namazi i jacisë, dëgjo ezanin dhe përsërite atë që e thotë muezini, pastaj fale namazin e jacisë dhe sunnetet pas tij.

Gjashtë: namazi i teravisë

Prej gjërave me të cilat dallohet Ramazani është edhe namazi i teravisë. Për vlerën e këtij namazi ka shumë hadithe. Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Kush e fal namazin e teravisë me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bë më herët”. (Buhariu dhe Muslimi).

Duke besuar në Allahun, premtimit të Allahut për shpërblim për ata që e bëjnë këtë vepër. Duke shpresuar, domethënë duke kërkuar shpërblimin e Allahut, duke treguar se këtë vepër nuk e ka bërë për syfaqe ose për ndonjë qëllim tjetër.

Është sunnet që gruaja ta fal namazin e teravisë në shtëpi dhe kjo është më mirë. Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Mos i ndaloni robëreshat e Allahut nga xhamitë, edhe pse shtëpitë e tyre janë më të mira për to”.

Falen njëmbëdhjetë rekate. Jepet selam në çdo dy rekate. Është sunnet që sa ma gjatë të lexohet Kuran në këtë namaz.

Gruas i takon ta fal namazin edhe në xhami, mirëpo nëse del për ta fal namazin në xhami duhet pasur kujdes që të falet pas imamit, i cili kur lexon Kuran ndikohet nga leximi që të ndikojë edhe te xhemati. Allahu, subhanehu ve teala thotë:

“... të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre”. (El-Enfal: 2).

“...kur u lexoheshin atyre ajetet e Zotit, binin në sexhde dhe qanin”. (Merjem: 58).

Nuk largohet nga namazi derisa ta përfundon imami namazin, se kështu i shkruhet shpërblim sikur të ketë falur namaz tërë natës. E kur imami të jep selam nga vitri, duhet të thotë:

Subhane Melikil-Kuddus

(I Madhëruar qoftë Sunduesi i Pastër (nga çdo e metë). Këtë e thotë tri herë, kurse herën e tretë e thotë me zë dhe këtë duke e zgatur zërin. Pastaj thotë:

[Rabbil-Melaiketi ver-Ruh].

(Zoti i Melaikëve dhe i Xhibrilit). (sahih, Nesaiu).

Gruaja kur të del në namaz me xhemat, mos të parfumohet, mos të lakuriqësohet, sepse kjo shkakton pasoja të mëdha negative.

Shtatë: Pas teravisë deri në syfyr

Shumë agjërues dhe agjëruese rrinë të zgjuar tërë natën. Dikush në vepra të lejuara e dikush në haram. Kjo shkakton që ta kalojnë pjesën më të madhe të ditës në gjumë, e me këtë u kalojnë shumë vepra të mira që mund t'i bëjnë.

Disa i kalojnë netët në mëkate dhe gabime, duke i shoqëruar ndejat e tyre me përgojim dhe bartje të fjalëve, me përbuzje dhe nënçmim të njerëzve. Ose duke ndejtur para televizionit dhe para programeve të ndryshme të padobishme ose me përmbajtje negative. Ose duke lexuar revista të pamoralshme, të cilat nuk sjellin të mira as në dynja e as në ahiret. Ose duke e harxhuar kohën në gjëra të padobishme.

Këtyre njerëzve u themi: ku jeni ju nga sjellja e muslimanëve të parë, të cilët shumicën e kohës e kalonin në adhurime, një pjesë të vogël flenin dhe pushonin, me qëllim që të forcohen për vepra të mira dhe për të bërë gara në adhurime.

Keni frikën Allahut në Ramazan, e mos e kaloni kohën në gjëra boshe dhe të padobishme, në gjëra të cilat nuk janë shkak për të fituar faljen e Allahut, subhanehu ve teala. Largohuni prej mëkateve, qofshin të vogla ose të mëdha.

Disa vepra, me të cilat mundet ta mbushë kohën gruaja në Ramazan

1- vizita e farefisit, kujdesi për farefisin, duke e shoqëruar këtë vizitë edhe këshilla dhe porosia, dhurimi i ndonjë incizimi me lexim të Kuranit, ose me ndonjë ligjëratë të dobishme, ose ndonjë broshurë ose libërth.

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Farefisnia është e lidhur për Arshi e thotë: kush kujdeset për mua, Allahu kujdeset për Të, e kush nuk kujdeset për mua, Allahu nuk kujdeset për Të”. (Buhariu dhe Muslimi).

“Kush dëshiron t'i zgjerohet rizku dhe t'i zgjatet ymri, le të kujdeset për farefisin”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Vizita e fqinjëve, jo për ta humbur kohën, por për të zbatuar hadithin e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

“Aq shumë më porositi Xhibrili për fqinjin, saqë mendova se do të më trashëgon”. (Buhariu).

Edhe kjo vizitë të shoqërohet me këshillë, porosi dhe dhuratë.

3- Tentimi për të mësuar përmendsh nga Kurani, për të qenë më i miri i këtij ummeti.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Më i miri prej jush është ai që mëson Kuran dhe ua meson të tjerëve”. (Buhariu).

Ose duke mësuar disa hadithe të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, përmendsh.

4- Bashkëpunim me motrat për të caktuar ders mes tyre, të cilin do ta mbajnë në netët e Ramazanit, që t’i mbulojnë melaqet, t’i kaplon mëshira dhe të zbret mbi ta qetësia, e t’i përmend Allahu te ata që gjinden tek Ai.

5- Prania në derse dhe ligjërata të cilat mbahen në xhamia, nëse ka mundësi, për ta shtuar diturinë, sepse ata janë njerëzit, kush ulet me ta, nuk vuan.

6- Dëgjimi i incizimeve, tentimi për tu bërë rezyme dhe për të përfituar nga to.

7- Caktimi i një programit për të lexuar disa libra të dobishme, hulumtimi i disa çështjeve shkencore, edhe pse më mirë është të angazhon kohën me lexim të Kuranit.

8- Nëse është e aftë në mësim leximin e Kuranit, preferohet të nis ndonjë grup për tua mësuar leximin e Kuranit. Anëtarëve të shtëpisë ose fqinjëve.

9- Ndeja me fëmijët ose me vëllezërit dhe motrat për t’i edukuar në dashuri ndaj Allahut, subhanchu ve teala dhe Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem,

dashurisë ndaj veprave të mira, edukatës dhe moralit, ose për tua mësuar disa lutje, dhikre, tregime islame, etj.

Shumë motra mendojnë se edukimi i fëmijëve ndodh duke u përgatitur ushqime dhe duke ua pastruar rrobat, e harojnë edukimin e zemrës dhe shpirtit, e kjo pa dyshim se është injorim i edukatës së vërtetë.

Dr. Omer Suud El-Id

## Ramazani sfidon globalizmin dhe post-modernizmin

Edhe ky Ramazan i erdhi Ummetit islam, kurse muslimanët edhe më tej shkojnë mbrapa, përçahen, si rezultat i ndodhive të mëdha në botë.

Nën hijen e kësaj gjendje mendova rreth këtij Ramazani dhe pash disa domethënie të reja, të cilat nuk më kishin ra ndërmend më herët. Pash në këtë muaj një dedikim të ri, i cili sfidon, nga i cili mund të nxjerrim konfirmim të ri për Njëshmërinë e Krijuesit, zbatimin e vendimit të Tij mbi mbarë botën të cilën e ka krijuar.

Dedikimi sfidues nuk është i përkufizuar vetëm në Ramazan, madje ai që mediton mund ta vëren në çdo adhurim, edhe pse në Ramazan është më i qartë.

Nëse mendojmë rreth Haxhit, psh, do të shohim manifestimin e nënshtrimit, vëllazërisë, bashkëpunimit, për hir të Allahut, duke sfiduar globalizmin, i cili thërret në individualizëm dhe refuzim të tjetrit. Mirëpo këtë bashkëpunim nuk e prekim te të gjithë muslimanët, sepse ky adhurim nuk është obligim për të gjithë, por vetëm për ata që kanë mundësi.

Kurse adhurimi i agjërimit gjatë Ramazanit dallohet me llojlojshmërinë e adhurimeve dhe gjithëpërfshirësin e tyre. Kjo llojlojshmëri shihet me agjërimin e ditës, namazin e natës, sadakanë, bashkëpunimin, etj., gjëra për të cilat do të flasim më vonë, inshaAllah. Kurse gjithëpërfshirësia shpalolet në mundësinë e këtij muaji për të unifikuar muslimanët e mbarë botës, në ripërtëritjen e lojalitetit të tyre, madje edhe të mëkatarëve, ndaj Allahut [subhanehu ve teala], duke vërtetuar me këtë se Islami është fe botërore, të cilës nuk mund t'i bëjë konkurrencë asnjë besim dhe ide njerëzore, pa marrë parasysh gradën e lartë dhe përparimin, të cilin e ka arritur.

Nga kjo që thash më erdhën idetë për formën se si Ramazani sfidon globalizmin.

- Në Ramazan konfirmohet pushteti i Zotit [subhanehu ve teala] mbi njerëzit. Muslimani në këtë muaj e ripërtërinë përkatësinë e kësaj feje, lojalitetin ndaj



Allahut, i cili është Një dhe i Gjithfuqishëm, i cili Vendors me urdhrat e Tija, i cili i ka përcaktuar të gjitha ligjet e dynjasë dhe të ahiretit, të cilat janë të mbështetura në dy rregulla: respekt dhe adhurim.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as s'dëshiroj të më ushqejnë ata”. (Edh-Dharijat: 56- 57).

Të cilat mbështeten në lirinë e zgjedhjes, element që nuk e privon njeriun nga e drejta për tu kënaqur në jetën e kësaj bote, duke marrë për sipër pasojat e kësaj zgjedhjeje, qoft shpërblimi ose denimi.

Ky rregull është marrë nga ajeti Kuranor:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. ...”. (El-Bekare: 256).

Kjo gjë është në kundërshtim të plotë me pushtetin e globalizmit, i cili ia imponon pushtetin e tij njeriut me fuqi dhe dhunë. Ia imponon nënshtrimin para ligjeve njerëzore, të cilat nuk i garantojnë as minimumin e jetës me nderë, në një anë dhe u ndihmon tjerëve që të pushtojnë burimet njerëzore dhe materiale, nga ana tjetër. E tërë kjo nuk paguhet me asgjë, përveç se me shtim të nënshtrimit, mposhtjes dhe privimit.

- Ramazani paraqet sfidë e madhe për globalizmin ideologjik, i cili përhap ide të çuditshme, siç është ideja e kënaqjes me epsheve materiale dhe trupore pa asnjë rregull dhe përgjegjësi, duke pretenduar se lirimi i epsheve ndihmon në arritjen e njeriut në lirinë dhe lumturinë e tij. Kurse agjërimi vërteton se lumturia dhe liria e vërtetë nuk bëhet me kënaqësi me epshe, por duke u ngritur prej tyre. Të vërtetën e thot Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur thotë:

“Njeriu nuk mbush enë më të keqe se barku i tij. I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata që ta mban shpirtin gjallë, e nëse e ka patjetër (të ha më shumë), atëherë

(le ta le) një të tretën për ushqim, një të tretën për pije dhe një të tretën për frymëmarrje”. (sahih, Tirmidhiu).

Kemi edhe disa fjalë të dijetarëve nga e kaluara dhe e tashmja që potencojnë se lumturia nuk është në kënaqjen me epshe, por në rregullimin dhe vendosjen e tyre në vendin e duhur, me ç’rast nuk largohet humanizmi njerëzor nga njeriu.

Një dijetar thotë:

“Tërë lumturia qëndron në mundësinë që njeriu ta posedon epshin e tij, kurse fatkeqësi është kur epshi e sundon njeriun”.

Argumenti më i madh bashkëkohor për faktin se nuk ekziston asnjë lidhje mes materies dhe lumturisë është kjo që tregon një shkencëtar perëndimor, Robert Rajti, studiues në Universitetin Pensilvani, i cili tregon se s’ka lidhje mes pasurisë dhe komoditetit material dhe lumturisë, sepse është vërtetuar se shtetet e varfra janë më të lumtura se shtetet e pasura, të cilët gëzojnë çdo komoditet material.

- Ramazani sfidon edhe globalizmin ekonomik, i cili vepron për të imponuar sistem unitar, i cili si parim ka individualizmin dhe refuzimin e tjetrit dhe fundosja e tij në borxhe dhe tatime, të cilat ia shtojnë varësinë dhe varfërinë, në kohë kur ajo e shton shfrytëzimin dhe pasurimin e vet. Kjo që thamë, përputhet me idenë themelore të kapitalizmit që thotë se ai që nuk mund të fiton kafshatën e vet, le të vdes!!

Ka zëra në perëndim që thërrasin se një miliard të varfër në botën e tretë, siç i emërtojnë shtetet me ekonomi të dobët, janë teprice, andaj duhet liruar prej tyre, sepse vetëm më i fuqishmi duhet të mbetet.

Ka ardhur agjërimi në këtë muaj që të degradoj këtë teori dhe të konfirmoj të drejtën e të varfrit në pasurinë e të pasurit, qoftë nëpërmjet sadakasë ose zekatit.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp)”. (Edh-Dharijat: 19).

“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t'i pastrosht me të dhe t'u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon e sheh”. (Et-Teube: 103).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e sqaron këtë përgjegjësi e cila bjer mbi supet e besimtarit, duke e udhëzuar besimtarin që të jep sadaka vëllait të vet atë që i tepron nga pasuria. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Kush ka tepricë të shalëve, le ti jep atij që s' ka shalë, kush ka tepricë të nozullit, le t'i jep atij që s' ka nozull”. (Muslimi).

Nëse ky është gjykimi i përgjithshëm për çdo kohë, atëherë edhe më tepër potencohet në Ramazan, pasi që shtohen hadithet që stimulojnë dhënien iftar agjëruesit, dhënien sadaka të varfërve.

Aisheja [radijAllahu anha] thotë:

“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte shumë bujar, edhe më bujar ishte në Ramazan. Kur i vinte xhibrili [alejhis-selam] e mësonin bashkë Kurandin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte më bujar se era që sjell bereqetin”. (Buhariu).

Kjo është në aspektin e sadakasë dhe ushqimit të varfërve, kurse sa i përket zekatit, duke e dhënë zekatin shumica e muslimanëve në këtë kohë, kontribuojnë për ta larguar barrën nga i varfëri dhe i mbeturi në rrugë, kontribuojnë në ndërtimin dhe aktivizimin e shumë pjesëve të domosdoshme të infrastrukturës, për të ngritur jetën e muslimanit dhe për ta bërë që të ndien humanizmin.

- Ramazani është sfidë për globalizmin shoqëror, që synon izolimin e njeriut nga familja dhe shoqëria e tij. Në Ramazan grumbullimi i familjes në ushqim e bashkon familjen e ndarë përsëri. Manifeston kapjen e muslimanit për sistemin e

tij shoqëror, i cili mbështet mbi dashurinë reciproke të anëtarëve të familjes dhe veprimet për të arritur kënaqësinë e Zotit, i cili ua ka caktuar qëllimet në jetë.

Nëse e marrim gruan që është shtylla e shtëpisë së muslimanit, ajo në Ramazan e sfidon globalizmin, i cili ia imponon principet e veta, duke e thirrur që të ik nga sistemi klasik i familjes, i cili mbështetet në përgjegjësin e burrit dhe respektin e saj ndaj burrit, e shumë nocione tjera, me të cilat dëshiron ta rrënon familjen. Gruaja në këtë muaj, sado që është e zënë, vepron për të siguruar kafshatë të këndshme për familjen e saj, duke mos u brengosur për ate se ka disa njerëz që punën e saj në shtëpi e konsiderojnë si nënçmim të pozitës së saj.

Nëse e marrim burrin dhe të zotën e shtëpisë, ai në takimet ditore me familjen e tij, lërja e punës dhe vrapimin pas kafshatës së gojës, potencon edhe më shumë principin e mëshirës dhe dashurisë, mbi të cilat bazohet familja muslimane. Ky takim ditor gjatë tërë muajit reflekton rehati dhe qetësi për anëtarët e familjes, e sidomos fëmijëve, të cilët vuajnë nga takimet e rralla të kësaj natyre gjatë tërë vitit. Sa bukur e tregon këtë poeti kur thotë:

*Nuk është jetim, ai që prindërit e tij janë rehatuar nga brenga e jetës dhe e kanë lënë të  
vetmuar*

*por jetim është ai që ka nënë, e cila e ka lënë pas dore ose babë të angazhuar*

Kjo reflektohet edhe në raportet shoqërore mes anëtarëve të familjes, gjatë vizitave të tyre reciproke përplot dashuri gjatë Ramazanit, për të vërtetuar, rëndësinë e kapjes së muslimanëve njëri për tjetrin, gjë të cilën e potencon Islami. Kjo del në shesh në sjelljet e llojllojshme të muslimanit, e prej tyre janë:

1- Mbushja e xhamive përplot me musliman nga gjeneratat e ndryshme. Kjo tregon barazinë mes muslimanëve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Njerëzit janë të barabartë, sikurse fijet e krehërit, s’ka dallim mes arabit dhe joarabit, përveç se në devotshmëri”.

Pastaj në hadithin tjetër tregon vlerën e xhematit duke thënë:

“Nëse gjinden tre persona në një fshat ose vend, e nuk e falin namazin (me xhemat) i kaplon shejtani nga çdo anë. Kapuni për xhematin, sepse ujku e ha delen e ndarë”. (sahih, Ebu Davudi).

2- Muslimani ik nga maltretimi i vëllait të vet musliman, qoftë edhe me fjalë. Këtë ndalesë e ka treguar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë:

“Nëse dikush prej jush është agjërueshëm, mos të flet fjalë imorale dhe mos të sillet si injorant, e nëse dikush të lufton ose ofendon, thuaji: unë jam agjërueshëm”. (Muslimi).

3- Muslimani nxiton të fus gëzimin në zemrën e muslimanëve, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme humanitare, duke i dhënë ushqim musafir, ose duke u dhënë lëmsh të varfërve. Tërë këtë e bën duke shprehur shpërblimin e dynjasë dhe të ahiretit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Kush i jep iftar agjëruesit, ka sa shpërblimi i tij, duke mos iu pakësuar aspak shpërblimi agjëruesit”. (sahih, Tirmidhiu).

Sejid Kutbi duke sqaruar gëzimin e njeriut dhe lumturinë kur u jep tjerëve thotë:

“Nga përvoja kam kuptuar se asgjë në këtë botë nuk vlen sa gëzimi shpirtëror të cilin e gjejmë kur kemi mundësi të ngushëllojmë ose gëzojmë të tjerët”.

Këtë gëzim me dhënie e kanë konfirmuar edhe shkencëtarët e perëndimit, mirëpo dallim i madh mes nesh dhe atyre, sepse ata këtë dhënie e kufizojnë me disa dollar të pakët, për të lehtësuar kompleksin e mëkatit, të cilin mund ta ndien kundrejt të varfërve, andaj Robert Rajti thotë: “Nëse vëren se nuk ke mundësi të flesh nga mërzia se u është mbyllur fabrika disa punëtorëve në Srilankë, e kanë mbetur pa punë, nga shkak i ngadalësimit që ka ndodhur me globalizmin, ka mënyra të cilat nëse i përdor do t’ia lehtësosh mërzitë vetvetes. Prej këtyre mënyrave është edhe

dhënia lëmosh pak para shoqatave humanitare, të cilat ndajnë ushqim shtresave më të varfra në botë”.

Dr. Nuha Katruxhi

## Muslimanët e parë gjatë muajit të ramazanit

Ja disa vepra të mira, të cilat duhet të veprohen edhe më tepër në Ramazan:

### 1) Namazi i natës:

Allahu [subhanehu ve teala]thotë:

“E robërit e Mëshiruesit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: Paqe!” dhe për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen)” (Furkan, 63-64)

Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Ai që falet natën gjatë ramazanit me besim në Allahun dhe shpreson në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e mëparshme” (Buhari dhe Muslim)

Falja e namazit të natës ka qenë praktika e Pejgamberit dhe as’habëve të tij. Aisha [radijAllahu anha] thotë: “Mos e le namazin e natës, nga se Pejgamberi nuk e linte, e kur sëmurej ose ishte i lodhur falej ulur.”

Kurse Omeri [radijAllahu anhu] falej deri në gjysmë të natës sa donte, e në gjysmë tjetër të natës zgjonte familjen e tij për tu falë duke u thënë: “Namazi, namazi”

Transmeton Said ibën Zejdi, i cili thotë: “Imami lexonte me qindra ajete, derisa mbështeteshim në shkopinj, nga të ndejturit në këmbë dhe nuk ndaheshim (nuk kryhej namazi) deri para agjërimit”.

### 2) Sadakaja

Pejgamberi ishte njeriu më bujar, kurse edhe më bujar ishte gjatë Ramazanit. Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] thotë: Sadakaja më e mirë është sadakaja që jepet në Ramazan”. (Hadithi është sahih, Transmeton Tirmidhiu) Omeri [radijAllahu anhu] thotë: “Pejgamberi na urdhëroi që të japim sadaka. Meqë unë posedoja pasuri, thashë: “Sot do t’ia kalojë Ebu Bekrit”. Andaj erdha në gjysmën e pasurisë. Kurse Pejgamberi më tha: “Çka i le familjes?” Unë i thashë:

Sa kjo që dhashë”. Në këtë rast erdhi Ebu Bekri me gjithë pasurinë, e Pejgamberi i tha: “Çka i le familjes” Tha: “Ua lash Allahun dhe Pejgamberin., Thashë (Omeri): “Nuk munda të të kalojë në asnjë send”.

Vëlla i dashur, sadakaja gjatë ramazanit ka veçori të shumta, prandaj mundohu që të shfrytëzosh çdo rast për të dhënë sadaka.

Sadakaja është shumë-llojesh:

Dhënia ushqim: Allahu [subhanehu ve teala]thotë:

“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojnë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe e dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu ata me Xhennet dhe me petka mëndafshi” (Insan, 8-12).

Selefu salih i jepnin rëndësi të madhe dhënies ushqim qoftë të varfërve ose vëllait të uritur, pra nuk është kusht që t’i jepet ushqim vetëm tek të varfrit. Disa prej selefrit thonë: Që të thërrasë dhjetë shokë të mijë dhe t’u ofroj ushqim të cilin e dëshiroj, është më e dashur tek unë se të lëshojë (lirojë) dhjetë robër. Shumë prej selefrit ia jepnin iftarin e tyre tjetrit edhe pse ishin vet agjërues. Gjithashtu ka pasur të tillë që u kanë ofruar ushqimin vëllezërve të tyre dhe u kanë shërbyer, sikurse ai ka qenë agjërues. Nga ky adhurim burojnë shumë adhurime, siç është dashuria ndërmjet vëllezërve, e cila është për shkak të hyrjes në Xhennet, siç thotë Pejgamberi: “Nuk do të hyni në Xhennet derisa të besoni, e nuk do të besoni derisa të duheni mes veti”. Gjithashtu, bëhen tubime të njerëzve të mirë dhe shpreson në shpërblim për atë që u ndihmon me ushqim tënd që të forcohen për adhurime etj.



T'u japësh iftar agjëruesve:

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Ai që i ofron iftar agjëruesit, ka shpërblim sikur shpërblimi i agjëruesit duke mos u pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit.” (Hadithi është sahih, transmeton Nesaiu).

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “ Ai që i ofron iftar agjëruesit ose përgatit një luftëtar, ka shpërblim sikur shpërblimi i tyre”. (Shikoni “Sahihut-terhib”, nr.2701.

### **3) Leximi i Ku'ranit**

Vëlla i nderuar po t'i përmendi dy vepra të të parëve tanë:

a) Leximi i shumtë i Kuranit, dhe

b) Qajtja gjatë leximit ose ndëgjimit të Kuranit nga frikërespekti.

Muaji i ramazanit është muaji i Kuranit, për këtë shkak, muslimani duhet të lexon më tepër Kuran.

Xhibrili alejhis-salam ia mësonte Kuranin Pejgamberit s.a.v.s. në Ramazan. Disa prej selefit bënin hatme gjatë muajit të Ramazanit për çdo tre ditë e disa tjerë për çdo shtatë ditë, e disa tjerë për çdo ditë lexonin Kuran në namaz dhe atë në vende të ndryshme. Shafiu [rahimehull-llah] bënte 60 hatme gjatë Ramazanit, të cilët i lexonte jashtë namazit, kurse Zuhriu [rahimehull-llah] kur vinte Ramazani ikte prej tubimeve të hadithit dhe diturisë dhe lexonte Kuran prej Mus'hafit. Sufjan Theuriu [rahimehull-llah] kur vinte Ramazani i linte të gjitha adhurimet (nafile) dhe lexonte Kuran. Ibën Rexhepi thotë: Ndalohet leximi i Kuranit në më pak se tre ditë për atë që vazhdon këtë vepër, kurse sa i takon kohëve të bekuara siç është muaji i Ramazanit, sidomos netët kur kërkohet nata e Kadrit, ose në vende të vlefshme siç është Mekeja për ata që nuk janë të Mekës është mustehab leximi i shumtë i Kuranit duke shfrytëzuar këtë kohë dhe vend të vlefshëm.

\*Qajtja gjatë leximit të Kuranit. Selef u salih i nuk kanë lexuar Kuranin siç lexohet poezia, pa mendim dhe kuptim, por ato lëviznin edhe zemrat e tyre gjatë leximit të Kuranit. Transmeton Buhariu nga Abdullah Ibën Mes'udi [radijAllahu anhu] i cili thotë: Pejgamberi më tha: "Lexo". Unë i thashë: "Të lexoj para teje, duke e ditur se Kurani mbi ty ka zbritur". Ai tha: "Kam dëshirë ta dëgjoj prej tjerëve. (Abdulla Ibën Mes'udi) tha: "Lexova suren Nisa deri sa erdha tek ajeti:

"Dhe si do të jetë gjendja e atyre, kur Ne do të sjellim dëshmitar për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitar mbi ta", (Nisa: 41) kur ai më tha: "Të mjafton". U ktheva kah ai dhe pashë se i lotonin sytë.

Transmeton Ebu Hurejra [radijAllahu anhu] i cili thotë: "Kur zbriti ajeti: "A prej këtij ligjërimi po çuditeni? E po qeshni e nuk po qani?" (Nexhm: 59-60), qajten Ehli Sufeja, derisa u derdhën lotët mbi qafën e tyre. Kur dëgjoji Pejgamberi qajtjen e tyre, qajti edhe ai, e ne qajtem bashkë me të. Në këtë rast Pejgamberi tha: "Nuk do të hyn në zjarr të Xhehennemit ai që qanë nga frikë-respekti ndaj Allahut".

Ibën Omeri [radijAllahu anhu] lexoi suren Mutaafin deri sa erdhi tek ajeti: "Në ditën kur njerëzit ngriten për të dalë para Zotit të botëve" (Mutaafin: 6), kur qajti derisa u alivanos, e nuk vazhdoi më tepër.

Transmetohet nga Muzahim Ibën Zufferi, i cili thotë: "Na e fali namazin e akshamit Sufjan Theuriu, i cili lexoi fatihanë deri sa arriti tek ajeti: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm të Ti kërkojmë ndihmë!", kur qajti derisa ndërpreu leximin e Kuranit, e pastaj përsëri e vazhdoi suren Fatiha.

Së fundi, vëlla i dashur, pas shetitjes sonë kopshteve të Xhennetit në të cilat na bëjnë hije veprat e mira, të tërheqim vërejtjen nga një vepër e rëndësishme. A e din se ç'është ajo. Ajo është ihlasi (sinqeriteti). Po, sinqeriteti, ngase sa agjërues nuk kanë nga agjërimi i tyre vetëm se etje dhe uri dhe sa prej tyre që falin namaz të natës, nuk kanë pos lodhje dhe pagjumësi? Allahu na ruajtë prej kësaj. Nga ky shkak shohim se Pejgamberi përforcon këtë çështje duke thënë: "Me besim (në Allahun) dhe shpresim (në shpërblimin e Allahut)." Selef i veprat të mira të tyre i

kanë fshehur, duke pasur frikë rijanë... Transmetohet nga Muhammed Ibën Vasiu, i cili thotë: "Kam takuar njerëz të cilët vendonin kryet me kryet e grave të tyre në një jastëk, e jastëku lagej nga lotët e tij, kurse gruaja e tij nuk e hetonte. Gjithashtu kam takuar njerëz që duke qenë në saf qanin, kurse askush nuk e hetonte se po qan! Ejub Sihtijani gjithë natën falej, e kur vinte mëngjesi ngrinte zërin, sikurse është ngritur në ato çaste. Transmetohet nga Ibën Ebi Adiu, i cili thotë: "Davud Ibën Ebi Hindi ka agjëruar 40 vjet duke mos e ditur familja e tij ishte këpuctar, andaj çdo ditë merrte me veti ushqim të cilin e jepte sadaka rrugës, kurse kur kthehej në mbrëmje hante me to." Sufjan Theuriu thotë: "Më kanë treguar se një rob vepron një vepër të mirë fshehurazi, e shejtani pa ndërprerë mundohet që ai të tregon këtë vepër, e pastaj pasi që ai të tregon këtë vepër, shejtani mundohet që ai të kërkon të falënderohet për këtë vepër, me ç' rast hyn në rija, syefaqësi.

## **Agjërimi i Ramazanit, simboli që i mbijetoi komunizmit dhe modernizmit, duhet të kalojë nga adeti në adhurim me qëllim, me efekte jetëgjata**

Ndër muslimanët në trevat tona një traditë islame i ka mbijetuar të gjitha betejat e regjimit komunist. Është agjërimi ai që gjithnjë mbeti simbol i islamit të një njeriu a familjeje. Njerëzit edhe gjatë atyre viteve, sidoqoftë, e kanë veçuar dhe madhëruar muajin e Ramazanit. Kanë agjëruar, kanë siguruar hurma për iftarë, kanë shkuar në xhami për të falur namazin e teravive e për ta lutur Zotin dhe i kanë mësuar fëmijët që bile gjysmën apo disa ditë të Ramazanit t'i agjërojnë. Në fund festa edhe e Bajramit. Edhe këto ditë veçoheshin me adete, ushqime, rroba e ëmbëlsira të posaçme.

Tradita në fjalë mori përmasa dukshëm më të gjëra pas rrëzimit të regjimit ateist komunist. Por, një negativitet ende vazhdon të shumica e agjëruësve. Ramazani kalon dhe me të edhe adhurimi i Zotit. Islami dobësohet tek njerëzit. Xhamitë zbrazen dhe po ata muslimanë që dje agjëronin dhe falnin teravitë ditën e Bajramit i kthehen rakisë dhe punëve tjera të ndyera. Për të tillët, islami është sezonal edhe i vlefshëm vetëm gjatë muajit të Ramazanit. Edhe më keq është kur dikush agjëron por është i njëjtë si gjatë agjërimit si jashtë tij: i ashpër, i vrazhdë, ofendues, zullumqar, mëkatar. . .

Pse ndodhë kjo? Përgjigjja është: Dikush agjëron sepse është “adet” dhe se “kështu bëjnë të tjerët”. Përderisa të mos jetë korrekt qëllimi i agjërimit kjo dukuri përherë do të vazhdojë të ekzistojë dhe nga agjërimi, do të përfitohet shumë-shumë pak krahasuar me atë që Zoti ka përgatitur për agjëruësit e sinqertë.

Mund të fyhet dikush nëse them se agjërimi i shumicës nuk është i sinqertë. Me këtë rast secili le ta pyesë veten sa mund të jetë jetëgjatë një agjërim që bëhet për adet? Sa mund të jetojë nëse muslimani del nga vendi ku është adet të agjërohet dhe vendoset në një vend ku nuk është adet agjërimi?! Sa mund të jetë jetëgjatë

një agjërime që bëhet për syfaqësi? Sa mund të jetë afatgjatë ai agjërime nëse agjëruesi i tillë fshihet nga njerëzit dhe i vije shansa për të ngrënë, pirë dhe fjetur me gruan?!

Kam për qëllim që atyre që agjërojnë për adet, për syfaqësi dhe atyre që agjërime nuk u le gjurmë në sjelljen e tyre t'ua bëjë me dije se agjërime është një ibadet shumë i çmuar tek Allahu dhe i veçuar tek Ai nga ibadetet tjera dhe se shpërblimi i tij është xhenneti. Me të, Zoti i falë mëkatet e vogla dhe na mbron nga xhehennemi. Dua t'ua bëj me dije edhe se mu për këtë kryhet agjërime, e jo për adet t'ua bëjë me dije se agjërime nuk është vetëm ndalim i barkut nga ushqimi dhe ndalim nga seksi, por ndalim nga rrena, fyerja, shpifja, ashpërsia, zullumi etj. Ndoshta dikush mund do të përfitojë nga kjo dhe agjërime i tij nuk do të jetë vetëm uri, etje, nervozë, hipokrizi e rrenë. . .

“Veprat shpërblehen sipas nijetit (qëllimit) të tyre.” Kështu kush agjëron për adet, shoqëria (rrethi) do ta shpërblejë si njeri të denjë të traditës së vendit, kush agjëron për syfaqe, njerëzit do ta vlerësojnë si musliman të mirë, por e te Zoti nuk ka asgjë, kush agjëron për t'u shëruar nga sëmundja, për të qenë më i shëndoshë apo për të mbajtur dietë, këto do t'i arrijë, por te Zoti nuk ka asgjë, dhe kush agjëron për Allahun, në shenjë respekti për Të, për t'iu afruar Atij, për t'u shpërblyer me xhennetin e Tij, për t'u mbrojtur nga dënimi i Tij, për ta adhuruar dhe falënderuar Atë, ai do të gjejë shpërblim të madh te Zoti i tij.

Për ta shndërruar urinë e tmerrshme, etjen kallëse dhe hipokrizinë në lumturi, kënaqësi, adhurim e dëlirësi, le të ndjekim udhëzimin e të Dërguarit të fundit të Zotit, Muhammedit, paqja e Allahut qoftë mbi të. Ai është shembulli më i mirë se si bëhet agjërime. Tregon Aishja, gruaja e Pejgamberit se, Pejgamberi ishte njeriu më i mëshirshëm, e edhe më i mëshirshëm ishte gjatë muajit Ramazan, kur Xhibrili çdo natë ka ardhur tek ai dhe ia ka mësuar Kurandin. Kështu ndikon në sjellje dhe në shpirt agjërime i sinqertë që bëhet për Zotin,. Njeriu me agjërime mësohet t'i frenojë epshet e tij dhe e ushtron vetëkontrollin.

## Ramazani mes realitetit dhe obligimit

Ramazani është sezon e mirësive të cilat Allahu ua ka dhuruar robërve të Vet që tua forcon besimin, tua shton devotshmërinë dhe tua përforcon kontaktin e tyre me Allahun, subhanehu ve teala.

Ai që analizon me vëmendje argumentet fetare që flasin mbi agjërimin dhe mbi urtësitë dhe synimet e agjërimin dhe realitetin e muslimanëve do të shoh dallimin shumë të madh mes këtyre gjërave te shumica e muslimanëve.

Do të mundohem me leje të Allahut, azze ve xhel-le, që t'i prek shkaqet më të dalluara që kanë shkaktuar këtë diskrepancë dhe mënyrën për shërimin e kësaj gjendje.

### NJË: SHKAQET.

Ka shumë shkaqe që kanë shkaktuar këtë gjendje, mirëpo ne do t'ji përmendim më të dalluarat:

1- Mos njohja e objektivave dhe urtësive të agjërimin.

Injoranca dhe mosnjohja e objektivave dhe urtësive të agjërimin që ka në sherijatin islam dhe zbatimi i këtij adhurimi te shumica e muslimanëve si traditë dhe për hatër të shoqërisë, duke mos analizuar dhe studiuar këtë adhurim është prej shkaqeve më të rëndësishme që e shkaktojnë këtë diskrepancë.

Shejh Abdurahman Duseriu thotë:

"Nëse njerëzimi nuk e ka perceptuar urtësinë e ligjeve islame dhe frytet e tyre në dynja para se të shkojmë në ahiret, ata nuk do t'i zbatojnë plotësisht ose ashtu si duhet". (Shiko: Safvetul-Athar vel-Mefahim", 3/ 82).

Këto urtësi mund t'i përmbledhim në këto gjëra:

a) Arritja e devotshmërisë.

Kjo gjë konsiderohet prej urtësive më të dukshme të agjërimit.

Raziu thotë:

"Agjërimi shkakton devotshmërinë sepse me agjërime dobësohet epshi dhe pasioni, largohet njeriu nga mendjemadhësia, mburrja dhe imoraliteti, i bëhen të pavlefshme lezetet e dynjasë dhe pozita. Kjo ndodh për shkak se agjërimi e dobëson epshin e barkut dhe organit, andaj ai që shumë agjëron i bëhen të pavlefshme këto dy epshe dhe e ka më të lehtë të luftoj kundër tyre, në këtë mënyrë agjërimi e pengon njeriun që të bëjë harame dhe vepra imorale, nuk ka ndonjë peshë të madhe pozita dhe autoriteti në dynja. Kështu përmbledhen të gjitha shkaqet e devotshmërisë...". (Shiko: "Mefatihul-Gajbi", 5/ 70).

b) Edukimi në durim dhe vullnet të çelikt.

Edukimi i njeriut në durim është prej synimeve të mëdha të agjërimit, pasi që Pejgamberi, sal-Allahuejzi ve sel-lem, e ka emërtuar muajin e agjërimit si muaj të durimit, sepse agjërimi e edukon njeriun në vullnet të çelikt për të frenuar epshin dhe egoizmin dhe që të forcohet njeriu në lënien e gjërave të zakonshme, siç është ngrënia, prija, marrëdhëniet intime, ashtu që vullneti për t'i zbatuar urdhrat e Allahut dhe bartjen e misionit të Muhammedit, sal-Allahuejzi ve sel-lem, dhe shtytja e tij përpara duke i tejkaluar të gjitha pengesat dhe vështirësitë... Agjërimi është një lloj durimi, i cili domethënë përqendrim në realizimin e adhurimeve dhe në të gjitha çështjet e jetës". (shiko: "Tefsirul-Menar", 2/45).

Njeriu gjatë agjërimit e detyron veten të duroj në adhurimet ndaj Allahut duke i respektuar kufijtë e Allahut, si urdhra dhe si ndalesa.

Allahu, subhanehu ve teala, pasi që përmendi disa dispozita mbi agjërimitin tha:

"Këto janë kufijtë (dispozitat) e Allahut, pra mos i kundërshtoni". (El-Bekare: 187).

Po edhe e frenon dhe e disiplinon për t'iu nënshtruar urdhrave të Allahut vullnetarisht dhe duke shpresuar shpërblimin e tyre.

S'ka dyshim se në këtë mënyrë edukohet njeriu në vendosmëri dhe vullnet, gjëra që e bëjnë njeriun të kontrolloj epshin dhe pasionin e tij.

c) Edukimi në dorëzim dhe nënshtrim Allahut, subhanehu ve tealà.

Agjërimi e edukon muslimanin që ta kontrolloj shpirtin e tij të lig, ta dominoj dhe ta udhëheq, duke mos iu nënshtruar atij por duke iu nënshtruar urdhrave të Zotit të vet, duke iu nënshtruar ndalesave të Tijja dhe duke i dhënë përparësi gjërave të dashura të Allahut para kërkesave të trupit dhe epshit.

d) Kultivon frikën nga Allahu dhe vetëdijen se Ai e mbikëqyrës

Agjërimi është adhurim i sinqertë mes njeriut dhe Zotit të vet, andaj e edukon muslimanin që t'i frikësohet Allahut, të jetë i vetëdijshëm se Ai e mbikëqyr dhe të synoj shpërblimin e Tij. Sepse njeriu ka mundësi të shfaqet para njerëzve agjërueshëm, kurse në realitet të mos jetë me agjërim, pa marrë parasysh formën se si e prish agjërimin, duke ngrënë ose duke munguar nijeti. Kjo gjendje e manifeston vërtetësinë e besimit, plotësinë e adhurimit, fuqinë e dashurisë ndaj Allahut dhe shpresimin e asaj që gjendet tek Allahu, pasi që shpërblimi i agjërimit tek Allahu është shpërblimi më i madh karshi të gjitha adhurimeve tjera.

Allahu, subhanehu ve tealà, në hadithin kudsì thotë:

"Çdo vepër e birit të Ademit i shumfishohet, një e mirë dhjetëfish deri në shtatëqind fish e derisa të dojë Allahu, azze ve xhel-le. Përpos agjërimit, sepse ai është për Mua dhe unë shpërblej për Të, e le epshin dhe ushqimin për mua...". (Muslimi).

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë:

Njerëzit mund të shohin lënien e gjërave të dukshme që e prishin agjërimin, kurse lërja e ushqimit, pijes dhe epshit për hir të Allahut është një gjë të cilën nuk mund



ta shohin njerëzit, kurse kjo është realiteti i agjërimit". (Shiko: "Zadul-Mead", 2/29).

E) Koncentrimi dhe përqendrimi i zemrës dhe mendjes në krijesat e Allahut

Nëse ushqimi, pija, biseda, gjumi dhe përzierja e tepruar e dekoncentrojnë njeriun dhe e ndërpresin nga udhëtimi i tij drejt Allahut, e dobësojnë, e pengojnë ose e ndalojnë, mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij ka qenë ajo që ka caktuar agjërimit që t'i largoj nga ushqimi i tepruar dhe ta pastroj zemrën nga përzierjet e ndryshme të epshit. Gjithashtu ka caktuar adhurime tjera gjatë Ramazanit, siç është itikafi, namazi i natës, lutja, leximi i Kuranit me qëllim që ta largoj njeriun nga biseda, gjumi dhe përzierja e tepruar me njerëz. Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Agjërimi është mburojë dhe fortifikatë e fuqishme kundër zjarrit". (Hasen, Ahmedi).

E ka llogaritur si fortifikatë e besimtarit për disa shkaqe:

- Sepse e dobëson epshin. Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Dredhja e umetit tim është agjërimi". (Sahih, Ahmedi).

Dhe ka thënë:

"O ju të rinjë! Kush ka mundësi që të martohet le të martohet, e ai që nuk ka mundësi të martohet le të agjëron, sepse agjërimi për Të është mburojë". (Muslimi).

- Ia ngushton shejtanit kanalet e qarkullimit duke ngushtuar kanalet e ushqimit dhe pijes.

Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Shejtani qarkullon te njeriu nëpër venët e gjakut". (Muslimi).

Në këtë mënyrë pushojnë zytjet e shejtanit.

Zemra gjatë agjërimit angazhohet vetëm me meditim rreth argumenteve të Allahut dhe krijesave të Tij, sepse teprimi në konsumimin e gjërave që na i do epshi na fusin në neglizhencë, madje na e ngurtësojnë zemrën dhe na verbërojnë nga e vërteta.

Imam Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë:

"Zbrazja e barkut nga ngrënia dhe pija e ndriçon zemrën, e bën suptile, e largon ngurtësinë dhe e paston vetëm për dhikër dhe logjikim". (Shiko: "Letaiful-Mearif", fq. 290).

F) Njerëzit i kuptojnë begatitë që i kanë dhe të pasurit e kujtojnë gjendjen e të varfërve.

Njerëzit e pasur nga shkak i abstenimit nga ushqimi dhe pija gjatë ditës së agjërimit vuajnë, e kjo gjendje shkakton që të kupton sasinë e dhuntive që ua ka dhënë Allahu kur i ka bërë të pasur, sepse ua ka dhënë këtë begati gjatë tërë vitit, në kohë kur të tjerët nuk kanë patur këtë mundësi, sdo mend se kjo ia imponon falënderimin Allahut, subhanehu ve teala.

Po edhe të varfërit shohin dobinë që sjell gjatë këtij muajit, siç është koncentrimi për logjikim, adhurim dhe dhikër për shkak të urisë dhe barkut të zbrazët dhe e kuptojnë se kjo gjendje i shoqëron ata tërë vitin përafërsisht dhe se ata janë të përgatitur që të shfrytëzojnë këto begati gjatë tërë kohës, e kjo sdo mend se duhet tua imponoj edhe këtyre falënderimin ndaj Allahut.

Agjërimi gjithashtu është shkak që të pasurit të shikojnë rreth vetes dhe ti vërejnë vëllezërit e tyre të varfër dhe kjo i thërret ata që të jenë të mshirshëm dhe të solidarizohen me ta.

G) Forcon trupin dhe i jep shëndet.

Qëllimi i agjërimit është ta forcon besimin dhe ti ofron njeriut devotshmëri, e cila e largon nga mëkatet dhe gabimet, mirëpo ka edhe qëllime dhe dobi tjera. Në mes

tyre është edhe ajo që na është qartësuar në shekullin tonë edhe më shumë: forcimi i trupit dhe ndikimi i tij në shëndetin e njeriut, duke e mbrojtur njeriun nga sëmundjet dhe defektet fizike dhe psikike.

## **2- ZBATIMI I AGJËRIMIT VETËM ME LËNIE**

Shumë njerëz mendojnë agjërimi përbëhet prej një sërë lëniesh duke harruar se Allahu, subhanehu ve teala, e ka bërë obligim agjërimin dhe me këtë adhurim ka përcaktuar edhe vepra të tjera që ndihmojnë në realizimin dhe arritjen e qëllimeve të shpresuara.

## **3- GABIMET E DISA AGJËRUESVE.**

Disa agjërues bien në gabime të ndryshme, ne do t'i përmendim disa prej tyre:

a) Harxhimet e tepruara.

Agjërimi përveç tjerash është edhe shkollë e kursimeve dhe stërvitje e vetes në durim dhe kontrollim i dëshirave dhe pasioneve, mirëpo fatkeqësisht në mesin e muslimanëve të sodit është duke ndodhur e kundërta. Në këtë muaj te ata shtohen harxhimet dhe kalohet në shkatërrim të pasurisë dhe pamaturi.

b) Ngrënia e ushqimeve dhe pijeve të ndryshme.

Është shndërruar Ramazani në sezonë të ngrënies, pijes dhe kënaqësive të ndryshme, s'do mend se kjo është në kundërshtim me synimet e agjërimin.

c) Qëndrimi zgjuar gjatë natës dhe gjumi gjatë ditës.

Gjatë Ramazanit përmbysset jeta e njerëzve, nata u bëhet ditë, kurse dita natë. Natën e kalojnë në takime, ndeja dhe biseda, kurse ditën në gjum dhe dembeli. Shtoja kësaj edhe haramet që ndodhin në ato ndeja dhe lërja e obligimeve.

d) Kapja pas dynjasë dhe mos interesimi për ahiret.

Disa njerëz me të hyrë të Ramazanit u shtohet angazhimi me tregti, me shitje dhe blerje. Disave u kalon edhe dita edhe nata në këto aktivitete. Tregtia dhe shitblerja nuk janë haram në Islam, mirëpo është e urrejtur dhe e qortuar varësia pas dynjasë dhe dhënia e tërë mundit dhe kohës kësaj veprimtarie, duke e neglizhuar hisen e ahiretit dhe nevojën për vepra të mira që e edukojnë dhe ia largojnë veset dhe gabimet.

e) Shoqërimi me njerëz të papunë dhe dembela.

Ata ua harxhojnë kohën njerëzve në gjëra që nuk u sjellin asnjë të mirë as në dynja dhe as në ahiret, ndoshta edhe nuk u bën ndonjë prishje dhe devijim në fe, mirëpo u sjell pendim dhe keqardhje për harxhimin e kohës në gjëra të kota dhe të pavlera.

f) Gabimet në disa adhurime.

Njerëzit zakonisht në këtë kohë kujdesen për disa adhurime, mirëpo forma se si i bëjnë ato adhurime është e gabuar.

- Vonimi i namazit.

- Kujdesi i njerëzve për rekatet e namazit të teravisë e jo për mënyren se si duhet të falet ky namaz.

- Njerëzit kujdesen që në këtë muaj ta bëjnë një herë apo më shumë hatme Kuranin, mirëpo nuk meditojnë dhe analizojnë ajetet që i lexojnë.

Leximi i shpejtë dhe i pavëmendshëm i Kuranit është në kundërshtim me qëllimin e leximit të Kuranit.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend". (Sad: 29).

Është e vërtetë se disa nga selevi kanë bërë hatme shumë herë gjatë Ramazanit, saqë Imam Zuhriu, rahimehull-llah, ka thënë:

"Ky muaj është për të lexuar Kuran dhe për të dhënë ushqim".

Mirëpo udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Pejgamberit, sal-Allahuh alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë:

"Nuk kupton ai që e lexon Kuranin për më pak se tre ditë".

- Disa musliman kujdesen për Itikafin, mirëpo në formë të kundërt me qëllimin dhe synimin e itikafit. Ata shkojnë në itikaf në mënyrë kolektive dhe në vend se të vetmohen dhe të llogarisin veten, të meditojnë mbi krijesat e Allahut dhe argumentet e Tij, ata e kalojnë kohën në biseda dhe ndëja të përbashkëta nga të cilat nuk ka ndonjë dobi të madhe.

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, pasi që tregoi mënyrën si e ka bërë Pejgamberi, sal-Allahuh alejhi ve sel-lem, itikafin, tha:

"Në këtë mënyrë arrihet qëllimi i itikafit dhe shpirti i tij, në kundërshtim me atë që e bëjnë disa injorantë duke e shndërruar vendin e itikafit në vend takimi, vizite dhe futje në biseda të llojllojshme. Kjo është diçka kurse itikafi i Pejgamberit, sal-Allahuh alejhi ve sel-lem, është diçka tjetër".

- Hapen dyert e veprave të mira dhe të gjitha ato nuk mund ti kryen besimtari. Andaj kjo kërkon që njeriu të bën selektimin e veprave dhe të zgjedh për vete ato vepra që i sjellin atij më shumë dobi dhe shoqërisë në përgjithësi. Ajo që vërejmë te disa njerëz është fakti se ata mundohen ti arrijnë të gjitha veprat e mira, mirëpo në realitet asnjë vepër nuk mund ta arrijnë ashtu si duhet, ose angazhohet me vepra të mira, mirëpo po të angazhohej me disa tjera ato do të ishin për Të më të dobishme.

- Media dhe kontaktet shoqërore.

Media, qoftë televizive, audio, apo e shkruar ka një rol të madh në dekoncentrimin e mendjes së shumë agjëruesve, e sidomos djemve dhe vajzave të reja. Andaj varësia prej tyre i largon njerëzit nga qëllimi dhe synimi i agjërimit dhe përfitimi prej tyre në përmirësimin e shpirtit dhe shoqërive ashtu si duhet.

Fatkeqësisht media ofron materiale argëtuese dhe dëfryese dhe pak janë ato programe që kanë qëllime edukative dhe morale, po edhe ato programe fetare që paraqiten në ekranet televizive janë sipërfaqësore dhe nuk luajnë rolin e duhur në shoqëri.

Zgjerimi në kontaktet shoqërore mes familjes, shokëve dhe farefisit ka një rol të dukshëm në humbjen e kohës, andaj është më mirë për muslimanët që gjatë këtij muajit të kujdesen për kohën e tyre dhe të përcaktojnë pjesën më të madhe të kohës të jetë për të përforcuar kontaktin me Allahun, subhanehu ve teala, dhe për të mësuar mësimet dhe udhëzimet e islamit.

## DY: SHËRIMI

*Këto ishin shkaqet më të dukshme që kanë shkaktuar këtë fenomen, kurse këto që do t'i paraqesim mund të jenë shkaqet më të dukshme për shërimin e tyre, shtoja kësaj edhe eliminimin e shkaqeve të asaj gjendje.*

1- Dijetarët dhe hoxhallarët duhet ta luajnë rolin e tyre në edukimin dhe orientimin e umetit, duke u përzier me ta, duke i mësuar ata, duke u ofruar shembull të mirë atyre, nëpërmjet sjelljes dhe zhvillimit të jetës në mënyrë të rregulluar sipas fesë.

2- Muslimani duhet ta perceptoj detyrën e tij të vërtetë në jetë, rëndësinë e kohës për Të që të bëhet kjo shtytës për seriozitet në jetë dhe baraspeshë mes veprave që mund t'i kryej dhe që të arrijë të shfrytëzoj maksimalisht begatinë e kohës, duke i ikur zhytjes në gjëra të lejuara dhe të pëlqyera në llogari të detyrave dhe obligimeve. Muslimani duhet të stërvit veten në kryerjen e veprave të mira, siç është shkuarja herët në namaz, qëndrimi pas namazit të sabahut në xhami, etj. me qëllim që edhe pas Ramazanit të mbetet shprehi e tij kjo vepër.

3- Të gjithë duhet të punojmë në thellimin e pasimit të Pejgamberit, sal-Allahun alejhi ve sel-lem, dhe marrjen e tij si shembull në të gjitha çështjet e jetës dhe sidomos gjatë këtij muajit të bekuar.

Kjo kërkon të mësojmë dispozitat e agjërimit, rregullat e agjërimit, urtësitë dhe synimet e agjërimit dhe tu ofrojmë mjetet që i mundësojnë të gjitha shtresave të umetit islam të përfitojnë nga agjërimi në edukimin e tyre, përhapjen e të mirës, vlerës, nderit dhe luftimit të të keqes, imoralitetit dhe ndyrësirave.

4- Institucionet e orientimit, qofshin ato mediat, shkollat, xhamitë, qendrat për rekreacion, të gjitha këto duhet të nisen nga pikënisja e fesë dhe të mbjellin seriozitet në popullin tonë, sidomos në këtë kohë kur populli jonë ballafaqohet me sfida të ndryshme.

5- Thirrësit në fenë islame dhe në përmirësim të shoqërisë, qofshin ata individ apo institucione duhet të ri-analizojnë programet e tyre edhe në cilësinë edhe në sasinë e tyre që të kontribuojnë në mënyrë më të mirë në zgjidhjen e problemeve të njerëzve dhe të veprojnë në eliminimin dhe përmirësimin e gabimeve të tyre, me qëllim të arritjes të devotshmërisë dhe tu forcohet besimi në Allahun.

Allahun e lusim që të na bëjë nga të pranuarit. Amin

Fejsal ibën Ali El-Budani



## Merre shpërblimin e agjërimit dy herë!

Era e lehtë dhe fisnikëruese e muajit të Ramazanit ka filluar t'i lëshojë krahët e saj mbi besimtarët, që t'i bëjë më të devotshëm dhe më bujarë. Melekët zbresin në tokë, shejtanët prangosen, dyert e Xhennetit hapen kurse dyert e Xhehennemit mbyllen. Lëshohet një zë nga qielli, zë të cilin e dëgjon zemra e besimtarit, dhe thotë: O ti që do të mirën, nxito kah ato! O ti që e do të keqen, ndalu!

Vepra më madhështore që ngriti prestigjin dhe vlerën e këtij muaji ishte zbritja e Kuranit: “Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)”. (Bekare, 185)

Në bazë të kësaj ndodhie, muaji i Ramazanit quhet edhe muaj i Kuranit. Ditët e tij nuk guxon të na kalojnë pa lexuar fjalët, këshillat dhe udhëzimet e tij. Pejgamberi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, çdo Ramazan e lexonte tërë Kuranin para Xhibrilit, kurse vitin e fundit të jetës së tij e lexoi dy herë. Kjo gjë mbeti traditë të cilën e ndoqën njerëzit e mirë.

Prej adhurimeve më madhështore që kryhen në këtë muaj është dhënia e iftareve. Për këtë vepër na foli vetë i Dërguari i Allahut, i cili na stimuloi duke përmendur shpërblimin e madh të Allahut. Ai tha: “Kush i jep iftar një agjëruesit, fiton të mira sa ai, pa iu pakësuar (agjëruesit) shpërblimi”. (Tirmidhiu, Ibën Maxhe, hadithi është i vërtetë)

Shpirti i besimtarit fisnikërohet edhe më tepër në këtë muaj, jeton me fjalët e Allahut dhe Pejgamberit, bëhet i zellshëm dhe i dobishëm për të tjerët. Ai është i vetëdijshëm se Allahu i Madhëruar ia kompenson shpenzuesit “e çka do që t'u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t'u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju”. (Bekare, 272), siç është përmenduar edhe në hadith: “Shpenzo që të shpenzoj për ty”. Po ashtu Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Derisa një njeri ecte në një hapësirë, dëgjoji një zë që vinte nga një

re: ujite kopshtin e filanit, pastaj ajo re lëvizi derisa lëshoi ujin mbi një tokë të djegur nga nxehtësia dhe ja, kur pashë ujin të mbledhur në një gropë. Ky njeri përcolli renë dhe kur arriti te vendi në të cilin ishte lëshuar uji pa një njeri i cili po mundohej të depozitonte ujin dhe i tha: O rob i Allahut, si e ke emrin? Ai ia përmendi emrin që e kishte dëgjuar prej resë, pastaj i tha: Përse më pyet për emrin tim? Iu përgjigj: unë dëgjova një zë në renë e cila e lëshoi ujin, thoshte: Ujite kopshtin e filanit duke përmendur emrin tënd, për këtë dëshiroj të di se ç'Vepron me këtë kopsht? U përgjigj: Pra, pasi e kërkove këtë gjë po të tregoj se prodhimin që fitoj nga kjo tokë, një të tretën e saj e jap lëmoshë, me një të tretën ushqehem unë dhe familja ime, kurse një të tretën e kthej përsëri në këtë tokë”. (Transmeton Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, ia shumëfishon pasurinë shpenzuesit: “Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet”. (Bekare, 261)

Shpenzuesi shpreh frikën e tij prej zjarrit të Xhehennemit: “Frikojuni prej zjarrit qoftë edhe me gjysmë hurme”. (Transmeton Buhariu)

Gjëja më e mirë më të cilën njeriu mjekohet është lëmosha: “Mjekoni të sëmurit tuaj me lëmoshë”. (Transmeton Bejhakui)

Shpenzimi i pasurisë është mbrojtje e saj: “Mbroni pasuritë tuaja me zekat”. (Transmeton Bejhakui)

Bujaria është prej cilësive më të lavdëruara tek Allahu, subhanehu ve teala, “Allahu është i Mirë dhe e do të mirën, i Pastër dhe e do pastërtinë, Bujar dhe e do bujarinë”. (Transmeton Tirmidhiu i cili thotë: ky hadith është garib, kurse Halid ibën Iljas është i dobët)

Dora e cila jep është më e mirë se dora e cila merr: “Dora e lartë është më e mirë se dora e poshtme”. (Transmeton Muslimi)

Ai që i jep tridhjetë iftare i dyfishohen të mirat në këtë muaj. Këtë shans të madh të parët tanë e shfrytëzonin në mënyrë më të mirë. Ata e dinin vlerën e shpërndarjes së ushqimit sidomos në muajin e Ramazanit. Njëri prej tyre kishte thënë: “T’i thërras dhjetë shokë të mi për të ngrënë një ushqim që ua ka ëndja është më e dashur për mua se sa t’i liroj dhjetë robër”.

Ebu Sivar Adeviu thotë: “Ishin disa burra të fisit Adij që kurrë nuk bënë iftar të vetëm. Nëse gjenin ndonjë që do të ushqej me ta e bënë atë, e nëse jo, merrnin ushqimin me vete dhe dilnin në xhami”.

Si rrjedhojë e këtij ibadeti dalin shumë ibadete tjera, siç janë: dashuria mes dhuruesit të iftareve dhe agjëruesve, pastaj kjo gjë me lejen e Allahut bëhet shkak për të hyrë në Xhennet, siç ka thënë Pejgamberi, lavdërimi dhe paqja e Allahut goftë mbi të: “Nuk do të hyni në Xhennet deri sa të besoni, e nuk keni besuar përderisa të duheni mes vete”. (Muslimi)

## Disa gabime të agjëruesve dhe agjërueseve

Në këtë kapitull dëshirojmë t'i paraqesim disa gabime në të cilat bien shumica e agjëruesve dhe agjërueseve, në të cilat bien ose nga injoranca ose nga imitimi i tjerëve.

Para se të fillojmë ti paraqesim këto gabime duhet ditur se secili ibadet bazohet në dy rregulla kryesore:

Një: sinqeriteti ndaj Allahut [subhanehu ve teala], siç thotë në Kuran:

“...andaj ti adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij!”. (Ez-Zumer: 2).

“Thuaj: “Allahu më urdhëroi mua drejtësinë dhe në tërësi kthejuni Atij në çdo namaz (lutje) dhe adhurojeni Atë duke qenë të sinqertë në lutje vetëm për të. Ashtu sikur që ju filloi (krijoi) së pari do të ktheheni te Ai”. (El-A'raf: 29).

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij,..”. (El-Bejjine: 5).

Dy: pasimi i Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], siç thotë Allahu [subhanehu ve teala]:

“Çka t'ju jep Pejgamberi, atë merreni e çka t'ju ndalojë, përmbanju...”. (El-Hashr: 7)

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun”. (El-Ahزاب: 21).

“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me urdhrin e Allahut t'i bëhet respekt (nga njerëzit) atij”. (En-Nisa: 64)

“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut”. (En-Nisa: 80).

Pasi që i kuptuam këto dy rregulla që janë shumë me rëndësi në fenë tonë, atëherë të fillojmë duke i përmendur këto gabime që gjinden tek agjëruesit tanë:

1- Fatkeqësia ma e madhe e muslimanëve tanë është se agjërojnë, mirëpo namaz nuk falin. Namazi është obligim para agjërimit. Është shtylla kryesore e islamit. Pa namaz në pikëpyetje është vlera e agjërimit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Marrëveshja mes nesh dhe atyre është namazi, kush e lë namazin, ka bërë kufër”. (hadithi është sahih, transmeton Ahmedi, Tirmidhiu dhe të tjerët).

Ne e dimë se agjërimi është obligim për muslimanin, e nëse një njeri del ose ka mundësi të del nga islami me lënje të namazit, me të vërtetë parashtrohet pyetja se sa ka mundësi ti bëjë dobi ky agjërim. Ne nuk jemi duke thënë që muslimani që nuk falet mos të agjërojë, mirëpo pasi që është duke agjëruar dhe është duke e repsektuar Allahun në këtë ibadet, që edhe të falet.

Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo gjë të keqe (ose në Gaja)”. (Merjem: 59).

2- Shumica e muslimanëve tanë më tepër rëndësi i japin namazit të teravisë sesa namazeve tjera që i ka obligim. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Islami ndërtohet mbi pesë shtylla: dëshmia se s’ka hyjni tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i Allahut, falja e namazit, dhënja e zekatit, haxhi dhe agjërimi i Ramazanit”. (Buhariu dhe Muslimi).

3- Disa njerëz nga dëshira për ta falur namazin e teravisë me imam të caktuar, u kalon namazi i jacisë me xhemat, ose ndonjë rekat i sajë. Kjo është gabim dhe vepër e cila nuk lejohet. Ky njeri mer mëkat nëse e din se me këtë vepër do t’i kalon namazi i jacisë. Është për tu habitur fakti se disa njerëz i japin rëndësi më

të madhe namazit të teravisë, i cili është sunnet, sesa namazit të jacisë, i cili është farz. Kjo është mashtrim i shejtanit, sepse në këtë mënyrë shkakton që muslimani të mbetet larg kësaj vepre të mirë, që është falja e namazit të jacisë me xhemat. Këtyre njerëzve u themi, keni frikë Allahun dhe mos toleroni që shejtani tu mashtrojë.

4- Disa njerëz duke marrë abdest, shumë pak e shpërlajnë hundën, saqë lirisht mund të thuash se aspak nuk e larë hundën. Këtë e bënë nga frika se mos i shkon ndonjë pikë uji në fyt.

Mirëpo ata duhet të dinë se shpëlarja e gojës dhe hundës është prej obligimeve të abdestit, ashtu që nëse ndokush nuk i shpërlanë këto dy vende, mund të mbetet pa abdest. Për këtë agjëruesi që merr abdest, duhet të shpërlajë hundën dhe gojën mirë, mirëpo duke mos e tepruar, ashtu siç ka porositur Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem]:

“Merr abdest mirë, lajë vendin mes gishtave, shpërlaje hundën mirë, në përjashtim të rastit kur je agjërueshëm”. (hadithi është sahih, transmeton Tirmidhiu, Ebu Davud dhe të tjerët).

5- Mospërdorja e misvakut duke menduar se kjo e dëmton agjërimit ose ia pakëson shpërblimin.

Përkundrazi, përdorimi i misvakut është sunnet për agjëruesin ashtu siç është sunnet edhe për ate që nuk agjëron, qoftë në fillim të ditës ose pas dite. Argument për këtë janë hadithet që flasin për vlerën e përdorimit të misvakut, duke mos bërë kurnjëfar dallimi mes agjërimit dhe joagjërimit. Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë:

“Po sikur mos t’i vinte rëndë ummetit tim, do ta urdhëroja të përdorë misvakun në çdo namaz”. (Buhariu dhe Muslimi).

“Misvaku është pastrim për gojën dhe kënaqësi për Zotin”. (Hadithi është sahih, transmeton Ahmedi, Nesaiu dhe të tjerët).

Kurse Imam Shevkaniu thotë: “Është e pëlqyeshme të përdoret misvak, qoftë në fillim ose në fund të ditës. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve”. Kurse shejh Muhammed Salih El-Uthjemini thotë: “Agjëruesit nuk i prishte agjërimi nëse përdor misvak, përkundrazi, përdorimi i misvakut është sunnet në çdo kohë, qoftë në fillim ose në fund të ditës”.

Nëse ndokush argumenton me hadithin se “era e agjëruetit është më e mirë se Allahu sesa era e parfymit”. Kuptimi i këtij hadithi nuk mundet ta rrënon domethënjen direkte të shumë haditheve që urdhërojnë përdorimin e misvakut, qoftë në fillim ose në fund të ditës.

6- Kur të hyjë koha e iftarit, disa njerëz vazhdojnë me lutjet ose bisedat. Kjo gjë nuk është në përputhje me sunnetin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Përkundrazi, muslimani duhet të nxitojë me iftar që tu kundërvihet çifutëve dhe të krishterëve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Njerëzit do të mbesin në të mira, përderisa e nxitojnë iftarin”. (Buhariu dhe Muslimi).

“Do të mbetet feja e fuqishme, përderisa njerëzit e nxitojnë iftarin, sepse çifutët dhe të krishterët e vonojnë”. (hadithi është hasen, transmeton Ebu Davud dhe ibn Hibbani).

E nëse dëshiron të arrish vlerën e lutjes, atëherë shfrytëzo kohën para iftarit dhe pas iftarit.

7- Ngritja e syve në qiell gjatë lutjes në kunut. Kjo gjë është në kundërshtim me hadithet e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] që tregojnë se njeriu shikimin e tij duhet pasur në vendin e sexhdes. Nga ana tjetër Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka ndaluar të ngritet shikimi në qiell duke thënë:

“Ç ‘kanë ata njerëz që i ngrisin shikimin në qiell gjatë namazit të tyre”. Aq shumë e qortoi këtë vepër saqë tha: “Ose nuk do ta bëni këtë vepër ose Allahu do tua merr shikimin”. (Buhariu).

“Kur ndokush prej jush falet, mos të ngrisë shikimin në qiell, se mund të verbërohet”. (hadithi është sahih, transmeton Ahmedi dhe Nesaiu).

Ngritja e shikimit gjatë namazit lart në qiell është e ndaluar, bile disa dijetarë kanë thënë se ai namaz nuk vlen.

8- Fërkimi i fytyrës pas përfundimit të lutjes së imamit në kunut. Fërkimi i fytyrës në këtë pozitë kërkon argument të vërtetë dhe të qartë nga Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem]. Mirëpo në këtë rast nuk ka argument të tillë. Kurse shumica e dijetarëve kanë thënë se kjo gjë nuk ka bazë në fe. E kanë pyetur Imam Malikun [rahimehull-llah]: një njeri e fërkon fytyrën me duar gjatë lutjes? Është përgjigjur: nuk di se ka bazë kjo vepër. Kurse Imam Mubareku [rahimehull-llah] ka thënë: nuk kam gjetur argument për këtë vepër. E Imam Ahmedi [rahimehull-llah] ka thënë: nuk kam dëgjuar argument për këtë vepër.

Imam Bejhakiu [rahimehull-llah] thotë: sa i përket fërkimit të fytyrës pa duasë së kunutit, nuk di se ndokush nga selefi e ka bërë këtë vepër. Kurse shejhul-Islam Ibn Tejmiu [rahimehull-llah] thotë: nuk ka asnjë argument që tregon se Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] e ka fërkuar fytyrën me duar pas përfundimit të lutjes. Për këtë sunnet është që namazliu mos të fërkon fytyrën e tij me duar pas lutjes, duke zbatuar urdhrin e Pejgamberit [sal-Allahu alejhi ve sel-lem]:

“Faluni sikur më shihni duke u falur”.

“Kush mer abdest siç është urdhëruar dhe kush falet siç është urdhëruar, i falen mëkatet që i ka bërë më parë”.

9- Muslimani gjatë lutjes së kunutit nuk duhet pas secilës fjali të thotë amin. Por duhet të dallojë mes fjalive që janë lavdërim për Allahun dhe fjalive që janë lutje drejtuar Allahut. Në rastin e parë duhet të heshtë, kurse në rastin e dytë duhet të thotë: amin.



Muhammed ibn Hesr El-Merveziu tregon se Muadh El-Kari, sahabe i vogël i Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], të cilin Omeri [radijAllahu anhu] e kishte caktuar si imam për tu falur muslimanin namazin e teravisë. Kur bëri dua, mes tjerash tha: Allahu ynë, thaje shiun. Ata që ishin pas thanë: amin. Pasi e kreu namazin u tha: unë thashë: Allahu ynë, thaje shiun, e ju thatë: amin. Vallë nuk dëgjoni se çka jam duke thënë!

10- Prej gabimeve të përhapura me të madhe anë e mbanë botës islame në ramazan është falja e shpejtë e teravisë. Namaz në të cilin nuk plotësohet leximi i Kuranit, e as rukuja dhe sexhdeja. Disa me qëllim që të lexojnë sa ma tepër Kuran, e disa që ta kryejnë sa ma tepër. Kjo është në kundërshtim me sunnetin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Përkundrazi është obligim që namazi të falet ngadal dhe secilit rekat t’ia jep hakun në lexim, ruku dhe sexhde. Kjo është namazi i cili mund të pranohet te Allahu përndryshe, ai namaz nuk pranohet te Allahu.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e pa një njeri duke u falur shpejt e tha:

“Po të vdes ky njeri në këtë gjendje, nuk do të vdes sipas miletit të Muhammedit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]”. (Hadithi është hasen, transmeton Ebu Jala, Bejhakui dhe Taberaniu).

Dhe thoshte:

“Vjedhësi ma i keq është ai që vjedh nga namazi i tij. Thanë: o I Dërguar i Allahut, si ka mundësi njeriu t’ë vjedh nga namazi i vet? Tha: Nuk e plotëson rukunë dhe sexhden”. (Hadithi është sahih, transmeton Taberaniu, Hakimi dhe të tjerët).

Dijetarët kanë thënë se është e urryer që imami të falet shpejtë saqë njerëzit që falen pas tij mos të kenë mundësi t’i plotësojnë edhe sunnetet. Atëherë çka të themi për ata imama që nuk u mundësojnë njerëzve të plotësojnë edhe farzet.

Imami duhet t’i frikohet Allahut dhe të falet ngadal, sepse nëse ia qëllon ai fiton shpërblim edhe xhemait, e nëse gabon ai merr gabim, kurse xhemati shpërblim.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka përmendur shumë hadithe ku u tërhiqet vërejtja muslimanëve nga nxitimi në namaz. Imam Mundhiri u në librin e tij “Et-Tergibu vet-Terhibu”, i ka përmendur mbi 30 hadithë që kanë të bëjnë me këtë temë.

11- Prej gabimeve është edhe zgjatja e tepërt e lutjeve të kunutit. Kjo gjë është vështirë për muslimanët dhe u shkakton dëme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka urdhëruar të kihet parasysh gjendja e namazlive duke thënë:

“Kur ndokush prej jush u fal namazin njerëzve le të falet shkurt, sepse pas vete ka njerëz të dobët, të sëmurë, të vjetër, nevojtar, e kur të falet vet, le ta zgjasë sa të dëshiron”. (Buhariu dhe Muslimi).

12- Ngritja e madhe e zërit gjatë lutjes. Kjo është në kundërshtim me sunnetin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Allahu [subhanehu ve teala] thotë:

“Luteni Zotin tuaj të përrulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë”. (El-Araf: 55).

Imam Kurtubiu thotë: “teprimi në lutje ndodhë në disa mënyra, njëra prej tyre është bërtitja gjatë lutjes”. Kurse Ibn Kethiri [rahimehull-llah] thotë: Ibn Xhurejxhi ka thënë: është e urrejtar yë ngritet zëri dhe të bërtitet gjatë lutjes, por urdhërohet besimtari të lutet i mposhtur dhe me butësi.

Ebu Musa El-Eshariu [radijAllahu anhu] thotë: Ishim duke ecur me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Kur kalonim luginat, thonim la ilahe il-lAllah dhe Allahu Ekber me zë të lartë. Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: O ju njerëz! Mëshironi vetveten, sepse ju nuk jeni duke lutur shurdhan e as qenie që nuk është e pranishme, por është me ju, Dëgjon dhe është afër”. (Buhariu).

Allahu ynë na prano agjërimin dhe namazin tonë. Na prano atë që kemi bërë deri tani dhe na ndihmo në atë që na ka mbetur. Allahu ynë, bëre këtë muaj, muaj të të mirave dhe bereqetit për islamit dhe muslimanët.

Dhe në fund do t'i përmendim disa vërejtje në mënyrë të shkurtër, e të cilat kanë të bëjnë me agjëruesit dhe agjërueset.

~ Dhënia rëndësi dobive shëndetësore dhe shoqërore të agjërimit dhe të harruarit se agjërimi është lloj i veçantë i adhurimit të Allahut [subhanehu ve teala].

~ Të bërit natën ditë, e ditën natë me pagjumësi gjatë natës dhe fjetje gjatë ditës.

~ Të fjeturit në kohët e namazeve farz, e sidomos në kohën e namazit të drekës dhe atë të ikindisë.

~ Harxhimi i tepruar në ushqime dhe në llojlojshmërinë e tyre.

~ Të humburit e kohës në gjëra të kota dhe të padobishme.

~ Syfyri i hershëm dhe fjetja për namaz të sabahut.

~ Vozitja e shpejtë e mjeteve të udhëtimit pak para kohës së iftarit.

~ Nevrikosja e tepërt gjatë agjërimit, fyerja dhe ofendimi i të tjerëve.

~ Moskryerja e plotë e namazit të teravisë [më pak se tetë rekate] .

~ Mbledhja nëpër çajtove dhe kafene për lojëra dhe fjalë të kota.

~ Dëmtimi i agjërimit me gënjeshtër, përgojim, bartje të fjalëve dhe shaka të ndaluara.

~ Shfrytëzimi i Ramazanit si rast për fjetje, përtaci dhe moslëvizje.

~ Ibadeti në Ramazan dhe mospërfillja e tij para dhe pas Ramazanit.

~ Prezenca në xhamia gjatë Ramazanit dhe lënia e saj pas Ramazanit.

~ Disa njerëz merakosen nëse hanë dhe pinë pa qëllim duke menduar se e kanë prish agjërimin ose nuk e kanë të plotë atë, edhe pse Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] e ka bërë të qartë se nuk prish gjë, ngase atë e ka ushqyer dhe ia ka shuar etjen Zoti i tij.

~Disa njerëz merakosen nëse zgjohen nga gjumi xhunubë (të papastër) duke menduar se kjo gjë e dëmton agjërimin e tij, ndërsa Pejgamberin [sal-Allah u alejhi ve sel-lem] shpeshherë e ka zënë agimi duke qenë xhunub, e pastaj është larë dhe ka vazhduar agjërimin e tij.

~ Disa njerëz i bëjnë haram marëdhënie me gratë e veta gjatë netëve të Ramazanit, edhe pse Allahu i Lartësuar thotë : “Natën e agjërimin u është lejuar afrimi grave tuaja...”.

~ Disa njerëz i ndalojnë fëmijët e tyre të cilët nuk janë të moshërritur nga agjërimi duke u frikuar për ta se mos po lodhen, edhe pse sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, i kanë urdhëruar fëmijët e tyre me agjërim, edhe pse fëmijët e tyre kanë qenë të vegjël, ashtu që kur kanë qarë fëmijët e tyre prej urisë u kanë dhënë lojëra që të mashtrohen dhe që ta harrojnë ushqimin.

#### VËREJTJE AGJËRUESEVE

~ Të kaluarit shumicën e kohës në kuzhinat e tyre dhe mosshfrytëzimi i këtyre rasteve të mëdha që të pajisen me devotshmëri .

~ Disa prej grave i marrin fëmijët e tyre të parehatshëm në xhami me ç’rast u pengojnë atyre që janë duke u falur .

~ Disa prej grave lidhen në namaz pas imami, edhe pse u kanë kaluar një apo më tepër reqate, kur jep imami selam edhe ato japin selam. Ndërsa, ajo që kërkohet prej tyre është plotësimi i reqateve të cilat u kanë mbetur pa falë.

~ Mosdrejtimi i safeve dhe plotësimi i tyre dhe lënia e zbrazëtirave mes safeve të tyre kur janë në xhami.

~ Disa prej grave mundohen që të jenë sa më të devotshme gjatë këtij muaji, por nëse ju paraqiten atyre menstruacionet, i braktisin të gjitha punët e mira, edhe pse disa prej tyre janë të lejuara, siç janë: të bërit dua, dhikër, istigfar, tespih, të dhënit

sadaka, të dërguarit salavat mbi Muhammedin [alejhis-selam], të bërit mirë farefisit dhe njerëzve, të ruajturit e gjuhës prej thashethemeve e tj.

~ Të parfymosurit e disa grave gjatë shkuarjes së tyre në xhami, të cilën gjë e ka ndaluar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] .

~ Disa prej grave i ngritin zërat e tyre në xhami duke biseduar, duke bërë dua ose duke qarë, gjë që është e ndaluar pasi që edhe kjo është njëlloj i fitnes prej të cilës ka ndaluar Allahu [subhanehu ve teala]

~ Shumica e grave angazhohen me gïbet, përgojim dhe me thashetheme në muajin e Ramazanit me të cilën gjë e humbin sevapin e agjërimit dhe mbushen me mëkate

~ Disa prej grave muajin e Ramazanit e bëjnë muaj të përtacisë dhe gjumit, ashtu që shumicën e kohës e kalojnë në gjum, ashtu që aspak nuk i ndiejnë kënaqësi muajit të Ramazanit, po madje as që e kuptojnë hikmetin (urtësinë) e tij .

~ Disa prej grave nuk kujdesen aspak për vajzat e tyre të cilat hynë në moshën e pjekurisë, pasi që siç e dimë nëna e ka për obligim që t'ia mësojë regullat e pastrimit mujor dhe kur e ka të lejuar të agjërojë e kur jo, ashtu që shpeshherë ndodhë që vajza e re të agjëron, edhe pse nuk ka të drejtë ta bëjë këtë, por e bën prej mosdijes së regullave .

~ Të dalurit e grave në treg gjatë muajit të Ramazanit, e sidomos në dhjetë ditët e fundit të tij me arsye se duhet përgatitur për Bajram, gjë që i shkelë normat fetare dhe vjen deri te humbja e kotë e kohës dhe sevapit.

Disa hadithe të dobëta të cilat përmenden shpesh gjatë muajit të Ramazanit, e të cilat nuk i ka thënë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]

1. Gjumi i agjëruesit është ibadet.
2. Agjëroni nëse dëshironi të jeni të shëndoshë.

3. Kush e ha një ditë të Ramazanit pa arsye, nuk mund ta zëvendëson atë, madje edhe nëse agjëron tërë jetën.
4. Sikur ta dinin njerëzit se çështë Ramazani, do të kishin dëshiruar që tërë viti të jetë Ramazan .
5. Për çdo gjë ka zekat, e zekati i trupit është agjërimi .

## Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Shevval

Imam Muslimi transmeton nga Ebu Ejub El-Ensariu, radijAllahu anhu, i cili tregon se Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kush agjëron Ramazanin, pastaj e përcjell me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevvalit, i regjistrohesh sikur të kishte agjëruar tërë vitin”. (Muslimi).

Në bazë të këtij hadithi shumica dërmuese e dijetarëve islam e preferojnë agjërimin e këtyre ditëve që pasojnë pas muajit të Ramazanit.

Dijetarët që e kanë preferuar agjërimin e këtyre ditëve kanë disa mendime rreth mënyrës se si të agjërohen këto ditë:

1- Disa thonë se është e pëlqyeshme që të agjërohen në fillimin e muajit edhe atëherë që është një ditë pas një. I këtij mendimi është Imam Shafiu dhe Ibën Mubareku.

2- Të tjerët kanë thënë se nuk është me rëndësi a i agjëron rend, ditë pas dite ose i ndanë gjatë tërë muajit. I këtij mendimi është Imam Ahmedu dhe Vekiu.

3- Nuk preferohet agjërimi menjëherë pas ditëve të bajramit, sepse janë ditë të ushqimit dhe pijes, por agjërohet tre ditë para ditëve të bardha dhe tre ditë pas tyre. I këtij mendimi është Muameri dhe Abdur-Rezaku.

Mirëpo shumica e dijetarëve janë të mendimit se nuk ka ndonjë pengesë nëse fillohet me agjërimin e këtyre ditëve që nga dita e dytë e fitër bajramit. (shiko: Letaiful-Mearif, fq. 390- 391)

Dijetarët kur kanë folur për shpërblimin që e fitojmë me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevvalit kanë thënë: “Nëse e agjërojmë muajin e Ramazanit, i cili i ka tridhjetë ditë, nëse këto ditë i shumëzojmë me dhjetë, atëherë dalin treqind ditë, e kur tia shtojmë këtyre ditëve edhe gjashtë ditët e shevvalit të shumëzuar me dhjetë, del treqind e gjashtëdhjetë ditë. Edhe pse sipas kalendarit lunar, viti i ka treqind e pesëdhjetë e pesë ditë.

Disa e kontestojnë këtë duke thënë se disa herë muaji i Ramazanit mundet me qenë njëzet e nëntë ditë. Mirëpo ata u përgjigjen duke u thënë se në këtë rast me rëndësi është vlera e këtyre ditëve dhe e zakonshmja.

Këtë e thonë duke u mbështetur na hadithin e Pejgamberit, sal-Allahuejhi ve sel-lem:

“Dy muajt e bajrameve nuk pakësohen: Ramazani dhe Dhil-Hixhheja”. (Buhariu dhe Muslimi).

Dijetarët kanë thënë, nuk janë të mangëta në vendim edhe pse janë të mangëta në llogari, ose zakonisht janë të plota, e rrallë herë janë të mangëta. (Xhamiul-Usul; 6/ 283).

Dobitë nga agjërimi i këtyre ditëve

Vazhdimi i agjërimin të këtyre ditëve pas Ramazanit ka shumë dobi. Në vijim do t'i përmendim disa prej tyre:

1- Agjërimi i këtyre ditëve pas Ramazanit të mundëson të fitosh shpërblimin e agjërimin të tërë vitit, siç treguam më lartë.

2- Agjërimi i Shevvalit dhe Shabanit është sikurse falja e sunneteve para dhe pas namazeve farz. E me këtë plotësohet mangësia që ndodh gjatë faljes së farzeve, sepse farzet në ahiret plotësohen me veprat tona vullnetare.

3- Vazhdimi i agjërimin pas Ramazanit është shenjë se Allahu e ka pranuar agjërimin e Ramazanit, sepse kur Allahu e pranon nga robi ndonjë vepër, i mundëson që ta bëjë edhe një vepër tjetër të mirë pas sajë. Siç kanë thënë disa dijetarë: “shpërblimi i një të mirë, është një e mirë pas sajë, ai që e vepron një vepër të mirë dhe pastaj e pason me një vepër tjetër të mirë, kjo është shenjë se Allahu ia ka pranuar këtë të mirë, e nëse pas ndonjë vepre të mirë ka bërë një vepër të keqe, kjo është sinjal se Allahu ia ka refuzuar atë vepër të mirë”.



4- Agjërimi i Ramazanit shkakton shlyerjen e mëkateve që janë bërë më herët, kurse shpërblimin e marrin në ditën e fitër bajramit, e cila është dita e shpërblimeve dhe dhuratave. Andaj agjërimi pas këtyre ditëve është falënderim për këto dhunti, sepse nuk ka dhunti më të madhe se sa shlyerja e mëkateve. Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, falej aq shumë derisa iu ënjtën këmbët. I thanë: pse lodhesh kaq shumë, kur Allahu t'i ka falur mëkatet që i ke bërë dhe që do ti bësh? Tha:

“A nuk duhet të jem rob falënderues”. (Buhariu dhe Muslimi).

Allahu, subhanehu ve teala, i ka urdhëruar robërit e Tij që ta falënderojnë për dhuntinë e agjërimit të Ramazanit duke e publikuar përmendjen e Tij, duke thënë:

“...Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni”. (El-Bekare: 185).

Nga falënderimi i robit për Zotin që i ka mundësuar ta agjërojë Ramazanin, i ka ndihmuar gjatë agjërimit dhe ia ka falur mëkatet, është që pas ditës festive, të agjërojë sërish.

Disa adhures nga gjeneratat e para të devotshme (selefus-Salih) kur arrinin sukses për tu ngritur natën që të falin namaz nate, ditën që vijonte e agjëronin në shenjë falënderimi ndaj Allahut për këtë ndihmesë.

Kur e pyetnin Vuhejb ibën Verdin për shpërblimin e ndonjë veprë të mirë, siç është tavafi, ose diç tjetër, u thoshte: Mos pyetni për shpërblimin, por pyetni për falënderimin që duhet ta bëjë njeriu, të cilit i është mundësuar ky adhurim, që t'ia shtoj suksesin dhe ta ndihmojë në këtë adhurim.

Çdo dhunti që Allahu ia ka dhënë besimtarit, qoftë e kësaj bote ose e ahiretit duhet të falënderohet. Vetë falënderimi është dhunti tjetër për të cilën sërish duhet falënderim, po edhe falënderimi i tretë është dhunti e cila sërish kërkon

falënderim, e kështu me radhë. Andaj, besimtari asnjëherë nuk mundet të arrijë kulmin e falënderimit. Për këtë dijetarët kanë thënë:

“Realiteti i falënderimit është pranimi se je i paaftë për ta falënderuar”. (Letaiful-Mearif, fq. 395).

Nëse dhuntinë e agjërimit të muajit të Ramazanit e pasojmë me mëkate, kjo është përbuzje e dhuntive të Allahut.

Ai që e fillon agjërimin e Ramazanit me nijet që pasi të përfundon Ramazani sërish të kthehet në mëkatet, le ta dije se agjërimi i tij është i refuzuar dhe dera e Mëshirës është e mbyllur përpara tij.

5- Veprat që i ka bërë besimtari gjatë Ramazanit nuk përfundojnë me përfundimin e Ramazanit, ato mbesin derisa të jetë gjallë robi.

Disa njerëz gëzohen me përfundimin e Ramazanit, sepse u ka ardhur rëndë agjërimi dhe janë mërzitur nga ditët e gjata e tij. Ky njeri e ka vshtirë të kthehet me të shpejtë në agjërim. Kurse ai që e fillon agjërimin me kalimin e ditës së bajramit, kjo tregon vullnetin që e ka për të agjëruar dhe se nuk e ka lodhur agjërimi e as që e ka mërzitur.

I kanë thënë Bishrit: Disa njerëz shumë bëjnë adhurime gjatë Ramazanit. Tha: sa të këqinjë janë ata të cilët nuk i njohin obligimet e tyre ndaj Allahut vetëm se në Ramazan. I mirë është ai që gjatë tërë vitit bënë adhurime dhe përpiqet në këto adhurime.

Shibliun e kanë pyetur: cili muaj është më i mirë, Rexhebi ose Shabani? Ai ka thënë: Bëhu njeri i lidhur për Zotin e jo për Shabanin. (Letaiful-Mearif, fq. 396).

Nëse dëshirojmë të dimë praksën e Pejgamberit, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, në adhurime, këtë më së miri na e tregojnë këto hadithe: E kanë pyetur Aishen, radijAllahu anha: A e veçonte Pejgamberi, sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, ndonjë

ditë me adhurim? Ajo tha: “Jo, veprat e tija ishin të vazhdueshme”. (Buhariu dhe Muslimi).

Thoshte: “Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk shtonte as në Ramazan e as jashtë Ramazanit ma shumë se njëmbëdhjetë rekate”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pastaj porosia e madhe e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]:

“Veprat më të dashura te Allahu janë ato të vazhdueshmet, edhe në qoftë se janë pak”. (hadith sahih).

Vepra e besimtarit nuk përfundon

Vepra e besimtarit nuk përfundon derisa nuk përfundon ymri i tij.

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: “Allahu, subhanehu ve teala, nuk i ka caktuar afat veprës së besimtarit përveç vdekjes”, pastaj lexoi ajetin:

“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)”. (El-Hixhr: 99).

Këto vite, muaj, ditë dhe netë janë masë matëse e exheleve dhe kohë e veprave, pastaj me të shpejtë kalojnë dhe të gjitha përfundojnë. Kurse ai që i ka shpikur, i ka krijuar dhe i ka veçuar me vlera është i Përhershëm, nuk kalon, i Vazhdueshëm nuk ndryshon. Ai në të gjitha kohërat është Një Zot dhe kontrollor e dëshmitar i veprave të robërve. I lartësuar qoftë Allahu i Cili i rrotullon në kohë të ndryshme mes detyrave e shërbimeve, që të lëshon mbi ta dhuntitë më të vlefshme dhe të sillet me ta me bujarinë dhe fisnikërinë kulminante. Pasi që përfunduan tre muajt e ndershëm, që fillojnë me muajin e parë prej muajve të shenjtë (eshhuril-hurum), e përfundojnë me muajin e agjërimit, pas tyre vijojnë tre muajt e haxhit. Nëse ai që agjëron dhe e kalon këtë muaj në namaz i falen mëkatet që i ka bërë më herët, ashtu edhe ai që e kryen haxhin, e nuk fol fjalë të ndyta dhe nuk bën mëkate, kthehet nga haxhi i pastër nga mëkatet sikurse në ditën që e ka lindur nëna. Besimtari çdo moment që e kalon nga jeta e tij, në atë çast ka obligime, detyra,

shërbime dhe adhurime. Muslimani rrotullohet mes këtyre detyrave dhe i afrohet Allahut me to, nën shpresë dhe frikë. (Letaiful-Mearif, fq. 398).

I dashuruari në Allahun, nuk lodhet duke u afruar me vepra vullnetare të Zotit të Tij dhe asgjë tjetër nuk shpreson përveç afërsisë dhe kënaqësisë së Tij.

Çdo kohë që e boshatisë besimtari nga adhurimet ndaj Zotit të tyre, e ka të humbur, çdo orë në të cilën është i shkujdesur nga përmendja e Allahut, në ditën e Kijametit do të bëhet pishman. Vaj për kohën që nuk e kalon në adhurime dhe që nuk kalohet në shërbime ndaj Tij!

Shenjat e pranimit të një veprë

Kush e kryen një adhurim, shenjë e pranimit të tij është ta ndërlidhë me një adhurim tjetër, kurse shenjë e refuzimit është ta pason me mëkat. Sa e mirë është e mira e cila vjen pas të keqes, e cila e shlyen atë. Kurse ma e mirë se kjo është e mira, të cilën e pason një e mirë tjetër. S'ka ma keq se kur ta bëjnë ndonjë të keq pas një veprës së mirë e cila, e shlyen atë të mirë. Një mëkat pas teubes është më i keq se shtatëdhjetë mëkate para pendimit. Recidivi është më i vështirë se vet sëmundja, ndoshta edhe e shkatërron njeriun.

Kërkoni nga Allahu përqendrim në adhurime deri në vdekje, strehohuni tek Allahu nga ndryshimi i zemrave dhe nga lajthitja pas udhëzimit.

Sa i keq është nënçmimi i mëkatit pas krenarisë së respektit edhe më keq se kjo është varfëria e lakmisë pas pasurisë së maturisë.

Mëshironi njeriun krenar të një populli, i cili me mëkate u mposht dhe të pasurin e një populli, i cili me gabime u varfërua.

Djelmoshat e pendimit, mos u ktheni në epshet pas largimit prej tyre. Edhe pse largimi nga epshet kërkon durim në hidhurin e largimit prej tyre, e nëse duroni e kompensoni me ëmbëlsinë e besimit në zemrat e juaja.

Nëse e leni ndonjë gjë për hir të Allahut, Allahu ua kompenson me diç më të mirë se ajo: "...se posa të vërejë Allahu ndonjë të mirë (besim të drejtë e të sinqertë) në zemrat tuaja, Ai ju jep edhe më shumë të mira nga ajo çka është marrë nga ju, ua falë gabimet, se Allahu falë pa masë, se është mëshirues i madh". (E1-Enfal: 70).

Kjo ka të bëjë me djelmoshat, kurse pleqtë nëse u kthehen mëkateve pas Ramazanit, kjo është edhe më keq, sepse ekziston shpresa për kthim dhe pendim te djelmoshat në fund të ymrit të tyre, edhe pse edhe ai është në rezik, ngase vdekja ka mundësi ta befasojë, kurse plaku ka arritur në bregdetin e detit të shpresave, nuk ka çka të shpreson ma shumë?

*Ta vajtojmë hijen e rinisë së thijnur*

*Të ka thirrur në emër të tjetërkujt*

*Bëhu gati për thirrjen e përfundimit*

*Se çdo gjë që vjen është afër*

*A nuk i shohim epshet e shpirtit*

*Harxhohen, kurse neve na mbesin mëkatet*

*Frikohen vetvetes ata që pendohen,*

*E si do të jetë gjendja e atyre që nuk pendohen.*

(Letaiful-Mearif; fq. 400).

## Si të fitojmë sevape e të shlyejmë mëkatet

Kjo është porosia të cilën ia dërgojmë secilit musliman që beson në Allahun dhe nuk i bënë Atij shirk, pasi që prej qëllimeve të muslimanit është që të del nga kjo botë me mëkate të falura, për të cilat nuk do të japë llogari në Ditën e Kijametit dhe të hyjë në xhennet të përhershëm, prej të cilit kurrë nuk do të del.

Në këtë letër do t'i përmendim 60 nga veprat të cilat i shlyejnë mëkatet dhe me të cilat fitohet shpërblim i madh, duke u mbështetur në hadithe të vërteta të Pejgamberit [sal-Allahun alejhi ve sel-lem]. E lusim Allahun [subhanehu ve teala], përveç të Cilit nuk ka hyjni tjetër, që t'i pranojë veprat tona, pasi që Ai është Dëgjues dhe i Ditur. Amin.

1- Teubeja. Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush pendohet para se të del dielli nga perendimi, Allahu ia pranon pendimin e tij”. (Muslimi) dhe thotë: “Allahu e pranon teuben e njeriut përderisa nuk i ka ardhur shpirti në fyt”. (Ahmedi dhe Tirmidhiu; hadithi është hasen).

2- Dalja për të nxënë dituri. Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush ecë rrugës për të kërkuar dituri, Allahu ia lehtëson atij me këtë vepër rrugën për në xhennet”. (Muslimi).

3- Përmendja e Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë: “A t’ju tregojë veprat më të mira, më të pastërta të Mbreti juaj, më së tepërmi që ua ngritë gradat dhe që është më mirë sesa të shpenzosh ari dhe argjend, më e mirë sesa të takoheni me armikun tuaj, ti vritni dhe t’ju vrasin? I thanë: po, gjithsesi. Tha: “Përmendja e Allahut [subhanehu ve teala]”. (Tirmidhiu).

4- Bërja mirë dhe udhëzimi kah e mira. Pejgamberi [sal-Allahun alejhi ve sel-lem] thotë: “Çdo vepër e mirë konsiderohet sadaka, kurse ai që udhëzon kah një e mirë është sikur ai që e bënë atë të mirë”. (Buhariu dhe Muslimi).

5- Vlëra e thirrjes në rrugë të Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush thërret në udhëzim, do të ketë shpërblimin e atij që e pason duke mos iu pakësuar shpërblimi i tyre”. (Muslimi).

6- Urdhërimi në të mirë dhe largimi prej të këqijave. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush prej jush e sheh një të keqe le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mundet, atëherë me gjuhë, e nëse nuk mundet, atëherë me zemër, kurse kjo është shkalla më e dobët e imanit”. (Muslimi).

7- Leximi i Kuranit të madhërishëm. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Lexoni Kuran, se ai do t’ju vjen ndërmjetësues për pronarët e tij në Ditë të Kijametit”. (Muslimi).

8- Mësimi i leximit të Kuranit dhe mësimi i tjerëve ta lexojnë Kuranin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve leximin e Kuranit”. (Buhariu).

9- Dhënia e selamit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni, nuk do të besoni derisa nuk duheni mes vete. A t’ju tregoi një vepër, të cilën po e bëtë do të duheni mes vete, përhapni selamin mes vete”. (Muslimi).

10- Të duash ndokënd për hir të Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Allahu do të thotë në Ditë të Kijametit: ku janë ata që janë dashur për hir Timin, sot do t’i fus nën hijen Time, në këtë ditë që s’ka hije tjetër përveç hijes sime”. (Muslimi).

11- Vizita e të sëmurit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Secili musliman që e ka vizituar një musliman të sëmurë në mëngjes, do ta bekojnë atë shtatëdhjetë mijë melek deri në mbrëmje, e nëse e viziton në mbrëmje, do ta bekojnë shtatëdhjetë mijë melek deri në mëngjes dhe do të ketë në xhennet kopsht të palmave”. (Tirmidhiu; sahih).

12- Tu ndihmohsh njerëzve për larje të borxheve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush ia lehtëson atij që ka vështirësi (të borxhit), Allahu do t’ia lehtësojë në dynja dhe ahiret”. (Muslimi).

13- Tua mbulosh njerëzve të metat. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush ia mbulon të metat një muslimani në dunja, Allahu ia mbulon të metat në ahiret”. (Muslimi).

14- Kujdesi për familjen. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Farefisnija është e varur për Arsh dhe thotë: kush kujdeset për mua, Allahu e ndërlihdh për rahmetin e Tij dhe kush nuk kujdeset për mua, Allahu e këputë nga mëshira e Tij”. (Buhariu dhe Muslimi).

15- Sjellja e mirë. E kanë pyetur Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] : Çka i futë më së shumti njerëzit në xhennet? U përgjigj duke thënë: “Devotshmëria dhe sjellja e mirë”. (Tirmidhiu, hadithi është sahih).

16- Vërtetësia. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Jini të vërtetë, sepse vërtetësia të dërgon në bamirësi, kurse bamirësia të dërgon në xhennet”. (Buhariu dhe Muslimi).

17- Përmbajtja gjatë hidhërimit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush e përmban hidhërimin e Tij edhe pse ka mundësi ta realizojë atë, Ditën e Kijametit Allahu e thërret para krejt njerëzve dhe i jep të zgjedhë cilën hyrie që e dëshiron”. (Tirmidhiu, sahih).

18- Duaja me të cilën shlyhen gabimet e bëra gjatë një ndeje. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush qëndron në një ndejë dhe bënë shumë gabime, kurse para se të ngritet e thotë këtë lutje: subhanekAllahumme ve bihamdike, eshhedu en la ilahe il-la ente, estagfiruke ve etubu ilejke, i falen të gjitha gabimet e bëra në atë mexhlis”. (Tirmidhiu, sahih).



19- Bërja sabër. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Çdo lodhje, sëmundje, brengë, mërzi dhe pengesë që e godet muslimanin, bile edhe një therrë që i hynë, do të jetë shlyerje të gabimeve të tija”. (Buhariu).

20- Bamirësia ndaj prindërve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Vaj për Të, vaj për Të dhe vaj për Të. I thanë: për kë, o Pejgamber i Allahut? Tha: Kush i arrin prindërit e tij në pleqëri ose njërin prej tyre dhe nuk hynë në xhennet”. (Muslimi).

21- Kujdesi për gruan e veje dhe për të varfrin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Ai që kujdeset për një grua të vejë dhe për një të varfër, është në pozitë të muxhahidit në rrugë të Allahut”, mendoj se edhe këtë ia shtojë: “dhe në pozitë të atij që falet pa pushuar dhe agjëron pa ngrënë”. (Buhariu).

22- Kujdesi për jetimin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Unë dhe kujdestari i një jetimit do të jemi në xhennet kështu, dhe tregoi me gishtin tregues dhe të mesëm”. (Buhariu).

23- Marrja e abdestit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush merr abdest mirë, dalin nga trupi i tij të gjitha mëkatet, derisa edhe ato që gjinden nën thonjtë e tij”. (Muslimi).

24- Thënia e dëshmisë pas abdestit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush merr abdest mirë dhe pastaj thotë: eshhedu en la ilahe il-lAllah, vahdehu la sherike lehu, ve eshehdu enne muhammeden anduhu ve resuluhu, Allahummexha’lni minet-tevvabin vexhe’alni minel-mutetahirin, i hapen dyert e xhennetit që të hyjë nga cila derë që dëshiron”. (Muslimi).

25- Përsëritja pas muezinit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush thotë pasi që e dëgjon ezanin: Allahumme rabbe hadhihid-davetit-tammeti ves-salatul-kaimeti, Ati muhammedenil-vasileti vel-fadileti veba’thhu mekamen mahmudenil-ledhi va’dettehu, i lejohet shefati im në Ditë të Kijametit”. (Buhariu).

26- Ndërtimi i xhamive. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush e ndërton një xhami për hir të Allahut, Allahu i ndërton një shtëpi të ngjashme në xhennet”. (Buhariu).

27- Përdorimi i misvakut. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Sikur mos t’i vinte rëndë ummetit tim, do t’i urdhëroja që ta përdorin në çdo namaz”. (Buhariu).

28- Shkuarja në xhami. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush shkon në xhami në mëngjes ose pas dite, atij Allahu i përgatitë vend në xhennet për çdo shkuarje të tij në xhami”. (Buhariu dhe Muslimi).

29- Falja e pesë kohëve të namazit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Secilit musliman që i vjen koha e namazit, kurse ai abdestin e merr mirë, pastaj e fal me frikë-respekt dhe rukunë e bënë mirë, do t’i shlyhen mëkatet që i ka bërë më parë, nëse nuk ka bërë mëkate të mëdha. Kjo i vazhdon gjatë gjithë jetës së tij”. (Muslimi).

30- Namazi i sabahit dhe namazi i iqindisë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush i falë dy namazet e ftohta (sabahun dhe iqindinë), hyn në xhennet”. (Buhariu).

31- Falja e namazit të xhumasë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush merr abdest mirë, pastaj shkon në xhuma dhe dëgjon e heshtë, i falën mëkatet mes kësaj xhumaje dhe tjetrës që vjen, duke ia shtuar edhe tre ditë”. (Muslimi).

32- Qëllimi i orës kur përgjigjen lutjet Ditën e Xhuma. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Ditën e xhuma është një orë, nëse e takon besimtari duke u falur dhe duke kërkuar diç prej Allahut, sigurisht se Allahu do t’ua jep atë që e kërkojnë”. (Buhariu dhe Muslimi).

33- Falja e sunneteve të rregullta me farzet. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Secili musliman që gjatë ditës i falën dymbëdhjetë rekate namaz vullnetar përveç farzit, Allahu i ndërton shtëpi në xhennet”. (Muslimi).

34- Falja e dy rekateve pas bërjes së mëkateve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Secili musliman që bënë mëkat, e pastaj merr abdest mirë dhe ngritet e i fal dy rekate dhe kërkon falje prej Allahut, sigurisht se Allahu do t’ia falë”. (Ebu Davudi, sahih).

35- Namazi i natës. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Namazi më i mirë pas farzit është namazi i natës”. (Muslimi).

36- Namazi i duhasë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Çdo mëngjes për çdo nyje të trupit të njeriut duhet dhënë sadaka, andaj çdo tesbih (subhanAllah) është sadaka, çdo tahmid (el-hamdulilah) është sadaka, çdo tehليل (la ilahe il-lAllah) është sadaka, çdo tekbir (Allahu ekber) është sadaka, urdhërimi në të mirë është sadaka, largimi prej të këqijave është sadaka. Për krejt këtë mjaftojnë dy rekate që i fal njeriu namaz duha”. (Muslimi).

37- Dërgimi salavate mbi Muhammedin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kush dërgon një salavat mbi mua, Allahu dërgon dhjetë salavatë mbi te”. (Muslimi).

38- Agjërimi. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Secili musliman që agjëron një ditë në rrugë të Allahut, për këtë ditë Allahu ia largon fytyrën nga zjarri i xhehenemit shtatëdhjetë vjet”. (Buhariu dhe Muslimi).

39- Agjërimi i tre ditëve nga çdo muaj. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Agjërimi nga tre ditë prej çdo muaj është sikur të agjërosh krejt vitin”. (Buhariu dhe Muslimi).

40- Agjërimi i Ramazanit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe shpresim të shpërblimit, do t’i falen mëkatet që i ka bërë më parë”. (Buhariu dhe Muslimi).

41- Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevvalit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush e agjëron Ramazanin dhe e pason me agjërim të gjashtë ditëve të Shevvalit, do të ketë shpërblim si të kishte agjëruar tërë vitin”. (Muslimi).

42- Agjërimi i ditës së Arafatit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Agjërimi i ditës së Arafatit i shlyen mëkatet e vitit të kaluar dhe të atij që vjen”. (Muslimi).

43- Agjërimi i ditës së Ashurasë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Me agjërimin e ditës së ashurasë shpresoj që Allahu të mi shlyen mëkatet e vitit të kaluar”. (Muslimi).

44- Dhënia iftar agjëruetit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush i jep iftar agjëruetit, fiton shpërblim sikurse ai që ka agjëruar, duke mos iu pakësuar aspak shpërblimi i agjëruetit”. (Tirmidhiu, hadithi është sahih).

45- Namazi gjatë natës së Kadrit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush fal namaz në natën e Kadrit, duke besuar dhe shpresuar shpërblimin, i falen mëkatet që i ka bërë më parë”. (Buhariu dhe Muslimi).

46- Dhënia sadaka. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Sadakaja e fikë gabimin ashtu sikurse uji e fikë zjarrin”. (Tirmidhiu, hadithi është sahih).

47- Haxhi dhe umreja. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Umreja gjer në umren tjetër, i shlyejnë mëkatet mes tyre, kurse haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç hyrjes në xhennet”. (Muslimi).

48- Veprat e mira në dhjetë ditët e Dhul-Hixhes. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Asnjë vepër e mirë nuk është e dashur te Allahu sikurse janë veprat që bëhen në këto dhjetë ditë të Dhul-hixhes”. I thanë: as xhihadi në rrugë të Allahut? Tha: “as xhihadi në rrugë të Allahut, në përjashtim të njeriut i cili ka dalur me shpirtin dhe pasurinë e tij dhe nuk është kthyer me asgjë”. (Buhariu).

49- Xihadi në rrugë të Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Qëndrimi i përgatitur për luftë në rrugë të Allahut një ditë është më i mirë sesa dunjaja dhe çka ka mbi të, kurse një vend në xhennet sa një shkop është më i mirë sesa dunjaja dhe çka ka mbi te”. (Buhariu).

50- Shpenzimi në rrugë të Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush ka përgatitur një luftëtar, është sikurse ai që ka luftuar dhe kush ka lënë një luftëtar në familjen e tij është sikurse ai që ka luftuar”. (Buhariu dhe Muslimi).

51- Falja e namazit të xhenazes dhe përcjellja e xhenazes së tij. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush dëshmon një xhenaze derisa t’i falet namazi, ka shpërblim një kirat, kurse kush e dëshmon një xhenaze derisa të varroset ka shpërblim dy kirata. I thanë: çjanë këto kirata? Tha: sa dy kodra të mëdha”. (Buhariu dhe Muslimi).

52- Ruajtja e gojës dhe organeve. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush mi garanton atë që ka mes dy fëlqive dhe atë që ka mes dy këmbëve, unë i garantoj xhennet”. (Buhariu dhe Muslimi).

53- Vlera e thënjes la ilahe il-IAllah dhe subhanAllahi ve bihamdihi. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush thotë gjatë ditës njëqind herë: la ilahe il-IAllah vahdehu la sherike lehu, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shejin kadir, ka shpërblim sikur të ketë liruar dhjetë robër, i shkruhen njëqind të mira, i fshihen njëqind të këqija dhe i bëhen rroje nga shejtani gjatë tërës ditës deri në mbrëmje. Askush nuk mund të vjen me vepra më të mira se të këtij, përveç atij që ka bërë më shumë vepra se ai”. Dhe thotë: “Kush thotë gjatë ditës njëqind herë subhanAllahi ve bihamdihi, i bijnë mëkatet edhe po që se janë sa shkuma e detit”. (Buhariu dhe Muslimi).

54- Largimi i pengesave nga rruga. Pejgamberi [sal-IAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kam parë një njeri duke u rrotulluar në xhennet, për shkak të një druri që e kishte larguar nga rruga, i cili u pengonte njerëzve”. (Muslimi).

55- Edukimi dhe kujdesi për vajzat. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush i ka tre vajza dhe kujdeset, i strehon dhe i mëshiron, qindpërqind e meriton xhennetin”. (Ahmedi me sened të mirë).

56- Bamirësia ndaj kafshëve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Një njeri ka parë një qen duke ngrënë dhe nga etja. Ai e mori këpucën e tij dhe e mbushi me ujë për t’i dhënë ujë qenit, derisa edhe u ngop. Allahu e falënderoi për këtë dhe e futi në xhennet”. (Buhariu).

57- Largimi prej polemikave sterile. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Unë i garantoj shtëpi në mesin e xhennetit atij që e le polemikën edhe nëse është në të vërtetë”. (Ebu Davudi, hadithi është sahih).

58- Vizita e vëllezërve për hir të Allahut [subhanehu ve teala]. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “A t’ju tregojë kush do të hyjë në xhennet? Thanë: po, o Pejgamber i Allahut. Tha: Pejgamberi është në xhennet, burri i drejtë hynë në xhennet dhe njeriu i cili e viziton vëllain e tij në skaj të vendit, të cilin nuk e ka vizituar për asgjë tjetër përveç se për Allahu, hyn në xhennet”. (Taberaniu, hadithi është hasen).

59- Respekti i gruas ndaj burrit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Nëse gruaja i falë pesë kohërat e namazit, e agjëron muajin e ramazanit, e ruan nderin e saj dhe e respekton burrin e saj, hynë në xhennet nga cila derë e xhennetit që dëshiron”. (Ibn Hibbani, hadithi është sahih).

60- Mos kërko prej njerëzve asgjë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Kush më garanton se nuk do të kërkon asgjë prej njerëzve unë i garantoj hyrje në xhennet”. (katër sunenet, hadithi është sahih).

Allahu na bëftë prej atyre që bëjnë veprat që e dërgojnë në xhennet dhe largohen prej të gjitha veprave që e dërgojnë në xhehenem. Amin.